

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 92-të i botimit
Janar 2024 / Nr. 1



ATDHE, SHTET, SIGURI, MBROJTJE

DREJTOR I QKMBMFA

ARBEN SKËNDERAJ

**Shefe e Sektorit të Botimeve &
Kryeredaktore**

ANJEZA MUSOLLARI

GAZETARË:

MIMOZA GOLIKJA

GRAPHIC DESIGNER

AFËRDITA HYSAJ

REDAKTORË / KORREKTORË

SUELA HODA

BASHKËPUNËTORË

KOLONEL HYSNI GJERGJI

GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

PROF. ASOC. DR. GËZIM MUSTAJ

KOLONEL (R) SALI ONUZI

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Viti i 92-të i botimit

Janar 2024 / Nr. 1

© Ministria e Mbrojtjes

*Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të
riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitim, pa marrë
autorizim nga botuesit e saj.*

Botues:*Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe
Muzeut**Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes***Adresa:***Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"**Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:**[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikimet/
revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikimet/revista-mbrojtja)***Mbrojtja**

- Presidenti Begaj: Me sakrificën, përkushtimin dhe disiplinën e treguar, ju keni lartësuar emrin e Shqipërisë si një anëtare e denjë e Aleancës Veri-Atlantike 4
- Presidenti Begaj: FA, mishërim i vlerave më të mira, partnerë të besueshëm të NATO-s 5
- Nis zbatim i programit, kredi strehimi me zero interes për mjekët, ushtarakët dhe policët 6
- Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, takim virtual me ministrat e 43 vendeve të NATO-s dhe BE-së 8
- Ministri Peleshi: Na bëni krenarë, jo vetëm në mbrojtje e siguri kombëtare, por edhe në eksportin e paqes e sigurisë kolektive 9
- Ministri Peleshi: Krah NATO-s, FA nis 100 ushtarë në Rumani, 22 ushtarakë dhe një anije në detin Egje 10
- Ministri Peleshi: Krenarë për pozicionin tonë në përmbushjen e detyrimeve për paqen dhe sigurinë tonë të përbashkët 11
- Gjeneralmajor Arben Kingji priti ekipin e Komandës së Forcës Tokësore Amerikane në Europë dhe Afrikë (USAEUR-AF) 12
- Ministri Peleshi dhe gjeneralmajor Arben Kingji pritën atashetë ushtarakë të Republikës së Turqisë 13
- Inaugurohet Muzeu i ri i Forcave të Armatosura 15
- Gruaja, Paqja dhe Siguria, sinkroni i ardhmërisë së jetës 16
- Studentët e vitit III Bachelor të AFA-së, trajnohen nga personeli mjekësor i Forcës Tokësore 18
- Certifikohen kursantët e Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit, KTHOSH 20
- Trajnohet personeli i Forcës Ajrore për përdorimin e dronëve TB2 22
- Efektivat e Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë trajnohen për përdorimin e pajisjeve speciale në luftim 27
- Përkujtohet 70 - vjetori i ditës së krijimit të MADM 28
- Përfundoi me sukses stërvitja dimërore "Fekeni-23" 30
- Komanda Mbështetëse, në mbështetje të Emergjencave Civile për hapjen e akseve rrugore të bllokuara në veri të vendit 34
- "Militarizimi i internetit" dhe impakti në politikën e sigurisë 36
- "Forca Rezervë, përtej paranojës së gjithë popullit ushtar" 39
- Kolonel Bardhyl Nuredinaj, drejt sfidave të AFA-së 43
- 'Gra, çfarëdo që bëni ju në jetë krijon diferencë, por jeni ju që duhet të zgjidhni se çfarë lloj diference dëshironi të bëni në botë' 44
- "Njerëzit nuk e kuptojnë se sa të mëdha janë këto 'krijesa' 46
- Përgjigjet alarmuese të chatbot-eve për të ardhmen e AI-së në 2024 48
- "Steadfast Defender 24", nis stërvitja më e madhe e NATO-s në dekada 50
- "Lufta, virus ende pa 'vaksinë', të përpiqemi për ta shëruar botën" 52
- Përjetësisht mirënjohje, veprës tuaj sublime 54
- Pesare Xhezo Kërroça, Këze Shahin Sulçaj, nënat shqiptare që dhanë jetën për atdhe 56
- Udhëtim në memorien e një Kundëradmirali 58
- Komanda Mbështetëse, struktura pararojë e Forcave të Armatosura 62
- Forca Detare, 98 vite histori suksesi në mbrojtje të brigjeve shqiptare 63
- Baza Ajrore Farkë, modernizimi i një strukture, simbol i bashkëpunimit 66
- 103 vite rrugëtim historik i Armës Xheniere 71
- Mitat Kondi, luftëtar partizan, oficer madhor, mbledhës i folklorit 75
- Brigada që shkroi histori ushtarake në LANÇ 78
- Brigada IV Sulmuese, një heroinë 80
- 80 vjet nga nata e 'Shën Bartolomeut' shqiptar 90
- 17 janar, dita e përjetësisë së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti, Skënderbeu 92
- Mundësit ushtarakë të Forcave të Armatosura shqiptare, afër medaljes së bronzit në Botërorin e Azerbajxhanit 98

36

**"Militarizimi i
internetit"
dhe impakti në
politikën e sigurisë**

04

Presidenti Begaj: Me sakrificën, përkushtimin dhe disiplinën e treguar, ju keni lartësuar emrin e Shqipërisë si një anëtare e denjë e Aleancës Veri-Atlantike

06

Nis zbatimi i programit, kredi strehimi me zero interes për mjekët, ushtarakët dhe policët

Ka nisur zbatimi i programit të kredive të favorshme për shtëpi. Familjet e reja të mjekëve, ushtarakëve dhe punonjësve të Policisë së Shtetit mund të përfitojnë nga ky program, ndërsa interesi do të paguhet nga shteti. Ky program do të shtrihet...

24

Ministri Peleshi: Krah NATO-s, FA nis 100 ushtarë në Rumani, 22 ushtarakë dhe një anije në detin Egje

Ministri Peleshi gjithashtu theksoi se: "Vendi ynë është ofruar për të dërguar 100 ushtarë në Rumani për të forcuar krahun lindor të NATO-s. Misioni prej 22 ushtarakësh dhe një anije "Iliria" në misionin e NATO-s në detin Egje. Ne jemi aktivë në KFOR, prezencë më e madhe në Kosovë, jemi në Bullgari me një togë, jemi ofruar për të dërguar më shumë se 100 ushtarakë në Rumani për të forcuar krahun lindor të NATO-s. Bëhen rreth 8 misione, ku marrim pjesë në mënyrë aktive"...



State Sponsored Cyber Warfare



Ministri Peleshi dhe gjeneralmajor Arben Kingji pritën atashetë ushtarakë të Republikës së Turqisë

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji pritën në një takim kortezie kolonel Muhammet Kelami Kablay...

Faqe 13



"Lufta, virus ende pa 'vaksinë', të përpiqemi për ta shëruar botën"

Teksa përpiqemi të bëjmë analiza si qenie humane mbi realitetin e sotëm, mbi atë se çfarë po ndodh në gjithë globin, ku çdo cep i saj 'kundërmon' era barut, ku qiejt 'oshtijnë' prej avionëve 'përbindës' dhe ku rrugët janë 'pikturuar' dhimbshëm prej rrekesh gjaku. Të duket se ky fenomen me termin Luftë, nuk...

Faqe 52



Presidenti Begaj: Me sakrificën, përkushtimin dhe disiplinën e treguar, ju keni lartësuar emrin e Shqipërisë si një anëtare e denjë e Aleancës Veri-Atlantike

Presidenti i Republikës, SH.T. Z. Bajram Begaj, i shoqëruar dhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji, vizituan efektivet e Forcave të Armatosura që shërbejnë në grup-batalionin e NATO-s, të stacionuar në Novo Selo, në kuadër të masave të shtuara të vigjilencës “Enhanced Vigilance Activity”.

Kreu i Shtetit përgëzoi ushtarët, oficerët dhe nënoficerët, që janë pjesë e kësaj strukture për shërbimin e çmuar ndaj vendit.

Presidenti, gjithashtu shprehu mirënjohjen për efektivet që festat e fund-vitit i gjejnë në krye të detyrës.

“Juve, këto festa ju gjejnë larg familjes dhe njerëzve tuaj të dashur, por në krye të detyrës dhe në shërbim të një misioni fisnik në ruajtje të paqes, sigurisë, lirisë dhe prosperitetit”, - iu drejtua Kreu i Shtetit efektiveve të FA-së.

Presidenti e vlerësoi shërbimin e ushtarakëve shqiptarë në misionet e NATO-s, duke theksuar se me sakrificën, përkushtimin, përgjegjshmërinë dhe disiplinën e treguar, ata kanë lartësuar emrin e Shqipërisë si një anëtare e denjë e Aleancës Veri-Atlantike.



Presidenti Begaj: FA, mishërim i vlerave më të mira, partnerë të besueshëm të NATO-s

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, SH.T. z. Bajram Begaj, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura, gjeneral-major Arben Kingji dhe ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Petrit Malaj, me rastin e festave të fund-vitit vizitoi efektivet e Forcave të Armatosura të Shqipërisë që ndodhen në Komandën Rajonale Perëndim, “Camp Villagio Italia” të KFOR-it.

Presidenti Begaj shkëmbeu me ta urimet për vitin e ri 2024. Fillimisht, Presidenti u takua me komandantin e bazës ushtarake, kolonelin Gabriele Vacca. Në këtë takim Presidenti shprehu edhe një herë vlerësimin e tij për KFOR-in, si një histori suksesi.

“Ajo që ju po bëni këtu është shumë e rëndësishme në mbrojtje të vlerave të lirisë dhe ruajtjes së paqes dhe sigurisë në rajon”, - i tha Presidenti komandantit Vacca.

Presidenti falënderoi Italianë që e drejton këtë bazë, duke koordinuar trupat e vendeve të ndryshme, të cilat tashmë kanë krijuar një bashkëpunim shumë të mirë mes tyre. Presidenti nënshkroi Librin e Vizitorëve të Nderit të bazës.

Vizita e Presidentit vijoi me një takim me trupat shqiptare që shërbejnë në bazë, të cilët i falënderoi për shërbimin që kryejnë ndaj atdheut dhe flamurit, si dhe u uroi një vit të ri me shëndet, begati e paqe për ta.

“Ju falënderoj për devotshmërinë, profesionalizmin dhe përgjegjësinë më të cilat kryeni detyrat tuaja. Sot gjendeni larg familjeve tuaja, por të jeni të sigurt se jeni gjithmonë në mendjet dhe zemrat tona”, - iu drejtua presidenti Begaj efektiveve ushtarakë.

Ndër të tjera, Presidenti shtoi: “Si përfaqësues të vendit tonë në misione paqeruajtëse, ju e lartësoni emrin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve kudo që ndodheni. Ju mishëroni vlerat tona më të mira. Falë punës suaj, vendi ynë konsiderohet partner i besueshëm në NATO”.

Në kontekstin aktual të sigurisë botërore, angazhimi juaj përbën një kontribut kritik, vijoi Presidenti.

“Shqipëria do të vijojë të kontribuojë në ruajtjen e paqes dhe



sigurisë në rajon e më gjerë si anëtare e NATO-s. Natyrisht, kjo kërkon rritje të buxhetit të Mbrojtjes dhe mbështetje për Forcat tona të Armatosura, kërkon mbështetje të familjeve për familjet tuaja dhe krijimin e kushteve, që ju të trajtoheni e të përgatiteni sa më mirë. Sot NATO nuk është vetëm një aleancë ushtarake, por edhe roje e vlerave të bashkësisë demokratike në botë, ndaj ne do të vijojmë angazhimin tonë maksimal në mbrojtje të vlerave të qytetërimit perëndimor, në të cilin bëjmë pjesë”, - tha ai.

Më tej, presidenti Begaj vizitoi ekspozitën e pajisjeve ushtarake të batalionit kinetik të bazës. Presidenti iu bashkua efektiveve të kësaj baze dhe drekoi bashkë me ushtarakët shqiptarë.



NIS ZBATIMI I PROGRAMIT,
kredi strehimi me zero interes për
mjekët, ushtarakët dhe policët

Ka nisur zbatimin e programit të kredive të favorshme për shtëpi. Familjet e reja të mjekëve, ushtarakëve dhe punonjësve të Policisë së Shtetit mund të përfitojnë nga ky program, ndërsa interesi do të paguhet nga shteti.

Ky program do të shtrihet edhe vitin tjetër, ku synohet edhe zgjerimi i përfituesve dhe kategorive.

Kryeministri Rama u shpreh se: “Kjo mbështetje që jepet sot për ju, në formën e kredive me zero interes, është shprehje e detyrimit tonë që momentin e mirë ekonomik që po kalon vendi, pasi është përballur me një sërë krizash, ta përkthejmë në më tepër solidaritet dhe një rishpërndarje edhe më të drejtë në funksion të mirëqenies së qytetarëve.

Ky është një program, i aplikuar për herë të parë këtë vit, mundësuar përmes ndryshimeve të posaçme ligjore, administruar online në e-Albania, si një zgjerim i programeve të strehimit, duke mundësuar në bashkëpunim me bankat e nivelit të dytë kredi të lehtësuara, interesi i së cilave subvencionohet tërësisht nga buxheti i shtetit. Në këtë frymë, iniciativën e këtij viti, për të mbështetur me kredi me zero interes 300 punonjës të rendit, mbrojtjes dhe shëndetësisë, do ta shtrijmë edhe në vitin tjetër, me synim për të përmbushur sa të e jetë e mundur nevojat e punonjësve që jetojnë larg vendeve të punës, apo që kanë nevojë për më shumë hapësira për strehim.

Synimi është gjithashtu që vitin tjetër të konsiderohet edhe zgjerimi i përfituesve dhe kategorive nga këto lehtësi.

Siç e dini, kemi alokuar gjithashtu, një fond të posaçëm për rritjen e pagave për vitin e ardhshëm, në mënyrë që të avancojmë me një rritje domethënëse të pagave për sektorin publik, patjetër përfshirë edhe sektorin e rendit, të mbrojtjes dhe të shëndetësisë, me synimin për të ofruar punësim cilësor, një pagë konkurruese edhe në rajon dhe me ambicien për të mos ndaluar këtu, por për të vazhduar më tej drejt një mbështetje më të madhe të shërbyesve publikë.

Me të njëjtën shprehje solidariteti, në aktin normativ që sapo miratuam, ju kemi dhënë mbështetje shtesave në nevojë, si edhe pensionistëve, të cilët morën bonusin e dytë brenda këtij viti, me synimin që gjatë vitit të ardhshëm të angazhohemi në një diskutim të thelluar për reformimin si të skemës së sigurimeve shoqërore, pra të pensioneve, ashtu edhe të shtyllave të



tjera të mbrojtjes sociale për shtresat në nevojë.

I njëjti akt normativ akordoi edhe kompensimin ushqimor për punonjësit e Policisë së Shtetit, pikërisht nën frymën e një trajtimi dinjitoz të atyre që shërbejnë nën uniformën e shtetit shqiptar.

Sepse siç e theksova, është detyrimi ynë që të jemi solidarë, të bëjmë politika sa më të drejta dhe të mbështesim sa të jetë e mundur të gjithë ata që me dinjitet dhe ndershmeri japin shërbimin e tyre në këtë vend. Ky është vetëm fillimi i një rruge të re mbështetjeje afatgjatë për familjet e reja të atyre që i shërbejnë ditë-natë shtetit dhe qytetarëve të Republikës së Shqipërisë”.

Më tej kryeministri Rama në fjalën e tij do shprehej: “Këtu më e mira është e gjitha përpara. Duhet të gjithë ta kuptojnë dhe ta besojnë këtë. Shqipëria, nuk ka asgjë tjetër veçse të shkojë më lart, më lart, më lart. Sepse Shqipëria ka dalë nga rrethi vicioz dhe një hap para, dy hapa mbrapa dhe mjafton të shikoni lekun. Shikojeni lekun sot, se të tjerat mund të merren me dyshim. Shikoni lekun. Lekun nuk e forcojnë as fjalimet e mia, as vendimet e qeverisë as planet e partisë, lekun e

forcon ekonomia, vetvetiu”.


Ndërsa, Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, gjatë ceremonisë për akordimin e kredive të buta për strehim, në fjalën e tij, theksoi se janë pranuar 92 aplikantë dhe kjo do të vazhdojë deri në plotësimin e të gjitha nevojave për strehim të personelit ushtarak.

“Janë pranuar 92 aplikantë. Një në tre aplikantë është përfitues. Kjo do të vazhdojë deri sa të plotësojmë nevojat për strehim të personelit ushtarak. 34 vjeç është moshë mesatare e përfituesve”.

Ai mbështeti kërkesën e ministrit Balla për rritjen e moshës së përfituesve dhe tha që edhe moshë e rekrutimit në Forcat e Armatosura do të rritet nga 27 në 30 vjeç.

“Edhe unë jam dakord me kërkesën e Ministrit të Brendshëm që moshë e përfituesve të rritet nga 40-45 vjeç, se kemi pasur disa të skualifikuar për shkak të moshës dhe çuarja në 45 vjeç do të rrisë numrin e përfituesve nga kjo skemë. Ashtu si pranimi në FA ka një limit në 27 vjeç, me ndryshimet e reja do të shkojë në moshën 30 vjeç”, - u shpreh ministri Peleshi.

Ministri renditi edhe disa nga përfitimet e deritanishme të ushtarakëve, nga rritja e pagës të trajtimit shëndetësor dhe trajnimet për rritjen në karrierë.



“Rritje me 40% të vitit të kaluar të pagave, rritje historike që kanë çuar pagën e tyre në nivelet më të larta në rajon dhe kjo do të vazhdojë deri sa të shkojmë në hapësirën

e vendeve të NATO-s. Trajtim shtesë për vështirësi dhe raste të veçanta. Pagesë papunësie për bashkëshorten kur humbin vendin e punës gjatë transferimit. Fëmijët

nën 18 vjeç u lind e drejta për të përfituar trajtim financiar.

Mjekët e ushtarakët tanë trajtohen me trajtim mjekësor për raste të veçanta si në Turqi, ku ka marrëveshje për të trajtuar 100 ushtarakë në vit. Hapje e një laborator modern mikrobiologjik për të trajtuar falas të gjithë personelin mjekësor pranë Spitalit të Traumës. Fëmijët e ushtarakëve të rënë në krye të detyrës përjashtohen nga pagesa e shkollë, kanë prioritet në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve. Trajtohen me pagesë dhe studentët që në moshën 18 vjeç, jo vetëm që shkollën e kanë falas, por marrin edhe pagën bazë. I gjithë personeli ushtarak, përfutet i kurseve dhe trajnimeve të zhvilluara jashtë vendit për rritjen e tyre në karrierë. Një pagë shtesë si shpërblim i veçantë, të gjithë punonjësve të shërbimit zjarrfikës për përkushtimin dhe angazhimin e jashtëzakonshëm në përballimin e situatës së zjarreve gjatë periudhës së verës. Nga ky vendim i qeverisë përfitojnë 586 efektivë ushtarakë. Ndërsa për 38 efektivët e Forcave të Armatosura të angazhuar në misionin e ndihmës për fqinjët grekë gjatë situatës katastrofike me zjarret, shpërblimi do jetë dy paga mujore’.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, takim virtual me ministrat e 43 vendeve të NATO-s dhe BE-së



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në takimin virtual të ministrave, shefave të Mbrojtjes dhe përfaqësuesve të lartë të 43 vendeve të NATO-s dhe BE-së, nën drejtimin e Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-së, Lloyd J. Austin III. Në fjalën e tij Ministri i Mbrojtjes Peleshi u shpreh se: “Shqipëria i bashkohet zërit të aleatëve, dënojmë me forcë sulmin e Lëvizjes Houthis ndaj anijeve ndërkombëtare në ujërat e Detit të Kuq! Këto sulme janë të papranueshme. Mbështesim lirinë e lundrimit në ujërat ndërkombëtare dhe denoncon çdo akt që kërcënon paqen dhe sigurinë globale”.

Ministri Peleshi: Na bëni krenarë, jo vetëm në mbrojtje e siguri kombëtare, por edhe në eksportin e paqes e sigurisë kolektive

"Urojmë që konfliktet e ndezura të shkojnë drejt shuarjes. Duket se do të jetë një konflikt i gjatë në Ukrainë. Shpresojmë që të ketë një adresim sa më të shpejtë në krahun e së mirës, me fitoren e Ukrainës".

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji, zhvilluan një bisedë online me efektivët shqiptarë, që kontribuojnë në misionet tona jashtë vendit.

Ministri i Mbrojtjes shprehu vlerësimet për këtë pjesë të Forcave të Armatosura që bën krenar të gjithë shqiptarët. "Ju jeni pjesa më e ekspozuar në angazhimet tona ndërkombëtare. Na bëni krenarë, sepse i jepni një dimension tjetër angazhimit tonë, jo vetëm në mbrojtje e siguri kombëtare, por edhe në eksportin e paqes e sigurisë në mbrojtjen kolektive. Kjo na bën jo vetëm përfitues nga anëtarësia në këtë Aleancë të madhe, por edhe kontributorë, ndonëse Shqipëria është një vend i vogël, me kapacitete modeste, por gjithnjë në rritje dhe të modernizuara. Ndaj ne duam ta tregojmë veten dhe të japim kontributin tonë si në operacionet e NATO-s, Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian, Forcat Shumëkombëshe ushtarake, por edhe humanitare dhe Mbrojtjes Civile, siç kemi qenë vitin e fundit në mbështetje të vendeve të rajonit", - u shpreh ministri Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes tha se Shqipëria përfaqësohet në 8 misione jashtë vendit: nga Iraku, Sudani i Jugut, Egjipti, Letonia, Bullgaria, Bosnja dhe Kosova, ku është edhe prezenca më e madhe në dy lokacione.

Z. Peleshi foli për konfliktet që janë shtuar sot në zona të ndryshme të globit, por edhe në rajon. Ndaj ai inkurajoi veçanërisht efek-

tivët që shërbejnë në misionin e KFOR-it në Kosovë, që të kontribuojnë me zell, por edhe me vetëpërmbytje, në mënyrë që të mos bien pre e provokimeve dhe situatave që mund të krijohen.

"Urojmë që konfliktet e ndezura të shkojnë drejt shuarjes. Duket se do të jetë një konflikt i gjatë në Ukrainë. Shpresojmë që të ketë një adresim sa më të shpejtë në krahun e së mirës, me fitoren e Ukrainës.

Urojmë që ky të jetë një vit i mbarë dhe i qetë për Kosovën dhe për rajonin e Ballkanin Perëndimor!", - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Z. Peleshi foli edhe për planet dhe objektivat e mbrojtjes për vitin që vjen. "Pas pak javësh do të fillojë operacionet Baza Taktike Ajrore e Kuçovës, që është një bazë e NATO-s. Po punojmë që të fusim në planet e mbështetjes së NATO-s, me modelin e Kuçovës edhe ndërtimin e një porti pranë portit të ri në Porto Romano, një port ushtarak që do ta bënte vendin me dy infrastruktura të rëndësishme të NATO-s, për stërvitje, mbështetje taktike apo dislokime në rast nevojë, operacionesh drejt krahut lindor të NATO-s. Shqipëria është e vendosur të luajë rolin e saj në rajon, në krahun e Perëndimit. Ne kemi vetëm një agjendë dhe ajo është integrimi euroatlantik", - theksoi ministri Peleshi. Nga ana e tij edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji shprehu vlerësimet maksimale për efektivët që shërbejnë në misionet paqeruajtëse jashtë vendit.





Ministri Peleshi:

Krah NATO-s, FA nis 100 ushtarë në Rumani, 22 ushtarakë dhe një anije në detin Egje

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi pas mbledhjes së Këshillit të Ministrave, për mediat dhe publikun e gjerë, bëri me dije se Shqipëria do të dërgojë 22 ushtarakë dhe një anije “Iliria” në misionin e NATO-s në detin Egje.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi pas mbledhjes së Këshillit të Ministrave, për mediat dhe publikun e gjerë, bëri me dije se Shqipëria do të dërgojë 22 ushtarakë dhe një anije “Iliria” në misionin e NATO-s në detin Egje. Ministri Peleshi gjithashtu theksoi se: “Vendi ynë është ofruar për të dërguar 100 ushtarë në Rumani për të forcuar krahun lindor të NATO-s. Misioni prej 22 ushtarakësh dhe një anije “Iliria” në misionin e NATO-s në detin Egje. Ne jemi aktivë në KFOR, prezenca më e madhe në Kosovë, jemi në Bullgari me një togë, jemi ofruar për të dërguar më shumë se 100 ushtarakë në Rumani për të forcuar krahun lindor të NATO-s. Bëhen rreth 8 misione, ku marrim pjesë në mënyrë aktive”. Po ashtu, ministri Peleshi tha se në mbledhje është rënë dakord që në takimin

e radhës të miratohet ngritja e një Komiteti Shtetëror që do merret me festimet e 80-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë. ‘Nëntori është muaji i 3 festave kombëtare, dua të sjell diskutimin e bërë sot lidhur me 80-vjetorin e çlirimit të vendit tonë. Një faqe shumë e rëndësishme e historisë sonë kur Shqipëria u rreshtua në krahun e duhur të historisë dhe kjo na dha edhe një kredo dhe meritë për të kërkuar të jemi pjesë e projektit të Europës së Bashkuar. E kemi merituar dhe paguar këtë të drejtë historike, merr akoma më shumë kuptim të kremtojmë 80-vjetorin e kësaj faqeje historie. U ra dakord, për ngritjen një e Komiteti Shtetëror për festimet e 80-vjetorit, do festohet në gjithë Shqipërinë. Do ketë një koordinim, nga Ministria përmes një komiteti shtetëror”, - tha ministri Peleshi.

Ministri Peleshi: Krenarë për pozicionin tonë në përmbushjen e detyrimeve për paqen dhe sigurinë tonë të përbashkët

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi zhvilloi një vizitë zyrtare në Zagreb, me ftesë të zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Mbrojtjes të Kroacisë, z. Ivan Anušić. Qëllimi i vizitës është intensifikimi i marrëdhënieve dypalëshe midis dy vendeve, me theks të veçantë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, adresimi i çështjeve aktuale të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë, bashkëpunimi në kuadër të NATO-s dhe iniciativave të tjera rajonale dhe ndërkombëtare.

Z. Peleshi u shpreh se: “Shqipëria dhe Kroacia janë bashkudhëtare në një nga rrugëtimet më të rëndësishme, anëtarësimin në NATO, e që këtë vit dy vendet shënojnë 15-vjetorin në NATO, duke qenë krenarë për pozicionin tonë në përmbushjen e detyrimeve për paqen dhe sigurinë tonë të përbashkët”.

Më tej Ministri shprehu mirënjohjen e tij ndaj Kroacisë, për rolin e saj të rëndësishëm në Ballkan, për mbështetjen e pakushtëzuar që i ofron vendeve të rajonit në të gjitha proceset integruuese euro-atlantike, duke theksuar këtu dhe kontributin e saj për një rajon të sigurt, pa konflikte dhe në paqe.

Ministri Peleshi vlerësoi qasjen e vazhdueshme pozitive të Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë ndaj Kosovës, si një mbështetëse e saj në perspektivën europiane, në anëtarësimin në të gjitha iniciativat rajonale dhe organizatat ndërkombëtare në të cilat Kosova ka kapacitetet për të kontribuar dhe për të luajtur një rol të rëndësishëm.

Ministri Peleshi njohu homologun e tij kroat me angazhimet për vitin 2024, një vit shumë impenjativ për Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë, pasi mirëpret organizimin e disa aktiviteteve të rëndësishme rajonale në vendin tonë, si dhe kryesimin e një prej iniciativave më të rëndësishme



të rajonit siç është SHBA-Karta e Adriatikut (A 5). Gjatë kësaj vizite, dy ministrat e mbrojtjes nënshkruan një Memorandum të ri Bashkëpunimi në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, risia e të cilit lidhet me përditësimin e këtij dokumenti me sfidat e



reja, përfshirjen dhe identifikimin e fushave të reja të bashkëpunimit në lidhje me inovacionin dhe kibernetikën, industrinë e mbrojtjes, trajnimet dhe edukimin dhe shumë fusha të tjera me interes të përbashkët për Forcat tona të Armatosura. Gjatë kësaj vizite, ministri i Mbrojtjes Peleshi u prit në takime të veçanta nga Presidenti i Republikës së Kroacisë, z. Zoran Milanovic dhe kryeministri z. Andrej Plenkovic. Ministri Peleshi i njohu dy krerët e shtetit kroat me zhvillimet e fundit politike në Shqipëri si dhe me reformat e ndërmarra së fundmi në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Edhe në bisedë me Presidentin dhe Kryeministrin, ministri Peleshi shprehu edhe njëherë mirënjohjen për mbështetjen që Kroacia ka ofruar gjithmonë për integrimin e Shqipërisë, por dhe në rolin që ajo luan për sigurinë dhe paqen e Ballkanit Perëndimor.





Gjeneralmajor Arben Kingji priti ekipin e Komandës së Forcës Tokësore Amerikane në Europë dhe Afrikë (USAEUR-AF)

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji, priti në një takim kortezie ekipin e Komandës së Forcës Tokësore Amerikane në Europë dhe Afrikë (USAEUR-AF), të kryesuar nga krye nënoficeri i Komandës, kryekapter Jeremiah E. Inman.

Gjeneralmajor Kingji, pasi adresoi një falënderim për mbështetjen e deritanishme, që Komanda e Forcës Tokësore Amerikane në Europë dhe Afrikë (USAEUR-AF) ka dhënë në rritjen e aftësive dhe kapaciteteve profesionale dhe operacionale të FARSH, shprehu gatishmërinë për rritjen e rolit të Nënoficerit brenda strukturave të FARSH.

“Organizimi i Konferencës kryesore Planëzuese të “CEANCO 24”, në Shqipëri, nga ana e Komandës Amerikane për Europën, është një tregues i bashkëpunimit të shkëlqyer mes dy ushtrive tona...”, - u shpreh ndër të tjera SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji.

Nga ana e tij kryekapter Jeremiah E. Inman, falënderoi SHSHPFA për mikpritjen dhe masat e marra për mbarëvajtjen e kësaj konference, e cila do të zhvillohet në vendin tonë në datat 06-10 maj 2024, në kuadër të bashkëpunimit të Forcës Tokësore dhe USAREU&AF.

Gjeneralmajor Arben Kingji priti komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutas

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji priti në një takim zyrtar komandantin e ri të KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutas.

Në takimin e zhvilluar mes dy delegacioneve, gjeneralmajor Kingji, pasi i uroi suksese në detyrën e re, vlerësoi me nota maksimale angazhimin dhe rëndësinë e misionit KFOR, në ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe sigurisë në Kosovë dhe rajon: “Shqipëria do të vijojë të japë kontributin dhe mbështetjen e saj ushtarake në misionin e NATO-s, KFOR. Ne do jemi gjithmonë pro alternativave për gjetjen e zgjidhjeve që në thelb kanë mbrojtjen e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së Kosovës dhe mbetemi mbështetësja më e fortë e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë. Gjithashtu, mbështesim dialogun Kosovë - Serbi, si një ndër hapat më të rëndësishëm që do i hapë rrugë zgjidhjeve të mëtejshme të problematikave në funksion të integritetit në strukturat ndërkombëtare”.

Gjeneralmajor Ulutas nga ana e tij u shpreh se: “Shqipëria me kontributin e saj politik dhe ushtarak vijon të jetë një nga mbështetëset kryesore të misionit të NATO-s, KFOR dhe pro dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, dialog ky që do t'i hapë rrugë zgjidhjeve të problematikave në funksion të integritetit në strukturat ndërkombëtare si dhe në shërbim të paqes dhe sigurisë në rajon dhe më gjerë.”

Në përfundim të takimit zyrtar, të dy autoritetet reciprokisht falënderuan përkushtimin dhe bashkëpunimin e frytshëm në ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në rajon.

Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutas, gjatë vizitës së tij në vendin tonë u prit në takim zyrtar edhe nga presidenti i RSH, sh.t. z. Bajram Begaj dhe ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi.



Ministri Peleshi dhe gjeneralmajor Arben Kingji pritën atashetë ushtarakë të Republikës së Turqisë

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji pritën në një takim kortezie kolonel Muhammet Kelami Kablay, me rastin e përfundimit të detyrës si atashe ushtarak i Republikës së Turqisë, i akredituar në vendin tonë, si dhe kolonelin Tolga Kip, i sapo emëruar në këtë detyrë.

Gjatë takimit gjeneralmajor Arben Kingji vlerësoi përpjekjet dhe punën e kolonel Kablay-it, për rritjen e bashkëpunimit mes dy vendeve në fushën e mbrojtjes, gjatë kohës së qëndrimit në detyrë.

Gjithashtu gjeneralmajor Arben Kingji i uroi suksese në detyrën e sapo marrë kolonel Kablay-it, duke e garantuar për gatishmërinë e FARSH-së në thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve e veçanërisht në fushën e arsimit ushtarak, në modernizimin e FARSH-së, ku asistenca turke ka qenë domethënëse në rritjen e kapaciteteve të emergjencave civile si dhe në modernizimin me pajisje luftarake të ndërveprueshme të reparteve të deklaruar në NATO.

Nga ana e tij kolonel Kablay, pasi shprehu kënaqësinë dhe mbresat gjatë qëndrimit si atashe ushtarak në Shqipëri, falënderoi gjeneralmajor Arben Kingjin për mbështetjen e dhënë në kryerjen e detyrës.

Kolonel Tolga Kip, në cilësinë e marrësit të detyrës, siguroi gjeneralmajor Kingjin për vijimin dhe thellimin e bashkëpunimit në fushën ushtarake mes dy vendeve.

Në përfundim të takimit, gjeneralmajor Arben Kingji i uroi kolonel Kablay-it suksese të mëtejshme në karrierën ushtarake.

Atasheu ushtarak turk Muhamet Kemali Kablay u nderua nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi me Certifikatë Mirënjohjeje në shenjë falënderimi për kontributin e tij.





SHSHPF gjeneralmajor Kingji, vizitë zyrtare në Maqedoninë e Veriut

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjeneralmajor Arben Kingji, realizoi një vizitë zyrtare në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku u takua me Shtatmadhorinë e Armatës.

Pas ceremonisë së pritjes me nderime ushtarake, gjeneral Kingji u takua me shefin e Shtatmadhorisë, gjeneral-nënkolonelin Vasko Gjurchinovski dhe me ministren e Mbrojtjes, Sllavajka Petrovska.

Përveç bashkëpunimit ushtarak dypalësh, temë e bisedimeve zyrtare ishin edhe aktivitetet dhe operacionet e NATO-s në të cilat marrin pjesë dy vendet, si dhe kapacitetet dhe mundësitë për kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta stërvitore.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së së Shqipërisë, më pas u prit dhe nga presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe komandanti suprem i Forcave Ushtarake, Stevo Pendarovski.

Delegacioni i ushtrisë shqiptare vizitoi dhe Komandën për Operacione, si dhe mori pjesë në koncertin e përbashkët para Vitit të Ri të orkestrave ushtarake të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Republikës së Shqipërisë, Republikës së Sllovenisë dhe Republikës së Kroacisë.

Në Kazermën “Kuzman Josifovski Pitu” në Tetovë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjeneralmajor Kingji u njoh me disa nga aktivitetet e batalionit të tretë të Brigadës së Parë të Këmbëtorisë.



Gjeneralmajore Manushaqe Shehu priti atasheun ushtarak holandez, nënkolonelin Jurgen Fleischmann

Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajore Manushaqe Shehu, priti në një takim atasheun e ushtarak të Mbretërisë së Holandës në vendin tonë, (rezident në Maqedoninë e Veriut), nënkolonel Jurgen Fleischmann. Në takim ishte i pranishëm gjithashtu edhe drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, kolonel Aleksandër Pando.

Gjenerale Shehu, pasi i uroi mirëseardhjen edhe në emër të SHSHPFA gjeneralmajor Kingjit, vlerësoi bashkëpunimin ushtarak midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, përkatësish në fushën e edukimit, trajnimit dhe stërvitjeve, ndihmën e dhënë për Akademinë e Nënoficerëve, mbështetjen gjatë emergjencës së zjarreve në 2021, etj., si dhe një sërë kursesh për personelin e FA-së të ofruara për vitin 2024.

Në vijim gjenerale Shehu shprehu gatishmërinë e FA-së për të përmirësuar bashkëpunimin dypalësh edhe në fusha të tjera, si: trajnim i personelit të Forcës Detare (Roja Bregdetare); trajnim në fushën kibernetike; mbështetje në fushën mjekësore; asistencë CBRN dhe EOD, etj. Nga ana e tij, nënkolonel Jurgen Fleischmann, pasi e falënderoi për pritjen e ngrohtë dhe tepër miqësore dhe vlerësoi bashkëpunimin e mirë që ekziston midis dy vendeve dhe në veçanti bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, u shpreh se do të punojë për forcimin dhe rritjen e mëtejshme të këtij bashkëpunimi ushtarak midis dy vendeve, si në fushën e trajnimit, operacioneve, të arsimit dhe në fusha të tjera të nevojshme për Forcat e Armatosura. Të dy bashkëbiseduesit ndanë pikëpamje të njëjta për situatën e sigurisë në Evropë e më gjerë, si dhe shprehën bindjen se, bashkëpunimi ushtarak Shqipëri-Holandë është i rëndësishëm, jo vetëm në kuadër të bashkëpunimit dy palësh, por edhe si dy vende anëtare të NATO-s dhe do të njohë gjithmonë rritje në interes të përbashkët.



Inaugurohet Muzeu i ri i Forcave të Armatosura

Muzeu i Forcave të Armatosura, tashmë me godinë të re, e cila ndodhet në një nga zonat më piktoreske pranë Tiranës, në Bërzhitë, do të sjellë për të apasionuarit e artit dhe historisë ushtarake, vlerat e papërsëritshme të kontributit të burrave dhe grave në uniformën ushtarake si dhe armatimet luftarake të ardhura në shekuj si një trashëgimi e vyer e kombit shqiptar.

Në ceremoninë e inaugurimit të hapësirave të reja morën pjesë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Igli Hasani, ministrja për Rininë Bora Muzhaqi, ish-ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, deputetë të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, zëvendësshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu si dhe komandantë të forcave të ndryshme.

Të pranishmit u njohën me hapësirat e reja të muzeut, i cili është i ndarë në 5 pavijone, në të cilat janë të ekspozuara objekte, informacione për historinë ushtarake, ilustrime me harta dhe foto, që nga ilirët e deri në ditët e sotme.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u foli të pranishmëve për funksionet e këtij muzeu, jo vetëm si qendër për vizitorët e shumtë, nxënës të shkollave, apo edhe turistët e huaj, por edhe si qendër aktivitetesh të ndryshme.

Në pavijonin e parë janë të ekspozuara rreth 110 objekte që prezantojnë momentet më të rëndësishme të historisë së Shqipërisë, si Epoka e Skënderbeut, Pashallëqet, Lidhja e Prizrenit, Pavarësia dhe Lufta e Dytë Botërore.



Gruaja, Paqja dhe Siguria, sinkroni i ardhmërisë së jetës



GJENERALMAJOR **MANUSHAQE SHEHU**
ZV/SHEFI I SHPPFA-së

Në kuadër të zbatimit të “Planit të Veprimit të Barazisë Gjimore në FA 2022-2030”, miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 651, datë 06.05.2022 dhe VKM-së nr. 400, datë 30.6.2021 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjimore, 2021–2030 dhe të planit të saj të veprimit”, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu zhvilloi një takim me gratë dhe vajzat ushtarake e civile të Qendrës së Personel rekrutimit në FA.

Në fjalën e saj, gjeneralmajor Manushaqe Shehu u shpreh se ishte e privilegjuar që në cilësinë e zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, por edhe si femër, si grua, si motër dhe si nënë, të zhvillonte këtë takim, ku të pranishmet ndanë mendimet, ndjesitë dhe konceptet e tyre për rolin e femrës në FA, e në veçanti në Qendrën e Personel Rekrutimit, si institucioni i administrimit të të gjithë dokumenteve të oficerëve aktiv, në rezervë e pension dhe të civilëve në FA.

Më tej në fjalën e saj gjeneralmajor Shehu do theksoi se “qëllimi i këtij takimi ishte për të folur me njëra-tjetrën, për të sotmen dhe sfidat e së ardhmes, në raport me aktivitetin e përditshëm, të prindëruarit e njerëzve në uniformën ushtarake, njëkohësisht për t’u njohur më shumë me Rezolutën 1325 të Këshillit të Kombeve të Bashkuara mbi “Gruan, Paqen dhe Sigurinë” dhe të gjitha dokumentet e tjera të dalë për këtë qëllim.

Gjeneralmajor Shehu në fjalën e saj u shpreh: “Femra shqiptare, aq më tepër femrat ushtarake, por edhe ato civile që punojnë në Forcat e Armatosura, janë një forcë e vlerësuar në tërë jetën politike, ekonomike, arsimore, ushtarake e në shumë fusha të rëndësishme të jetës së vendit.

Shembujt e femrave që kanë bërë dhe bëjnë karrierë të suksesshme dhe mjaft të vlerësuar e të spikatur në jetën e

vendit ka me qindra, ashtu siç ka edhe mjaft femra ushtarake po me karrierë të suksesshme, në çdo pozicion që i është dhënë mundësia të kontribuojë në zhvillimin e Forcave të Armatosura. Femra të tilla ushtarake patjetër që ka edhe këtu midis Jush.

Gjej rastin t’ju falënderojë secilën femër të kësaj qendre në veçanti për kontributin e dhënë dhe që vijoni të jepni. Ju sot përballeni me një realitet tjetër në drejtim të punës me dosjet e ushtarakut, sepse falë teknologjisë, por edhe përkushtimit Tuaj, përgjigjet qytetarët i marrin shumë shpejt online. Një mundësi e tillë lehtëson ish-ushtarakët dhe qytetarët në përgjithësi, por rrit përgjegjësin tuaj si specialistë.

Sot femrat ushtarake i gjen në fushat e poligonet e stërvitjes, në mbështetjen e furnizimit e reparteve, i gjen pranë anijeve luftarake e pranë mjeteve ajrore (ku tani kemi edhe piloten e parë femër), i gjen në patrullim në detyrat policore, në kryerjen e shërbimit të rojës, në auditorët e Akademisë së Forcave të Armatosura, në



Shtabin e Përgjithshëm dhe në shtabet e Komandave të Forcave, e kudo tjetër ku është nevoja dhe ku e kërkon funksioni organik, siç jeni edhe ju në këtë institucion shumë të rëndësishëm të FA-së, duke mos neglizhuar për asnjë çast e moment nga kryerja e detyrave.

Ato i gjen, jo vetëm nëntogere, togere, kapitene e majore, por edhe me grada të larta si nënkolonele e kolonele e deri gjeneralmajore. Ato i gjen komandante strukturash të ndryshme ushtarake, pedagoge, me grada shkencore, atashe ushtarake etj.

Nga të dhënat që kam marrë, ju si qendër keni 69 femra ushtarake



dhe 47 femra civile, parë kjo në raport me numrin e përgjithshëm të personelit prej 132 vetash, zini 87 %, një shifër kjo shumë mbi mesataren si FA, prej afërsisht 15.01%, por parë nga natyra e punës që ju bëni, kjo shifër është plotësisht e justifikuar.

Ju sot keni 4 femra të nderuara nënkolonele, 7 majore, 7 kapitene, 4 togore dhe 5 nëntogore. Po kështu keni 1 kryekapitene, 4 kapitene, 13 rreshtere, 2 tetare dhe 4 nëntetare.

Pra siç shihet nga shifrat, ju i keni pothuajse të gjitha gradat. Sot duke qenë pranë Jush, dua t'ju përgëzoj të gjithave për përkushtimin, sakrificat dhe përgjegjësitë që merrni përsipër, përkrah edhe kolegëve tuaj meshkuj.

Në veçanti unë dua të përgëzoj ato femra që kanë marrë pjesë në promovimin e figurës së ushtarakut që është bërë në disa qytete e shkolla civile të vendit.

Unë si Manushaqe edhe në detyrat e mëparshme që kam kryer, kam ndjekur në vazhdimësi problemin e zbatimit të rezolutës 1325 në FA. Për këtë kam marrë pjesë në shumë aktivitete brenda e jashtë vendit, ku kam ngritur me forcë zërin që sot femrës ushtarake në FA t'i jepet me dinjitet vendi dhe roli që i takon, ku mund të përmend takimin e fundit, më 22-23 tetor 2022, në Prishtinë, ku me iniciativë të presidentes së Republikës së Kosovës, u zhvillua

Forumi Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Në këto takime në fjalën time veç të tjerash kam dhënë përvojën e Forcave të Armatosura shqiptare në zbatimin e Barazisë Gjinore, ku rreth 15.1% e personelit ushtarak janë femra. Ju tashmë jeni të njohura me Rezolutën 1325 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara: "Gruaja, Paqja dhe Siguria", Planin Kombëtar dhe Planin e Ministrisë së Mbrojtjes në zbatim të kësaj rezolute. Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes unë kam qenë në krye të një grupi pune që ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rezolutës, ku pjesë e këtij grupi mund të ketë qenë edhe dikush prej jush që ndodheni sot në këtë takim. Sa për dijeni ish-ministrat e Mbrojtjes, zonja Kodheli e zonja Xhaçka dhe aktualisht zoti Niko Peleshi kanë qenë dhe janë mbështetës kryesorë të këtij procesi.

Gjithashtu dua të theksoj edhe mbështetjen që jep në këtë drejtim shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, i cili ka qenë dhe është mbështetës i çdo takimi që ka të bëjë me rritjen e rolit të femrës ushtarake në FA".

Në fund gjeneralmajor Shehu falënderoi komandantin e kësaj qendre, kolonel Fadil Cirokun, për gatishmërinë e treguar për zhvillimin e këtij takimi..



Studentët e vitit III Bachelor të AFA-së, trajnohen nga personeli mjekësor i Forcës Tokësore

Studentët e vitit të tretë të kursit Bachelor të AFA-së, zhvilluan në mjediset e Forcës Tokësore, nga mjekët e FT-së dhe Batalionit të Mbështetjes të Shtabit të Përgjithshëm, trajnimin mjekësor “Programi i trajnimit Mbështetje Mjekësore”, i cili konsistonte në 20 orë teorike dhe 10 orë praktikë.

Gjatë orëve teorike, të cilat u zhvilluan në mjediset e Shkollës së Trupës të Forcës Tokësore, u zhvilluan temat: organizimi shëndetësor, dhënia e ndihmës së parë të dëmtuarve, tema të psikologjisë dhe menaxhimit të stresit post-traumatik etj.

Praktika mësimore u zhvillua në mjediset e Regjimentit të operacioneve Speciale. Në orët taktike instruktorët synuan në instruktimin e studentëve në dhënien e



ndihmës së parë në fushëbetejë, tërheqjen e të dëmtuarve nga fusha e luftimit, organizimi i pikës të grumbullimit të të dëmtuarve, 9 linjat MEDEVAC dhe evakuimi i të

dëmtuarve. Temat mësimore u përvetësuan nga studentët e kursit të tretë Bachelor, gjë që u pasqyrua dhe në rezultatet e provimit përfundimtar.

Kursantët e kursit të 11-të të Kryekapërit në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve (QAPN), zhvilluan vizitë njohëse dyditore në shkollën e Nënoficerëve, si dhe në Gardën Kombëtare të Kosovës. Qëllimi i këtij takimi ishte njohja me këtë komandë, konkretisht me shkollën e Nënoficerëve, ekuivalente me QAPN-në. Kjo vizitë drejtohej nga Komandanti i QAPN-së, kolonel Besim Bala. Ata morën takim me komandantin e Komandës, gjeneral Jeton Dreshaj, shefi i Shtabit të KDS-së, kolonel Nevzat Asllani, si dhe komandanti i Shkollës së Nënoficerëve, rreshter Major Komandues, Genc Metaj. Gjatë kësaj vizite u shkëmbyen mendime dhe ide mbi mundësitë e shumta në fushën e bashkëpunimit midis trupave të Nënoficerëve të FSK-së dhe FA-së. Shkëmbimi i kurikulave dhe programeve të kurseve ekuivalente ishte një nga hapat kryesorë për të ndihmuar procesin e standardizimit në nivel strategjik dhe operacional.

Në fjalën e tij, kolonel Bala theksoi: “Binjakëzimi i shkollës Tuaj dhe i Qendrës së Arsimit Profesional të Nënoficerëve duhet të jetë një proces ku çdo e re, e cila ndikon në fushën e sigurisë dhe



mbrojtjes, të përditësohet në kohë tek të dyja institucionet. Kursi i Kryekapërit dhe stafi mësimdhënës ndoqën nga afër dhe disa aspekte nga stërvitja e kurseve mësimore të shkollës së Nënoficerëve. Në ditën e dytë kursit i Kryekapërit, pasi mori takim me Komandantin e Gardës Kombëtare të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri u njoh me strukturën e saj dhe planin e tyre të bashkëpunimit në kuadër të Emergjencave Civile. Në ku-



jtimit të heroit të kombit Adem Jashari, efektiv i këtij kursi u ndal në Prekaz, ku u njoh me të gjithë historinë dhe vendngjarjen e betejës së familjes Jashari.

AFA promovon projektet në fushën e mësimdhënies dhe mendimit shkencor

Akademia e Forcave të Armatosura, në mbështetje të projekteve në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor realizoi ceremoninë e promovimit të pesë teksteve mësimore: “Historia Ushtarake”, “Koncepte mbi Sigurinë dhe Strategjinë”, “Hyrje në Udhëheqje Ushtarake”, “E drejta në Forcat e Armatosura” dhe “Kultura e Organizatës”.

Në ceremoni morën pjesë zëvendëskomandanti i AFA-së, kolonel Bardhyl Nuredinaj, personeli akademik i FMS-së si dhe autorët e publikimeve.

Të pranishmëve në këtë ceremoni iu prezantua një briefing, nga zëvendësdekani, kolonel (R) dr. Ahmet Leka, ku shkurtimisht për secilin tekst, u trajtuan qëllimi, rëndësia në mbështetje të programeve, fokusi, tematika e trajtuar etj.

Gjatë promovimit u evidentua fakti se procesi i transformimit të kurrikulave dhe programeve mësimore, kërkon jo vetëm njohje të tyre, por edhe pranimin e ushtrimitin e përparësive që e shoqërojnë atë, ndaj në të ardhmen angazhimi i parësor i fakultetit dhe departamenteve mbetet çuarja përpara e këtyre publikimeve të rëndësishme, por dhe atyre që do të përgatiten më pranë studentit dhe auditorëve në sistemin tonë arsimor ushtarak. Krahas botimeve të brendshme dhe blerjeve të librave, u theksua rëndësia që merr zhvillimi i bibliotekave elektronike për të shkuar me tej në projektin e dixhitalizimit



të librit.

Gjatë ceremonisë, secili nga autorët foli rreth rëndësisë që ka teksti mësimor në përmbushjen me sukses të programit dhe interesave studentore.

Kolonel Bardhyl Nuredinaj, zëvendëskomandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, në fjalimin e tij mes tjerash tha: “Këto publikime janë rezultat i bashkëpunimit të ngushtë në AFA, duke shprehur njëherazi falënderim të veçantë për FMS dhe veçanërisht për autorët e këtyre publikimeve”. Më tej vijoi se në kuadër të

projektit për reformën e sistemit arsimor do vazhdojë edhe më tutje të mbështetjes dhe përkrahës ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve kërkimore e shkencore të Akademisë Forcave të Armatosura.

Në përfundim kolonel Nuredinaj theksoi në fjalën e tij se, Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, në vijimësi do të punojë për transformimit të sistemit tonë arsimor dhe zhvillimin e mendimit teorik e shkencor për përdorimin me sa me shumë efektivitet të burimeve, mbështetur në filozofinë dhe metodologjinë e re të kërkuar.

Garda Kombëtare e New Jersey-t, vizitë në QAPN

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Gardës Kombëtare të New Jersey-t dhe Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, AFA, një ekip ushtarakësh oficerë dhe nënoficerë vizituan QAPN-në. Fokusi kryesor i këtij takimi ishte krijimi i asistencës dhe mbështetjes së trupës së nënoficerëve të QAPN-së, si dhe planifikimi në vijim i aktivitetit për vitin 2024-2025.





Certifikohen kursantët e Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit, KTHOSH

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë organizoi ceremoninë e certifikimit të kursantëve të Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit (KTHOSH). Në këtë aktivitet morën pjesë zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandantë forcash dhe njësi autonome të FA, drejtorë të Shtabit të Përgjithshëm, staf pedagogjik, mbështetës dhe familjarë.

Ceremonia u hap me fjalën e rastit të komandantit të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj, i cili ndër të tjera citoi se: "I bindur se me përvojën e pedagogëve, kurrikulën, infrastrukturën e kolegjit, ju keni marrë njohuritë e duhura për të qenë oficerë kandidatë për gradën "major", të aftë për të shërbyer në pozicione të ndryshme të reparteve dhe shtabeve në nivel batalioni brenda dhe jashtë vendit. Në këtë kurs morën pjesë dhe përfaqësues, oficerë nga Forca e Sigurisë së Kosovës, të cilët i falënderoj sërish që zgjodhën kolegjin për vijimin e studimeve të tyre. Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë do të mirëpresë ushtarakët nga Forca e Sigurisë së Kosovës dhe do të rrisë bashkëpunimin me të gjitha institucionet arsimore të FSK-së, jo vetëm me kursantë, por edhe me shkëmbime lektorësh".

Në emër të kursantëve përshëndeti kapiten Eduart Kumaraku, i cili falënderoi trupën pedagogjike për përkushtimin dhe uroi kolegët për mbarimin me sukses të kursit.

Në vijim, përshëndeti zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e cila u shpreh se: "Kursi që ju sot certifikoheni, sikurse shprehet edhe në emërtimin e tij, ndërton bazat dhe themelet e zhvillimit të oficerëve të rinj, që do të jenë komandantët dhe liderët e së nesërme. Kjo është shumë e rëndësishme për forcën ushtarake të dy vendeve tona. Ju përbëni bazat kryesore të oficerëve të FA-së dhe FSK-së dhe sa më të forta dhe të konsoliduara të jenë dhe të zhvillohen këto baza, aq më të forta dhe të afta do të jenë forcat tona. Tani ne presim nga ju që të reflektoni rritjen tuaj profesionale në përmirësimin dhe ndryshimin pozitiv të situatës në strukturat dhe detyrat që kryeni ose mund të kryeni në nivele paralele apo më të larta. Kjo është normale dhe e pritshme, sepse



tani ju jeni në gjendje të kuptoni më mirë mënyrën se si funksionon dhe kryen detyrat një shtab, si punohet dhe menaxhohet puna në grup, por edhe si mund të jeni edhe profesionistë të aftë dhe dinjtoz në shtabe, struktura dhe ambiente të punës së Aleancës apo shumëkombëshe".

Në këtë kurs morën pjesë oficerë nga Forcat e Armatosura Shqiptare dhe nga Forca e Sigurisë së Kosovës.

Ceremonia u mbyll me fotografi të përbashkët dhe shpërndarjen e certifikatave.



Gjeneral brigade Ylli Pulaj priti atasheun ushtarak të Republikës së Kosovës, kolonel Enver Hoti

Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj priti në një takim kortezie atasheun ushtarak të Republikës së Kosovës, kolonel Enver Hoti.

Gjatë takimit u diskutua mbi bashkëpunimin shumë të mirë mes vendeve për zhvillimin e kurseve institucionale nga oficerët e Forcës së Sigurisë së Kosovës pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.



Përfundon trajnimi i Policisë Ushtarake me Karabinierinë Italiane



*Bashkëpunimi i shkëlqyer
mes Shqipërisë dhe Italisë
në fushën e mbrojtjes
u përmbyll këtë vit me
trajnimin e efektivëve të
Policisë sonë Ushtarake
nga karabinierët italianë,
në shpërndarjen e turmave
dhe ruajtjen e rendit publik.*





Trajnohet personeli i Forcës Ajrore për përdorimin e dronëve TB2

Pas përfundimit me sukses të fazës së përgatitjes teorike, efektivet kanë filluar trajnimin praktik për përdorimin operacional dhe mirëmbajtjen e mjeteve ajrore pa pilot, me të cilët Shqipëria do të pajiset shumë shpejt.

Oficerë dhe nënoficerë nga Forcat tona të Armatosura, aktualisht po ndjekin kurse intensive në Turqi për specialitetet pilot-UAV, elektronik-UAV dhe mekanik-UAV, për të bërë të mundur aftësimin profesional për çdo aspekt të operimit të kësaj teknologjie të përparuar.

Forcat Ajrore janë të angazhuara që efektivet të pajisen me kompetencën e nevojshme për të operuar këta dronë të pararojës teknologjike në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare.



Pjesëmarrja e komandantit të Forcës Ajrore në takimin e Komitetit të Aviacionit

Gjeneral brigade Ferdinant Dimo mori pjesë në takimin e Komitetit të Aviacionit të mbajtur në selinë e NATO-s në Bruksel, Belgjikë. Në këtë takim të rëndësishëm, ku merrnin pjesë komandantët e Forcave Ajrore aleate dhe krerët e autoriteteve të aviacionit civil, u diskutua për lirinë e fluturimit dhe dekonfliktimin e hapësirës ajrore në zonën operationale të SACEUR në mbështetje të masave parandaluese dhe mbrojtëse të NATO-s.

Vendi ynë është në mesin e vendeve



firmëtare të letrës së qëllimit (Letter of Intent) që i hap rrugë Forcave Ajrore të NATO-s të shfrytëzojnë hapësirën ajrore të vendit tonë gjatë stërvitjeve apo situatave reale.

Hapi tjetër është firmosja e letrës së marrëveshjes në samitin e radhës në Uashington DC, SHBA. Ky proces do të lehtësojë trajnimet e Forcës tonë Ajrore me aleatët dhe vendet partnere, do të rrisë qëndrueshmërinë si dhe do të shmangë procedurat e panevojshme shkresore gjatë situatave të ndryshme.

Anija “Butrinti P-134” dhe efektivi, pjesëmarrës në operacionin “Sea Guardian” në detin Egje, kthehen në atdhe

Anija “Butrinti P-134” dhe efektivi, pjesëmarrës në operacionin “Sea Guardian” në detin Egje, kthehen në atdhe. Kontingjenti II, gjatë qëndrimit në mision kreu disa operacione, duke identifikuar dhe shpëtuar një numër të lartë emigrantësh. Gjatë kohës në mision u zhvilluan disa stërvitje ushtarake me anijet e vendeve aleate në ujërat ndërkombëtare.

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra shprehu mirënjohje për përkushtimin e treguar gjatë kohës së qëndrimit në zonën e operacionit dhe përmbushjen me sukses të misionit. Të gjitha strukturat e Aleancës dhe vendet aleate kanë vlerësuar maksimalisht pjesëmarrjen, përkushtimin dhe profesionalizmin e personelit të Forcës Detare në këtë mision. Roli i efektivëve dhe anijes



shqiptare në këtë operacion është raporti i trafikut të emigrantëve në zonën operacionale dhe ndërhyrja duke ofruar ndihmë në rastet kur konstatohet se jetët njerëzore janë në rrezik, si dhe detyrë shtesë nga NATO: monitorimi dhe identifikimi i anijeve ruse në rajon.

Anija “Trenton TEPF5” viziton portin e Durrësit

Anija e Forcave Detare të Shteteve të Bashkuara “Trenton TEPF5” mbërrin në Durrës për një vizitë të planifikuar në port. Vizita e kësaj anijeje në vendin tonë nxjerr në pah fuqinë e partneritetit mes Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë në fushën e mbrojtjes.



Anija turke “TCG KINALIADA”, vizitë në Portin e Durrësit

Anija turke “TCG Kinaliada” (F - 514) realizoi një vizitë portuale disaditore në Portin e Durrësit. Gjatë qëndrimit të saj u zhvillua edhe një ditë e hapur për publikun.

Në bordin e anijes u zhvillua një pritje zyrtare, në të cilën ishin të ftuar komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebehxhia, atashetë ushtarakë të akredituar në vendin tonë, si dhe ushtarakë e të ftuar të tjerë.

Kundëradmiral Agastra, në fjalën e tij, i uroi mirëseardhjen efektivit të anijes në vendin tonë dhe theksoi vlerësimin e vizitës portuale si një angazhim të përbashkët për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet forcave detare të dy vendeve.

Komandanti i anijes, kapiten i rangut II Serkan Doğan falënderoi për mikpritjen dhe angazhimin e Forcës Detare gjatë kësaj vizite portuale dhe çmoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve.

Nga ana e tij, atashëu ushtarak i Turqisë kolonel Muhammet Kelami Kablay, në fjalën tij shprehu rëndësinë e bash-



këpunimit të ngushtë ushtarak ndër vite dhe vlerësoi mirëpritjen e Shqipërisë gjatë viteve të qëndrimit në detyrë dhe prezantoi atashëun e ri në detyrë kolonel Tolga Kip, duke i uruar suksese në detyrë.

Gjatë largimit të anijes turke u zhvillua një stërvitje e përbashkët me anijen P - 133 “Lissus” të Forcës Detare, gjatë së cilës u zhvilluan disa skenarë sipas standardeve të NATO-s.

Anija "Lissus", gati për misionin në detin Egje

Në rajonin e gjirit të Vlorës u zhvillua kontrolli teorik dhe praktik i gatishmërisë së anijes "Lissus" për misionin e saj të ri në detin Egje. Kontrolli u zhvillua nga një ekip i Komandës dhe Shtabit të Forcës Detare dhe Distriktit Detar Vlorë, nën drejtimin e shefit të Shtabit të Forcës Detare, kapiten I rangut të I Arsen Mullaj.

Qëllimi i këtij kontrolli ishte testimi i efektivitetit dhe posteve luftarake të anijes, nëpërmjet dhënies së situatave të ndryshme taktike gjatë lundrimit. Konkretisht u provuan direkt në lundrim aftësitë e efektivitetit për realizimin e detyrave nga çdo pjesëtar i ekuipazhit, nëpërmjet dhënies së situatave konkrete si: Përgatitja e anijes për lundrim, Kontrolli i Komandave dhe sistemeve të anijes, kryerja e manovrës para ç' bregëzimit, veprimet e efektivitetit në situatën "njeriu në det", zgjidhja e detyrave taktike të lundrimit, veprimet kur ka defekt në timonin e anijes dhe drejtimi i saj me timon rezervë, rënia e zjarrit në anije, çarja e skafit të anijes, hedhja dhe ngritja e spirancës, kryerja e manovrës së ç' bregëzimit, etj.

Në konkluzionet e këtij testimi gjithëpërfshirës, kapiten i rangut të I Arsen Mullaj dhe Komandanti i Distriktit Detar Vlorë, kapiten i rangut të I, Engjëll Sinanaj, vlerësuan përkushtimin dhe profesional-



izmin e ekuipazhit të anijes "Lissus", që nga komandanti i saj, kapiten i rangut të III Mario Miftari, në kryerjen e detyrave individuale, në poste luftarake dhe kompaktësimin si anije, që shprehën qartë garancinë e përmbushjes me sukses të

misionit në detin Egje. Gjithashtu drejtuesit e këtij kontrolli, në emër të Komandantit të FD-së, kundëradmiral Adnand Agastra, dhanë porosi të veçanta për gjithë veprimet e efektivitetit gjatë operacioneve që do kryejnë në Egje.

Studentët e degës Navigacion, në Komandën e Forcës Detare...

Grupi i studentëve të degës Navigim, që studiojnë pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, zhvilluan një vizitë në Komandën e Forcës Detare.

Ata u pritën nga Komandanti i FD, K/Admiral Adnand Agastra dhe shefi i Shtabit të FD-së, Kapiten i Rangut I, Arsen Mullaj. Fillimisht lundruerit e ardhshëm me uniformë, bënë një prezantim të shkurtër të arsimit të tyre dhe treguan pse kanë zgjedhur degën Navigim në Akademinë e FA-së, si janë lidhur me detin.

Më pas K/Admiral Agastra, shpjegoi rëndësinë e përgatitjes akademike-teorike-praktike si oficer marine, punën, mundin dhe sakrificën që kërkon ky profesion, duke sjellë shembuj dhe nga përvoja e karriera personale në Forcën Detare.

Kjo përgatitje kërkon këmbëngulje e disiplinë, që nga jeta në anije si marinar, njohja dhe kryerja e kësaj detyre, zotërimi i të gjithë detyrave e posteve luftarake brenda anijes, kompaktësimi i ekuipazhit, e deri tek dalja në lundrim e kryerja e operacioneve të ndryshme.

Gjatë takimit të zhvilluar në formë bash-



këbisedimi, studentët kërkuar kryerjen e praktikës lundimore, marrjen pjesë në stërvitje të ndryshme të FD-së, apo angazhimin në veprimtari të ndryshme të FD-së. Kërkesave të studentëve, Komandanti i FD-së, iu përgjigj pozitivisht, sepse plotësimi i tyre, i shërben direkt përgatitjes tekniko-profesionale si oficerë të ardhshëm lundruer. Për këtë u theksua forcimi i bashkëpunimit midis Akademisë së FA-së, Universitetit UAMD dhe Komandës së FD-së, për integrimin e programit mësimor-akademik me praktikë në anijet e Forcës Detare.

Studentët e Navigimit në AFA, në vijimë-



si do kenë mbështetjen e Komandës së FD-së, në të gjitha fushat, që nga uniformat e marinarit e deri tek realizimi i programit mësimor, sepse kjo i shërben direkt formimit të tyre si ushtarakë, që janë kontingjent e do shërbejnë në Distriktet e Forcës Detare, në jug e veri.

Në fund të takimit, komandanti i Kompanisë, kapiten Ornest Cekrezi, në emër të Komandës së AFA-së e studentëve, falënderoi Komandën e FD-së, për mbështetjen dhe bashkëpunimin e deritanishëm në përgatitjen sa më mirë të lundruerëve të ardhshëm me uniformë.

Shefqet Kërçelli

Vëzhgim mbi rolin dhe angazhimet e trupës së nënoficerëve në FA

Gjatë ditëve të ftohta të fund janarit, një grup pune i nënoficerëve të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, i kryesuar nga kryekapiter Arben Avdiaj, nënoficeri i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, zhvilloi një plan vëzhgim-monitorimi në Forcat e Komandat kryesore dhe Njësitë autonome të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

Ky plan është në vijim të zbatimit të detyrave e përgjegjësi që kanë nënoficerët e Komandantëve të Forcave dhe Komandave kryesore për zhvillimin e mëtejshëm të trupës së nënoficerëve të FA-së.

Gjatë vëzhgimit, grupi i nënoficerëve të SHP-së, në përbërje të së cilit ishin dhe kryekapiterët e SHP-së, Elona Konini, Alba Saraci dhe Gazmir Hoxha, zhvilluan takim me nënoficerët e komandantëve të Forcave, u njohën me problematikat e trupës së nënoficerëve, ndryshimet, përcaktimin e objektivave për nënoficerët, rritjen e efikasitetit e rolit të nënoficerit, marrjen e përgjegjësi nga ana e tyre, referuar rregulloreve e ligjeve përkatëse mbi të cilat janë organizuar Forcat tona të Armatosura. Kjo u bë e mundur si nëpërmjet brifingut të nënoficerit të Forcës, diskutimeve të pjesëmarrësve në takim ashtu dhe kontakteve e plotësimit të një pyetësi të përgatitur enkas për këtë, sipas përvojës së kolegëve të NATO-s.

Këtë javë grupi i vëzhgimit i SHP-së, ndodhej në Komandën e Forcës Detare,



ku u pritën nga Shefi i Shtabit të FD-së, Kapiten i Rangut I, Arsen Mullaj, kryekapiteri i FD-së, Kastriot Hysa dhe një grup nënoficerësh të FD-së.

Fillimisht, shefi i Shtabit të FD-së, e njohu grupin e vëzhgimit me disa realizime e problematika të nënoficerëve të FD-së, përpjekjet për të mbajtur në detyrë nënoficerët profesionistë, etj. Ndërsa kryekapiter Hysa, i prezantoi gjerësisht problematikat e trupës së nënoficerëve në FD, kryerjen e detyrave me përgjegjësi e disiplinë në çdo operacion e mision të ngarkuar, ku ata kanë mbajtur peshë kryesore. Në fund

pjesëmarrësit plotësuan pyetësin e përgatitur nga grupi i punës.

Kryekapiter Arben Avdiaj, na informon se këtë praktikë pune, grupi i punës e ka zhvilluar dhe po e zhvillon në të gjithë repartet e FA-së, që nga Komandat e Forcave. Në përfundim të vëzhgimit, ekipi i nënoficerëve, referuar diskutimeve, analizimit të pyetjeve dhe konkluzioneve paraprake të dala nga vëzhgimi, do përgatisë një informacion të hollësishëm për Shefin e Shtabit të FA-së, theksoi, kryekapiteri i ushtrisë sonë, Arben Avdiaj.

Shefqet Kërçelli



21 efektivë, mes të cilëve një anëtar i FSK-së, përfunduan Kursin XIX Bazë të Forcave Komando.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebe-xhia, komandanti i qendrës stërvitore të FT-së, kolonel Eglan Dauti dhe anëtarë të Shtabit të Forcës Tokësore.

Ceremoninë e hapi komandanti i ROS-së, kolonel Ajet Jata, i cili vlerësoi punën e pa lodhur dhe djersën e derdhur nga kursantët dhe instruktorët për arritjen e objektivave në realizimin e gjithë programit stërvitor dhe përfundimin me sukses të këtij kursi selektues nga pjesa më e madhe e kursantëve. Ai u uroi suksese në karrierën ushtarake.

Më tej, fjalën e mori komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebe-xhia, i cili pasi falënderoi kursantët për arritjen e tyre u ndal në rëndësinë e këtij kursi:

“Kursi Bazë Komando është një sfidë ku shfaqen aftësitë fizike e psikologjike të gjithsecilit nga ju. Në këtë kurs kryhen tema e taktika, të cilat ju bëjnë juve që në përfundim të këtij kursi të jeni në një nivel më të lartë së ushtarakët e zakonshëm, pasi dhe detyra e misioni juaj është i tillë që kërkon aftësi dhe cilësi mbi normalen. Vendi ynë është një faktor i rëndësishëm i sigurisë në rajon e sot Forcat e Arma-

tosura pranojnë në gjirin e tyre komandot më të rinj, kjo gjë na bën krenarë, prandaj ju uroj ta mbani lart emrin e bukur Komando”.
Më pas kursantët kryen betimin dhe vendosën beretat blu, duke realizuar ëndrrën e tyre për t’u bërë pjesë e trupave komando. Kursi Bazë Komando zgjati 3 muaj dhe në përfundim të tij u certifikuan 21 efektivë nga 25 që filluan kursin, gjë që tregon intensitetin dhe vështirësitë fizike ekstreme dhe psikologjike që përmban ky kurs.



Efektivat e Batalionit të Këmbësonisë së Lehtë trajnohen për përdorimin e pajisjeve speciale në luftim

Në kuadër të modernizimit të Forcës Tokësore me mjete e pajisje dhe në vazhdim të bashkëpunimit me ushtrinë amerikane, efektivët e Batalionit të Këmbësonisë së Lehtë (bkl) në FT, kryen trajnime për përdorimin e këtyre pajisjeve nën drejtimin e specialistëve amerikanë. Bkl dhe Dega e Zbulimit në këtë batalion, po kryejnë trajnim e operatorëve për përdorimin e avionëve pa pilot (UAV). Ky trajnim kryhet nën drejtimin e specialistëve të Gardës Kombëtare të New Jersey-it, USA.

Trajnimi kryhet me qëllim rritjen e kapaciteteve operacionale të trupave të zbulimit dhe realizimin në kohë të informimit për situatën reale të zhvillimit të veprimeve në fushën e luftimit. Gjithashtu përdorimi i këtyre pajisjeve do të realizojë mundësinë e grumbullimit të informacionit të zbulimit në interes të vendim-marrjes ushtarake.

Gjithashtu grupi i specialistëve amerikanë (SFAB) po trajnojnë prej tre ditësh drejtuesit e mjeteve të blinduara HM-



MWV të Batalionit të Këmbësonisë së Lehtë.

Trajnimi ka si qëllim drejtimin e mjeteve të blinduara në kushtet e pamjes së kufizuar dhe të errësirës pa përdorur sistemin ndriçimit të mjeteve. Përdorimi i këtyre pajisjeve do të rrisë aftësitë luftarake të trupave në fushëbetejë, në çdo kohë dhe në kushte të vështira të motit.

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia pret atasheun e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia priti në një takim kortezie atasheun e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, nënkolonel Timothy Wight-Boycott.

Komandanti i FT-së, pasi i uroi mirëseardhjen, vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer mes Forcës Tokësore dhe Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar, kontributin që ato kanë dhënë në drejtim të rritjes së kapaciteteve të FT-së në trajnim, stërvitje dhe pajisje.

Më pas për atasheun u prezantua një briefing i shkurtër mbi strukturën e re të organizimit të Forcës Tokësore, misionin, detyrat e saj, kapacitetet operacionale, kontributin e FT-së në misionet në përbërje të NATO-s etj.



Në këtë takim, vëmendje e veçantë iu kushtua planit të bashkëpunimit dypalësh në fushën e Mbrojtjes për vitet 2024 - 2025. Atasheu, pasi falënderoi komandantin dhe të pranishmit për pritjen e ngrohtë, thek-

soi se bashkëpunimi midis dy forcave tokësore tona do të forcohet akoma më shumë për të qenë sa më ndërvëprues në përgjigje të situatave kritike që po kalon rajoni ynë.

Përkujtohet 70 - vjetori i ditës së krijimit të MADM

Në mjediset e Qendrës së Mbrojtjes nga Armët e Dëmtimit në Masë dhe Lëndëve të Rrezikshme (MADM) në Forcën Tokësore u zhvillua ceremonia e 70 -vjetorit të shërbimit të MADM.

Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, drejtori i Shtabit në SHPFA, kolonel Aleksandër Pando dhe drejtorë drejtorish në SHPFA. Gjithashtu ishin të ftuar dhe veteranë të Shërbimit Kimik të FA-së.

Ceremoninë e hapí komandanti i kësaj qendre, nënkolonel Lorenc Veliu, i cili uroi pjesëmarrësit në këtë ditë të shënuar për MADM dhe falënderoi veteranët e këtij shërbimi për kontributin e tyre ndër vite.

Më tej e mori fjalën komandanti i FT-së, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia. Ai përshëndeti të pranishmit dhe vlerësoi lart veprën e kimistëve të FA-së në vite në mënyrë të veçantë punën e veteranëve të sotëm, atyre që ngritën dhe drejtuan këtë shërbim. Ai vuri theksin në punën e specialistëve të kimisë në menaxhimin e kimikateve dhe hot-spoteve, duke theksuar se ky shërbim aktualisht vepron sipas standardeve të NATO-s.

Më tej komandanti në fjalën e tij i kushtoi rëndësi konceptimit dhe modernizimit të këtij shërbimi për të qenë të aftë dhe të ndërveprueshëm me partnerët tanë. Ai u shpreh se: "Transformimi i FA-së ka përfshirë dhe shërbimin e MADM-së për të qenë e pakët në numër, por e konceptuar e tillë që të jetë e ndërveprueshme për t'iu përgjigjur situatave të ndryshme, si dhe për të mbështetur e operuar me aleatët e partnerët tanë në operacione ndërkombëtare.

Në vijim të rritjes profesionale, ju jeni dhe objektiv kapaciteti i NATO-s, FT, SHPFA dhe MM, duke patur mbështetjen e plotë nga aleatët dhe partnerët tanë dhe veçanërisht SHBA-së, më qëllim rritjen e mëtejshme të kapaciteteve operacionale të MADM-së,



duke zhvilluar projekte për modernizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore, pajisjeve dhe infrastrukturës." Në vazhdim e mori fjalën dr. ing. kimist Shyqyri Kondi, veteran dhe një nga themeluesit e shërbimit kimik dhe komandanti i njësisë së parë të mbrojtjes kimike të ngritur në vitin 1953. Ai falënderoi pjesëmarrësit, duke i uruar festën

dhe përcjellë falënderimet e shumë kolegëve të tij kimistë, tanimë në pension, brezave të rinj të shërbimit të MADM-së. Në vazhdim u shpërndanë medalje "Për shërbim të veçantë", efektivëve të MADM-së, akorduar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji. Ceremonia u mbyll me një foto të përbashkët.





Përfundon stërvitja para-vlerësuese me specialistët e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, USA

Në Qendrën Mjekësore të Forcës Tokësore përfundon stërvitja para-vlerësuese me specialistët e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, USA.

Gjatë kësaj stërvitje u zhvilluan temat: tërheqja e të dëmtuarit në fushën e luftimit, grumbullimi i të dëmtuarve në pikën e grumbullimit të të plagosurve, evakuimi mjekësor për në Rol 1, triazhimi i tyre, dhënia e ndihmës mjekësore, stabilizimi dhe evakuimi i tyre në nivelet Rol 2 dhe Rol 3. Personeli mjekësor gjatë stërvitjes tregoi përkushtim dhe profesionalizëm të lartë.

Gjatë stërvitjes ekipi i përfaqësuesve të GKNJ-së u pritën

nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, i cili pasi dëgjoi mbi rezultatet e stërvitjes, vlerësoi punën e tyre dhe shprehu bindjen se përgatitja e personelit të ekipit mjekësor të Rol.1 do të jetë në nivelin e kërkuar për të marrë vlerësimin maksimal. Gjithashtu ai theksoi se ky bashkëpunim i frytshëm me Gardën Kombëtare të New Jersey-it do të vijojë edhe në të ardhmen. Në përfundim të stërvitjes, ekipi para-vlerësues i GKNJ-së, pasi shprehu konsideratë të lartë për angazhimin dhe profesionalitetin e ekipit mjekësor Rol - 1, shpërndau certifikatat për pjesëmarrësit në stërvitje.

Përfundoi me sukses stërvitja dimërore “Fekeni-23”

Në Poligonin Kombëtar të Bizës përfundoi stërvitja “Fekeni-23”. Për disa ditë trupat e batalionit “Komando”, strukturat mbështetëse të Forcës Tokësore, si dhe një kompani e Regjimentit të 3-të të Këmbësorisë të FSK-së, kryen stërvitje në kushte të vështira moti.

Stërvitja ishte konceptuar me veprime luftarake mësimëse në front e kombinuar kjo me goditje në prapavijë të kundërshtarit. Në këtë stërvitje u aplikuan procedurat standarde të NATO-s, kryerja e veprimeve në një mjedis të përbashkët operacional të efektivave të ushtrive partnere në drejtim të ndërveprimit dhe bashkëveprimit në faza të ndryshme të kryerjes së operacioneve luftarake. Në këtë stërvitje u synua ndërveprimi i kapaciteteve të luftimit dhe mbështetjes, si dhe koordinimi i elementeve të luftimit me ato të mbështetjes së luftimit së bashku me nënrepartet e mbështetjes me shërbime. Qëllimi i kësaj stërvitje ishte, përgatitja dhe testimi i Batalionit “Komando”, për planëzimin dhe zhvillimin e operacionit në prapavijë të kundërshtarit, duke aplikuar standarde të NATO-s në një mjedis të përbashkët operacional.

Objektivat e kësaj stërvitjeje ishin:

Trajnimi dhe stërvitja e strukturave pjesëmarrëse në një mjedis me intensitet të lartë të veprimeve luftarake në terrene malore dhe në kushte ekstreme moti; Planëzimi dhe zhvillimi i stërvitjes në përputhje me Doktrinën e Forcave të Armatosura dhe standardet/procedurat e NATO-s, me qëllim përmirësimin e aftësive drejtuese dhe planëzuese të shtabit të Batalionit “Komando”, gjatë zhvillimit të operacioneve mësimëse; Zbatimi i procedurave standarde, integrimi dhe koordinimi i veprimeve me aktorët e tjerë pjesëmarrës në stërvitje.

Kjo stërvitje u zhvillua në tre faza. Faza e parë: zhvillimi i specifikimeve të stërvitjes, faza e dytë: planëzimi i stërvitjes, faza e tretë: zhvillimi i operacionit, ku përfshihen marshimi dhe ekzekutimi i operacionit.



Operacioni u zhvillua në Poligonin Kombëtar të Bizës, ku lëvizja e trupave për në zonën e operacionit u krye në kushte tepër të vështira të motit, por që nuk ndikoi në kryerjen me sukses të marshimit. Gjithashtu kryerja e veprimeve luftarake të trupave u kryen sa më reale me ato të terreneve të luftimeve në kushte ekstreme të motit e terrenit. Së bashku me efektivat e trupave të FSK-së në këtë stërvitje u realizuan objektivat e caktuara, duke rritur kështu dhe aftësitë e ndërveprimit të trupave në terren të përbashkët operacional.

Në përfundim të stërvitjes u organizua Dita e Vizitorëve të Shquar (DVD), ku efektivat kryen një demonstrim të veprimeve


luftarake në luftimin mësimëse.

Në këtë ditë ishin të pranishëm komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, komandanti i R3K të FSK, nënkolonel Ilir Beqiri, atasheu ushtarak i Kosovës në Shqipëri, Enver Hoti e të ftuar të tjerë.

Gjatë fjalës së tij përshëndetëse, komandanti i FT-së përgëzoi trupat për përkushtimin e tyre në kryerjen e stërvitjes në kushte ekstreme moti e terreni si dhe siguroi efektivat e FSK-së se bashkëpunimi midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes do të vijë duke u rritur.

Miq të nga Kosova falënderuan efektivat duke vlerësuar bashkëpunimin midis dy vendeve në fushën e Mbrojtjes.





Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia priti në një takim kortezie atasheun ushtarak të Republikës së Turqisë, të sapo emëruar në këtë detyrë, kolonel Tolga Kip.

Në takim me atasheun ushtarak të Republikës së Turqisë, komandanti i FT-së, gjeneral brigade Xhebexhia fillimisht i uroi mirëseardhjen dhe detyrën e re, më pas e falënderoi atasheun për bashkëpunimin e shkëlqyer midis dy vendeve tona dhe veçanërisht për ndihmën që ka dhënë Turqia në interes të arsimimit, trajnimit, stërvitjeve dhe modernizimit të forcave të armatosura shqiptare, e fokusuar kjo në Forcën Tokësore. “Bashkëpunimi do vazhdojë, - u shpreh komandanti i FT-së - edhe në të ardhmen, duke u fokusuar në nevojat që ka Forca Tokësore në kuadër të implementimit të strukturës së re si dhe zhvillimin e objektivave të kapaciteteve. Kjo për të bërë të mundur rritjen e kapaciteteve operationale dhe përgatitjen e efektivave të Forcës Tokësore, për të qenë të aftë t'i përgjigjen në kohë, çdo detyrë që kërkohet në misione në përbërje të NATO-s”.

Atasheu ushtarak i Republikës së Turqisë, Kolonel Tolga Kip, pasi shprehu mirënjohjen e tij për pritjen, siguroi komandantin e Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, se ai do të angazhohet që

bashkëpunimi të vijojë dhe në të ardhmen, duke mbështetur kërkesat dhe nevojat që ka Forca Tokësore në të gjitha drejtimet, si në arsimim, stërvitje dhe modernizim. Në fund të takimit u shkëmbyen dhurata.





Përfundon Kursi EOD Nivel I në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse

Në ambientet e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve, të cilët përfunduan Kursin EOD Nivel I.

Në këtë ceremoni ishte i pranishëm zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mhillaj dhe përfaqësuesi i "Golden West William Ziervogel". Ky kurs, i cili zgjati dy muaj, kishte në fokus rritjen e aftësive profesionale dhe kapaciteteve të ushtarakëve për të kryer detyrën e operatorit EOD Nivel I, si dhe aftësimin e kursantëve për dhënien e ndihmës së parë, njohjen e municioneve, vënien në zbatim të procedurave të asgjësimit final të municioneve dhe eksplozivëve për të cilat janë trajnuar.



Përfundon ura në fshatin Plan, bashkia Pukë

Specialistët e Kompanisë së Urave të Batalionit të Xhenios, në Komandën Mbështetëse, kanë përfunduar montimin e urës 15 metra me seksion 2/1, në fshatin Plan, bashkia Pukë.

Ndërtimi i kësaj ure bën të mundur lidhjen e fshatrave: Luf-Plan, Kcirë e Epërme, Dush si edhe lidh këto fshatra me qendrën e njësisë dhe rrugën kryesore.

Kjo urë i shërben rreth 500 banorëve, të cilët janë banorë të përhershëm të këtyre fshatrave si edhe shumë banorë të tjerë, që janë sezonalë dhe kanë tokat bujqësore dhe shtëpitë e tyre në këto zona, për kalimin normal në periudhat vjeshtë - dimër për në fshatrat e tyre.

Ura është e gjatë 15 m dhe me kapacitet mbajtje peshe 40 tonë.





Në Batalionin e Xhenios u zhvillua ceremonia e përcjelljes së Kontingjentit XIV EOD

Në mjediset e Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse, u zhvillua ceremonia e nisjes së Kontingjentit XIV EOD, i cili do të marrë pjesë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar (Enhanced Forward Presence - eFP) të NATO-s, si pjesë e grup – batalionit kanadez të dislokuar në Letoni.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast mori pjesë drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, kolonel Aleksandër Pando, zëvendëskomandant i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, familjarët e kontingjentit EOD dhe efektivit i Batalionit të Xhenios.

Fjalën e hapjes e mbajti komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mhillaj, i cili shprehu mirënjohje për SHPFA dhe Komandën Mbështetëse për mbështetjen e pakursyer të këtij misioni, si dhe falënderoi kontingjentin për përkushtimin e treguar në stërvitjen paradisllokuese, duke arritur aftësi operacionale për misionin dhe duke u shprehur besimplotë për kryerjen e këtij misioni.



Më pas fjalën përshëndetëse e mbajti drejtori i SHPFA-së, kolonel Aleksandër Pando, i cili shprehu mbështetjen në emër të SHPFA-së si dhe uroi kontingjentin për misionin e radhës. Në emër të kontingjentit përshëndeti togër Denis Keshi, i cili, pasi falënderoi komandantin e Batalionit për

mbështetjen e vazhdueshme gjatë stërvitjes paradisllokuese, u shpreh se kontingjenti do të përfaqësojë me dinjitet dhe krenari flamurin tonë kombëtar në Letoni. Ceremonia vijoi me dorëzimin e flamurit për Kontingjentin XIV EOD, dhe u mbyll me një foto të përbashkët.

Komanda Mbështetëse, në mbështetje të Emergjencave Civile për hapjen e akseve rrugore të bllokuara në veri të vendit

Nisur nga situata e krijuar në vendin tonë nga përkeqësimi i motit dhe reshjeve të dendura të borës, në bashkinë Fushë Arrëz, qarku Shkodër u angazhuan dy borëpastruese nga BMEC në mbështetje të Emergjencave Civile për hapjen e akseve rrugore të bllokuara.

Pavarësisht kushteve të vështira të terrenit, rrugëve të ngushta, prezencë bore e ngrirë, erërave të forta dhe temperaturave nën zero, u bë e mundur hapja e 13,5 km rruge, me një trashësi bore prej 40 - 60 cm.


Operacioni vazhdoi në disa fshatra të këtij qarku për t'u ardhur në ndihmë banorëve të zonës për hapjen dhe sigurimin e rrugëkalimeve.



Xhenierët e Komandës Mbështetëse eliminojnë rrezikun e rënies së shkëmbinjve në Krujë

Ekipi i specializuar xhenier është angazhuar për realizimin me sukses të operacionit për shpërthimin e komanduar dhe prishjen e masivit shkëmbor, i cili përbënte rrezik serioz për 12 familje të lagjes Bekteshi, fshati Kurcaj, komuna Nikël, Krujë.

Në vazhdim të kontributit të Forcave të Armatosura në ndihmë të komunitetit, Kompania e Punimeve Xheniere, në Batalionin e Xhenios, punoi për eliminimin e këtij rreziku. Pavarësisht terrenit të vështirë dhe kushteve atmosferike u bë e mundur hapja dhe rehabilitimi i rrugës për eliminimin e rrezikut dhe sigurimin e kalueshmërisë për banorët e zonës.



Specialistët EOD të Batalionit të Xhenios në KM eliminojnë rrezikun nga municionet e paplasura në bashkitë Elbasan dhe Lezhë

Fillimi i vitit i gjen specialistët EOD të Batalionit të Xhenios të angazhuar në dy operacione në ndihmë të komunitetit, për rritjen e sigurisë dhe eliminimin e rrezikut nga municionet e pa plasura.

Nga raportimet në bashkitë Elbasan dhe Lezhë u gjetën municione të pa plasura në zona të banuara, të cilat i përkasin periudhës së Luftës së Dytë Botërore.

Ekipet EOD të Batalionit të Xhenios pasi kryen rikonicionin, zhvilluan operacionin për identifikimin, vlerësimin dhe asgjësimin e një predhe 100 mm e Luftës së Dytë Botërore të gjetur në Mengel, Elbasan dhe një predhe artilerie 75 mm, të gjetur në fshatin Kolsh, bashkia Lezhë.

Të dy operacionet përfunduan me sukses, falë përgatitjes dhe aftësive profesionale të xhenierëve tanë, të cilët bënë të mundur asgjësimin në vend dhe largimin e mbetjeve, duke respektuar të gjitha rregullat dhe masat sigurisë.





“Militarizimi i internetit” dhe impakti në politikat e sigurisë



KOLONEL HYSNI GJERGJI

“Ushtritë kibernetike kanë të bëjnë me përdorimin e sulmeve kibernetike kundër një shteti armik, duke shkaktuar dëme të krahasueshme me luftën aktuale dhe/ose duke ndërprerë sistemet jetike kompjuterike. Disa objektiva të ushtrive kibernetike mund të jenë spiunazh, sabotim, propagandë, manipulim ose luftë ekonomike.



eti i dokumenteve të sigurisë kombëtare dhe veçanërisht ato ushtarake të domaineve tokësorë, detarë, ajrorë dhe hapësinorë, është i përfshirë dhe po ndikohet nga interneti në përgjithësi dhe militarizimi i internetit në veçanti. Pranohet nga ekspertët e sigurisë, se po përjetojmë një “paradigmë”, ose një set konceptesh dhe doktrinash të ndryshueshme me shpejtësi, që përshijnë dhe ndikojnë njëra-tjetrën. Ato janë teoritë, metodat kërkimore, postulatet dhe doktrinën, të cilat formësojnë ligjshmërinë dhe fushën e veprimit dhe kontributin e tyre në një fushë të caktuar. Në SHBA, gjenerali Keith B. Alexander, kreu i parë i USCYBERCOM (komandës kibernetike), i tha Senatit se “militarizimi i internetit” në rritet kompjuterike po evoluon aq shpejt sa ka një “mospërputhje midis aftësive tona teknike për të kryer operacione dhe ligjeve të politikave qeverisëse të sigurisë, për t’iu kundërvënë këtij kërcënimi”. Në Samitin e NATO-s 2023, në Vilnius, u miratua një dokument i ri për të rritur kontributin e mbrojtjes kibernetike në parandalimin e përgjithshëm dhe aftësinë e mbrojtjes të NATO-s. Koncepti integron tre nivelet e mbrojtjes kibernetike të NATO-s; politik, ushtarak dhe teknik, duke siguruar bashkëpunimin civilo-ushtarak në paqe, kriza dhe

konflikte, si dhe angazhimin me sektorin privat, sipas rastit.

“Militarizimi i internetit” është faktori kryesor që çoi në rishikim të politikave të sigurisë së NATO-s dhe SHBA-së, i përkufizuar si përdorimi i internetit dhe platformave të tij nga shtetet në fushën e sigurisë kombëtare si brenda vendit, ashtu edhe për të mbrojtur veten nga çdo sulm i jashtëm. Militarizimi i internetit është shfrytëzuar nga shumë shtete totalitare, si përpjekje për të izoluar qytetarët e vet nga burime të tjera alternative informacioni. Duke monopolizuar internetin brenda vendit, shteti autoritar përforcon idetë dhe përforcon propagandën e duhur për qytetarët e tij, të cilët nuk kanë burime apo platforma të jashtme lajmesh alternative, që mund të ofrojnë informacione të ndryshme. Militarizimi i internetit zhvillon gjithashtu aftësinë për shtetet të ndërhyjnë në funksionimin e shteteve të tjera kundërshtarë. Për shkak se interneti është një domain publik, entet shtetërore e kanë aftësinë të ndërhyjnë në zgjedhje, duke përdorur burime online, të promovojnë propagandën në favor të tyre, apo kandidatëve të pëlqyer nga ato dhe në këtë mënyrë të cenojnë demokracinë dhe sigurinë kombëtare për vendet e shënjestruara nga ato. Në vitin 2011, Ron Deibert, nga Laboratori i Kanadasë, paralajmëroi për “militarizimin e hapësirës kibernetike”, pasi reagimet militariste ushtarake mund të mos jenë të përshtatshme dhe proporcionale. Lufta e bazuar në përdorime të caktuara të TI-ve brenda një strategjie ushtarake sulmuese ose mbrojtëse të miratuar nga një shtet dhe që synon ndërprerjen ose kontrollin e menjëhershëm të burimeve të armikut. Militarizimi mund të zhvillohet edhe brenda mjedisit informativ, me agjentë dhe objektiva që variojnë si në aspektin fizik dhe fusha jofizike. Qeveria kineze, për shembull, ka një kontroll strikt të përdorimit të internetit brenda vendit. Duke përdorur censurën, qeveria kineze e ka aftësinë të bllokojë çdo informacion që mund të mos jetë dakord me idetë dhe direktivat e Partisë Komuniste Kineze. Megjithatë, më shpesh qeveria është e interesuar të mos i censurojë këto postime, por të monitorojë se nga po postohen ato. Censuruesit monitorojnë rrjetin me qëllim bllokimin brenda vendit, për të parandaluar kryengritjet ose protestat. Censorët gjithashtu kanë qëllim të censurojnë faqet e individëve që mbështesin protestat kundër Kinës, në mënyrë që të mos përhapin më tej idetë e tyre. Me zhvillimin e përdorimit të internetit në Kinë, qeveria filloi të vendosë rregullore strikte që rrethojnë infrastrukturën e internetit, përdorimin komercial dhe social, si dhe pasojat e tij të mundshme politike. Kina ka krijuar një Sistem Kreditimi Social (SCS) për përdoruesit e saj publik të internetit, që synon të gjurmtojë “besueshmërinë” dhe “besnikërinë” e individëve dhe organizatave që e përdorin hapësirën kibernetike. Pikët e fituara ose të humbura nëpërmjet këtij programi përdoren në përfitime, ose ndëshkime të përcaktuara nga qeveria. Ky sistem i shtoi një nivel mbikëqyrjes dhe censurës shtetërore të vendosur brenda vendit.

Në mënyrë të ngjashme, për të izoluar qytetarët e saj nga burimet e lajmeve të jashtme, Rusia krijoi internetin e saj të monitoruar

në territorin e saj. Për ta bërë këtë, shteti bllokoj dhe delegjitimoi mediat, që mbanin mendime të kundërta për Vladimir Putin, si dhe idetë brenda partisë së tij. Ky “internet paralel” megjithëse nuk është plotësisht i izoluar, i mundëson qeverisë të kontrollojë atë që shihet nga qytetarët e saj, si dhe u jep autoriteteve shtetërore mundësinë për të mbyllur qeverinë, kur kërcënohet me një sulm në internet.

Lufta e Rusisë kundër Ukrainës ka nxjerrë në pah shkallën në të cilën aktivitetet kibernetike janë një tipar i konfliktit modern. Rusia gjithashtu ka intensifikuar veprimet e saj hibride kundër aleatëve dhe partnerëve të NATO-s, duke përfshirë edhe aktivitetet kibernetike keqdashëse. Ambiciet e deklaruara të Kinës dhe politikat shtrënguese sfidojnë interesat, sigurinë dhe vlerat e NATO-s. Operacionet hibride dhe kibernetike të Kinës, retorika konfrontuese dhe dezinformimi, synojnë aleatët dhe dëmtojnë sigurinë e NATO-s. Aleatët e kundërshtojnë në mënyrë aktive numrin në rritje të vazhdueshëm të kërcënimeve, duke përfshirë sistemet e tyre politike demokratike si dhe infrastrukturën kritike, duke përfshirë këtu edhe luftën hibride. Si pasojë e militarizimit të internetit, mund të shkaktohet kompromentimi i sistemeve ushtarake kombëtare dhe të NATO-s, nga ushtritë kibernetike armiqësore, në komponentët C4ISTAR. “Command, Control, Communications, Computers, Intelligence, Surveillance, Targeting Acquisition and Reconnaissance”, të cilët janë përgjegjës për



urdrat dhe komunikimet, nga përdorimi qëllim keq i “internetit të militarizuar” mund të çojë në përgjimin ose shkatërrimin e tyre si sistem.

Sipas kësaj perspektive në evoluim, nocioni i luftës kibernetike sjell një paradigëm të re edhe në doktrinën ushtarake. Pothuaj të gjithë shtetet pa përjashtim kanë themeluar tashmë ushtritë e tyre kibernetike si komanda më vete që operojnë në domain-in e 5-të luftës, përkrah atij tokësor, detar, ajror dhe hapësinor. Ushtritë kibernetike, janë quajtur një formacion ushtarakësh shumë të aftë në teknologjinë e informacionit dhe aftësitë kibernetike. Ushtritë kibernetike janë fuqia kibernetike ushtarake e re, që vendet përdorin për të ruajtur sigurinë kibernetike kombëtare. Oficerët e inteligjencës kibernetike mbledhin informacion se nga

vijnë kërcënimet ndaj sistemeve të teknologjisë së informacionit (IT) dhe si funksionojnë ato. Militarizimi i hapësirës kibernetike përfshin përdorimin subversiv të kompjuterëve dhe rrjeteve kompjuterike, për të promovuar një axhendë që mund të kthehen në sulme, vjedhje dhe sabotazhe virtuale që mund të shihen si luftë kibernetike, ose dhe mund të mashtrohen me të.

Ushtarët kibernetikë janë të trajnuar për të ekzekutuar operacione sulmuese në hapësirën kibernetike, për të kryer mbrojtjen e rrjetit kompjuterik dhe për të zbuluar aktivitetin keqdashës në fushën e betejës elektromagnetike, duke përdorur rrjete të avancuara si ushtarake ashtu edhe sisteme të armëve kibernetike.

Ka një debat mes ekspertëve ushtarakë dhe të sigurisë në lidhje me përkufizimin dhe paradigmen e fjalës së duhur gjatë trajtimit të luftës kibernetike, madje deri aty, nëse një e tillë ekziston. Një pikëpamje është se, termi është një emërtim gjuhësor i gabuar, pasi asnjë sulm kibernetik deri më sot nuk mund të përshkruhet si një luftë. Ushtritë kibernetike kanë të bëjnë me përdorimin e sulmeve kibernetike kundër një shteti armik, duke shkaktuar dëme të krahasueshme me luftën aktuale dhe/ose duke ndërprerë sistemet jetike kompjuterike. Disa objektiva të ushtrive kibernetike mund të jenë spiunazh, sabotim, propagandë, manipulim ose luftë ekonomike. Ekziston një debat se si duhet të përkufizohet lufta kibernetike dhe asnjë përkufizim absolut nuk është dakorduar gjerësisht. Ndërsa shumica e studiuesve, ushtarakëve dhe qeverive përdorin përkufizime që i referohen aktorëve shtetërorë dhe të sponsorizuar nga shteti, përkufizime të tjera mund të përfshijnë aktorë jo shtetërorë, siç janë grupet terroriste, kompani, grupe ekstremiste politike ose ideologjike, madje dhe hakera të pavarur.

Shembuj të përkufizimeve të propozuara nga ekspertë të fushës së sigurisë dhe inteligjencës janë si më poshtë. “Lufta kibernetike” përdoret në një kontekst të gjerë për të treguar përdorimin ndërshtetëror të forcës teknologjike, brenda rrjeteve kompjuterike, në të cilat informacioni ruhet, ndahet ose komunikohet në internet. Paulo Shakarian parashtroi përkufizimin e mëposhtëm të “luftës kibernetike” në 2013, duke u mbështetur në përkufizimin e Clausewitz për luftën: “Lufta është vazhdimi i politikës me mjete të tjera”; Lufta me ushtritë kibernetike është një shtrirje dhe vazhdim e politikës me veprime të ndërmarra në hapësirën kibernetike nga aktorë shtetërorë ose jo shtetërorë që përbëjnë një kërcënim serioz për sigurinë e një kombi ose që kryhen në përgjigje të një kërcënimi të perceptuar kundër sigurisë së një kombi.

Në vitin 2012, Eugene Kaspersky, themeluesi i Kaspersky Lab, arriti në përfundimin se “terrorizmi kibernetik” është një term më i saktë se “lufta kibernetike”. Ai thekson se “me sulmet e sotme, nuk keni ide se kush e bëri atë ose kur do të godasin përsëri. Nuk është luftë kibernetike, por terrorizëm kibernetik”. Howard Schmidt, ish-koordinatori i sigurisë kibernetike në administratën e Obamës, tha se “nuk ka luftë kibernetike”. Në vitin 2017, akademiku i Oksfordit Lucas Kello propozoi një term të ri, për të treguar sulmet kibernetike, megjithëse janë shumë të dëmshme, por efektet jo të dhunshme të të cilave nuk ngrihen në nivelin e luftës tradicionale. Veprime të tilla nuk janë as luftarake por dhe as paqësore. Edhe pse lufta me ushtritë kibernetike është më pak e dhunshme, efektet e tyre të dëmshme në ekonomi dhe shoqëri mund të jenë më të mëdha se ato të disa sulmeve të armatosura.

Përveç sulmeve dixhitale hakmarrëse, vendet mund t'i përgjigjen sulmeve kibernetike me sanksione kibernetike të ekzekutuara nga ushtritë kibernetike. Ndonjëherë, nuk është e lehtë të zbulosh sulmuesin, por dyshimet mund të përqendrohen në një vend ose grup të caktuar vendesh. Në këto raste, sanksionet ekonomike të njëanshme dhe shumëpalëshe mund të përdoren në vend të luftës kibernetike.

Energjia, uji, karburanti, komunikimi dhe infrastruktura e transportit mund të jenë të prekshme shumë me pasoja ndaj ndërprerjeve si pasojë e militarizimit të internetit. Sfera civile është gjithashtu në rrezik, duke vënë në dukje se shkeljet e sigurisë tashmë kanë shkuar përtej numrave të kartave të kreditit të vjedhura dhe se objektivat e mundshëm mund të përfshijnë gjithashtu rrjetin e energjisë elektrike, trenat ose tregun e aksioneve. Decentralizimi, shpejtësia e evoluimit dhe gama e madhe e hapësirës kibernetike e bën jashtëzakonisht të vështirë drejtimin dhe kontrollin e saj nga perspektiva e politikave të sigurisë që mund të ndiqen.

Aktorët jo shtetërorë mund të luajnë një rol të madh në hapësirën e internetit të militarizuar, aq sa dhe aktorët shtetërorë, gjë që çon në pasoja të rrezikshme, ndonjëherë të paparashikuara dhe katastrofike. Grupe të vogla të zhvilluesve shumë të aftë të malware-ve janë në gjendje të ndikojnë po aq efektivisht në politikën globale dhe luftën kibernetike sa agjencitë më të mëdha qeveritare. Për shembull, prerja e kabllave të komunikimit nënujor mund të gjymtojë rëndë disa rajone dhe vende në lidhje me aftësinë e tyre për luftë informacioni. Ndërprerjet masive të energjisë të shkaktuara nga një sulm kibernetik mund të prishin ekonominë, të largojnë vëmendjen nga një sulm i njëkohshëm ushtarak ose të krijojnë një sabotim dhe traumë kombëtare. Hakerët iranianë, ose Ushtria Kibernetike iraniane shkaktuan një ndërprerje masive të energjisë elektrike për 12 orë në 44 nga 81 provincat e Turqisë, duke prekur 40 milionë njerëz.

Propaganda në internetin e militarizuar, është përpjekje për të kontrolluar informacionin në çfarëdo forme që ai merr dhe për të ndikuar në opinionin publik. Është një formë e luftës psikologjike, përveçse përdor media sociale, faqe interneti të lajmeve të reme dhe mjete të tjera dixhitale. Në vitin 2018, Sir Nicholas Carter, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Britanike deklaroi se ky lloj sulmi nga aktorë të tillë si Rusia “është një formë e luftës së sistemit që synon të delegjitimojë sistemin politik dhe social mbi të cilin bazohet forca jonë ushtarake”. Jowell dhe O'Donnell përcakton “propaganda është përpjekja e qëllimshme, sistematike për të formësuar perceptimet, manipuluar njohjet dhe sjelljen e drejtpërdrejtë për të arritur një përgjigje që çon përpara qëllimin e dëshiruar të propaganduesit”.

Objektivat e mundshëm në sabotazh të internetit përfshijnë të gjitha aspektet e internetit të militarizuar që nga antenat, tek ofruesit e shërbimeve të internetit, tek llojet e ndryshme të mjeteve të komunikimit të të dhënave dhe pajisjeve të rrjetit. Kjo përfshin: serverët në internet, sistemet e informacionit të ndërmarrjeve, sistemet e serverëve të klientëve, lidhjet e komunikimit, pajisjet e rrjetit dhe desktopët dhe laptopët në biznese dhe shtëpi. Rrjetet elektrike, rrjetet financiare dhe sistemet e telekomunikacionit konsiderohen gjithashtu të cenueshme, veçanërisht për shkak të tendencave aktuale në kompjuterizimin dhe automatizimin.

“Forca Rezervë, përtej paranojës së gjithë popullit ushtar”



Gjeneral (R) PIRO AHMETAJ,
ekspert për SK, Rajonin dhe NATO-n,
Zv/President i Këshillit të Atlantikut

Paraprakisht, si ekspert, dëshmitar apo kontribuues teknik në reformat e sistemit të sigurisë kombëtare si dhe në 30 vjet rrugëtim drejt dhe pas anëtarësimit në NATO (1993-2023) dëshiroj të shpreh konsiderata dhe rekomandime strategjike rreth përpjekjeve të RSH për ngritjen e Forcës Vullnetare Rezervë (FVR).

Po ashtu, që në fillim të herës më duhet ta theksoj se është një ngjarje e vonuar, por njëkohësisht e domosdoshme për peshën në fushën e reformave Euro-Atlantike në FA si dhe modernizimin e kapaciteteve të mbrojtjes kombëtare.

Për realizimin e ngritjes së kësaj force, padyshim meriton të komplementohet Ministri Peleshi, i cili ka sigurisht privilegjin dhe meritën që jo vetëm po e kurorëzon këtë përpjekje serioze, por edhe për arritjen e buxhetit të mbrojtjes 2 %; në dyfishimin e pagave të ushtarakëve; rikthimin e një profesionisti elitari në krye të Forcave Detare; modernizimin e kapaciteteve operacionale, të planifikimit dhe cilësinë e bashkëpunimit me NATO-n”.

Ky projekt është një qasje e përbotshme, që aplikohet nga 31 vendet e NATO-s si dhe nga 194 shtete të njohura nga OKB-ja, përfshi Islandën, e cila për shkak të një marrëveshje speciale me SHBA-të nuk ka forca aktive.

Ajo është edhe një qasje e përjetshme, pasi në të gjitha kohët dhe format e shtetit, asnjë vend, qoftë perandori, mbretëri, demokraci apo regjim diktatorial nuk mundet kurrsesi të mbajë 100 % forca aktive për të gjithë skenarët e kërcënimeve apo ambicieve.

E thënë edhe më qartë, me zyrtarizimin e këtij projekti, RSH i bashkohet një përqasjeje moderne të konfirmuar edhe në doktrinën e NATO-s për planifikimin, ngritjen si dhe përdorimin e përshtatshëm të kapaciteteve dhe të fuqisë ushtarake.

Së dyti: cila është historia, çfarë përfaqëson, eksperiencat, strukturat dhe misioni i forcës vullnetare rezervë?

Përkufizimi në Wikipedia: “Një forcë vullnetare rezervë është një komponent ushtarak i shtetasve të një vendi që i bashkohet vullnetarisht forcave të armatosura, duke kombinuar karrierën civile edhe një detyrë ushtarake me kohë të pjesshme”.

Historikisht, forca rezervë ka lindur pas disfatës së Prusianëve në betejën e Jena-Auerstedt-it, dhe me nënshkrimin e traktatit të Til-sit, më 9 korrik 1807, kur Napoleoni detyroi Prusinë të mos kishte një ushtri më të madhe se 42.000 vetë. Në këto kushte, reforma e quajtur Krumpersystem, e propozuar nga reformisti ushtarak prusian Gerhard von Scharnhorst, reflektoi me zgjuars, duke trajnuar mbi baza tremujore një numër rekrutësh që nuk e kalonin shifrën e sipër caktuar, por që në rast nevojë, përbënin një kontingjent ushtarak shumë herë më të madh. Ky koncept u përmirësua gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, si dhe më tej u ngrit në sistem të bazuar në specifikat e çdo vendi.

Pas Luftës së Ftohtë (1990), mjedisi strategjik i sigurisë, në rrafshin global, rajonal dhe kombëtar u imponua nga një ndryshim i ndjeshëm i natyrës së rreziqeve dhe konflikteve. Gjatë këtyre tre dekadave, përjashtoi rastin e sulmit neo-Nazist të Rusisë-Putiniste ndaj sovranitetit të Ukrainës: “kërcënimi kryesor për paqen dhe sigurinë nuk ka ardhur nga ndonjë konflikt i formës tradicionale ndërmjet shteteve, por nga rreziqe asimetrike, përfshi edhe krizat e brendshme të shteteve të dështuara, krimin e organizuar dhe terrorizmit ndërkombëtar!

Për rrjedhojë, ky ndryshim në natyrën e konflikteve, u shoqërua me shkurtime kritike në forcat e armatosura si dhe te buxhetet e mbrojtjes. Në shumicën e vendeve, përfshi RSH u kryen reforma radikale që synonin kalimin nga shërbimi mbarë popullor (popullit-ushtar) në shërbim të detyrueshëm aktiv si dhe forca të mbështetura nga një komponent rezervë vullnetare. Kjo tendencë u bë më e ndjeshme në vendet e vogla e me resurse të kufizuara. Për më tepër, forca rezervë, janë bërë gjithmonë e më shumë pjesë e spektrit të operacioneve humanitare në mbështetje të paqes, përfshi ato brenda vendit në rastet e emergjencave civile, ndërsa pritet që në dekadën e tretë të shekullit të XXI, angazhimi i tyre të jetë akoma më i madh.

Forca rezervë është një forcë që përbëhet nga personel oficer, nënoficer dhe ushtarë, që bashkohen me një kontratë vullnetare në forcat e armatosura për të shërbyer vetëm në një kohë të përcaktuar (maksimumi 45 ditë), duke kryer detyra të përcaktuara në ligj.

Sigurisht forca rezervë vullnetare është më pak e kushtueshme se



forca aktive, sepse ajo aktivizohet në kohë të pjesshme gjatë vitit. Ndërsa për specialitete dhe detyra të caktuara, ajo është edhe më cilësore edhe se vetë forca aktive. Kjo ka bërë që vende të ndryshme, ta shikojnë forcën rezervë vullnetare si një opsion të leverdishëm të reformës në forcat e armatosura.

Në disa vende, edhe shërbimi ushtarak aktiv dhe edhe në rezervë, mbetet akoma i detyrueshëm, ndërsa në shumë vende të tjera, si shërbimi ushtarak në forcën aktive ashtu edhe shërbimi ushtarak në forcën rezervë është tërësisht vullnetar.

Në rastin e parë, shërbimi i detyrueshëm rezervë është karakteristikë e vendeve si Suedia, Finlanda, Izraeli, etj., të cilët kanë probleme të konflikteve historike dhe ushtarake me fqinjët.

Në rastin e dytë, shërbimi vullnetar rezervë është tipar i vendeve që relativisht janë çliruar nga problemet e konfrontimit tradicional. Ky shërbim aplikohet konkretisht me pjesëmarrje në operacion në shumicën e vendeve të NATO-s dhe BE-së si SHBA, Angli, Kanada, Francë, Gjermani, Belgjikë, Itali, Spanjë, Slloveni, Hungari, Kroaci, etj.

Si shembull, forcat Kanadeze në Afganistan, përfshinin mbi 30% komponent rezervë, të dislokuar në Kandahar për të shërbyer atje 6 deri 9 muaj. Për më tepër, një pjesë e rezervistëve në bashkëpunimin civil-ushtarak ose në operacionet e veçanta janë rezervistë dhe kanë aftësi më të mira se forcat aktive.

Ndërsa në disa vende, si në SHBA, Angli, etj., forcat rezervë vullnetare përbëhen kryesisht nga ish-ushtarakë të shërbimit aktiv profesionist pas daljes së tyre në rezervë. Ky detyrim për të shërbyer

në përbërje të rezervës vullnetare parashikohet qysh në kontratën e hyrjes së tyre në shërbimin aktiv të shumë vendeve të 31 vendeve të Aleancës. Po ashtu, në vendet e NATO-s, rezervistë mund të jenë edhe nga shoqëria civile, të cilët dëshirojnë vullnetarisht të kontribuojnë në FA.

Kush mundet të jenë raportet mes forcës aktive dhe Rezerviste?

Nga 31 vende anëtare të NATO-s, më shumë se 20, si p.sh: Gjermania, Italia, Greqia, Bullgaria, Polonia, Spanja, Portugalia, vendet Baltike etj., numri i forcave rezervë është shumë më i madh se ai i forcave të rregullta.

Ndërsa në SHBA njësitë luftarake rezerviste janë atashuar në Gardën Kombëtare. Me rreth 20 % të njërive të Ushtrisë së SHBA-së dhe 5,3 % të buxhetit të saj, forcat rezervë sigurojnë rreth 50% të mbështetjes së luftimit në operacione.

Një avantazh tjetër është se ata janë shumë më pak të kush-tueshëm se forca aktive, gjë që lidhet me kohën e pjesshme të shërbimit të tyre, dhe vetëm me nevojat specifike të përdorimit të tyre. Gjithsesi forca vullnetare rezerviste nuk mund të përdoren për të gjithë spektrin e misionit të Forcave të Armatosura.

Sa mund të përdoret rezerva vullnetare?

Duke eksploruar eksperiencat e vendeve të tjera, për rastin e vendit tonë, nuk bëhet fjalë për të rekrutuar ushtarë nga shoqëria civile për të plotësuar togat apo kompanitë e FA-së, apo të ngjashme të nivelit bazë, por vetëm për plotësimin me ato kapacitete të nevojshme cilësore që ose kemi me pakicë, ose nuk kemi fare në FA ose që na duhen në periudha të caktuara.

Cili mund të jetë misioni i forcave Rezervë?

Teorikisht, spektri i misionit të forcave rezervë mund të jetë gjithëpërfshirës, pra nga ato paqeruajtëse deri në luftarake, por prioritet mbeten operacionet në mbështetje të paqes të drejtuara nga NATO/BE/OKB, si dhe në emergjencat civile kombëtare.

Së treti: disa konsiderata dhe rekomandime strategjike për një forcë vullnetare rezervë të FA-së të Shqipërisë?

Na duhet ta qartësojmë edhe më tej se, nuk bëhet fjalë për nostalgji mbi forcën rezervë klasike, dhe aq më shumë, nuk bëhet fjalë fare për konceptin e forcës rezervë të sistemit komunist të mbrojtjes me forcat e veta të çdo pëllëmbë të territorit dhe ku çdo qytetar ishte presupozuar ushtar. Sot ky model aplikohet nga Koreja e Veriut dhe ndoshta Xhibudi.

Përkundrazi, mbas anëtarësimit në sistemin e mbrojtjes kolektive (NATO), RSH ka detyrimin të aplikojë një model të ri të forcës rezervë vullnetare në kushtet e mjedisit të ri të sigurisë, pra një forcë e arsyeshme, e leverdishme dhe e (shumë) përdorshme në operacionet brenda dhe jashtë vendit.

Forca e ardhshme rezervë shqiptare duhet të përfitojë nga eksperiencia më e mirë e vendeve të Aleancës. Sigurisht do të jetë një forcë e vogël, e bazuar në prioritetet të specializuara, e leverdishme dhe e gatshme për mbështetjen e forcës aktive profesioniste.

Normalisht, nuk mund të pritet as planifikohet që komponenti i ardhshëm rezervë të kryejë të gjitha misionet dhe detyrat që kryejnë forcat profesioniste aktive, por Ato mund të kryejnë me shumë sukses një pjesë të detyrave të tyre, pse jo, me cilësi edhe më të lartë se forca aktive, sidomos ato në fushën e emergjencave civile. Forca rezervë është e bazuar në kushtetutën e RSH, ku në nenin 166 shprehet që “shtetasit shqiptarë kanë për detyrë të marrin pjesë në mbrojtjen e RSH...”. Prandaj, me të drejtë parimi kryesor i këtij komponenti mbetet zhvillimi i një force rezervë e tipit vullnetar dhe jo të rekrutimit të detyrueshëm.

Por me gjithë dëshirën Euro-Atlantike dhe të drejtën kushtetuese, komponenti rezervë, ashtu si ai aktiv, nuk mund të jetë aq “universal” sa për të pranuar çdo shtetas që e kërkon një “të drejtë” të tillë. Sigurisht, çdo shtetas duhet t’i respektohet e drejta kushtetuese të aplikojë, por bazuar në kritere profesionale dhe në nevojat konkrete të strukturave të FA-së, vetëm një pjesë shumë e vogël të tyre mund t’u plotësohet kërkesa e pjesëmarrjes në forcën rezervë.

Një kuadër i ri ligjor

Është shumë e rëndësishme, që ngritja e komponentit rezervë të mbështetet me një kuadër ligjor të avancuar. Forca rezervë vullnetare ose bëhet ose nuk bëhet funksionale, ajo nuk bëhet përgjysmë. Kjo do të thotë që nëse po ndërtojmë një elitë profesioniste ushtarake aktive, duhet ta ndërtojmë gjithashtu një elitë të tillë edhe forcën rezervë vullnetare.

Çfarë force rezervë i duhet RSH?

Forca rezervë mund të plotësohet kryesisht (por jo vetëm) nga kontingjentet e personelit të FA-së mbas mbarimit të shërbimit aktiv, duke nënshkruar që në hyrjen në shërbimin profesionist për

të vijuar shërbimin në rezervë deri 3 - 6 vjet.

Po ashtu, në forcën rezervë vullnetare mund të rekrutohen edhe kontingjentet e dëshiruara të shoqërisë civile, të cilat disponojnë kualitet të lartë specialitetesh që mund t’i nevojiten FA-ve në periudha dhe operacione të caktuara.

Një parim tjetër themelor i komponentit rezervë mund të jetë që ai duhet të shihet si komponent operacional, i integruar i njësisë ushtarake. Kjo do të thotë që forca rezervë, përveç rasteve të rralla, nuk duhet të jetë e organizuar mbi bazë njësishe apo repartesh kompakte rezervë, përkundrazi, komponenti rezervë duhet të jetë i integruar së bashku me forcën profesioniste aktive, në një përqindje të caktuar që nuk pengon por e plotëson shkallën e gatishmërisë së pranuar të njësisë për mision.

Bazuar në eksperiencat e vendeve të NATO-s, forca rezervë mund të shkojë deri 20 %. Por, nuk përjashtohet mundësia e ndërtimit me komponent dominues rezervë të kapaciteteve “niche” të FA-së, sidomos në emergjencat civile, si dhe në operacionet paqe-ndërtuese ndërkombëtare.

Thënë këtë, besoj se është logjike se, një prezencë më të madhe të komponentit rezervë në forcën tokësore, krahasuar me forcën detare dhe ajrore si dhe në specialitetet në elementët mbështetës të tipit “enabling”, se sa në forcat e luftimit.

Për ilustrim, mund të marrim një nga detyrat kryesore të misionit të FA-së: “sigurimi i hapësirës ajrore të RSH”. Përveç komponentit profesionist aktiv që mund të kemi në Forcën Ajrore, mund të rekrutojmë edhe komponent civil rezervë vullnetar nga Agjencia e Kontrollit të Hapësirës Ajrore të RSH, e cila ka ekspertizë dhe eksperiencë të spikatur, dhe vetëm me një trajnim në kohë të pjesshme mbi sistemin ushtarak dhe sistemin NATINADS të Aleancës, mund të jetë shumë i vlefshëm edhe për misionin e Forcave Ajrore. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për sistemin e vëzhgimit të Hapësirës Detare. Po kështu, mund ta zgjerojmë listën edhe me shfrytëzimin e kapaciteteve kombëtare kundër efekteve të ASHM, të kapaciteteve xheniere, të kapaciteteve për emergjencat civile, të luftës kundër terrorizmit, etj.

Si mund të trajnohet rezerva vullnetare?

Sipas përvojës së vendeve të Aleancës, forca rezervë vullnetare trajnohet rregullisht çdo vit dhe paguhen me rreth 80-100 për qind të pagës së forcave të rregullta aktive. Një variant i trajnimit të forcës rezervë mund të jetë 30-45 ditë trajnimi në vit.

Sa mund të jetë numri i forcës vullnetare rezervë të FASH?

Gjykoj që për rastin e RSH, pra një forcë profesioniste aktive prej më pak se 10 mijë vetë (pa përfshirë personelin e Emergjencave Civile), mund të vlerësohet zhvillimi i një force rezervë vullnetare prej mbi 1 mijë vetë, pra rreth 20 % të forcës aktive.

Në shtesë, më duhet gjithsesi ta theksoj që për sa në disa dhjetëra vlerësimet dhe rekomandimet strategjike, përfshi në këtë rast, nuk pretendoj kurrësi të jenë të vërteta të fundit ose EUREKA, por një përpjekje modeste për të kontribuar me eksperiencën dhe ekspertizën Euro-Atlantike edhe për këtë projekt.

Kolonel Bardhyl Nuredinaj, drejt sfidave të AFA-së

Kolonel Bardhyl Nuredinaj, aktualisht zëvendëskomandant i Akademisë së Forcave të Armatosura, ka lindur në Vlorë, më 13 Maj 1969. 40 vite më parë, në shtatorin e vitit 1983 u ul në bankat e Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej”.

Katër vitet në këtë shkollë, padyshim, janë themeli i karrierës së gjatë dhe të suksesshme të tij. Më tej, ai vijoi studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në vitet 1987-1991 në degën “Gjitharmësh”, ku në përfundim të saj u titullua oficer dhe emërimin e parë “komandant toge” e mori në qytetin e tij të lindjes, Vlorë. Në nëntor të po këtij viti ai vuri mbi supë edhe gradën e parë “nëntoger”. Në mars të vitit 1993, shkoi në Stamboll, Turqi, ku për një periudhë 15 mujore studioi gjuhën turke dhe më pas kreu me mjaft sukses kursin bazë të oficerit të Këmbësorisë. Pas kthimit në Atdhe për afro 7 vjet vazhdoi karrierën në batalionin e SHP, duke kryer disa detyra si shef i stërvitjes, shef i operacioneve, shef Shtabi batalioni dhe komandant i Truprojës së Nderit. Nga viti 2002 deri në 2005 kreu detyrën e specialistit të Arsimit në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Ministrinë e Mbrojtjes, në të cilën spikati për punën me përkushtim, profesionalizëm e ndjenjë të lartë përgjegjësie. Në bashkëpunim edhe me kolegët e tjerë por dhe me ekipet amerikane të asistencës për mbrojtjen dha një kontribut mjaft të çmuar në hartimin për herë të parë të disa dokumenteve të rëndësishëm për FA-të, veçanërisht në fushën e personelit.

Kolonel Bardhyli, arriti suksese dhe në përmbushje të detyrës si oficer koordinator i Shqipërisë në Komandën Qendrore Amerikane, Tampa, Florida, ku për 18 muaj përfaqësoi vendin e tij me shumë dinjitet, gjë për të cilën ai është vlerësuar maksimalisht edhe nga pala amerikane.

Misioni njëvjeçar si Vëzhgues Ushtarak i Kombeve të Bashkuara “UNOMIG” në Gjeorgji ishte një detyrë sa e vështirë aq edhe fisnike, ku ashtu si edhe 38 oficerë të tjerë të Shqipërisë, pjesëtarë ndër vite në këtë mision, dha kontributin maksimal në shërbim të paqes.

Përmbushja me sukses e detyrave të caktuara jashtë shtetit vazhdoi për dy vite të tjera, në Stamboll, Turqi, nga 2009-2011, ku caktohet si Shef i Zyrës së Komandantit të Brigadës të Evropës Juglindore, SEEBRIG, me pjesëmarrës nga Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Italia, Maqedonia, Rumania dhe Turqia, për të cilën u vlerësua maksimalisht. Gjatë karrierës, ai kreu dhe detyra të tjera të rëndësishme në KDS, Komandën e FT-së, Shtabin e Përgjithshëm të FA-së dhe Ministrinë e Mbrojtjes. Vlen të përmenden detyra e Drejtorit të NATO-s, BE-së dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Mbrojtjes, detyra e Drejtorit të Kabinetit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Komandantit të Qendrës së Personel Rekrutimit, e cila në misionin e saj menaxhon ciklin jetësor të personelit të FA-së që nga rekrutimi,



karriera ushtarake e deri në daljen në pension. Ai ka marrë pjesë në mjaft stërvitje, trajnime dhe kurse të ndryshme afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, brenda dhe jashtë vendit. Kështu mund të përmendet Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit dhe Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, në përfundim të të cilit u nderua me medalje për rezultate të larta. Po kështu, ka marrë pjesë në shumë takime, vizita e konferenca të niveleve të larta brenda e jashtë vendit, duke dhënë një kontribut mjaft të çmuar.

Kolegji i Luftës në SHBA, padyshim shënon kulmin e karrierës së tij, të cilin e përfundoi në vitin 2015 me rezultate të shkëlqyera, duke fituar edhe titullin Master për Studime Strategjike.

Kolonel Bardhyl Nuredinaj është nderuar për punë të shquar dhe kontribut të veçantë me medalje të ndryshme nga autoritet vendase dhe të huaja. Sot në detyrën e komandantit të Akademisë së Forcave të Armatosura, institucionit të arsimit ushtarak, kolonel Nuredinaj, përpos sfidave, do të sjellë dhe risi të cilat janë pjesë e formimit të tij akademik dhe profesional.

Për kontributin dhe përkushtimin e tij në interes të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit, kolonel Bardhyl Nuredinaj merr gradën “gjeneral brigade”.

Skënderbegasi Pavllo Gjidede, manifesti i historisë dhe publicistikës

Dr. i Shkencave Pavllo Gjidede, lindi më 14 maj 1940, në Vuno të Himarës, në një familjen e njohur të Milo Gjidedes, figurë e spikatur, mësuesit dhe priftit të fshatit në atë kohë si edhe Aleksandrës, nënës së tij gjermane nga fisi Averbah, gjyshi i të cilit, Zylber Averbah, në kohën e qeverisë së Ismail Qemalit, ishte sekretar në konsullatën gjermane në Vlorë. Mësimet e shkollës 7-vjeçare i ndoqi në shkollën e Dhërmiut. Në vitin 1953, dërgohet për të vazhduar studimet në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”. Në vijimësi, studimet e larta i përfundoi në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Histori-Filologjisë, ku u diplomua për gjuhë ruse dhe gjuhë-letërsi shqipe. Pas studimeve universitare, Pavloja nisi të punonte si mësues dhe pedagog i gjuhës ruse dhe letërsisë shqipe në qytetin e Vlorës. Nuk janë të paktë, nxënësit e shumë dhe kolegët e asaj periudhe kohore që ruajnë të fiksuara ne kujtesën e tyre, mbresa të jashtëzakonshme prej figurës dhe kontributit të tij në qytetin e Vlorës. Në gazetari, Pavllo Gjidede nisi të debutonte në vitet 60-të, si korrespondent i gazetës së përditshme “Zëri i Popullit”, ndërsa në vitin 1972, merret në redaksinë e gazetës në Tiranë, fillimisht si korrespondent për kryeqytetin, e në vijimësi si redaktor dhe përgjegjës i departamentit politik. Në këtë periudhe kohore, është vendimtar dhe i padiskutueshëm edhe kontributi krejt i veçantë në gjallërimin e publicistikës lokale dhe bashkëpunimi i ngushtë i përjavshëm i Pavllo Gjidedes me gazetën lokale të asaj kohe, Zëri i Vlorës. Reportazhet e shkrimet e tij plot gjallëri, zgjuan interesimin e një mase të madhe lexuesish të asaj periudhe kohore.

...Dr. Pavllo Gjidede për kontributet e cilësitë njerëzore që manifestoi, spikati dhe ka shkruar histori, jo vetëm në fushën e publicistikës e gazetarisë, por përpos kësaj, edhe në fushën e botimeve dhe kërkimeve shkencore me hulumtime dhe memorialistikë. Në vitet 1979-1983, Pavloja emërohet sekretar i kolegjiut të revistës “Studime Politiko-Shoqërore”, e njëherazi si bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit të Kulturës Popullore dhe atij të Gjuhësisë e Letërsisë, ku angazhohet gjerësisht në kërkimet shkencore. Për kontributet e tij studimore, Pavllo Gjidede, laureohet me titullin shkencor “Doktor”. Në vitet 1984-1987, ai është drejtor i Shtëpisë Botuese “8 Nëntori”. Ai është njëkohësisht autor i 11 botimeve të ndryshme, ku mund të veçojmë “Fletët e një Ditari”, “Midis nëntë maleve”, “Shtegtim



në lashtësi”, “Pranverë vrastare”, “Rrugë të mbarë nëpër Vlorë”, “Legjenda Himarjote, Zaho Koka”, “Përse kaq shumë urrejtje në ndershmërinë e re”, “Çajka”, “Dashuri e Plumba”, “Nga Gorbacovi tek Ramiz Alia”.

Më 9 maj 2013, zemra e Pavllo Gjidedes pushoi së rrahuri, por vepra e Dr. Pavllo Gjidedes, do të mbetet një trashëgimi e vyer në publicistikë.

'GRA, ÇFARËDO QË BËNI JU NË JETË KRIJON DIFERENCË, POR JENI JU QË DUHET TË ZGJIDHNI SE ÇFARË LLOJ DIFERENCE DËSHIRONI TË BËNI NË BOTË'

Susan B. Anthony

Susan B. Anthony House mori pjesë në kongresin e parë për të drejtat e grave në vitin 1852. Më tej, pati një aktivitet mjaft të ngjeshur. Përmes saj, qarkulluan peticione për të drejtat e pronës së grave të martuara, themeloi një zyrë shtypi për të siguruar artikuj për shtypin kombëtar, mbajti fjalime, formoi Shoqatat e Grave. Ajo ngriti gjithashtu zërin për heqjen e skllavërisë dhe përmirësimin e të drejtave të punëtorëve, për arsimin e lartë për gratë dhe standardizimin e regjistrimit e trajnimeve për infermierët. Kjo figurë, ndikoi në ndryshimin e 19-të Kushtetutës, duke i dhënë të drejtën e votës të gjitha femrave në SHBA.



Anna Bissell

Megjithëse ishte burri i saj që shpiku makinën e pastrimit të qilimave në 1876 dhe themeloi Bissell, Anna Bissell u bë CEO e kompanisë në 1889, duke e bërë atë CEO-n e parë femër në Amerikë. Pas vdekjes së burrit të saj, Anna ishte ajo që e çoi biznesin në një tjetër nivel. Ajo udhëtoi në të gjithë vendin, duke shitur spastrues dhe duke bërë marrëveshje me shitës të mëdhenj për të transportuar markën Bissell. Përfundimisht, ajo mori markën ndërkombëtare. Ajo ishte gjithashtu një nga drejtueset e para, që dha plane pensionesh dhe kompensime.



Malala Yousafzai

Kjo femër provoi se nuk mund të jesh kurrë shumë i ri për të qëndruar në këmbë për atë që është e drejtë. Kur Talibanët filluan të merrnin pushtetin në vendlindjen e saj dhe të sulmonin shkollat e vajzave, ajo, në atë kohë studente në shkollën që babai saj kishte themeluar, mbajti një fjalim për të drejtat që duhet të kenë femrat në arsim. Ajo përdori një emër të rremë për të raportuar për BBC-në, në vitin 2009, duke folur rreth jetës nën presionin dhe shtypjen e Talibanëve. Në vitin 2012, 15-vjeçarja ishte duke shkuar për në shtëpi nga



shkolla, kur një person i maskuar, hipi në autobus dhe e qëllloi në kokë. Ajo mbijetoi, dhe pas një gjendje kome të induktuar nga mjekësia dhe operacione të shumta, ajo u kthye në shkollë në Angli, iu drejtua Kombeve të Bashkuara, botoi librin e saj të parë "Unë jam Malala" dhe themeloi fondin "Malala" një vit më vonë. Në vitin 2014, ajo u bë personi më i ri që fitoi çmimin "Nobel" për Paqen.

Ruth Bader Ginsburg

Ruth ka qenë një zë i fortë liberal dhe një avokate që ka lobuar fuqishëm për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave. Ajo ishte e para që zyrtarizoi martesë të njëjtë seks.



Ali Stroker

Ali Stroker e pushtoi botën e teatrit, kur më 9 qershor 2019, ajo u bë interpretuesja e parë në një karrige me rrota, për të cilën mori një "Tony Award". Fjalimi i pranimit është i paharrueshëm: "Çdo fëmijë..., i cili ka një paaftësi, një kufizim, një sfidë, sot i përfaqësoj të gjithë në këtë arenë".




Victoria Woodhull

Hillary Clinton mund të ketë qenë gruaja e parë që u zgjodh si kandidate presidenciale për një parti të madhe, por ideja u shtrua nga disa gra të tjera që ndryshuan botën, duke kandiduar për Presidente të Shteteve të Bashkuara. E para nga këto ishte Victoria Woodhull, e cila në vitin 1872, shkruan: "Unë ... pretendoj të kem të drejtën të flas për gratë e paanshme të vendit". Do duhej të kalonin 50 vjet që gratë të fitonin të drejtën e votës.



Elizabeth Blackwell

Gjatë gjithë rinisë së saj, Elizabeth Blackwell, nuk e kishte menduar asnjëherë se do të studionte mjekësi, deri kur një shoqe në prag të vdekjes, i tha se, nëse mjeku i saj do të ishte femër, atëherë do arrinte të shpëtonte. Kjo ngjarje i shënjoji shumë fort. Ajo u pranua në kolegjin mjekësor të Gjenevës dhe u bë gruaja e parë në Amerikë që mori një diplomë mjekësore. Eksperienca e saj është mjaft e gjatë në fushë të mjekësisë, por edhe mësimdhënies.



Marie Curie

Duke punuar së bashku me burrin e saj Pierre Curie. Hulumtimi

i saj çoi në një kuptim më të madh se si të përdorim rrezatimin në ilaç, duke ndryshuar përgjithmonë teknikat diagnostifikuese, sidomos në onkologji, teknika të cilat i ndjek edhe sot onkologjia moderne.

Edith Wharton

Produkti i shoqërisë së lartë të Bregut të lindjes, u shndërrua në roman dhe shkrimtarja e tregimeve të shkurtra u bë gruaja e parë që iu dha çmimi “Pulitzer” për letërsi në vitin 1921 për librin e saj “Mosha e Pafajësisë”. Një fakt interesant është që ajo nuk e ndoqi kurrë shkollën. Shkruante ku të mundej. Arriti të botonte 38 libra. Iu dha Kryqi i Legjionit të Nderit të Francës për punën e saj në ndihmë të Luftës së Parë



Botërore, e cila përfshinte ushqimin dhe strehimin e 600 jetimëve belgë, ndërsa jetonte në Paris.

Harriet Tubman

E lindur në skllavëri, Tubman i shpëtoi rrahjeve brutale në vitin 1859. U detyrua të linte pas burrin e saj të lirë, motrat dhe prindërit. Ajo arriti të shpëtonte shuam njerëz nga skllavëria. Bëri punë nga më të ndryshmet. Arriti të bënte fjalime dhe të bënte një biografi të sajën.



Murasaki Shikibu

Në rininë e saj, Shikibu, shfaqti inteligjencë të madhe dhe një dashuri për të mësuar, çka e detyroi të atin e saj ta lejonte të studionte letërsi kineze dhe budiste. Duke shërbyer nën perandorinë e asaj kohe, ajo prodhoi atë që konsiderohet gjerësisht romani i parë në botë, një libër prej 54 kapitujsh.



Joan Ganz Cooney

Një pioniere e mediave, atëherë kur kishte pak gra në industrinë e mediave. Në vitin 1966, ajo ishte duke prodhuar dhe krijuar programe për televizionin publik në New York, Ganz Cooney fitoi fonde dhe bëri kërkime. Arriti të bënte gjëra të mrekullueshme në media.



Ella Fitzgerald

Ajo njihet si “Zonja e Parë e Këngës” për një arsye! Gruaja e parë që fitoi dy çmime “Grammy” dhe e para afrikano-amerikane që fitonte çmim. Ajo u evidentua nga një saksofonist i xhazit dhe filloi të performojë më shumë shfaqje talentesh, kështu fama e saj vetëm u rrit.



Junko Tabei

Njëzet e dy vjet pas misionit të parë të suksesshëm në majën e malit Everest, alpinistja japoneze Junko Tabei u bë gruaja e parë që arriti majën. Ajo ishte gruaja e parë që u



ngjit në malin më të lartë të çdo kontinenti. Ajo mori imazhin e një femre të fortë dhe të një atleteje mjaft të mirë.

Grace Hopper

Me një diplomë bachelor nga Vassar dhe një doktoraturë në matematikë nga Yale, Grace Hopper, ka punuar në projekte mjaft të mëdha. Ajo drejtoi ekipin që shpiku COBOL (gjuha e zakonshme e orientuar nga biznesi), gjuha e parë programuese që përdori fjalë në vend të numrave. Ende përdoret sot. Ndër nderimet e saj: Një Medalje Kombëtare e Teknologjisë, Medalje për subjektin Google Doodle. Falënderojeni sa herë përdorni një kompjuter.



Gertrude Ederle

Mbretëresha e Valëve, e cila gjithashtu ka qenë e shurdhër, ishte gruaja e parë që notoi nëpër kanalin anglez. Kështu, ajo vendosi një rekord në vitin 1911. Ajo luftoi përmes temperaturave të ftohta dhe baticave të forta që ndryshojnë drejtimin çdo gjashtë orë.



Betty Friedan

Gazetarja dhe aktivistja për të drejtat e grave, Betty Friedan ndihmoi në ndezjen e debateve për feminizmin me artikujt e saj, ligjëratat dhe më së shumti me librin e saj “The Feminine Mystique”, (Mistika e femrës), e cila eksploroji idenë se gratë mund të gjenin lumturi jashtë roleve tradicionale. Ajo bashkë-themloi Organizatën Kombëtare për Gratë (TANI) në vitin



1966, organizoi Grevën e Grave për Barazi, ndihmoi në fillimin e Lidhjes Kombëtare të Veprimit për të Drejtat e Abortit (sot e njohur si NARAL Pro-Choice America), dhe ka punuar me aktivistë kryesorë të viteve 1960 dhe 1970 si Gloria Steinem dhe Shirley Chisholm për fillimin e Grupit Kombëtar Politik të Grave.

Virginia Apgar

Gjeneratat e prindërve i kanë borxh kësaj mjekeje amerikane një falënderim të madh, pasi ajo zhvilloi vlerësimin “Apgar”, sistemin e parë të standardizuar të testeve për të vlerësuar nëse foshnjat e porsalindura ishin të shëndetshme apo jo. Apgar mban titullin e gruas së parë që u punësua si një profesore në Universitetin “Columbia”.



Kathryn Bigelow

Kathryn Bigelow pasi kishte bërë filma për gati tre dekada, u bë gruaja e parë që fitoi çmimin e Akademisë për Regjisorin më të mirë. Drama e saj në vitin 2009, Hurt Locker, gjithashtu e bëri atë gruan e parë që mori një trofe “Oscar”.



“Njerëzit nuk e kuptojnë se sa të mëdha janë këto ‘krijesa’”

Sipas një studimi të fundit, akullnaja Pine Island në Antarktidën Perëndimore ka përfjetuar një tërheqje të pakthyeshme, duke kaluar një pikë kthese në 80 vitet e fundit.

Gjetjet, të cilat u botuan në revistën me mjaft ndikim “Nature Climate Change”, dolën kur liderët botërorë u mbledhën në Dubai për të debatuar ndikimet e ndryshimeve klimatike në konferencën COP28.

Ndërsa simulimet e modeleve numerike janë përdorur për disa kohë për të studiuar sjelljen e akullnajave dhe shtresave të akullit, studiuesit nga Universiteti “Northumbria” dhe Universiteti i Bangor i kombinuan këto për herë të parë me vëzhgimet satelitore të botës reale për të identifikuar nëse një pikë kthese është kapërcyer nga e kaluara.

Ata tani kanë qenë në gjendje të konfirmojnë se Glacier i Pine Island iu nënshtrua një tërheqjeje të shpejtë dhe të paqëndrueshme në një moment midis viteve 1940 dhe 1970, duke çuar në një humbje të pakthyeshme të akullit gjatë disa dekadave.

Glacier Pine Island, së bashku me fqinjin e tij Thwaites Glacier, është quajtur “nënarku” i shtresës së akullit të Antarktidës Perëndimore. Pine Ice Glacier është një nga daljet më të shpejta të akullit në Antarktidën Perëndimore dhe ka kontribuar më shumë në rritjen mesatare globale të nivelit të detit në dekadat e fundit se çdo akullnajë tjetër Antarktidë.

Mekanizmi i tërheqjes dhe implikimet

Midis viteve 1940 dhe 1970, akullnaja, e cila ishte 40 km më e avancuar se pozicioni i saj i sotëm, u shkëput nga një kreshtë e shtratit të detit. Ajo iu nënshtrua një tërheqjeje të shpejtë derisa u stabilizua përkohësisht në një pjesë të cekët të shtratit të detit në fund të viteve 1980. Ndërsa studimi i tyre sugjeron se kjo fazë e përshpejtuar e humbjes së masës tani mund të jetë ndalur, rezultatet e tyre tregojnë se në fillim të viteve 1970, akullnaja ishte tërhequr në një pikë ku nuk mund të rikuperonte masën dhe pozicionin e saj origjinal gjatë kushteve më të ftohta. Kjo konfirmon se tërheqja e akullnajës gjatë kësaj periudhe është e pakthyeshme, që do të thotë se ka kaluar një pikë kthese.

Pika pa kthim: Akullnaja e madhe e Antarktidës ka kaluar nëpër një tërheqje të pakthyeshme

Studiuesit aplikuan gjithashtu modelin e tyre numerik për të parashikuar sjelljen e ardhshme të akullnajës në një studim të veçantë dhe kanë zbuluar se ajo do të hyjë përsëri në periudha të tërheqjes së shpejtë nëse

ngrohja globale nuk mbahet brenda kufijve.

Dr. Brad Reed, një studiues në modelimin e oqeanit të akullit në Universitetin “Northumbria”, filloi kërkimin ndërsa merrte doktoraturën në Universitetin “Bangor”. Ai tha: “Implikimet për të ardhmen janë të qarta. Ajo që ka ndodhur në të kaluarën mund të ndodhë përsëri. Aftësia jonë për të modeluar ndryshimet e së kaluarës ndërsa akullnaja kaloi një pikë kthese, na siguron një besim të shtuar në parashikimet tona të së ardhmes. Por është shqetësuese që modeli ynë parashikon periudha të mëtejshme të pakthyeshme dhe të shpejta të humbjes masive nga i njëjti rajon në të ardhmen, nëse nuk mund të ndalojmë ngrohjen globale.”

Ai shtoi: “Ndërsa faza e tërheqjes që ne modeluam mund të ketë përfunduar, ne nuk mund të përjashtojmë humbje të ngjashme të pakthyeshme të masës nga kjo pjesë e shtresës së akullit në të ardhmen e afërt dhe nuk duhet të rrezikojmë pasojat që lidhen me këto lloje tërheqjesh dhe humbje masash.”

Roli i ndërveprimeve të oqeanit dhe akullit

Profesor Mattias Green, Profesor i Oqeanografisë në Shkollën e Shkencave të Oqeanit në Universitetin “Bangor”, tha: “Hetimi nxjerr në pah ndërveprimet e rëndësishme midis oqeanit dhe akullnajave në Antarktidë. Shkaku i tërheqjes historike ishte ndoshta një episod i ujit të ngrohtë të oqeanit që hynte në zonën e akullnajës së Pine Island, dhe madje edhe kur kushtet u kthyen në gjendjen e ftohtë, tërheqja vazhdoi. Kjo është mjaft



shqetësuese për gjendjen e ardhshme të Pine Island Glacier dhe fqinjët e saj në një botë që po ngrohet.

“Ai gjithashtu thekson se hetimi i sjelljes së kaluar të shtresës së akullit të Antarktidës mund të na japë njohuri se si do të përgjigjet në të ardhmen, dhe na jep besim në aftësinë tonë për të parashikuar ato përgjigje.”

Universiteti Northumbria ka një nga grupet më të mëdha në botë të glaciologëve që studiojnë ndërveprimet midis shtresave të akullit dhe oqeanëve. Hilmar Gudmundsson, profesor i Glaciologjisë dhe drejtuesi akademik i grupit të Universitetit “The Future of Ice on Earth”, ishte bashkë autor i studimit. Ai paralajmëroi se ishte potencialisht një rast fati që tërheqja e akullnajave u stabilizua pas disa dekadash humbjeje të akullit për shkak të topografisë së shkëmbinjve nën Detin Amundsen.

“Ky studim ka të bëjë me të kuptuarit e shkaqeve të ndryshimeve të fundit në këtë fushë dhe çfarë mund të presim më pas. Sjellja e pakthyeshme e akullnajës që shohim në ato simulime, shihet edhe në parashikimet tona të ardhshme”, - tha ai.

“Implikimi është se ne duhet të mendojmë për humbjen e akullit nga kjo pjesë e botës jo në kuptimin e një reagimi të matur gradual ndaj ngrohjes globale, por si diçka që, kur shtyhet shumë larg, humbet akullin vetë me një ritëm të përshpejtuar.

“Këtë herë rezultati ishte se gjatë një periudhe prej disa dekadash, akullnaja u bë kontribuuesi më i madh i Akullit të Antarktikut në ngritjen e nivelit të detit. Ajo që sugjerojnë modelet tona është se kalimi i pikave të mëtejshme të kthesës së Pine Island Glacier do të shkaktojë humbje edhe më të madhe të akullit. Në këtë kuptim, këtë herë mund të kemi pasur fat.”

Studiuesit nga Universiteti Northumbria po udhëheqin studime të mëdha që vlerësojnë ndryshimet në Antarktidë, duke përfshirë TIPACC (Pikat e kthesës në sistemin klimatik të Antarktidës). Ky projekt prej 4 milionë funtesh po heton probabilitetin e ndryshimeve të papritura dhe të mëdha në kontributin e nivelit të detit nga shtresa e akullit në Antarktik për shkak të kalimeve të pikave të kthesës në detet marginale dhe linjave të tokëzimit të rafteve të akullit lundrues që rrethojnë shtresën e akullit.

Vëzhgimet e NASA-s

Akullnajat në Antarktidën perëndimore po shkrihen me një ritëm të pandalshëm që mund të shkaktojë që nivelet e deteve në mbarë botën të rriten shumë më shpejt sesa mendohej më parë, thanë dy grupe shkencëtarësh.

Ekipet e studiuesve nga NASA dhe Universiteti i Kalifornisë thanë se shtresat e akullit do të vazhdojnë të tërhiqen për dekadat apo edhe shekujt në vijim, pavarësisht nga çdo përpjekje njerëzore për të reduktuar emetimet e karbonit një shkak kryesor i ndryshimit të klimës, megjithëse temperaturat e ngrohta mund të përshpejtojnë procesin.

Raportet përfaqësojnë kapërcimin e një “pragu kritik” për të kuptuar shtresat e akullit të Antarktidës, thanë studiuesit në NASA dhe Universitetin e Kalifornisë në Irvine, të cilët ishin pas studimeve, të planifikuara për botim në revistat Science and Geophysical Letters. Përfundimet në raporte bazohen në 40 vjet vëzhgim të zonës së Detit Amundsen që shkrihet me shpejtësi në Antarktidën Perëndimore. Gjashtë akullnajat në rajon kanë hyrë në një tërheqje të pandalshme që ka kaluar pikën e moskthimit, thanë studiuesit.

“Është krahasuar me një shishe vere që ka një tapë në pjesën e përparme, ku tapa përfaqëson raftin e akullit”, - tha Eric Rignot, një profesor i shkencës së sistemit tokësor në UC Irvine dhe një akullnajolog në Laboratorin Jet Propulsion të NASA-s në Pasadena,

Kaliforni.

“Ne jemi në pikën ku mund të themi se shishja është hapur”, - tha ai në një konferencë shtypi.

Shkencëtarët thanë se e quajtën tërheqjen akullnajore të pandalshme, sepse tani e dinë nga vëzhgimet në terren se topografia e tokës nën akullnajat nuk do të bëjë asgjë për të ndaluar shkrirjen.

Studiuesit thanë se një kodër ose një mal do të ishte i nevojshëm për të mbyllur shishen, por studimet e tyre tregojnë se nuk ka formacione të tilla. Në vend të kësaj, toka bie, duke i vendosur akullnajat edhe më larg nën nivelin e detit dhe duke ekspozuar më shumë akull ndaj ujërave të ngrohta, gjë që mund të përshpejtojë tërheqjen e tyre.

Akullnajat e Antarktidës Perëndimore ndodhen në tokë kryesisht nën nivelin e detit, ndryshe nga ato në pjesën lindore të kontinentit, duke i bërë ato më të ndjeshme ndaj shkrirjes nga temperaturat e ngrohta të oqeanit.

Shkrirja e akullnajave të Antarktidës Perëndimore mund të ketë pasoja të mëdha në mbarë botën dhe mund të rezultojë në një rritje të nivelit të detit (SLR) prej 1.2 metrash, përveç asaj që ishte parashikuar tashmë në studime të tjera, si p.sh., raportin e IPCC.



“Kjo pjesë e Antarktidës po kalon një ndryshim të madh”, - tha Sridhar Anandakrishnan, një profesor i gjeoshkencave në Universitetin Shtetëror të Pensilvanisë në “University Park”, në një konferencë për shtyp. Ngrohja e temperaturave të oqeanit – në krahasim me temperaturat e ajrit – po nxit tërheqjen e pakthyeshme të akullnajave të Antarktidës Perëndimore, thanë raportet.

“Është temperatura e ujit që në këtë rast ‘po i ha këmbët e akullnajave’ dhe po shkakton tërheqjen e tyre”, - tha Anandakrishnan.

Ujërat e ngrohta tërhiqen drejt poleve nga modelet e erës që shkencëtarët thanë se janë forcuar gjatë dy dekadave të fundit. Hollimi i shtresës së ozonit mbi Antarktidë gjithashtu kontribuon në shkrirjen e përshpejtuar.

Po bëhet e qartë se akulli i Antarktidës do të ketë një rol më të madh në SLR në dekadat e ardhshme, thanë shkencëtarët. Vlerësimet e mëparshme SLR nuk kanë marrë parasysh shkrirjen e Antarktidës për shkak të mungesës së të dhënave.

“Parashikimet e SLR do të duhet të ndryshojnë lart për shkak të kësaj”, - tha Anandakrishnan, duke shtuar se rishpërndarja e masës akullnajore të Antarktidës Perëndimore mund të ketë implikime në mbarë botën.

“Njerëzit nuk e kuptojnë se sa të mëdha janë këto krijesa”, - tha ai.

Përgjigjet alarmuese të chatbot-eve për të ardhmen e AI-së në 2024

Nga “ChatGPT” që pushtoi botën te ndezja e goditjeve historike të Hollivudit, inteligjenca artificiale pati vitin e saj të shpërthimit në 2023. Çfarë pret për teknologjinë më të fundit në 2024? “DailyMail” u kërkoi chatbot-eve kryesore të AI-së: “Bard” i “Google” dhe “Claude” i mbështetur nga “Amazon”, të parashikonin fatin e tyre, dhe mori disa rezultate alarmante. U zgjodhën këto dy modele gjuhësore sepse ato përdorin informacione të drejtpërdrejta nga interneti për të bërë parashikime, ndryshe nga “ChatGPT” dhe “Bing” i “Microsoft”, të cilët mbështeten në të dhëna më të vjetra. Këto ishin rezultatet:

Sistemet e AI-së mund të fillojnë të arsyetojnë vetë

“Claude” parashikoi se modelet e para të AI-së do të fillonin të tregonin shenja të AGI - “inteligjencës së përgjithshme artificiale”. AGI është një agjent teorik inteligjent i aftë për të përfunduar çdo detyrë intelektuale që një njeri mundet, dhe ardhja e AGI-së parashikohet të shkaktojë ndryshime të mëdha në shoqërinë njerëzore.

Mbështetur nga “Google” dhe “Amazon”, kompania mëmë e “Claude”, “Anthropic”, u themelua nga ish-anëtarët e “OpenAI”, krijuesit e “ChatGPT”.

“Claude” u përgjigj: “Vitet e fundit, ne kemi parë që algoritmet e AI-së përputhen ose tejkalojnë performancën njerëzore në detyra të specializuara si njohja e objekteve, luajtja e lojës dhe përpunimi i gjuhës.

Teknikat si mësimi i thellë dhe rrjetet nervore që funksionojnë në infrastrukturë të fuqishme kompjuterike i kanë çuar këto hapa përpara. Investimet e mëdha nga kompanitë e mëdha të teknologjisë dhe startup-et sugjerojnë se ritmi i inovacionit nuk do të ngadalësohet së shpejti.

A u lodh vallë AI-ja prej nesh? ChatGPT “ndalon përgjigjet ndaj kërkesave të përdoruesve” dhe askush nuk e di pse

Dhe disa studiues të AI-së parashikojnë që ne jemi tani më afër “Inteligjencës së Përgjithshme Artificiale” (AGI), algoritme që mund të përputhen me fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë e njerëzve në mjedise dhe detyra të ndryshme.

Grupe si ‘DeepMind’, ‘OpenAI’, ‘Google Brain’ dhe ‘Anthropic’ po shtojnë drejt këtij qëllimi të AGI-së. Ndonëse ka të ngjarë që nuk do të shkatërrojmë plotësisht inteligjencën e përgjithshme deri në vitin 2024, mund të shohim demo sistemes që fillojnë të shfaqin arsyetim, kreativitet dhe aftësi më të gjera vendimmarrëse.

“Claude” u përgjigj se problemet rreth AI-së mund të përfshijnë sisteme që sillen në mënyrë të paparashikueshme dhe automatizimi i punës që tejkalon aftësinë e punëtorëve për t'u përshtatur.

Bioteknologjia do të “përmirësojë” njerëzit

“Bard” parashikoi se në vitin 2024 mund të shihen përparime bioteknologjike që “përmirësojnë” racën njerëzore.

AI-ja sugjeroi që këto mund të përfshijnë përparime në “Ndërfaqet tru-kompjuter”, ku truri i njeriut lidhet me kompjuterët.

“Neuralink” i Elon Musk do të testojë një teknologji të tillë në vullnetarë gjatë vitit të ardhshëm.

Analiza nga “Foresight Factory” sugjeroi këtë vit se më shumë se një e treta e konsumatorëve do të ishin të lumtur të kishin një çip të tillë të implantuar për t'u lidhur më lehtë me sistemet kompjuterike.

“Bard” tha: “Përparimet në materialet biokompatibile dhe inxhinierinë robotike mund të çojnë në gjymtyrë bionike që rivendosin funksionin motorik pothuajse natyror ose madje tejkalojnë kufizimet njerëzore në forcë dhe shkathtësi. Ekzoskeletet mund të rrisin aftësitë fizike për ngritjen e peshave, aplikime ushtarake ose për të ndihmuar të moshuarit.

Ndërfaqet tru-kompjuter (BCI) mund të lejojnë komunikim të drejtpërdrejtë midis trurit dhe sistemeve kompjuterike, duke mundësuar kontrollin e protetikëve, pajisjeve të jashtme apo edhe mjediseve virtuale. Aplikimet e mundshme përfshijnë komunikimin për individët me paralizë, krijimtarinë dhe produktivitetin e rritur, apo edhe komunikimin tru-tru.”

“Pajisjet që krijojnë ndjesi realiste të prekjes mund të revolucionarizojnë realitetin virtual dhe përvoja të tjera zhytëse, duke ofruar trajnime të përmirësuara mjekësore, lojëra dhe reagime argëtuese.”

Agimi i mjekësisë së personalizuar

Mjekësia e personalizuar, ku trajtimet i përshtaten individit bazuar në ADN-në e tyre, ka potencialin të ndryshojë jetën e njeriut në një shkallë të madhe.

“Bard” parashikoi që AI-ja mund të nxisë përparime të reja në mjekësinë e personalizuar në vitin e ardhshëm.

“Mjekësia e personalizuar, e njohur edhe si mjekësi precize, synon të përshtatë trajtimet dhe strategjitë parandaluese për faktorët unikë gjenetikë, mjedisorë dhe të stilit të jetesës të çdo individi. “Në këtë kërkim, AI-ja po shfaqet si një ndryshim i lojës, duke fuqizuar përparime në aspekte të ndryshme të kujdesit shëndetësor:

“Duke deshifruar sasi të mëdha të të dhënave gjenetike, AI-ja mund të identifikojë faktorët e rrezikut për sëmundje specifike, duke lejuar ndërhyrje proaktive dhe plane të personalizuar parandaluese.

“AI-ja mund të minojë Regjistrimet Elektronike të Shëndetit (EHR) për të zbuluar modele dhe lidhje të fshehura midis simptomave, ilaçeve dhe rezultateve, duke çuar në diagnoza më të sakta dhe



rekomandime të personalizuara të trajtimit.

“AI-ja mund të analizojë të dhënat e pacientëve dhe të parashikojë se si ata mund t'i përgjigjen trajtimeve të ndryshme, duke ndihmuar mjekët të zgjedhin opsionet më efektive dhe më pak të dëmshme për secilin individ.”

“Bard” tha se problemet rreth përdorimit të AI-së në mjekësi përfshijnë sigurimin e të dhënave personale dhe sigurimin që AI-ja nuk i trajton pacientët në një mënyrë të njëanshme.

Me afrimin e zgjedhjeve të vitit 2024 në SHBA, shqetësimet rreth ndërhyrjeve dhe manipulimeve të huaja përmes sulmeve kibernetike dhe fushatave të dezinformimit po rriten. Këto kërcënime, shpesh të ndërthurura, mund të ndikojnë ndjeshëm në opinionin publik, të mbjellin mosmarrëveshje dhe në fund të minojnë integritetin e proceseve demokratike.

Paralajmërim për hakerimin e zgjedhjeve

Me zgjedhjet presidenciale të afërta në SHBA, “Bard” i “Google” parashikoi se aktorët keqdashës do të përpiqeshin të minonin zgjedhjet duke përdorur teknologjinë.

Sulme të tilla mund të përfshijnë sulme në makinat e votimit në një përpjekje për të minuar besimin në rezultat, paralajmëroi “Bard” me “Gemini Pro”.

“Bard” tha: “Aktorët keqdashës mund të synojnë bazat e të dhënave të regjistrimit të votuesve, makinat e votimit ose sistemet e raportimit të rezultateve të zgjedhjeve për të prishur procesin e votimit, për të mbjellë dyshime në rezultatin ose për të manipuluar rezultatet.

“Vjedhja e të dhënave të ndjeshme të votuesve ose informacioni i fushatës mund të përdoret për shantazh, fushata dezinformuese të synuara ose taktika të shtypjes së votuesve.

“Robotët dhe llogaritë e rreme mund të përdoren për të përhapur

propagandë, për të përforcuar narrativa të caktuara dhe për të heshtur zërat kundërshtarë. ‘Deepfakes’, video të manipuluar ose regjistrime audio mund të turbullojnë më tej linjat midis së vërtetës dhe trillimit.

“Artikujt e përshtatur të lajmeve të rreme, postimet në mediat sociale, apo edhe e-mailët e personalizuara mund të shfrytëzojnë paragjykimet dhe ankthet ekzistuese për t'i shtyrë votuesit drejt kandidatëve të veçantë ose për t'i dekurajuar ata që të votojnë krejtësisht.

Tensionet me Kinën rriten

“Claude” i “Anthropic” parashikon se tensionet midis SHBA-së dhe Kinës do të vazhdojnë të rriten në vitin 2024.

Tensionet midis Tajvanit dhe Kinës, e cila e sheh ishullin e qeverisur në mënyrë demokratike si territorin e vet, janë rritur në katër vitet e fundit pasi Kina kërkon të ushtrojë pretendimet e saj për sovranitet me presion politik dhe ushtarak.

“Claude” u përgjigj: “Marrëdhënia midis Kinës dhe SHBA-së dhe aleatëve të saj perëndimorë është bërë gjithnjë e më e tensionuar vitet e fundit për shkak të disa faktorëve kryesorë:

“Tajvani mbetet një nga çështjet më të diskutueshme. Kina e sheh Tajvanin si një provincë të shkëputur që duhet të ribashkohet me kontinentin me forcë nëse është e nevojshme.

Por Tajvani ka evoluar në një shoqëri të veçantë, demokratike me identitetin e vet. SHBA ka mbështetur historikisht të drejtën e Tajvanit për vetëvendosje dhe ka furnizuar me armë për mbrojtjen e tij, duke rritur tensionet me Kinën.

“Nëse Tajvani bën lëvizje drejt pavarësisë formale në vitin 2024, kjo mund të provokojë qëndrime më agresive apo edhe veprime ushtarake nga Kina”.

“STEADFAST DEFENDER 24”, NIS STËRVITJA MË E MADHE E NATO-S NË DEKADA

PËRSHTATI:
MIMOZA GOLIKJA

Filloi “Steadfast Defender 24”, stërvitja më e madhe e NATO-s që nga periudha e Luftës së Ftohtë, ndërsa luftanija e zbarkimit “USS Gunston Hall” (LSD 44) u nis, më 24 janar 2024, nga Norfolk, Virxhinia, Shtetet e Bashkuara dhe pas një serie operacionesh do të fillojë kalimin e saj përtej Atlantikut, drejt territorit të aleancës në Evropë.

Nisja e “USS Gunston Hall” shënon lëvizjen e parë taktike të “Steadfast Defender 24”. Anija kanadeze “Charlottetown” e Madhërisë së Tij, do të niset nga Halifax, Nova Scotia, Kanada për në Evropë gjatë këtij muaji.

E planifikuar gjatë disa viteve, “Steadfast Defender 24” do të nxjerrë në pah aftësinë e NATO-s për të vendosur forca me shpejtësi nga Amerika e Veriut dhe pjesë të tjera të Aleancës për të përforcuar mbrojtjen e Evropës.

NATO tha se rreth 90 000 forca do të marrin pjesë në stërvitjen disamujore të quajtur “Steadfast Defender 2024” (“Mbrojtësi i Vendosur 2024”). Operacioni stërvitor ka për qëllim të vërë në provë mbrojtjen e NATO-s, ndërkohë që vazhdon lufta e Rusisë në Ukrainë.

“Aleanca do të demonstrojë aftësinë e saj për të përforcuar zonën euro-atlantike nëpërmjet lëvizjes transatlantike të forcave nga Amerika e Veriut”, - tha gjenerali Christopher Cavoli, Komandanti

Suprem i Aleatëve në Evropë (SACEUR). “‘Steadfast Defender 2024’ do të jetë një demonstrim i qartë i unitetit tonë, forcës dhe vendosmërisë sonë për të mbrojtur njëri-tjetrin, vlerat tona dhe rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla.”

“Steadfast Defender 24” do të zhvillohet në disa vende, me stërvitjet përkatëse që do të zgjasin deri më 31 maj 2024. Do të jetë stërvitja e parë e NATO-s në shkallë të gjerë, ku planet e reja të mbrojtjes do të vihen në veprim. Ajo do të tregojë se NATO mund të kryejë dhe të mbajë operacione komplekse me shumë fusha për disa muaj, në mijëra kilometra, nga Veriu i Lartë në Evropën Qendrore dhe Lindore, dhe në çdo kusht.

Stërvitja është projektuar si një simulim i përgjigjes së aleancës prej 31 vendesh anëtare ndaj një sulmi nga një vend rival, si Rusia. Stërvitja do të përbëhet nga një seri manovrash më të vogla që do të shtrihen nga Amerika e Veriut dhe deri në krahun lindor të NATO-s, pranë kufirit me Rusinë.

Pritet të marrin pjesë rreth 50 luftanije, 80 avionë dhe mbi 1100 mjete luftarake tokësore.

Kjo është stërvitja më e madhe që nga viti 1988, kur u mbajt stërvitja “Reforged” gjatë Luftës së Ftohtë. Ajo vjen në një moment kur NATO ka transformuar mbrojtjen e saj, që kur Rusia filloi sulmin ndaj Ukrainës në vitin 2022.

Aleanca ka dërguar mijëra forca ushtarake në krahun e saj lindor dhe ka përgatitur planet më të zgjeruara që nga rënia e Bashkimit Sovjetik, për t’u mbrojtur nga një sulm i Rusisë.



NATO LIDH KONTRATA 1.2 MILIARDË DOLLARËSH PËR MUNICION ARTILERIE 155 MILIMETRA

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg dhe Drejtoresha e Përgjithshme e Agjencisë së Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s (NSPA) Stacy Cummings, të martën e 23 janarit 2024, përfunduan kontrata për blerjen e rreth 220,000 predhave artilerie 155 milimetra me vlerë 1.2 miliardë dollarë amerikanë.

“Kjo tregon se strukturat e provuara dhe të testuara të NATO-s për prokurime të përbashkëta po japin rezultate”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. “Lufta e Rusisë në Ukrainë është kthyer në një betejë për municione, kështu që është e rëndësishme që aleatët të mbushin rezervat e tyre, pasi ne vazhdojmë të mbështesim Ukrainën.”

Që kur udhëheqësit aleatë ranë dakord për Planin e Veprimit të Prodhimit të Mbrojtjes të NATO-s, në korrik 2023, NSPA ka rënë dakord për kontrata për municione me vlerë rreth 10 miliardë dollarë. Blerjet e fundit të NSPA-së përfshijnë një kontratë 5.5 miliardë dollarë për 1000 raketa “Patriot” dhe 4 miliardë dollarë për artileri 155 mm, raketa të drejtuara antitank dhe municione tankesh. Në nëntor 2023, agjencia e prokurimeve e NATO-s zgjodhi gjithashtu të blejë gjashtë avionë “E-7A Wedgetail” me një



kontratë që do të nënshkruhet në vitin 2024.

Këto kontrata rekord demonstrojnë kapacitetin e industrisë së mbrojtjes transatlantike për të rritur parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s dhe për të mbështetur Ukrainën.

NATO ndihmon në nxitjen e trafikut ajror civil në të gjithë Ballkanin Perëndimor

Linja të reja ajrore civile u krijuan në të gjithë hapësirën ajrore shqiptare, më 24 janar 2024, për të lehtësuar fluturimet drejt dhe nga aeroporti i Prishtinës. Ky zhvillim i ri është rezultat i përpjekjeve të kryera nën një proces të udhëhequr nga NATO, që synon normalizimin e trafikut të aviacionit civil në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Linjat e reja do të ndikojnë pozitivisht në aviacionin civil dhe do të ofrojnë përfitime të konsiderueshme, duke përfshirë kohë më të shkurtra fluturimi, konsum më të ulët të karburantit dhe reduktim të ndotjes.

NATO ka mbështetur procesin e normalizimit të përdorimit të hapësirës ajrore mbi Kosovë që nga viti 1999, duke udhëhequr konsultimet e njohura si “Takimet e Normalizimit të Aviacionit Ballkanik”. Në këto takime marrin pjesë rregullisht përfaqësues të vendeve aleate, autoritetet e navigacionit ajror, autoritetet ushtarake kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare përkatëse, duke përfshirë Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit dhe EUROCONTROL, ndër të tjera.

Në vitin 2014, hapësira e sipërme ajrore mbi Kosovë u rihap. Kjo u bë e mundur nga kontributet e ofruara nga Hungaria dhe roli i kryer nga Ofruesi i saj i Shërbimit të Navigimit Ajror (HUNGAROCNTRONL), i cili mori përsipër përgjegjësinë për të kontrolluar fluturimet mbi 6400 këmbë. Në vitet e fundit, përmes Takimeve Ballkanike për Normalizimin e Aviacionit, NATO



lehtësoi zyrtarizimin e një Marrëveshjeje Kornizë ndërmjet KFOR-it dhe Islandës. Autoriteti i Sigurisë së Transportit të Islandës (ICETRA) tani po vepron si funksion i mbikëqyrjes së sigurisë në mbështetje të komandantit të KFOR-it, i cili ruan autoritetin parësor për përdorimin e hapësirës së poshtme ajrore mbi Kosovë, sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të vitit 1999. ICETRA kryen shqyrtimin e të gjitha zgjidhjeve teknike që mundësojnë vendosjen e rrugëve të reja direkte, në hapësirën e poshtme ajrore, ndërmjet Prishtinës dhe qyteteve të tjera.

"Lufta, virus ende pa 'vaksinë', të përpigemi për ta shëruar botën"



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Teksa përpigemi të bëjmë analiza si qenie humane mbi realitetin e sotëm, mbi atë se çfarë po ndodh në gjithë globin, ku çdo cep i saj 'kundërmon' era barut, ku qiejt 'oshtijnë' prej avionëve 'përbindësja' dhe

ku rrugët janë 'pikturuar' dhimbshëm prej rrekesh gjaku. Të duket se ky fenomen me termin Luftë, nuk paska pasur një fund, ajo ka qenë aty, gëlonte deri sa çdo ditë shpërthen gjithandej si krater vullkani. Por sot luftërat çuditërisht kanë një konotacion tjetër, "Luftëra Moderne", ku me një tastierë kompjuteri përpara dhe një 'klik' mbi të, bën që me mijëra kilometra katrorë tokë të mos mbijë për qindra vjet qoftë dhe një lule e jo më jetë njerëzore. Shpesh në kontradiktë me veten time, analizoj jo fenomenin por shkaktarin e tij, humanët, psikologjinë, çfarë e bën racën njerëzore të urrejë llojin e vet? Pse 'grykësia' është kthyer në 'pasion'?

Luftërat i fitojnë njerëzit dhe jo armët

Lufta është ferri në Tokë, dhe nëse dyshoni për këtë vizitoni tani Ukrainën. Sigurisht edhe një luftë e vogël është e tmerrshme për ata që janë të përfshirë në të.

Ndaluni një moment dhe reflektoni mbi pasojat. Lufta është rikthyer. Por a mund të rikthehet edhe lufta botërore?

Nëse po, ajo do të ndikojë në të gjithë jetën tonë. Në epokën e dytë midis 2 luftërave (1991-2019), ne e harruam rolin e luftës mbi ekonominë globale. Për shkak se luftërat e asaj kohe ishin të vogla (Bosnje, Afganistan, Irak), harruam se lufta është shtytësi i preferuar i historisë për inflacionin, falimentimin për shkak të borxheve, por edhe për zinë e bukës. Kjo sepse lufta në shkallë të gjerë, është njëkohësisht shkatërruese e kapaciteteve prodhuese, përçarëse e tregtisë dhe destabilizuese e politikave fiskale dhe monetare. Por ajo ka të bëjë po aq edhe me mobilizimin e burimeve reale sa edhe me financat dhe paratë: çdo fuqi e madhe





duhet të jetë në gjendje të ushqejë popullsinë dhe të fuqizojë industrinë e saj.

Bota apo Lufta? Kush krijoi, kë?

Në të gjithë botën ka pasur luftëra që nga kohërat e lashta gjatë gjithë historisë, madje edhe kur është e qartë se luftërat shkaktojnë shkatërrime të jetës dhe pronës së njerëzve, ende justifikohen dhe shihen si zgjidhje e fundit për shumë probleme. Shpeshherë, lufta çuditërisht ka shërbyer si një forcë kryesore lëvizëse, që ka kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të komuniteteve dhe shfaqjen e mundësive të reja. Ajo është konsideruar si një nga mjetet e seleksionimit natyror që ka nxitur mbijetesën e grupeve më të forta dhe zhdukjen e atyre më të dobëta.

Cilat kanë qenë shkaqet e luftërave?

Shkaqet e luftërave kanë qenë të ndryshme përgjatë historisë. Në përpjekje për të marrë një avantazh të caktuar konkurrues, shtetet kanë luftuar për territor, burime, njerëz dhe dominim të natyrave të ndryshme. Megjithatë, në rrjedhën e evolucionit të shoqërisë dhe zhvillimit të diplomacisë, shkaqet e luftës tanimë janë më komplekse. Rasti i konfliktit të tanishëm Rusi-Ukrainë provon se nuk janë të rralla rastet kur një shtet sulmon shtetin sovran fqinj, duke u thirrur në mbrojtjen e pakicave të veta atje, që luajnë rolin separatist dhe të viktimës në këto raste, duke i dhënë shkas të mjaftueshëm shtetit amë për invazion të armatosur, e që në fakt shpesh është një pasqyrë e situatës në terren.

Në rastin e tanishëm të Ukrainës është edhe përsëritje e historisë: më 17 shtator 1939, Ministria Sovjetike e Punëve të Jashtme dërgoi një notë që t'i jepej urdhër trupave sovjetike

për të mbrojtur popullsinë ukrainase e bjelloruse që jetonin në Poloni. Në këtë mënyrë, kompleksiteti i ngjarjeve të sotme të luftës në Ukrainë krijon rrezik për zgjerim të luftës së armatosur ndërmjet më shumë vendeve evropiane.

Shumë kultura moderne zakonisht janë të prirura t'i konsiderojnë luftërat si veprim dinjitoz, edhe pse ato rezultojnë me shumë vdekje ose vuajtje të qenieve njerëzore. Kjo vjen pjesërisht nga fakti se lufta konsiderohet si një shenjë respekti dhe pjesërisht sepse pjesëmarrja në luftëra në shumë kultura është shenjë krenarie dhe guximi, në përpjekje për t'i shërbyer vendit duke e mbrojtur atë!

Çfarë është lufta?

Lufta shkatërron familjet dhe asgjëson vlerat më të çmueshme njerëzore. Njerëzit që kanë përjetuar luftën shumë shpesh nuk janë në gjendje të rivendosin ekuilibrin e tyre të brendshëm dhe të ribashkohen me familjen për shkak të dallimeve në qëndrimet ndaj luftës dhe qasjes së shoqërisë ndaj tyre, kështu që shpesh rezultojnë me kolapsin e sistemit tradicional të vlerave.

Në përgjithësi, vetë natyra e luftës dhe karakteri i saj kanë një ndikim shkatërrues në jetën e njerëzve. Pavarësisht se lufta mund të shkaktojë dëme dhe tortura të mëdha në jetën e njerëzve të përfshirë në të, në varësi të situatës ajo është edhe e justifikueshme. Për shembull, nëse shteti përfshihet në luftë si një mënyrë vetëmbrojtjeje nga shfarosja apo deportimi, atëherë ajo është e justifikueshme, siç ishte lufta çlirimtare e UÇK-së 1998-1999, që u përkrah nga shumica e botës demokratike.

Lufta ka fytyrën e tmerrit, shkatërrimit dhe shpërfaq mizorinë e njeriut ndaj njeriut në formën më të tmerrshme, prandaj STOP LUFTËS!

Përjetësisht mirënjohje, veprës tuaj sublime

Mbi luftën Nacional Çlirimtare shpesh aludohet, madje shumë 'syresh' dhe gjykojnë mbi pjesën më të rëndësishme të historisë shqiptare, duke e tjetërsuar dashakeqësisht për t'i zbehur vlerën e padiskutuar që ka.

Viti 2024 përkon me 80-vjetorin e Çlirimit të Shqipërisë, ditë për të cilën dhanë jetën 28 mijë bijë dhe bija. Nga çdo krahinë u bënë bashkë për t'i dhënë lirinë atdheut të tyre, kësaj toke, të cilën e gëzojmë ne sot.

Misioni jonë është të kujtojmë veprën e tyre, kjo për t'iu lënë brezave që vijnë pas, arkivin më të vlerë të historisë shqiptare. Mes mijëra prej tyre ishin dhe Hasan Rakipi dhe Loni Nako.

Hasan Rakipi (1927-1953) ka lindur në Pojan të rrethit Korçë, në vitin 1927. Familja e tij dhe ai vetë kanë qenë të lidhur me Lëvizjen Antifashiste Nacional Çlirimtare qysh në fillimet e saj. Në vitin 1943 aktivizohet me njësitet guerile dhe rininë antifashiste. Në qershor 1944 del partizan dhe inkuadrohet në Brigadën XV Sulmuese. Merr pjesë në të gjitha luftimet dhe betejat që zhvilloi brigada deri në çlirimin e vendit, duke u dalluar si partizan i guximshëm dhe trim. Pas çlirimit ka qëndruar në radhët e ushtrisë deri në vitin 1949, ku në provokacionet e gushtit ka luftuar me trimëri për mbrojtjen e kufijve të Atdheut tonë. Për këtë është dekoruar me Medaljen e Trimërisë.

Më vonë është kthyer në fshatin e tij, në Pojan, ku pushteti i atëhershëm e ngarkoi me detyra të tjera. Ai dha një kontribut të veçantë në zhvillimin e fshatit dhe ngritjen e kooperativës bujqësore nga ku u zgjodh edhe në drejtimin e saj si nënkryetar. Kudo ka qenë një djalë energjik, i matur dhe i drejtë. Në mbrëmjen e 3 shtatorit të viti 1953, ishte diktuar një bandë diversantësh në zonën e Podgories. Nevojitej mobilizimi i forcave vullnetare të Pojanit, por edhe të fshatrave të tjerë përreth për asgjësimin e saj. Në këtë kohë ai ishte edhe sekretar i organizatës bazë të partisë së fshatit Pojan dhe si i tillë e ndjeu për detyrë të merrte pjesë në asgjësimin e armiqve të fshatit dhe të pushtetit, për ruajtjen e kufijve të vendit dhe të pronës së kooperativës. Hasani ishte ndeshur edhe herë të tjera me grupe diversantësh, kur ishte pjesë e repartit të Mbrojtjes së Popullit dhe si i tillë kishte fituar eksperiencën e nevojshme. Ai ishte i pari që u nis për të ndeshur me banditët. Ishte kjo një sfidë e re për të. Si në Pojan edhe në Podgorie, fshatarët kishin rrëmbyer armët për të mbrojtur vendin, pronën dhe pushtetin e tyre. Hasani ishte i pari që doli në sheshin në mes të fshatit i pasuar edhe nga shumë bashkëfshatarë. Të gjithë filluan marshimin drejt Koritës. Hasani



HASAN XHAFER RAKIPI

nga Pojani dhe Loni nga Podgoria pasi ndanë zonat e veprimit, u sulën mbi strofkën e kriminelëve. Nata e errët dhe pozicionet e përgatitura të kriminelëve fillimisht e bënë të vështirë manovrën e rrethimit të asgjësimit të tyre. Krismat e armëve jehuan tutje, në thellësi të fshatrave. U zhvillua një betejë e ashpër. Banda armike u asgjësua. Por në këtë luftim mbetën të vrarë Hasan Rakipi dhe Loni Nako. Ai së bashku me Loni Nakon, në korijen mbi fshatin Koritë, atë natë të datës 3 shtator 1953, dhanë jetën në lule të rinisë për të mbrojtur pushtetin e popullit dhe fitoret e arritura me aq gjak e sakrificë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në raportin e mbledhjes, në shënimet e fundit Hasani kishte shkruar: "Ndaj armiqve duhet të jemi të pamëshirshëm. Të jemi kurdoherë ushtarë të denjë të Atdheut, të gatshëm për të dhënë edhe jetën, po të paraqitet nevoja." Hasani ra dëshmor në moshën 26-vjeçare, duke lënë bashkëshorten (veterane e LANÇ-it) me dy fëmijë të vegjël (vajza vetëm 6-muajshe dhe djalë ende pa ardhur në jetë).

Muajt e fundit në jetën e një heroji

Ali Demi, (1918-1943) ky bir i Çamërisë martire, ishte një nga heronjtë që spikati në luftën për çlirimin e Shqipërisë nga zgjedha fashiste, për krijimin e një Shqipërie të lirë, republikane e demokratike. I ikur për studime që fëmijë në Konviktin “Çamëria” të Sarandës, më pas ai vazhdoi studimet në gjimnazin e Gjirokastrës, ku bashkë me shokun e tij të ngushtë Themo Vasi, organizoi një nga protestat e fuqishme të këtij gjimnazi kundër monarkisë, duke u vendosur në ballë të një lëvizje revolucionare. I përjashtuar nga shkolla, ata erdhën në Tiranë, ku vazhduan studimet dhe u angazhuan në grupet e para komuniste, duke organizuar greva e demonstrata antifashiste. Në prillin e vitit 1942, ai arrestohet, burgoset dhe kërkohet ta internojnë në Itali, por menjëherë dënohet me 25 vjet burg. Në burg, për organizimin e protestave dhe si reprezalje të aksioneve antifashiste në Tiranë, atë kërkohet ta pushkatojnë, por ishte protesta e brendshme e burgut që i bëri fashistët të tërhiqen. Pasi organizoi ikjen e të burgosurve politikë nga burgu, në prill 1943, Aliu iu bashkua çetave partizane, dhe pas detyrës si komisar i batalionit të Çermenikës, ai u dërgua në Vlorë, në një kohë të vështirë të luftës dhe të përçarjes në gjirin e komunistëve...

Muajt e fundit në jetën e një heroji

Ja si e kujtojnë disa nga bashkëluftëtarët e tij Ali Demin: Ai ishte i thjeshtë dhe njeri që mendonte shumë. Nuk dinte të imponohej dhe të diktonte... kishte një tjetër metodë pune me njerëzit. Me Aliun mund të bisedoje lirshëm.

Në këto ditë të vështira, Aliu shkonte fshat më fshat dhe fliste me fshatarët, duke u folur për luftën dhe se ora e lirisë po afrohej. Ishte e rëndësishme që partizanët të rinj të mbushnin radhët e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare dhe në veçanti për formimin e Brigadës së V-të Sulmuese. Nga fillimi i shtatorit Aliu, i shoqëruar nga luftëtarët të zonës dhe me automatik në krah, kishte marrë të përpjetën e Malit të Çikës dhe netëve qëndronte në stanet e barinjve. Kishte zbritur në Vuno dhe ishte takuar me komunistët dhe luftëtarët e krahinës.

Pranvera dy hapa afër

19 dhjetor 1943. “Atë mbrëmje bëmë një mbledhje të rëndësishme në një nga shtëpitë bazë, – më tregoi Dhimitër Mandro një ditë, – ku Aliu foli për situatën e luftës dhe rolin e dëmshëm të ballistëve, të cilët kishin bërë tashmë pakt me gjermanët. Qëndruam deri në mesnatë. Pastaj dolëm të flinim në një nga bazat e tjera. Ramë të flinim. Pa zbardhur mirë, u dëgjuan trokitje tek dritarja. U zgjuam. Dikush na njoftoi se shtëpia ishte rrethuar nga ballistë, të udhëhequr nga Ismail Golemi. Aliu dhe Pano Dhimgjoka morën automatikët dhe të tre nxituam drejt malit që t’i largoheshim Kaninës. Por pas pak, pas tri katër shtëpish një zë thirri: ‘Ndal! Dorëzohuni! Jeni të rrethuar!’...

Kanina po zgjohej, por krismat e para e zgjuan gjithë popullin. Pas pak, duke e kuptuar se s’kishin rrugë për të çarë rrethimin, Aliu u tha dy shokëve të tij se ishte më mirë të ktheheshin drejt shtëpisë ku ishin dhe të rezistonin deri sa të vinte mbrëmja dhe pastaj të tentonin të çanin rrethimin. Ishin të vetëm dhe shtigjet e fshatit nuk i njihnin ashtu siç i njihnin fshatarët. Me nxitim u kthyen drejt shtëpisë dhe u thanë njerëzve që banonin në të që të largoheshin që të mos vriteshin nga armiqët. Lufta filloi e ashpër. Pano Dhimgjoka zuri vend tek dera që të mos lejonte njeri të afrohej nga rruga përballë hyrjes së shtëpisë. Aliu ishte në një nga dritaret dhe në tjetrën Dhimitri. Thirrjet nga jashtë për t’u dorëzuar vazhdonin. Por si përgjigje kishte vetëm shkrehje armësh. Tashmë drejt Kaninës po afroheshin dhe forca gjermane. Rrethimi ishte i jashtëzakonshëm. Madje gjermanët zunë pozicione dhe në kalanë e Kaninës nga ku mund të vëzhgonin çdo lëvizje. Por rezistenca ishte e fortë.

Nga dreka, pasi e panë se ishte e vështirë që të rrethuarit të



dorëzoheshin, ballistët mblodhën popullin në qendër të fshatit dhe i kërcënuan që t’i dorëzojnë të rrethuarit. Por si? Askush nuk pranonte të shkonte drejt tyre. Ndërkohë, nga kodra filloi gjëmimi i artilerisë. Aliu e kuptoi se gjylet e para ishin thjesht për t’i impresionuar dhe se gjermanët nuk mund të qëllonin, pasi rrezikonin të qëllonin shtëpi të tjera. Por një orë më vonë, forcat që i rrethonin bënë dhe një përpjekje tjetër për t’u afruar. Filloi një shkëmbim i ashpër zjarri. Aliu dhe Dhimitri qëllonin nga dritare të ndryshme për të dhënë përshtypje se ishin një grup i madh luftëtarësh dhe jo thjesht tri persona. Në një moment qetësie, Aliu i tha Dhimitrit t’i thoshte Panos të bëhej gati që të çanin rrethimin. Nuk kishte asnjë rrugëdalje tjetër. Forcat balliste i kishin larguar njerëzit e shtëpive përreth dhe tani po fillonin të qëllonin shtëpinë me artileri. Kur Dhimitri zbriti, Panon e gjeti në frymën e fundit. I shtrirë pranë derës ai ishte mbushur në gjak. Një breshër e kishte qëlluar për vdekje. – ‘Pano është vrarë!’ – i tha Dhimitri Aliut. Për të dy ishte e dhimbshme të shihnin shokun e tyre të vrarë. Aliu dhe Dhimitri e përqaftuan si për t’i dhënë lamtumirën e fundit dhe menjëherë u sulën nga dera dhe çanë përpara duke qëlluar...’. Dhimitri vazhonte tregimin e tij: ‘Gjithnjë duke qëlluar, kaluam disa shtëpi rradhazi, por ndërkohë Aliu më pa që isha plagosur dhe u rrëzova. Ndaloj dhe kërkoi të më ngrinte. ‘Mbahu, edhe pak’, më tha, dhe më tërhoqi me vete, por unë isha mbushur gjithë gjak. Ç’të bënte. Krismat tutje vazhdonin. Artileria qëllonte duke goditur muret e shtëpisë. Gjermanët ende nuk e dinin se luftëtarët e kishin lënë ‘shtëpinë-kështjellë’. – ‘Më lër Ali, nuk mundem!’ – i thashë Aliut. Por ndërkohë Aliu dalloj një ferrë të madhe dhe u sul duke më tërhequr. – ‘Shiko Miti, do të të fsheh këtu. Mos lëviz që këndeje. Në mbrëmje do të dërgoj shokët të të marrin!...’ – Kështu më tha dhe u largua duke qëlluar... Më shtrëngoi dorën dhe kapërceu shtëpi të tjera. Që nga ai çast nuk e pashë më... nuk do ta shikoja më kurrë atë njeri me një kurajë të jashtëzakonshme, i cili besonte se kjo luftë do të sillte një Shqipëri të re, të bashkuar dhe të begatë. Edhe pse kishte tetë orë që luftonin, lodhjen Aliu nuk e ndjente. Kaloi dhe fushën, pa u kuptuar nga njeri, pasi të gjithë ishin përqendruar nga shtëpia ku mendohej se partizanët atje ende luftonin. Po linte Kaninën dhe po drejtohej nga ‘Kodra e Dheut të Bardhë’... Aliu mendonte se më së fundi e kishte çarë rrethimin dhe tashmë nxitonte drejt Ujit të Ftohtë. Nga ullisat poshtë dukej deti. Por pikërisht në atë moment, një breshër mitralozi u shkreh mbi të. Gjermanët i kishin zënë të gjitha pikat nga ku mund të kalohej. Tutje ende gjëmonin të shtënat e artilerisë. Në sytë e Aliut ullinjtë dukej sikur binin e rrëzoheshin me rrapëllimë, bashkë me të. Pastaj gjithçka ra në heshtje. Heshti përgjithnjë...’.

Pesare Xhezo Kërroça, Këze Shahin Sulçaj, nënat shqiptare që dhanë jetën për atdhe



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

(Homazh dhe mirënjohje me rastin e 80-vjetorit të ekzekutimit nga pushtuesit fashistë në fshatin Vajzë të Vlorës, të Këze Shahin Sulçaj (28.5.1898 – 25.12.1943) dhe Pesare Xhezo Kërroçaj (22.3.1906 – 30.1.1944), heroinave labe që u ekzekutuan nga nazifashistët gjermanë gjatë LANÇ-it)

Gratë shqiptare, përgjatë shekujve të mbijetesës nga pushtuesit, kanë luftuar krah për krah burrave, kanë qenë burim frymëzimi për trimëri e mençuri nëpër breza. Ato kanë qenë nëna që kanë lindur trimërinë në djepe dhe kanë përkundur ëndrrat e lirisë së truallit arbëror. Gratë shqiptare që shkruan lavdi me gjakun e tyre janë të shumta në të gjitha betejat, por veçanërisht përgjatë LANÇ-it në rreshtat partizane u rreshtuan qindra gra e vajza në formacionet luftarake, pa llogaritur qindra mijëra të tjera që mbështetën luftën me ushqime, veshmbathje e transportim armësh e municionesh në drejtim të frontit. Historiku i fshatit Vajzë njih dy shembuj sinjifikativ të kontributit të dy grave heroina të këtij fshati, në të cilin shkruhet respektivisht: “Këze Shahin Sulçaj, nëna e dëshmorëve Mete e Delo Mystehak Sulçaj, u vra nga nazistët gjermanë në afërsi të shtëpisë së saj, më 28.12.1943. Ajo kujdesej shumë për partizanët dhe me çka i ndodhej i ushqente. Të dy djemtë e saj ishin në luftë në formacionet partizane. Ajo gjithçka e kishte vënë në shërbim të luftës (Këze Shahin Sulçaj, nëna e dëshmorëve Mete e Delo Mystehak Sulçaj, ishte me origjinë nga fshati Beçisht i Tepelenës; ndërsa “Pesare Xhezo Kërroçaj, ka qenë një grua fshatare e varfër, e cila me sa mundësi që kishte dhe me çfarë i ndodhej në shtëpinë e saj jepte kontributin e saj për luftën pa u kursyer. Gjermanët dhe bashkëpunëtorët e tyre e kapën Pesaren, duke u larguar nga një kasolle dhe e pushkatuan me pretekstin se ajo ndihmonte partizanët me ushqime, strehime etj.”.

Jeta dhe aktiviteti i të pushkatuarve të fshatit Vajzë është trajtuar në dekada si pjesë e krenarisë së fshatit të martirizuar përgjatë luftës, fshat që për mbështetjen që i dha formacioneve çlirimtare ishte djegur tre herë nga fashizmi. Gratë e pushkatuara kishin tipare të përbashkëta të gruas qëndrestare dhe kundërshtuese të pushtimit. Këze Shahin Sulçaj, që ishte edhe nëna e dëshmorëve Mete e Delo Mystehak Sulçaj, kishte lindur në Beçisht të Tepelenës më 28.5.1898, ndërsa Pesare Xhezo Kërroçaj ishte lindur në fshatin Vajzë të Vlorës, më 22.3.1906.

Vajzëria e tyre ishte një periudhë të pamundësisë për ta jetuar periudhën e fëmijërisë, pasi fshatrat e tyre përngjanin për nga jetesa e vështirë ekonomike, megjithëse atyre nuk u trembej syri para asnjë vështirësie. Ato ishin rritur me halle dhe hallat nuk iu ndanë edhe kur u bënë nëna. Në Labëri thonë: “dardha bie nën dardhë”. Oxhaku familjar i kishte mëkuar që në vajzëri me dashurinë për atdheun dhe urrejtjen ndaj pushtuesve. Të dyja ishin gra trimëresha, pasi nuk i mposhtën as kërcënimet e fashistëve dhe as vdekja. Jetuan në familje të varfër, por krenare dhe me vlerat e larta njerëzore e atdhetare. Ato u bashkuan me gjithë gratë antifashiste të fshatit Vajzë dhe ndihmonin me luftën çlirimtare me gjithçka mundeshin. Ishin nëna e gra të zgjuara, të gojës, si dhe të patrembura nga vështirësitë e jetës, ato i shikoje shpesh që të kuvendonin edhe me burrat e fshatit për problemet themelore dhe më të mprehta të fshatit në kohë pushtimi.

Pesarja është kapur nga fashistët dhe bashkëpunëtorët në janar 1944-ës, pranë shtëpisë së saj dhe me gjithë përpjekjet që bëri për t'u shpëtuar fashistëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre, nuk i shpëtoi ndëshkimit fashist të breshërisë së plumbave. Kriminelët nazistë që erdhën në Shqipëri si “kalimtarë” të mbështetur edhe nga disa bashkëpunëtorë kishin mbërritur edhe në zonat “problematiche”, që rebelimin ndaj pushtuesve e kishin në gjak. Që të dy gratë sikurse gjithë nënat në fshatin Vajzë, Këza dhe Pesarja njiheshin si strehuese të forcave partizanëve dhe aktiviste tepër aktive për mbështetjen e Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Për qëndrimin e saj të vendosur pro LANÇ-it dhe duke mos mundur që ta detyronin të tregonte bazat partizane dhe mbështetësit e luftës partizane e pushkatuan në oborrin e shtëpisë, në fshatin e saj në Vajzë të Vlorës. Akti i saj si dhe qëndrimi i palëkundur trimëror edhe përpara pushkatimit ishte një burim frymëzimi i një nëne heroinë për brezat, për atdhedashurinë dhe papërkulshmërinë edhe në situatat më kërcënuese për jetën edhe në momentet kur i morën jetën me vdekje skuadra naziste e pushkatimit. Breshëria e automatikut ia preu jetën në mes, në moshën 38 vjeçare, Pesare Kërroçaj,



një nënë e fortë labe me virtyte të larta atdhetarie në mesditën e 30 janarit 1944. Shembulli i saj u bë burim frymëzimi për gjithë vajzat e gratë e fshatit Vajzë dhe mbarë krahinës në mbështetje të Luftës së Madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare. Pushkatimi i Pesare Kërroçaj me pretekstin se ndihmonte partizanët dhe e kishte kthyer shtëpinë në bazë për mbështetje për partizanët, nuk i trembi dhe nuk i stepi bashkëfshataret e saj, nënat dhe vajzat e fshatit të Vajzës, që ishin bërë mbështetje e fuqishme për luftën antifashiste në fshat dhe në mbarë krahinën. Fakt është se në gati gjysmëshekulli, Pesare Xhezo Kërroçaj është trajtuar si dëshmore edhe pse nuk i ishte akorduar titulli me vendim juridik, kur në fakt e kishte merituar prej kohësh. Në radhët e librit të ish-zëvendësministrit të Mbrojtjes Popullore, ushtarakut madhor Maliq Sadushi, “Fshati ynë i mirë, Histori e fshatit Vajzë”, ka një gjykim e sugjerim si amanet brezash: “Okupatori nazifashist në bashkëpunim me tradhtarët, në çdo operacion që ndërmori bëri terror në popull. Ata kapën e pushkatonin gra e fëmijë të pafajshëm. Krime të tilla bënë edhe në Vajzë, duke kapur e pushkatuar pa gjyq nëntë vetë, midis tyre edhe dy gra. Po të merret parasysh aktiviteti i këtyre viktimave në dobi të luftës dhe mënyra se si janë kapur nga armiku, qëndresa e tyre etj., ata me të drejtë duhen quajtur dëshmorë të LANÇ-it dhe jo viktima. Ky problem mbetet i hapur edhe në organet kompetente dhe mund e duhet të shikohen në të ardhmen... ligjërisht ky problem nuk është zgjidhur ende”. Por populli ynë ka një maksimë proverbiale që thotë se, “e drejta zhytet por nuk mbytet”. Këze Sulçaj dhe Pesare Kërroçaj ranë nga breshëria e plumbave të falangave fashiste. Ato ranë në fushën e nderit për të mos u harruar dhe për të mos vdekur. Ata ngejnë në kujtimet e fshatit Vajzë, të krahinës, ndërkohë që kryeplaku dhe pleqësia e fshatit Vajzë e ka evidentuar si një ndër dëshmorët që plotëson kriteret ligjore, bazuar në ligjin nr. 109/2018, datë 20.12.2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, në nenin 5, “Kriteret për shpalljen e statusit “Dëshmor i atdheut”, Pika “d” në të cilën thuhet që: “Shpallen Dëshmorë të Atdheut shtetasit shqiptarë të pushkatuar për pjesëmarrjen në formacionet luftarake të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare apo për mbështetje të pjesëmarrësve të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, si dhe të pushkatuar për hakmarrje nga pushtuesit nazifashistë apo bashkëpunëtorët e tyre, nga data 7 prill 1939 deri më 9 maj 1945”.

Është më se e natyrshme se ligji ka hapur dritën jeshile që Këze Sulçaj dhe Pesare Kërroçaj, të shpallen me titullin “Dëshmor i Atdheut” bazuar në kriteret ligjore. Propozimi për herë të parë për t’i shpallur dëshmore është bërë në vitin 1989 - 1990, por me kalimin në sistemin e ri demokratik, dokumentacioni ngeli i paplotësuar në ish-Komitetin Ekzekutiv të Këshillit popullor të rrethit të Vlorës. Prishja e sistemit e shtyu procesin e përgatitjes së dokumentacionit në pothuaj mbi një çerek shekulli. Gratë dhe vajzat në fshatin Vajzë, në Labëri dhe në të gjithë Shqipërinë, u afirmuan si luftëtare të lirisë dhe progresit shoqëror e politik me aktivitetin dhe shembullin e tyre, edhe në zonat më të thella të vendit. Ashtu si bashkëluftëtarët e tyre në formacionet partizane, ato i rezistuan faktorëve të rrezikut në luftë, i rezistuan vështirësive të terrenit natyror e të motit, i rezistuan urisë dhe pagjumësisë, i rezistuan torturave e plagëve të marra në luftë, u përballën me burgjet fashiste dhe kampet e përqendrimit e të shfarosjes në masë, u përballën me dhimbjen e ndarjes nga jeta të njerëzve të tyre të afërt dhe luftëtarëve të çetave, batalioneve e brigadave partizane. Shembulli më sinjifikativ janë edhe ekzekutimi i dy grave të ekzekutuara nga fashistët në fshatin Vajzë të Këze Sulçaj dhe Pesare Kërroçaj. Shembulli i kontributit të këtyre grave luftëtare të lirisë, dëshmore e heroina duhet të njihet, respektohet dhe të mbrohet nga brezat, si modeli luftarak i qëndresës për ekzistencën e mëvetësinë e shtetit dhe kombit. Krahas akteve të larta të trimërisë dhe të vetëmohimit të shumë grave e vajzave si, Bule Naipi, Persefoni Kokëdhima, Liri Gero, Margarita Tutulani, Shejnaze Juka, Mine Peza, Nimete Progonati, Zonja Çure, Qeriba Derri, Fato Berberi, Qybra Sokoli, Ylberë Belibashi, etj., kishte edhe gra që u ekzekutuan si mbështetëse të fuqishme të kësaj lufte të madhe të shqiptarëve. Gratë e fshatit Vajzë dhe të mbarë Labërisë sikurse gratë në mbarë shqiptarinë në Luftën Nacionalçlirimtare, ishin kontribuuese reale të çlirimit kombëtar e shoqëror të saj. Lufta ishte në njëjtën kohë edhe një shkollë e madhe për emancipimin shpirtëror të gruas, ku në fakt gruaja shqiptare theu mjaft koncepte e praktika të vjetra dhe afirmoi veten e saj të denjë për një shoqëri të lirë dhe përparimtare. Gjaku i grave të fshatit Vajzë, i Këzes dhe Pesares ishte gjaku që u derdh për lirinë e Shqipërisë dhe kombit shqiptar, prandaj edhe meriton vlerësim, nderim dhe mirënjohje në ditët tona dhe në brezat që do të vijnë.

Udhëtim në memorien e një Kundëradmirali

Intervistë me kundëradmiralin Muharrem Kuçana, ish-komandant në Forcat Detare



PROF. ASC. DR. GËZIM MUSTAJ

“

Redaksia e shtypit ushtarak, falënderon bashkëpunëtorët tanë, ish-ushtarakë me kontribute të çmuara në profesionin e tyre në ‘Mbrojtje të Atdheut, pa kursyer as jetën’, për përkushtimin dhe dëshirën e madhe për të sjellë pranë redaksisë jetën dhe aktivitetin e miqve, kolegëve, bashkëpunëtorëve të tyre në rrugëtimin e vështirë dhe sfidues të ushtarakut.

Edhe pse përtej oqeanit, zemra e tyre është në Shqipëri. Tek çdo fjalë lexuesit e shtypit do shohin mallin dhe dashurinë që kanë marrë me vete, në ato vise të largëta.

Mirënjohje të nderuar zonja dhe zotërinj, ish-ushtarakë që ende vazhdoni dhe kontribuoni për atdheun tonë.



Përschendetje Admiral Kuçana!

Kemi menduar të bëjmë një cikël intervistash dhe kemi kënaqësinë që intervistën e parë ta nisim me ju, si një ish-ushtarak madhor i ushtrisë shqiptare dhe anëtar i vjetër i shoqatës. Më lejo ta fillojmë intervistën me një pyetje që na kthen pas në kohën e fillimeve Tuaja:

Nëse jam i saktë, në moshën 12-vjeçare ju filluat hapat e para të karrierës ushtarake! Pse K/Admiral Kuçana la flladin e bjeshkëve të bukura të Tropojës për flladin e detit?

Unë kam veshur uniformën ushtarake në moshën 12-vjeçare, në shkollën e lavdishme “SKËNDERBEJ” kam filluar në klasën e pestë, 7-vjeçare. Nuk mund të lë pa thënë dy fjalë për këtë shkollë që përcaktoi rrugën e jetës

time. Veç uniformës me vija të kuqe, me të cilën krenoheshim kur visheshim, ishin edhe gjërat e tjera ushqimi, fjetja, shkolla, etj. Aty, në ato vite kish edhe nxënës të klasës së parë e të dytë fillore. Ishte koha kur vendi kishte shumë mungesa. Buka ishte me racion e me triska. Ne shkonim një muaj në vit në shtëpi me leje dhe shkolla na jepte fletë shoqërimi, me të cilën prindërit tanë shkonin në Degë Ushtarake e merrnin ushqime që na dilnin për tërë familjen për atë muaj. Në vitin 1958 mbarova klasën e tretë gjimnaz. Kishin filluar të vinin anijet luftarake nga ish-BS, flitej edhe për Nëndetëse, prandaj u shtua numri i kursantëve që do shkonin për studime jashtë. Nga ata që kishin mbaruar maturën nuk mjaftonin se ca dolën të paaftë e ca nuk kishin nota të larta, prandaj morën nga vitet e treta 10 veta që ishin më mirë me mësim, midis tyre isha edhe unë. Mbërritëm në shkollën e lartë për nënujës, në Riga të Lituanisë. Aty e në vazhdim u dashurova me detin me anijet luftarake mbi e nënujëse, po asnjëherë nuk e harrova flladin e bjeshkës e erën e luleve të vendlindjes.

Çfarë kujtoni në ato vite të para të studimeve? Si ishte të studioje jashtë vendit dhe për marinë?

Sapo mbërritëm në shkollë, filluam një kurs gjuhe rreth tre muaj e pastaj vitin e parë kishim vështirësi në njohjen e gjuhës ruse. Mbasi mbaruam vitin e parë vizituam shumë anije luftarake, shumë muzeume të anijeve të komanduar nga heronj të Luftës Dytë Botërore. Një vit më vonë Shkolla u transferua në Shën Petërburg, (Leningrad) edhe aty u mësua me kërkesat dhe kishim një etje për të ditur gjithçka se ishin të gjitha gjëra të reja. Në vitin 1961 si rezultat i prishjes së marrëdhënieve me ish-BS ndërpreme studimet pa mbaruar vitin e fundit dhe u kthyem në Atdhe. Po në këtë vit u hap shkolla e marinës me studentët e kthyer edhe nga shkollat e tjera e aty pas një viti u diplomuam. Unë dhe shumë shokë të mi, morëm gradën "Toger" se ishim me rezultate të mira dhe u emërova me kërkesën time në Sazan në Dragaminën e madhe.

Ju keni një karrierë të gjatë ushtarake. Cila ka qenë detyra më sfiduese që keni patur?

Në Sazan shërbeva 11 vjet, duke kaluar nga komandant organi në komandant anije, komandant grupi e vendbazimi. Gjatë këtyre viteve unë mbarova me korrespondencë në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin Histori-Filogji, degën Histori-Gjeografi. Në vitin 1974 u transferova në Shkollën e Lartë të Marinës në Vlorë në detyrën e shefit të degës mësimore (shef i shtabit).

Në vitin 1983 mbarova Akademinë Ushtarake në Tiranë dhe u emërova Komandant i Shkollës së marinës. Shkolla e Lartë e Marinës ishte hapur kur ne u kthyem nga jashtë për të vazhduar studimet, por më vonë lindi nevoja urgjente për kuadro për Flotën tregtare po edhe të peshkimit, prandaj u hapën edhe degët e tyre, që kërkonin programe të diferencuara. Uniforma dhe rregullat ishin për të gjithë ushtarakët, megjithatë ia dolëm me sukses, duke nxjerrë kuadro për flotën luftarake, tregtare e të peshkimit. Detyra e komandantit të Shkollës së Marinës, ndoshta ishte më sfiduesja, por jo më e vështira.

Ndonjë kujtim nga deti që ka mbetur në memorien tuaj?

Në vitin 1988 u emërova Komandant i Bazës ushtarake detare të Vlorës, të cilën e njihja mirë, se kisha shërbyer në fillim të karrierës ushtarake. Problemet aty ishin të shumëllojshme po kryesoret ishin; gatishmëria luftarake e anijeve, ruajtja e kufirit detar, stërvitja etj. Në fillim të vitit 1990 situata në Bazë filloi të liberalizohej me shpejtësi. Kishte moszbatim urdhrash, largime nga shërbimi, tentativë për marrje armësh etj. Më vonë anijet e peshkimit filluan të dilnin në det për peshkim e të iknin në Itali (sigurisht të mbushur me njerëz nëpër bregdet). Në një nga ditët cisterna që furnizonte me ujë Sazanin në mezokanal merr kthesën për Perëndim drejt Italisë. Në të kishte edhe pasagjerë që do vinin në Sazan, ku edhe banonin. Në Bazën e Durrësit iku Kateri silurues me gjithë ekuipazhin drejt Italisë. Ishte dhënë urdhri që të





forcohet gatishmëria. Në Sazan kishim 2 Katera silurues (KS) me silurë brenda, ndërkohë dy komandantët e KS-së të gatshëm po bëheshin gati të merrnin anijet dhe të iknin duke marrë edhe të tjerë me vete. Komandant Regjimenti i KS-së ishte Bujar Hasani. Me sa duket e sinjalizoi dikush dhe ai shkoi vetë në bankinën e KS-së, hoqi oficerët nga shërbimi, mori vetë armën dhe bëri roje deri në mëngjes, duke mënjeluar ikjen. Shtroheshe pyetja: A mund të ndaloheshin këto lloj arratisjesh? Sigurisht që po, por duheshe të vrisje njerëz e të godisje anije të mbushura me njerëz, gjë që nuk e bëmë. Urdhrrat nga lart vinin të paqartë: “NDALOJE OSE KTHEJE ME TË GJITHA MËNYRAT”, këtu kishin parasysh edhe hapjen e zjarrit po pa e përmendur. Në një nga këto ditë, kishte ardhur një anije transporti e flotës sonë tregtare me grurë në portin e Vlorës. Aty mbledhet një turmë me njerëz dhe hynë brenda e u nisën për Itali. U informova nga pika kufitare se kishin hipur në anije rreth 300 veta midis tyre edhe gra e fëmijë. Bëmë përpjekjet tona për ta ndaluar, por nuk u kthye. Më mori në telefon direkt Ministri i Mbrojtjes e me thotë: - “Ndaloje anijen me çdo kusht, po nuk u bindën nxirr katerat silurues e godite pa dalë nga Mezokanali”. I thashë ka 300 veta brenda me gra e me fëmijë. Më thotë se për ty ajo ka grurin e popullit e vepro. Kisha komisar të BUD të ndjerin Halil Lelin. Ai ishte edhe anëtar i KQ edhe atë e mori në telefon R. Alia e i tha: - “Pse nuk zbatoni urdhrin?”, - “Nuk mund të vrasim popullin e Vlorës shoku Ramiz”, - i tha ai. Bujar Hasanit i thashë të dilte me dy KS pa silurë dhe të qëllonte me mitraloz poshtë

në vijën e ujit, e ai ashtu bëri. Anija iku, por nga dallgët me ngritje e ulje ishte vrarë një njeri e plagosur dy - tre të tjerë. Ditën e nesërme ne të dy, unë e Halili u pushuam nga detyra dhe u liruem nga ushtria. Kështu mendova se e mbylla karrierën ushtarake, por nuk ndodhi ashtu.

Detyra më e lartë që keni mbajtur ishte Komandant i Forcës Detare. Si u ndjetë, kur në vitin 1994 morët gradën madhore të K/Admiralit dhe u emëruat si Komandant i FD-së?

Në vitin 1993 më ftuan të kthehesha si këshilltar i Ministrit për Flotën Luftarake. Më thirri Ministri i Mbrojtjes e më tha për detyrën. Unë u mendova e nuk i dhashë përgjigje menjëherë. Ai mu drejtua: - “Unë nuk po të ftoj të vish në parti por po të kërkoj si specialist i marinës dhe si patriot të punosh se të kanë kërkuar vetë oficerët e Flotës. Fillova punë si këshilltar pas 3-4 muajsh ish-komandantin e Flotës, Edmond Zhupanin e dërguan për studime në Akademi në Gjermani e unë u vesha përsëri me gradën “Kapiten i Rangut Parë” (kolonel). Puna ishte e vështirë, ishin rikthyer njerëz që ishin zhveshur për probleme biografike etj. Pas disa muajsh u bë një ceremoni gradimi dhe midis të tjerëve u gradova edhe unë, “Admiral”. Të them të drejtën nuk ndjeva ndonjë gëzim sepse aty u graduan gjeneralë, oficerë me vjetërsi shërbimi 5-10 vjeçare, u gradua kapiteni, gjeneral me katër vje... etj. Në të gjitha ushtritë gradat jepen me kohë e merita shërbimi, unë për vete në 1964 kam qenë kapiten i dytë, ndoshta mbas 30 vjetësh më takonte të gradohesha. Fillova detyrën si Komandant i Flotës. Kishte çdo ditë ngjarje nga më të çuditshmet. Flota jonë ishte ngarkuar të siguronte embargon e ish-Jugosllavisë, brenda ujërave tona territoriale, ndërsa jashtë në ujërat ndërkombëtare ishin Fregatat e NATO-s. Vinin cisternat me karburant e qëndronin në Korfuz gati për të gjetur mundësinë për të kaluar në Ulqin. Ne e kryem këtë detyrë me nder.

Në vitin 1996 me ftoi në SHBA për vizitë Komandanti i Rojës Bregdetare. Gjatë kësaj vizite më pritë ish-Komandanti i Flotës Amerikane, Admiral Borda në selinë e pritjes në Pentagon. Po atë ditë, pasdite, më thirrën në një takim në Departamentin e Shtetit, ku më pritë, Ndihmës Sekretari i Shtetit për embargon e ish-Jugosllavisë. Ai ishte në pritje me 11 veta, unë kisha vetëm një përkthyes. Na falënderoi për kryerjen e detyrës së ruajtjes së embargos nga deti dhe pastaj thanë që embargoja në Shqipëri shkelet në ujërat e brendshme, si në liqenin e Shkodrës, në lumin Buna etj. Ne ju sugjerojmë që t'i kontrollojë e të përgjigjet Flota Luftarake edhe për ato. Unë u shpjegova se këto janë me ligj në vartësi të degëve të brendshme e nuk varen nga ne, megjithatë unë ia transmetova ish-Presidentit të asaj kohe, por nuk u ndryshua gjë.

Gjatë periudhës që ju drejtonit FD-në, nga mesi i vitit 1994, ka ndodhur një incidentet në det me palën greke. Specifikisht diçka rreth urdhrin në vitin 1994 për minimin e kanalit të Korfuzit për të penguar ardhjen e anijeve greke, si u kthye urdhri nga minim real në minim imitues?

Në vitin 1994 aty nga muajt mars-prill u acarua shumë situata me Greqinë, diku në jug të vendit, Sarandë, Gjirokastrë, ishin arrestuar tre gazetarë grekë të akuzuar për spiunazh. Ata i nxorën edhe në gjyq dhe i dënuan në Tiranë. Në fund të asaj jave avionët grekë fluturuan mbi zonat e Gjirokastrës, Sarandës dhe Përmetit, ata hodhën shumë fletushka me sharje e kërcënime, midis të tjerash thoshin se së shpejti do zbarkonin në Sarandë e



do të çlironin "Vorioepirin". Situata u acarua shumë. Një pasdite vonë me thirrë Shefi i Shtabit dhe me thotë, përgatituni urgjent për të vendosur mina detare në gjirin e Sarandës, për të bllokuar zbarkimin e desantit grek në port. E pyeta, kush ka urdhëruar? Komandanti i Përgjithshëm më tha. U mundova ta sqaroja... se minat detare janë shumë të vështira për t'u çminuar e në qoftë se do t'i vendosim, do bllokojmë Sarandën për vete, se ato nuk çminohen as për shumë vjet e për mendimin tim nuk bën gjë Greqia, ajo është anëtare e NATO-s etj. Më kërkoi mendimin si t'u them eprorëve, e unë i thashë: të bëjmë një imitim, duke vendosur mina mësimore. Mbas disa orësh kur ne po përgatishnim dokumentet luftarake më thirrën e më thanë, që ne jemi dakord me mendimin tënd, por duhet ta bësh sot. E kundërshtova, sepse anijet dhe minat ishin në Vlorë e nesër mbrëma mund ta kryenim detyrën. Mirë më tha, veproni kështu. Unë mora tri anije, morëm minat mësimore e u nisëm afër mëngjesit. Bëmë imitimin e minimit dhe u kthyem në Palermo e pastaj në Vlorë. Në javët më vonë situata me Greqinë u bë dritë dhe kjo ngjarje u harrua. Nuk më ka pyetur kush kurrë për të, është rasti i parë që më keni pyetur.

Tani le të kthehemi tek ardhja juaj në Amerikë. Si e morët vendimin për të lënë vendin tonë, pas një karriere të pasur ushtarake, për të nisur një jetë të re përtej oqeanit?

Në Janar të vitit 1997 u lirova nga ushtria, pasi më propozuan që të shkoja këshilltar i presidentit për Flotën e Aviacionin e unë i falënderova po nuk pranova. Ngjarjet e atij viti i ndoqa me lot në sy. Anijet vidheshin e shkatërroheshin, silurët luftarakë e minat hidheshin në det, në Sarandë qytetarë grekë përdornin katerat silurues duke qëlluar me mitraloza e duke terrorizuar tërë qytetin. U shkatërrua e u vodh ushtria dhe flota. Unë isha në shtëpi, pasi më nxorën në pension. Të tre fëmijët i kisha jashtë shtetit e vendosa të largohem. Më dhanë leje qëndrimi këtu e vazhdoj jetën normalisht, por me shumë probleme shëndetësore.

A i përcjell zhvillimet në Shqipëri dhe veçanërisht në FA? A mendoni se vendi ynë dhe FA-të, janë në rrugën e duhur drejt ëndrrës evropiane?

Sigurisht që kam shkuar në Shqipëri dhe e ndjek situatën atje, e më duket që është në rrugë të drejtë për në BE. Gjendja po shkon gjithmonë drejt përmirësimit. Reforma në drejtësi është një nga arritjet e mëdha.

Ndonjë mesazh për shqiptarët këtu apo shoqatën tonë?

Jeta në emigracion ka shumë vështirësi, sidomos në fillim, këtu të mungon shoqëria, njerëzit janë në punë, pandemia e gjatë që kaluam na ndau edhe më shumë. Krijimi i shoqatës tonë "SKANDERBEJ" është një gjë shumë e mirë për të bashkuar ushtarakët e liruar e në pension, për t'iu gjetur njeri-tjetrit në gëzime e halle. Kryesia e shoqatës ka organizuar festa të ditëlindjes së shokëve, festime të festave tona e të Amerikës, ku i kemi kaluar bashkë me gëzim e hare. Ju uroj punë të mbarë ju si kryetar dhe kryesisë së shoqatës. Unë ju uroj gjithë bashkatdhetarët këtu e kudo që janë, qoftë viti 2024 vit i mbarë për ta e për gjithë familjet e të afërmit e tyre!



Komanda Mbështetëse, struktura pararojë e Forcave të Armatosura



Historiku i Komandës Mbështetëse

14 nëntor 1947, Krijimi i Depos Qendrore të Intendencës.

1948, Depoja Qendrore e Intendencës emërtohet Magazinat Qendrore të Ushtrisë.

1949, Magazinat Qendrore të Ushtrisë, emërtohen Reparti me numër 8770, numër të cilin e mbajnë deri në vitin 1993.

1993, Magazinat Qendrore të Ushtrisë, emërtohen Bazat e Furnizimit të Ushtrisë në Tiranë, Elbasan, Berat dhe Rrëshen.

2000, krijohet Komanda e Mbështetjes Logjistike, e cila mori në përbërje dhe Bazat e Furnizimit të Ushtrisë.

2003, në kuadër të riorganizimit të Komandës së Mbështetjes Logjistike, Bazat e Furnizimit të Ushtrisë në Tiranë, Elbasan, Berat dhe Rrëshen, suprimohen dhe mbi bazën e tyre krijohet Brigada e Furnizimit të Ushtrisë.

2007, Komanda e Mbështetjes Logjistike, riorganizohet në Komandë Mbështetëse me përbërje, Brigadën Logjistike (krijuar nga suprimimi i Brigadës së Furnizimit dhe Brigadës së Transportit), Regjimentin e Mbështetjes së SHP, Regjimentin e Infrastrukturës, Qendrën e Personel-Rekrutimit, Spitalin Ushtarak Qendror Universitar dhe Batalionin e Policisë Ushtarake.

2010, mbi bazën e urdhrat të shefit të SHP të FA-së, nr. 31 datë 24.02.2010, Komanda Mbështetëse suprimohet dhe mbi bazën e saj riorganizohet Brigada Logjistike.

2014, mbi bazën e urdhrat të Ministrit të Mbrojtjes nr. 603, datë 23.07.2014 Brigada Logjistike dhe Brigada e Mbështetjes Rajonale suprimohen dhe mbi bazën e tyre riorganizohet Komanda Mbështetëse.

Misioni i Komandës Mbështetëse

Mbështetja me shërbime të trupave të luftimit, mbështetjes së luftimit të Komandave në kohë paqe/krize/luftime, në interes të plotësimit të misionit të tyre, si dhe në operacione të Emergjencave Civile dhe në misionet ndërkombëtare.

Detyrat

Të sigurojnë në çdo kohë aftësi operacionale dhe gatishmëri luftarake në kapacitetet e nevojshme, për t'iu përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit kushtetues.

Të mbështesë aktivitetet e Forcave të Armatosura të RSH me të gjitha klasat e furnizimit (1-5) dhe me shërbime logjistike.

Të sigurojnë kapacitete të nevojshme operacionale për kryerjen e operacioneve luftarake, emergjencave civile, kërkim - shpëtim, operacioneve humanitare dhe ato në ndihmë të komunitetit në bashkëpunim me strukturat e tjera të FA-së.

Të sigurojnë kapacitete të nevojshme operacionale për përmirësimin e infrastrukturës së FA-së të RSH.

Të sigurojnë kapacitete të nevojshme operacionale për kërkimin, zbulimin, çminimin dhe asgjësimin e municioneve të rrezikshme dhe lëndëve plasëse në operacionet brenda dhe jashtë vendit.

Të sigurojnë mbështetjen e strukturave të FA-së me riparime,

mirëmbajtje të përgjithshme të specializuara të mjeteve motorike tokësore, në operacione brenda dhe jashtë vendit në kohë paqe, krize, lufte e emergjence civile.

Të mbështesë me transport strukturat e FA-së brenda dhe jashtë vendit.

Të sigurojnë mbështetjen shëndetësore të personelit ushtarak aktiv në rezervë dhe pension, familjeve të tyre si dhe punonjësve civilë të FA-së.

Të administrojnë, menaxhojnë municionet, armatimin, teknikën dhe pajisjet rezervë të FA-së të RSH.

Të ruajë, administrojnë materialet, vlerat monetare, pajisjet në përdorim e rezervë, sipas klasave dhe niveleve të furnizimit.

Të sigurojnë nëpërmjet BCU, trajnimin dhe përgatitjen e personelit ushtarak dhe civil për detyra specifike që dërgohen me misionet jashtë vendit.

Të arsimojë, trajnojnë, stërvitë, të kualifikojë oficerët, nënoficerët dhe ushtarët e strukturave të FA-së në specialitetin furnizim, transport, mirëmbajtje, xhenio, personel-administratë, armatim-municion dhe shëndetësi në interes të përmbushjes së misionit të tyre.

Forcat e Armatosura vijojnë të transformohen dhe modernizohen dita-ditës me armatim, teknikë dhe pajisje nga më modernet.

Projektet ambicioze të modernizimit me teknikë, aparatura dhe pajisje të Komandës Mbështetëse, jo vetëm që do të mundësojnë arritjen e një stadi më të lartë të gatishmërisë dhe operacionalitetit, por edhe do të ofrojnë një mbështetje më të plotë e më të gjithanshme për të gjitha strukturat e tjera të Forcave të Armatosura.



Forca Detare, 98 vite histori suksesi në mbrojtje të brigjeve shqiptare

Deti ka pasur dhe do të ketë rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik të Republikës së Shqipërisë. Pasuritë detare, nëndetare dhe përfitimet, që vijnë nga përdorimi i detit, përbëjnë vlera të mëdha kombëtare, e prandaj administrimi dhe ruajtja e tyre është një nga elementët e rëndësishëm të sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë ka një vijë bregdetare prej 220 millesh detare (rreth 400 km), ushtron sovranitetin e saj në mbi 6 000 km² dhe të drejtën për shfrytëzim të pasurive ujore dhe nënujore në një hapësirë detare rreth 11 000 km². Forca Detare e Republikës së Shqipërisë, tradicionalisht, ka përfaqësuar institucionin kryesor për ushtrimin e sovranitetit të shtetit shqiptar në hapësirën e tij detare. FD, përfaqëson një forcë të vetme, e cila kryen një gamë të gjerë të aktiviteteve civile (policore) dhe ushtarake në hapësirën detare të RSH. Ky ndryshim thelbësor dhe përzjerja e veçantë e autoritetit të FD/RB (ndërvarësia nga SHSHPFA dhe MM për shkak të misionit, si dhe nga struktura të tjera si MB për shkak të bashkëpunimit) krijojnë kapacitete për të drejtuar dhe mbështetur një sërë operacionesh për të siguruar sovranitetin dhe përdorimin e ligjshëm të hapësirës detare.

Vlera e vërtetë e kontributit të FD-së për kombin nuk është aftësia për të kryer një mision, por aftësia e lartë për t'u përshtatur dhe karakteri shumë-misionesh. Përgjegjësitë në hapësirën detare janë gërshetuar jo vetëm ndërmjet Forcave të Armatosura, por edhe midis institucioneve të tjera. Interesat dhe objektivat e RSH-së në shekullin e ri kanë sjellë një zhvillim të konceptit të sigurisë. Në një botë gjithmonë e më shumë të globalizuar, Shqipëria i përmbahet parimit se nuk mund të ketë siguri kombëtare pa siguri rajonale dhe globale. Ajo vlerëson si prioritet strategjik integrimin në organizmat rajonale dhe ndërkombëtarë të sigurisë. Në këtë kontekst, operacionet e sotme dhe të ardhme të FARSH-së do të zbatojnë konceptin e "qasjes gjithëpërfshirëse". Ato do të karakterizohen nga një pjesëmarrje e gjerë e kapaciteteve ushtarake dhe civile, si dhe agjencive qeveritare dhe joqeveritare. Sipas rastit, në varësi të shtrirjes, vendit, rëndësisë dhe intensitetit



të tyre, pjesëmarrja e FARSH-së në operacionet e sotme dhe ato të ardhshme do të kryhet nën konceptin "joint" (e bashkuar), ndër-agjenci dhe shumëkombëshe. Doktrina e Forcës Detare, si rrjedhim i Doktrinës së FARSH-së ka karakter mbrojtës, i cili sanksionohet në qëllimin parësor strategjik të FARSH, që është: "ushtrimi i sovranitetit të Republikës së Shqipërisë; mbrojtja e pavarësisë dhe integritetit territorial; mbrojtja e jetës dhe e pasurisë së shtetasve, zhvillimi i pandërprerë demokratik dhe prosperiteti ekonomik; mbrojtja e dinjitetit dhe e vlerave kombëtare; si dhe integrimi i plotë në strukturat ndërkombëtare të sigurisë, në Organizatën e Atlantikut të Veriut (NATO) e në Bashkimin Evropian (BE)"². FD vlerëson kërcënimet dhe rreziqet në mjedisin kombëtar detar si pjesë përbërëse të kërcënimeve dhe rreziqeve në nivel kombëtar. Për shkak të mjedisit në të cilin këto kërcënime veprojnë dhe duke mbajtur në konsideratë pozicionin gjeografik të Republikës së Shqipërisë, kërcënimet kryesore të interesave kombëtare në mjedisin detar sipas Strategjisë të Sigurisë Kombëtare janë: Identifikimi i zonave të kontaminuara nga municionet e ndryshme; Pastrimi i zonave të kontaminuara; Asgjësimi i municioneve në det; Siguria Hidro-lundrimore.

Forca Detare, në bazë të nenit 14 të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë, është institucioni përgjegjës për sigurinë lundrimore në hapësirën detare të RSH. Ky mision i FD-së realizohet nëpërmjet Shërbimit Hidrografik (SHH). Shërbimi Hidrografik është institucion tekniko-shkencor shtetëror, në përbërje të Forcave Detare të Republikës së Shqipërisë, që drejton, organizon dhe përpunon botimin e hartave detare, të vjetarëve, të udhëzuesve të lundrimit e të fenerëve.

Shërbimi Hidrografik Shqiptar kryen studimet e karakterit hidrografik e hidrologjik të relievit e të fundit të detit, për vendosjen e fenerëve e të shenjave detare dhe të kabllove



detare të nënujshme. Ai boton dhe pajis me dokumentacionin e nevojshëm detar të gjitha anijet shqiptare, si: anijet luftarake, të transportit, të peshkimit e të turizmit. SHH, me autorizim të Ministrisë së Mbrojtjes, bashkëvepron me shërbime dhe institucione hidrografike të shteteve të huaja për qëllime studimi, bashkërendimi dhe veprimtarie tjetër në fushën e hidrografisë.

Asistenca në lundrim është një nga detyrat e FD/RB. Kjo asistencë do të jepet nga ana e anijeve të Forcës Detare apo QNOD në të gjithë hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë, si dhe për të gjitha mjetet detare që janë në këtë hapësirë, pavarësisht shtetit të flamurit. Përgjegjësia për sigurinë në lundrim është e kapitenit të anijes. Njësitë e FD/RB mund të japin informacion për një anije tjetër në rajonin e lundrimit, pasi të jenë të bindura se ky informacion nuk është i bazuar në opinione, por vetëm në dokumente zyrtare dhe publikime nga institucione të specializuara dhe të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare. Roja Bregdetare nuk do të rekomandojë kurse lundrimi për t'u ndjekur nga anije të ndryshme, përveç rasteve kur ky rekomandim ka qëllim shmangien e një rreziku të menjëhershëm dhe të pashmangshëm, nëse vazhdohet në atë drejtim. Çdo informacion apo sugjerim për ndërrim kursi të një anijeje që ka kërkuar ndihmë, pasqyrohet në ditarin e anijes. Nëse ka ndonjë dyshim për sigurinë e individëve që kanë kërkuar ndihmë, ky rast do të trajtohet si një rast SAR dhe do të jepet ndihma e duhur.

Forca Detare, me anë të strukturave vartëse (të Shërbimit Hidrografik Shqiptar), organizon dhe drejton punën për ngritjen dhe mbajtjen në gatishmëri të sistemit të Faro-Fenerëve bregdetarë, shenjave me drejtim, sistemit të bovizimit, si për qëllime ekonomike, ashtu edhe për qëllime mbrojtjeje. Informacioni i dhënë për asistencën në lundrim përfshin: Karakteristikat e fenerëve; Skemat e trafikut detar; Thellësitë e ujit në rajonit; Rreziqet nënujore; Pozicionet e bovave, fenerëve; Gjerësitë dhe gjatësitë gjeografike të rreziqeve nënujore; Drejtimin dhe shpejtësinë e rymave në rajon; Nivelin e baticë-zbaticës, etj.

Interesat kombëtare detare të Republikës së Shqipërisë burojnë dhe janë pjesë përbërëse e interesave kombëtare në mjedisin

detar. Për shkak të natyrës fizike dhe juridike të mjedisit, si dhe të tendencave pritshme të mjedisit të sigurisë detare dhe rajonale, interesat kombëtare detare të Republikës së Shqipërisë formulojnë si më poshtë: 1. Ushtrimi i sovranitetit dhe të drejtave sovraane kombëtare detare; 2. Mbrojtja e integritetit territorial kombëtar detar; 3. Mbrojtja e jetës dhe pronës nga fatkeqësitë në det; 4. Mbrojtja e pasurive detare dhe nëndetare; 5. Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kombëtare; 6. Angazhimi në sigurinë rajonale detare, si në kuadrin e strukturave të sigurisë evropiane (NATO & BE), ashtu edhe globale (OKB) dhe rajonale (ADRION, etj.); Angazhim për sigurinë rajonale detare, në kuadër të bashkëpunimit dhe marrëveshjeve dypalëshe me fqinjët tanë detarë.

Doktrina e FD/RB e Republikës së Shqipërisë përfaqëson dokumentin kryesor për veprimin e FD-së në ushtrimin e sovranitetit dhe të drejtave sovraane të shtetit shqiptar në hapësirën e tij detare. Mbrojtja e interesave kombëtare detare të Republikës së Shqipërisë në të ardhmen do të kërkojë kapacitete për t'u përdorur përtej hapësirave detare tradicionale.

Po ashtu do të kërkojnë kapacitete për angazhimin e Forcës Detare dhe Rojës Bregdetare në sigurimin detar të Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe nismave dypalëshe dhe shumëpalëshe të sigurisë rajonale.

Në kuadrin e Konceptit të Sigurisë, siguria dhe mbrojtja e vendit tonë nuk është vetëm çështje e Forcave të Armatosura. Ajo është përgjegjësi edhe e shumë institucioneve të tjera të shtetit. Në këtë kontekst, Doktrina e Forcës Detare ofron zgjidhjet më të sigurta, me cilësinë më të lartë dhe koston më të ulët për sigurinë e vendit tonë. Për shkak të aderimit të RSH në konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, fusha e veprimit të Forcës Detare del përtej hapësirës territoriale të RSH. Si rrjedhim, është rritur hapësira e përgjegjësisë për t'u kontrolluar, e burimeve për t'u mbrojtur e menaxhuar, si dhe përgjegjësi e detyrimeve.

Operacionet për Sigurinë: Operacionet kryesore që FD zhvillon në interes të rritjes së sigurisë në hapësirën detare janë: Operacionet për dhënien e ndihmës në det (SAR, SALVAGE); Operacionet e kërkimit dhe shpëtimit në det; Asistenca humanitare; Operacionet EOD; Siguria hidro-lundimore; Asistenca në lundrim.

Operacionet për dhënien e ndihmës në det: Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka një interes të veçantë për ruajtjen e jetës së njerëzve në hapësirën detare. Në hapësirën detare është detyrë parësore e FD-së të garantojë këtë siguri dhe të përmirësojë sigurinë detare. FD kontribuon në sigurinë detare nëpërmjet parandalimit të aksidenteve, kërkim-shpëtimit, hetimit të incidenteve detare, si dhe duke bashkëpunuar ngushtë me të gjitha institucionet lokale apo kombëtare, si dhe me faktorë të tjerë, individë apo shoqëri private që kryejnë aktivitetet në det. Sfidat e sigurisë kërkojnë nga Roja Bregdetare zhvillimin e standardeve dhe rregulloreve, plane të ndryshme në varësi të situatave, inspektime të rregullta dhe kontrole. Rritja me ritme të shpejta e numrit të mjeteve detare kryesisht për turizëm dhe aktivitete ekonomike, i shton përgjegjësitë e FD-së, e cila duhet të jetë më shumë aktive për të minimizuar humbjen e jetëve në det dhe dëmtimin e pronës private. FD duhet të ndikojë së tepërmi në edukimin e popullsisë mbi të drejtat dhe detyrimet për të lundruar në det, krijimin e programeve për edukimin e përdorimit të pajisjeve të sigurta në anije, mbrojtjen nga ndotjet e ambientit detar, si dhe krijimin e një tradite detare në respektimin e ligjeve kombëtare



dhe ndërkombëtare nga lundëtarët.

Asnjë incident nuk regjistron histori suksesi. Ato ndodhin duke marrë shpeshherë jetë njerëzore, prandaj përgatitja për momentin e vështirë duhet të jetë moto e efektive të FD-së. Për këtë, stërvitja e pandërprerë, mbështetja me pajisje dhe disiplinë të lartë janë çelësi drejt suksesit. Si një forcë lider në operacionet në det e në ujërat e Republikës së Shqipërisë, FD koordinon të gjitha veprimet, në bashkëpunim me forcat e tjera apo aktorë të ndryshëm, për një përgjigje të menjëhershme ndaj thirrjeve për ndihmë. Gjithashtu, me anë të Qendrave Operacionale ajo koordinon punën me të gjitha mjetet në rajon, për t'u dhënë ndihmë në kohë mjeteve në vështirësi.

Operacionet e kërkimit dhe shpëtimit në det

Shpëtimi i jetës në det është një detyrim, i cili buron nga e drejta ligjore. Historikisht, detarët i kanë dhënë ndihmë njëri-tjetrit si një detyrim të profesionit, duke marrë formën e të drejtës zakonore, e cila më pas u kthye në të drejtë ligjore, nëpërmjet konventës së Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO) për SAR-in. Sot, struktura dhe organizimi i Rojës Bregdetare (Forcës Detare) i përshtatet përmbushjes së misionit të kërkimit dhe shpëtimit në det, në varësi të rritjes së vazhdueshme të trafikut detar. Ligji nr. 9495, datë 20.3.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Shpëtimin".

E gjithë struktura e komandimit dhe kontrollit të Rojës Bregdetare (Forcës Detare) përshtatet në të gjitha nivelet e saj me detyra të kërkim-shpëtimit, që burojnë nga legjislacioni shqiptar për Rojën Bregdetare. Roja Bregdetare (Forca Detare) organizon shërbimin e kërkim-shpëtimit në det, duke llogaritur nevojat për mjete dhe duke bërë njoftimet e duhura në zonat e kërkim-shpëtimit, të cilat duhet të jenë të përcaktuara në planin kombëtar të SAR-it. Këto zona duhet të përfshijnë të gjithë zonën detare të RSH-së në detin Jon dhe Adriatik. Roja Bregdetare mbështet ngushtë në partneritet dhe bashkëpunim kryerjen e operacioneve SAR

Bashkëpunimi duhet të përfshijë të gjitha institucionet detare, si shtetërore ashtu dhe shoqëritë private, bashkëpunim të ngushtë me Forcat Ajrore dhe përfshirjen e helikopterëve në operacionet e kërkim-shpëtimit në det, si dhe angazhimin e forcave të tjera ushtarake, policore apo civile në kërkimin përgjatë bregdetit. Operacionet e kërkim-shpëtimit (SAR) minimizojnë humbjen dhe dëmtimin e jetëve njerëzore, shpëtimin e pasurisë së dëmtuar, apo gjetjen dhe ndihmën e marinarëve në vështirësi.

Roja Bregdetare Shqiptare organizon shërbimin e kërkim-shpëtimit në det, duke llogaritur nevojat për mjete dhe duke bërë njoftimet e duhura në zonat e kërkim-shpëtimit, të cilat duhet të jenë të përcaktuara në planin kombëtar SAR-it. Këto zona duhet të përfshijnë të gjithë zonën detare të RSH-së në detin Jon dhe Adriatik.

Roja bregdetare mbështet ngushtë në partneritet dhe bashkëpunim për të kryer operacione SAR. Bashkëpunimi duhet të përfshijë të gjitha institucionet detare si shtetërore si dhe shoqëritë private. Bashkëpunim të ngushtë me Forcat Ajrore dhe përfshirjen e helikopterëve në operacionet e kërkim-shpëtimit, si dhe përfshirjen e batalioneve të reagimit të FA-së në kërkimin përgjatë bregdetit. Drejtimi operacional i SAR-it në det bëhet sipas strukturës: Qendra Kombëtare e SAR (QBO) - Qendra Kombëtare e SAR Detar (QNOD) - Anijet.

Asistenca humanitare

Vendi ynë është i ekspozuar ndaj fatkeqësive që mund të shkaktohen nga natyra apo dora e njeriut si tërmetet, zjarret, përmytjet, bllokimet që mund të shkaktohen nga reshjet atmosferike, etj. Forca Detare, si pjesë përbërëse e FA-ve i jep ndihmë popullsisë në rast katastrofe natyrore apo industriale, si dhe lajmëron popullsinë për rreziqet me natyrë ushtarake ose

civile. FD kontribuon, me mjetet dhe personelin e saj, në ndihmë të popullatës së prekur nga këto fatkeqësi, duke kryer këto operacione: Evakuim nga përmytjet. Furnizim me ujë, ushqime dhe medikamente. Dhënie kontributi me personel dhe mjete për shuarjen e zjarreve dhe zhblokimin e rrugëve. Operacionet EOD, Operacionet për diktimin, gjetjen, nxjerrjen dhe asgjësimin e lëndëve plasëse/eksplozive në det janë operacione që kontribuojnë në sigurinë e ujërave në hapësirën detare shqiptare. Këto operacione, Forca Detare i kryen nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Zhytjeve, e cila ka personelin dhe mjetet e duhura për këto operacione. FD, në kryerjen e këtyre operacioneve, krijon bashkëpunim dhe me vendet e tjera aleate që ofrohen për kryerjen e këtyre operacioneve me teknologji moderne. Qendra e Zhytjes, me personelin dhe mjetet që ka në dispozicion, kryen operacione si më poshtë: Identifikimin e zonave të kontaminuara nga municionet e ndryshme; Pastrimin e zonave të kontaminuara; Asgjësimin e municioneve në det.

Siguria Hidrolundrimore

Forca Detare, në bazë të nenit 14 të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë, është institucioni përgjegjës për sigurinë lundrimore në hapësirën detare të RSH. Ky mision i FD-së realizohet nëpërmjet Shërbimit Hidrografik (SHH). Shërbimi Hidrografik është institucion tekniko-shkencor shtetëror, në përbërje të Forcave Detare të Republikës së Shqipërisë, që drejton, organizon dhe përpunon botimin e hartave detare, të vjetërve, të udhëzuesve të lundrimit e të fenerëve. Shërbimi Hidrografik Shqiptar kryen studimet e karakterit hidrografik e hidrologjik të relievit e të fundit të detit, për vendosjen e fenerëve e të shenjave detare dhe të kablllove detare të nënujshme. Ai boton dhe pajis me dokumentacionin e nevojshëm detar të gjitha anijet shqiptare, si: anijet luftarake, të transportit, të peshkimit e të turizmit. SHH, me autorizim të Ministrisë së Mbrojtjes, bashkëvepron me shërbime dhe institucione hidrografi ke të shteteve të huaja për qëllime studimi, bashkërendimi dhe veprimtarie tjetër në fushën e hidrografi së.

Asistenca në lundrim

Asistenca në lundrim është një nga detyrat e FD-së. Kjo asistencë do të jepet nga ana e anijeve të Forcës Detare apo QNOD në të gjithë hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë, si dhe për të gjitha mjetet detare që janë në këtë hapësirë, pavarësisht shtetit të flamurit. Përgjegjësia për sigurinë në lundrim është e kapitenit të anijes. Njësitë e FD-së mund të japin informacion për një anije tjetër në rajonin e lundrimit, pasi të jenë të bindura se ky informacion nuk është i bazuar në opinione, por vetëm në dokumente zyrtare dhe publikime nga institucione të specializuara dhe të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare. Roja Bregdetare nuk do të rekomandojë kurse lundrimi për t'u ndjekur nga anije të ndryshme, përveç rasteve kur ky rekomandim ka qëllim shmangien e një rreziku të menjëhershëm dhe të pashmangshëm, nëse vazhdohet në atë drejtim. Çdo informacion apo sugjerim për ndërrim kursi të një anijeje që ka kërkuar ndihmë, duhet të pasqyrohen në ditarin e anijes. Nëse ka ndonjë dyshim për sigurinë e individëve që kanë kërkuar ndihmë, ky rast do të trajtohet si një rast SAR dhe do të jepet ndihma e duhur.

Forca Detare, me anë të strukturave vartëse (të Shërbimit Hidrografik Shqiptar), organizon dhe drejton punën për ngritjen dhe mbajtjen në gatishmëri të sistemit të Faro-Fenerëve bregdetarë, shenjave me drejtim, sistemit të bovëzimit, si për qëllime ekonomike, ashtu edhe për qëllime mbrojtjeje. Informacioni i dhënë për asistencën në lundrim përfshin: Karakteristikat e fenerëve; Skemat e trafikut detar; Thellësitë e ujit në rajonit; Rreziqet nënujore; Pozicionet e bovave, fenerëve; Gjerësitë dhe gjatësitë gjeografike të rreziqeve nënujore; Drejtimin dhe shpejtësinë e rrymave në rajon; Nivelin e baticë-zbaticës, etj. Forcat Detare në këtë 98-vjetor festojnë histori suksesi të cilat do të pasojnë njëra-tjetrën.

Baza Ajrore Farkë, modernizimi i një strukture, simbol i bashkëpunimit

Baza Ajrore Farkë shënoi, më 6 dhjetor 2023, vitin e 56-të të krijimit të saj. Tashmë, ajo prej mbi gjysmë shekulli, me pilotët, teknikët dhe helikopterët e saj, u shërben qytetarëve dhe kombit shqiptar, madje edhe shpesh herë kur rastet kanë qenë nga më kritikët, prej kushteve të motit, emergjencave civile, ata kanë qenë pararojë në shërbim të jetës. 56-vjetori i krijimit e gjen Bazën Ajrore Farkë më të modernizuar në teknikë, pajisje dhe personel, me helikopterët bashkëkohorë, duke e bërë atë më operacionale edhe në misionet ndërkombëtare. Baza Ajrore Farkë ka ecur në rrugëtimin e saj prej më se gjysmë shekulli me përpjekje, kurajë, mundin e djersën e derdhur ndër vite nga breza të tërë pilotësh, teknikësh, specialistësh, të cilët kanë sakrifikuar edhe jetën e tyre në përmbushje të misionit dhe detyrave në shërbim të qytetarëve dhe vendit. Ky kontribut i dhënë ndër vite prej tyre është transmetuar sot edhe tek brezat e rinj, që evidentohet me pjesëmarrjen e tyre në Emergjencat Civile në ndihmë të komunitetit, stërvitjet e përbashkëta brenda dhe jashtë vendit.

Që nga krijimi e në vazhdim kjo bazë ka dhënë gjithashtu një kontribut të shquar në realizimin e misioneve të ndryshme ushtarake dhe civile, ka zhvilluar stërvitje të përbashkëta me ushtritë e ndryshme të rajonit dhe ka ndihmuar komunitetin në zona malore të zëna nga dëbora, në operacionet për tërmetet, si dhe në krizën e kosovarëve në vitin 1999. Reformimi dhe modernizimi i Forcës Ajrore, dhe Bazës Ajrore Farkë me mjete dhe teknologji perëndimore të gjeneratave të fundit, është një proces i vazhdueshëm dhe i pandërprerë. Baza Ajrore, ashtu sikurse e gjithë Forca Ajrore, ka në natyrën e shërbimit të saj nevojën dhe sfidën e vazhdueshme për t'u zhvilluar dhe modernizuar, por edhe për t'u transformuar në përgjigje të kërkesave të reja dhe standardeve bashkëkohore.

Si filloi historia 56-vjeçare e Bazës Ajrore Farkë

Në korrik 1956, pilotë dhe teknikë u dërguan në ish-Bashkimin Sovjetik për t'u trajnuar në përdorimin e helikopterëve. Në qershor 1957 u krijua Njësia e Transportit Ushtarak nr. 5818 dhe struktura e saj organizative përfshinte një MI-4, tre MI-1, disa avionë JAK-11, JAK-18 dhe PO-2. Komandant reparti në atë kohë u emërua Peço Polena, komandant i treshes së parë të MI-4 u emërua Petrit Malindi, Mersin Minxha u emërua komandant i treshes së dytë të MI-1 dhe Refit Jazo komandant i avionëve JAK-18. Këto pra ishin emërimet e para që hynë në histori.

Më 4 shtator 1957, mijëra njerëz në Tiranë panë për herë të parë në vendin tonë fluturimin me një helikopter në qiell. Helikopteri i pilotuar nga Peço Polena ka fluturuar mbi linjën Tiranë-Shkodër-Tiranë. Në qershor 1958, një nga helikopterët MI-1 u përplas dhe ai doli jashtë përdorimit. Fluturimet me helikopterë MI-4 vazhduan duke përmbushur detyra speciale, veçanërisht në situatat dimërore



të viteve 1958, '59, '60, në kushte shumë të vështira atmosferike. Në vitin 1967, rreth 30 helikopterë të rinj MI-4 të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës u përfshinë në këtë njësi. Kjo njësi u emërua "Regjimenti i Helikopterëve", më 6 dhjetor 1967, dhe komandant i saj u emërua Lulo Musaj. Regjimenti përfshinte tre skuadrilje helikopterësh MI-4, një makineri për riparimin e helikopterëve, pistën për helikopterët që lejon ngritjen dhe uljen e njëkohshme të disa helikopterëve, kazermat dhe kushte normale për personelin, rojet dhe gjithë infrastrukturën e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre.

Baza Ajrore Farkë ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në realizimin e stërvitjeve të ndryshme ushtarake të asaj kohe, por edhe në ndihmë të popullatës në emergjenca civile, veçanërisht në rastet e përmbajtjeve, zonave malore të bllokuara nga bora, tërmetet apo edhe në kohë krize.

Kjo bazë ka marrë pjesë edhe në disa stërvitje, si në stërvitje të Forcave Ajrore, edhe në stërvitje të përbashkëta me forca të reparteve të tjera të FA-së, duke treguar cilësi dhe nivel të lartë stërvitjeje fluturimi.

Për të kryer misionin e saj, personeli i kësaj baze trajnohet intensivisht për të mbajtur në gatishmëri të vazhdueshme

teknikën ajrore, për kryerjen e detyrave si transportimi i trupave, operacionet e kërkim-shpëtimit (SAR), shpërndarja e ndihmave ushqimore, apo transportimi i pacientëve në emergjencave civile. Vitet e fundit infrastruktura bazë u përmirësua ndjeshëm kryesisht falë ndihmës së dhënë nga ushtria italiane. Heliporti i ri është ndërtuar me të gjitha pajisjet e tij përkatëse për ulje dhe ngritje ditën dhe natën. U rikonstruktuan kazermat, si dhe makineri për mirëmbajtjen e helikopterëve dhe kulla e drejtimit dhe fluturimit është e pajisur me mjete moderne.

Personeli i Bazës Ajrore të Farkës është kualifikuar për të përbushur standardet dhe misionin e saj. Kjo bazë është simbol i bashkëpunimit me aleatët tanë në stërvitjet e përbashkëta, ku pjesëmarrësit kanë treguar dinjitet dhe profesionalizëm duke bashkërenduar veprimet për realizimin e misionit.

Çdo vit kryen mbi 500 fluturime në operacione humanitare për të ndihmuar njerëzit në nevojë, për transportimin e të sëmurëve, kundër zjarreve, transportin e ndihmave humanitare, në mbështetje të komunitetit gjatë përmbytjeve etj. Treguesi real dhe i prekshëm i mbarë Shqipërisë ishte kontributi i dhënë viteve të fundit gjatë përmbytjeve në Shkodër, ku pavarësisht kushteve të papërshtatshme atmosferike, pilotët ndihmuan njerëzit. Pilotët e bazës ajrore janë trajnuar për të qenë në gjendje të kryejnë operacione ajrore në kushte të ndryshme moti dhe të ndërveprojnë me ushtritë e tjera aleate të NATO-s.

Pjesa më e madhe e personelit teknik dhe pilot është kualifikuar në shkolla dhe njësi perëndimore si në Itali, SHBA, Turqi, Greqi, Gjermani, Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Emrat që drejtuan Bazën e Farkës në vite dhe bënë historinë janë: Lulo Musai, Refat Kasimati, Hetem Mehmeti, Sinan Çela, Enver Taho, Beqir Barxha, Raqi Qarri, Syrja Gjoka dhe Frederik Beltoja etj.

Pilotët e Bazës Ajrore Farkë, heronjtë e ditëve tona

Baza Ajrore Farkë, është strukturë në përbërje të Forcës Ajrore që me kapacitetet e veta kryen mbështetjen me transport të kufizuar të trupave dhe materialeve, mbështetje teknike dhe mirëmbajtje për mjetet ajrore dhe evakuim shëndetësor në operacione luftarake dhe jo luftarake, operacione humanitare dhe të shërbimit SAR si dhe detyra të tjera në interes të operacionit.

Baza Ajrore Farkë ka për detyrë që në bashkëveprim me strukturat e

Forcës Ajrore dhe të forcave të tjera të FA-së të sigurojë mbështetjen ajrore në operacionet e përbashkëta dhe në kuadër të realizimit të misionit kryen detyra kryesore si të sigurojë gatishmërinë luftarake të mjeteve fluturuese që ka në përdorim në përputhje me nivelet operacionale të përcaktuara, të realizojë përbushjen e detyrave luftarake dhe atyre stërvitore në përputhje me standardet e ICAO, Eurokontroll dhe NATO, të realizojë transport trupash, materialesh dhe VIP në operacione luftarake, të mbështesë dhe kryejë operacione humanitare në ndihmë të popullsisë (emergjencat civile dhe fatkeqësitë natyrore). Baza Ajrore Farkë kryen detyra të zbulimit dhe rikonicionit me interes kombëtar dhe në kuadër të NATO-s, kryen monitorim sipas situatave të kufirit detar dhe tokësor në interes të detyrave speciale si dhe në interes të vendimmarrjeve të shpejta, zhvillon më vete ose në bashkëpunim me të tjerët operacionet e kërkim-shpëtimit (SAR), siguron përgatitjen dhe trajnimin e personelit sipas teknologjisë në përdorim dhe standardeve në interes të plotësisë të misioneve në lloje të ndryshme operacioni, siguron dhe realizon shërbimet e mirëmbajtjes në kohë dhe sipas kërkesave teknike të përcaktuara si për mjetet ajrore, ashtu edhe për mjetet tokësore që ka në përdorim. Ajo ka detyrë gjithashtu, të realizojë operacione MEDAVAC transport të sëmurësh, të marrë pjesë dhe mbështesë stërvitjet e ndryshme "Joint" me FA-të dhe institucionet e tjera të vendit.

Modernizimi i Bazës Ajrore Farkë, trajnimi dhe edukimi

Me investimet e reja, Baza Ajrore e Farkës ka tashmë një sistem të ri sigurie duke nisur që nga rrethimi i jashtëm, ndriçimi, e deri te sistemi i mbikëqyrjes 24 orë me kamera. Gjithashtu është rikonstruktuar objekti i klasave të pilotëve, si dhe mensa e tyre. Pjesë e këtij investimi janë edhe depot e reja të magazinimit të karburantit, të cilat janë të standardeve të NATO-s dhe më të sigurtat në Shqipëri. Pas këtyre investimeve, depot e reja në Bazën Ajrore të Farkës, garantojnë karburant për rreth 6 muaj, jo vetëm për helikopterët e Forcës Ajrore, por edhe për ata të Ministrisë së Brendshme dhe asaj të Shëndetësisë.

Nga ana tjetër, efektivet e Forcës Ajrore janë në vëmendje të veçantë të lidershipit politik dhe ushtarak të MM dhe SHP të FA-së, pasi puna dhe përkushtimi i tyre në situatat e ndryshme kanë qenë vendimtare dhe jetike. Pilotët dhe teknikët e kësaj baze, për angazhimet e tyre gjatë përballimit të situatës së krijuar nga reshjet e borës, emergjencat e zjarreve apo të situatave shëndetësore, kanë marrë vlerësime dhe mirënjohje maksimale për heroizmat e bëra, për devotshmërinë, guximin e treguar në shërbim të njerëzve dhe qytetarëve.

Baza Ajrore Farkë ndodhet në qendër të Republikës të Shqipërisë dhe mbulon të gjithë territorin e vendit në aspektin operacional. Duke qenë afër me Aeroportin Ndërkombëtar, ajo ka një pozicion perfekt për mbështetjen e Forcave Tokësore dhe Detare si dhe institucionet e tjera shtetërore.

Në shtator të vitit 1957, fluturimi i parë në qiellin shqiptar u krye me helikopterin MI-2. Ata u përdorën kryesisht për trajnim dhe rikonicion ajror. Data 6 dhjetor, shënon edhe ditën e krijimit të Regjimentit të Helikopterëve. Regjimenti arriti të kishte një numër prej rreth 40 helikopterësh të tipit MI-4 të prodhimit Ruso-Kinez. Kurse versionet e Helikopterëve MI-4, ishin Transport Trupash



dhe Materiale, Aeroambulancë, Kërkim-Shpëtim, Transport PLSH, si dhe janë përdorur në Mbështetje të Autoriteteve Civile në Raste Fatkeqësish Natyrore.

Pas daljes nga fluturimi së helikopterit MI-4 në vitin 2002, në Bazën Ajrore Farkë filloi epoka e ndryshimit në teknologji, si dhe në konceptin e trajnimit dhe operimit.

Faza e I, quhet si faza e ndryshimit të teknologjisë, në 2002 me helikopter Trajnimi dhe Rikonicioni AB-206, në 2004 me Helikopter Transporti AB-205.

Faza e II, Zhvillimi me Helikopter Shumërolesh në 2007, Helikopter VIP, A-109 dhe po në 2007 me Helikopter Shumërolesh BO-105.

Faza e III, Modernizimi, në vitin 2012, Helikopter VIP Helikopter EC-145, në 2012 Helikopter SAR "Cougar" AS-532AL, në 2013, Helikopter CASEVAC "Cougar" AS-532AL, po në 2013, Helikopter TTH "Cougar" AS-532AL, në 2014, Helikopter TTH "Cougar" AS-532AL, dhe në 2015, Helikopter SAR EC-145. Në 2016, Grupi i Helikopterëve të Transportit Mjekësor, po në 2016, Sektori i Repartit Special RENE.

Struktura Aktuale është Grupi i Helikopterëve të Transportit Mjekësor 11, versioni Aero-Ambulancë MEDEVAC. Gjithashtu përmendim edhe Grupin e Helikopterëve të Sektorit RENE, që mbështet operacionet e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Grupi i mirëmbajtjes të helikopterëve realizon pjesërisht punë të nivelit të dytë.

Infrastruktura e Bazës Ajrore të Farkës përbëhet nga Qendra e Kontrollit të Trafikut Ajror, Hangarët e Helikopterëve, Qendra e Mirëmbajtjes së Helikopterëve. Plani i vendosjes së kuadrateve të uljes së helikopterëve si dhe rulimi/fluturimi për tek kuadrati i ngritjes "H". Plani i vendosjes së kuadrateve të uljes/ngritjes së helikopterëve si dhe rulimi/fluturimi për tek kuadrati i ngritjes "H". Trajnim Bazë me helikopterin AB-206 dhe trajnim i avancuar me helikopterin dymotorësh BO-105, bazohet në eksperiencën e pilotëve. Përmendim implementimin e STANAG/AP dhe SOP të miratuar, Trajnimi Operacional i ekuipazheve mbështetur në ATP-49, "Përdorimi i Helikopterëve në Fushën e Operacionit" dhe ATP-10 "Operacionet SAR". Gjithashtu trajnimi në punë "On job training", për teknikët dhe specialistët e mirëmbajtjes, kurset Profesionale dhe ato të Karrierës gjithashtu.

Në bazë të ligjit, Forcat Ajrore janë përgjegjëse për kryerjen e



misioneve SAR. Urdhri i misionit merret nëpërmjet QKR-së, Rinas. Misionet SAR/CASEVAC planëzohen nga Zyra Operacionale (OPS Office). Komandantët e Ekuipazheve janë përgjegjës për ekzekutimin e misionit.

I rëndësishëm është gjithashtu bashkëpunimi me aviacionin civil. Marrëveshje teknike me "Albcontrol" për shfrytëzimin e infrastrukturës aeroportuale të Rinasit, LATI Fluturime Stërvitore Instrumentale, Fluturim Taktik Stërvitor, Trajnim duke shfrytëzuar infrastrukturën aeroportuale (Pistën, Taxi Ways...) Praktikë për terminologjinë e komunikimit në Anglisht, etj.

Objektivat e kapaciteteve dhe planifikimi i fluturimeve

Objektivat e kapaciteteve përmendim A1501 N "Kapacitetet e Gatishmërisë së Dislokueshme të Përcaktuara", (2018).A1105 N "Operacionet në kushtet e vështira të motit", (2017).A 5301 N "Mjetet e navigimit dhe radiot në mjetet ajrore", A 6206 N "Vetëmbrojtja e Mjeteve Ajrore", (2017).

Fluturime treneruese me pilotët e rinj, si dhe pilotët operacionalë (jo më pak se 120 orë fluturimi për pilotët operacionalë) Trajnimi i ekuipazheve SAR, Trajnimi i ekuipazheve IFR, Trajnimi i ekuipazheve NVG. Mundësimin e shërbimit 24 orë SAR. Stërvitje SAR dhe mirëmbajtjen e teknikës ajrore me kontraktor.

Planifikimi i fluturimeve ka për qëllim të sigurojë gatishmëri operationale, të mbështesë Operacionet e Forcës Tokësore dhe Detare, të kryejë transport të trupave dhe materialeve ushtarake, të kryejë zbulim ajror, operatione CASEVAC dhe SAR. Të kryej transport ajror në rast të Emergjencave Civile dhe të fatkeqësive natyrore, të sigurojë dhe realizojë shërbimin e mirëmbajtjes, të stërvitë dhe trajnojnë personelin dhe pajisjet.



Shkolla e Trupës,

kontributi dhe vizioni për trajnimin e personelit ushtarak në Forcat e Armatosura

“Bijtë e Nënës Shqipëri bëhen bashkë në Bunavi!”, vargje drithëruese që dëgjohen fuqishëm nga garnizoni i Bunavisë, dhe më tej kënga vazhdon “Betohen për Flamur, stërviten dhe s’lodhen kurrë”, vargjet e kësaj kënge përfshijnë gjithë dinamikën e këtij garnizoni.

“Ne gjithmonë do t’u nderojmë ku do vemë ... ku do shkojmë, si kujtimin e rinisë, shkolla e parë e ushtrisë ...”, këngë apo betim ushtarak është premtimi më domethënës i rekrutëve/ushtarëve, të cilët premtojnë të jenë të aftë të shërbejnë me dinjitet brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Me këtë premtim domethënës mbyllet cikli stërvitor në Shkollën e Trupës në Bunavi, aktiviteti i së cilës filloi më 27 janar 2003.

Koncepti i Ri i Arsimit Ushtarak Profesional në Forcat e Armatosura është shoqëruar me ndryshimet e nevojshme organike dhe strukturore, ndryshime që prekën ndjeshëm edhe Shkollën e Trupës.

Me kalimin në strukturën e re, Shkollës së Trupës iu hoq përgjegjësia për arsimimin/trajnimin e personelit “nënoficerë dhe oficerë” të Forcave të Armatosura dhe iu caktua si mision, zhvillimi dhe menaxhimi i Stërvitjes Individuale me të gjithë të rekrutuarit në Forcat e Armatosura dhe certifikimi i aftësive të personelit të trajnuar në specialitete, në qendrat stërvitore të strukturave ushtarake.

Certifikimi i aftësive të personelit të trajnuar në specialitete ushtarake nga Shkolla e Trupës dhe trajnim-kualifikimi i tyre nga qendrat stërvitore të strukturave ushtarake, dikur risi e Konceptit të Arsimit Ushtarak Profesional, tashmë realitet dhe një përvojë me vlera të pakundërshtueshme, e fituar përgjatë testimit, vlerësimit dhe certifikimit në 30 kurse institucionale (përfshi SIB dhe SIA), prej kalimit në strukturën e re të Shkollës së Trupës. Përvoja e fituar në zhvillimin e Stërvitjes Individuale (SIB dhe SIA)



është shndërruar në aset me vlerë për Shkollën e Trupës, që tashmë lehtëson realizimin me sukses të padiskutueshëm të kësaj stërvitjeje dhe në përgatitjen e një trupe ushtarësh të devotshëm dhe të aftë për të shërbyer në Forcat e Armatosura. Transformimi nga qytetar, në të përgatitur të kontingjenteve të trajnuara në Bunavi, tashmë kthyer në një proces normal dhe të natyrshëm.

Stërvitja Individuale

Stërvitja Individuale përbën bazën e piramidës së arsimit/trajnitimit të ushtarakut dhe është shkolla e parë e edukimit ushtarak, për të gjithë të rekrutuarit në Forcat e Armatosura. Ajo përbëhet nga Stërvitja Individuale Bazë dhe Stërvitja Individuale e Avancuar dhe të dyja së bashku, janë përgjegjësi e Shkollës së Trupës.

Qendra e Stërvitjes Individuale e Shkollës së Trupës ka hartuar dhe zhvilluar me seriozitet programet e Stërvitjes Individuale (SIB&SIA) qysh prej marrjes së përgjegjësisë për zhvillimin e kësaj stërvitjeje. Përgjegjësia për zhvillimin e Stërvitjes Individuale të Avancuar, për të gjitha specialitetet, Shkollës së Trupës i kaloi në muajin tetor 2014, ku struktura aktuale e shkollës (QSI) u diskutua e miratua në përshtatje me Konceptin e Ri për Arsimimin Ushtarak Profesional (AUP) në FARSH, ndërsa faktikisht, kjo stërvitje, përfshi edhe specialitetet, për shkak të aseteve që ofron ky garnizon prej vitit 2012, është zhvilluar në Bunavi.

Efektiviteti i kësaj stërvitjeje ka qenë më i lartë edhe në raport me çdo strukturë tjetër stërvitore, pasi janë siguruar standarde të njëjta në trajnim, shkëmbehet përvojë në trupën e instruktorëve, zhvillohet më mirë fryma e garës dhe e konkurrencës ndërmjet individëve, sigurohen burimet mbështetëse më të plota, zhvillohen më mirë kapacitetet stërvitore etj.

Kompanitë stërvitore aktivizohen në detyra brenda misionit të tyre të përcaktuar, ndërsa personeli kryen detyra sipas funksioneve organike.

Stërvitjen Individuale të Avancuar e kryejnë vetëm personeli i emëruar për këtë qëllim dhe nuk aktivizohet personel nga kompania e SIB apo strukturat mbështetëse të Shkollës së Trupës, që sigurisht nuk kanë përvojën, nivelin dhe aftësitë e personelit të kompanisë së SIA-s për këtë lloj dhe nivel stërvitjeje, personeli i QSI-së dhe i kompanive stërvitore angazhohet me ngarkesë normale gjatë gjithë vitit, duke mos krijuar periudha boshe, të pambushura me aktivitet, të cilat përgjumin personelin trajnues dhe që sjellin problematika në kursin e radhës. Sigurohet mbështetje efikase e efektivave me materiale logjistike e stërvitore dhe, sigurisht, menaxhim më efektiv i kontingjenteve të ardhura për trajnim.

Zhvillimi i SIA-s, dy vjet e më tepër, pas SIB(16), siç ka ndodhur vitet e fundit, dëmton procesin e përgatitjes së ushtarëve, pasi, për t'i riformtuar ata dhe për t'i rikthyer në gjendjen e pas kursit SIB, kërkohet kohë dhe angazhim shtesë, për një periudhë tjetër 1 deri në 3-javore.

Afati ligjor për kalimin nga grada e "ushtarit I" në gradën e "ushtarit II" është një vit dhe për të marrë këtë gradë, ushtari duhet të ketë zhvilluar kursin e SIA.

Certifikimi i aftësive të personelit të trajnuar në specialitetet ushtarake

Shkolla e Trupës ka marrë përsipër dhe ka realizuar detyrimet e përgatitjes dhe certifikimin e aftësive të personelit të trajnuar për specialitetet ushtarake në qendrat stërvitore të strukturave ushtarake të Forcave të Armatosura.

Shkolla e Trupës, bashkëpunimin me komandat e strukturave ku janë vendosur qendrat e ka vlerësuar dhe vijon ta vlerësojë si element përcaktues dhe vendimtar për realizimin e detyrave, për standardizimin e përgatitjes. Zhvillimi i kurseve të SIB dhe SIA, njëri pas tjetrit, jo vetëm që do ketë detyrim, por edhe do të ruante parametrat e produktit të përfutur në SIB.

Niveli, performanca dhe cilësia e kontingjenteve të rekrutëve 18, sidomos pas futjes në fuqi të ligjit nr. 59/2014, datë 12.06.2014 Për "Karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", kanë qenë të kënaqshme dhe kanë lehtësuar punën e personelit trajnues, për shndërrimin e rekrutëve nga civilë, në ushtarë të denjë për të shërbyer në Forcat e Armatosura.

Vizioni i Shkollës së Trupës

Bazuar në kontributin e Shkollës së Trupës për konsolidimin e Stërvitjes Individuale, përvojës së fituar dhe rezultateve të pakontestueshme në procesin e standardizimit të përgatitjes dhe certifikimit të aftësive të personelit të trajnuar në specialitetet ushtarake, Shkolla e Trupës vazhdon realizimin e menaxhimit dhe certifikimit me të gjithë të rekrutuarit e Forcave të Armatosura.

Me grupe pune dhe specialistë janë hartuar programet e Stërvitjes Individuale të Ushtarit (SIB&SIA), kurrikula për hartimin e programeve të nënoficerit dhe kurrikula për hartimin e programeve të oficerit, të cilat janë dërguar në të gjitha qendrat stërvitore, në interes të hartimit dhe standardizimit të programeve të specialiteteve dhe kurseve përkatëse.

Shkolla e Trupës, nëpërmjet Qendrës së Programeve dhe Vlerësimit (QPV), prej marrjes së kësaj përgjegjësie, ka udhëhequr dhe realizuar me seriozitet procesin e vlerësimit.

Kushtet jetësore

Garnizoni i Bunavisë plotëson në mënyrë optimale nevojat jetësore, stërvitore dhe ato të argëtimit të kursantëve, si dhe mundësinë që SIA, ashtu si dhe SIB, të zhvillohet e përqendruar në një garnizon të vetëm, duke realizuar të gjithë sistemin e stërvitjes individuale në një institucion. Në këtë garnizon krijohen kushtet optimale që të gjithë të rekrutuarit të zhvillojnë stërvitjen individuale në regjim 24 orë (duke zgjidhur problemin e disa standardeve në zhvillimin e saj).

Infrastruktura stërvitore: Infrastruktura aktuale e stërvitjes dhe kapacitetet e saj në garnizonin e Bunavisë (poligonet e qitjes, taktikës, kabinete, klasa, sheshe stërvitore për xhenio, MADM, topografi, shëndetësi, përgatitje fizike) mbështesin plotësisht zhvillimin e programit SIA në specialitetin Këmbësori, Zbulim, Polici Ushtarake, Shëndetësi, MKK; Furnizim dhe Ndërlidhje. Baza materiale dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e programeve të SIA-s në specialitetet e elementit tokësor të siguruar.

Programet: Programet e SIA-s janë përgatitur për të gjithë specialitetet. Në programe janë përcaktuar objektivat, aftësitë, cilësitë, njohuritë që përftohen nga çdo kursant në specialitetin përkatës.

103 vite rrugëtim historik i Armës Xheniere

Ndër shekuj Arma e Xhenios ka udhëtuar duke u transformuar dhe standardizuar si simotrat e saj në të gjitha ushtritë e tjera. Ajo nuk kishte fizionominë, përcaktimin dhe rëndësinë që ka sot, por nuk duhet harruar se ndërtimi i kalave, fortifikatave, tuneleve, kanaleve që shërbenin si pengesa për armikun, urave dhe rrugëve për kalimin e trupave ushtarake, ngritja e kurtheve, hapja e puseve për ujë të pijshëm, përdorimi i pirgjeve të gurëve si mjet luftimi etj., nuk janë asgjë tjetër veçse format e para të Armës të Xhenios, e cila mori trajtat dhe kuptimin e kohës tonë. Natyrisht që ajo do të merrte vlerën e vërtetë fill pas krijimit të ushtrisë tonë, pas shpalljes së pavarësisë, pra, pas 4 dhjetorit të vitit 1912. Dhe ishte 20 janari i vitit 1921, fill pas Kongresit të Lushnjës, kur u vendos krijimi i një kompanie xheniere që quhet dhe data e lindjes së Armës së Xhenios. Çlirimi i vendit nga okupatorët nazifashistë si rezultat i luftës heroike të UNÇ-së krijoi mundësitë që kësaj armë t'i jepej roli dhe vendi i duhur. Këtë e kushtëzonte si nevoja për çminimin e territoreve të mëdha, sidomos përgjatë bregdetit tonë që ishte minuar nga armiku, por edhe perspektiva e modernizimit të ushtrisë për mbrojtjen e vendit. Për këtë shërbyen si oficerët atdhetarë që kishin shërbyer në ushtrinë e vjetër, ashtu edhe kuadrot e dalë nga lufta, shumë prej të cilëve u dërguan për



studime të specializuara jashtë vendit e kryesisht në ish-Bashkimin Sovjetik. Me kohë, shumica prej tyre studiuuan në shkollat tona si ajo e Bashkuar e Oficerëve e deri në Akademinë Ushtarake. Shumë prej tyre njëkohësisht kryen studimet edhe në universitet ku u titulluan inxhinierë. Këta, kudo që ishin caktuar, nëpër repartet e shumta të shpërndara anë e kënd atdheut, dalloheshin jo vetëm për aftësi të spikatura profesionale e përkushtim, por edhe për kulturë të lartë. Kam pasur fatin t'i njoh nga afër shumë prej tyre dhe ruaj respektin më të madh për kuadrot e kësaj arme. Si mund të harrohet erudicioni dhe humanizmi i Tomor Dedes, takti pedagogjik i Bexhet Guxhollit, urtësia e Stefan Inxhilizit, zgjuarsia e Subi Maskës, pedagogëve tanë në shkollën e oficerëve. Puna e ndershme dhe plot sakrificë e përkushtim i sa e sa oficerëve xhenierë nëpër repartet ku punova, më ka mbetur në mendje. E kam ndier atë të Sabri Rexha, që ishte plagosur duke çminuar

bregdetin te shkëmbi i Kavajës, ku i ishin vrarë shokë. E kam parë atë te miku im i ndjerë Besnik Alibali, i cili edhe pse i ndëshkuar, dhe i liruar padrejtësisht nga ajo çmenduria e politikës, bënte çmos duke organizuar veprimtari nga më të ndryshmet, duke shkruar libra, broshura, fletëpalosje e artikuj nëpër gazeta për të ndërgjegjësuar njerëzit nga rreziku i minave. Si të mos e vija re te puna e të urtit Koli Dano në Durrës e më pas në Korpusin e Tiranës.

Si mund të mos përmendet vepra e inxh. Habil Serjanit në ndërtimin e atyre kthesave të famshme në ata malet shkëmborë pranë Tamarës. Dhe natyrisht, te shoku im i shkollës “Skënderbej” ing. Cane Mehmetaj që punonte si hero për të realizuar detyrat në fortifikim dhe që e ruajti dashurinë për armën e xhenios edhe pasi e dënuan poshtërsisht. Por e ka parë kushdo tek ai xhenieri burrë shteti dhe mjaft i ekuilibruar, Alfred Moisiu, që u bë Ministër i Mbrojtjes e deri President i Republikës në demokraci. Dhe mbi të gjitha, vlerat e tyre janë shkruar me gjakun e mbi 80 dëshmorëve që dhanë jetën në moshën më të re, duke zbatuar detyrat e ngarkuara dhe që në libër është përjetësuar vepra e tyre. Këta që përmenda janë vetëm disa nga ata që e shkuan jetën për ta vënë mbi baza shkencore Armën e Xhenios në Shqipëri, për t’ua mësuar mjeshtërinë dhe sekretet e saj kuadrove, ushtarëve, rezervistëve, studentëve e nxënësve të shkollave, apo për t’i stërvitur ata sipas kërkesave të Artit Ushtarak të kohës në fortifikimin e vendit. Ndaj u gëzova kur nënkoloneli pasionant Zabit Cuku më solli librin e tij prej 1060 faqesh (vol. I), kushtuar “Oficerëve të Xhenios në rrjedhën e historisë”. Parakalojnë aty plot figura të njohura dhe të pa njohura, rreth 500 të tilla, me jetë dhe veprimtari pak a shumë të ndryshme. Të ndryshme në moshë, pjesëmarrje në luftë, shkollim, vendet ku studiuan, repartet ku shërbyen, detyrat që kryen, gradat e dekoratat që fituan, fatet politike që i ndoqën etj. por sa të ngjashëm në atdhetari, ndershmëri, përkushtim, dashuri për profesionin, solidaritet e deri korrektesë shembullore si bashkëshortë apo si prindër. Kam ndeshur aty shumë nga shokët e mi të shkollës së mesme ushtarake “Skënderbej”, si Canja, Andon Dhana, Hiqmet Muça, Riza Murati, Teodor Biceri, Ilirian Xhemalaj, Skënder Sulaj etj., dhe janë përshkruar nga ky autor me shumë vërtetësi. Ata ishin djem nga më të mirët dhe të tillë mbetën derisa dolën në pension. Duke iu përmbajtur një metodologjie skrupuloze, Zabit Çuku ka arritur të japë vazhdimësinë e funksionimit të kësaj arme, pra traditën që krijuan aty kuadrot me emër në ushtri, si (veç disave që përmenda deri tani), Veli Dedi, Dhimitër Dhespoti, Spiro Shalsi, Menduh Backa, Josif Zegali, Abedin Poloska, Petrit Çobani, Pandi Dushku, Kadri Brahimaj, Njazi Çepani, Myfit Mushi, Maliq Tartari me shokë. Nga kjo armë, ushtrisë shqiptare iu shtuan shumë oficerë madhorë si dhjetëra kolonelë dhe gjeneralë si Luan Hoxha dhe zoti Dedë Prenga.

Shumë prej tyre janë dalluar edhe si personalitete të kulturës tonë, si fjala vjen shkrimtari i njohur Vasil Premçi apo ish-komandanti i Brigadës së Urave në Kavajë, i ndjeri Mustafa Dervishi, autor i disa romaneve mjaft të arrira, por që Kovid i ndau nga jeta. Po kështu kujtojmë ata që shkuan nëpër misione jashtë vendit



si kapiten Feti Vogli, rënë në Afganistan, major Klodian Tanushi, nëntetare Zarife Hasanaj, e rreshter Julian Kapaj, që dhanë jetën në Letoni. I lexon emrat dhe veprën e tyre dhe ndien nderim e krenari për bij të tillë të atdheut tonë. Dhe këtë nderim e krenari e ndien për armatën e xhenierëve që ndër dekada kryen punime të jashtëzakonshme, sidomos vendkomanda, spitale e vendstrehime njerëzish, armatimesh e municionesh.

Janë mbresëlënëse ato të bazave të FLD-së apo aviacionit të asaj kohe si p.sh. ajo në Gjadër, i cili pas viteve 1990 u vizitua nga ushtarakë të lartë të vendeve anëtare të NATO-s, mes tyre Shefi i Shtabit të Turqisë bërë vlerësimin e kuadrove që kanë ndërtuar këto objekte me vlera të rralla ndërtuese dhe historike në rajon e më gjerë. Dhe të mendosh se aso kohe teknika që përdorej nuk ishte e avancuar si kjo e tashmja. Por kuadrot e xhenios e efektivat e tyre, punonin me shpirt e sedër të madhe.

**"Historia e Armës së Xhenios në Shqipëri",
Zabit Cuku**



Lundrimi 59-vjeçar i flotiljes ushtarake

Nga fundi i vitit 1964, Këshilli i Mbrojtjes të asaj kohe vendosi rishikimin e FLD-së, e cila deri në atë kohë ishte e centralizuar, me vendbazim ishulli Sazan. Kështu u vendos që anijet mbiujëse luftarake të ndahen e të krijohen Flotilja e Durrësit dhe Flotilja e Vlorës. Si kriter bazë i caktimit të kuadrove do të merrej vendbanimi Durrës, dhe kjo për efekte strehimi.

Në përbërje të Flotiljes Durrës u caktuan anije minahedhëse, gjuajtëse kundër ND si dhe anije ndihmuese. Komandant ishte caktuar Dashamir Ohri. Ai vinte nga një përvojë e pasur si ish-komandanti i bazës së nëndetësive të Pashalimanit, pikërisht në periudhën kur ishte krijuar konflikti i madh me aleatin e atëhershëm, Bashkimin Sovjetik. Ai është dhe një nga 17 oficerët e parë shqiptarë që ka mbaruar studimet në vitin 1947 në ish-Jugosllavi. Është, ndërkohë edhe një nga specialistët e parë të përgatitur në ish-Bashkimin Sovjetik dhe më pas, një ndër personat e parë, i përgatitur për nëndetëse po në ish-Bashkimin Sovjetik. Dashamir Ohri ka qenë pikërisht komandanti i nëndetësive së parë shqiptare, të ardhur me një katërshe nga Bashkimi Sovjetik.

Në mesditën e 4 janarit 1965, kap. i rangut III Dashamir Ohri, i emëruar komandant i Flotiljes Durrës, organizon një takim me kuadrot e Shtabit të Flotiljes dhe komandantët e anijeve, i njeht me planin e lundrimit të Flotiljes nga Sazani në Durrës. Rreth orës 20:00 fillon dalja e anijeve nga Sazani.

Dalja e anijeve u shoqërua me rënien e sirenavë si përshëndetje tradicionale e FLD-së. Lundrimi për në Durrës u bë natën, në formacion lundrimi dhe në kushtet e një deti të trazuar. Në mëngjesin e datës 05 janar 1965 anijet mbërritën në radën e Durrësit, e më pas u akostuan në Kalatën Lindore të Portit Detar Durrës.

Kështu data 5 janar 1965 shënon ditën e rikrijimit të Bazës Detare Durrës. Para komandës e Shtabit të Flotiljes dëlnin detyra për konsolidimin e vendbazimit. Nisi gjithçka nga e para sepse mungonte infrastruktura, si bankinat, godina e komandës, kushtet e përgatitjes speciale, depot, baza materiale për përgatitjen e efektivave etj.

Në sajë të punës vetëmohuese të kuadrove dhe efektivave u arrit

që të ndërtohej bankina e silurë-hedhësve, ofiçina e silurëve si domosdoshmëri për anijet që pritej të vinin në vitin 1965 nga RP e Kinës. Ndihej të madhe për sigurimin e kushteve të vendbazimit dhanë edhe ndërmarrjet e qytetit të Durrësit si NN Porti, Porti Detar etj.

Rruga në të cilën ka ecur Baza Detare e Durrësit gjatë këtyre viteve është e mbushur me sakrificë në kryerjen e detyrave për mbrojtjen e ujërave tona territoriale nga veprimtaritë e paligjshme të anijeve të huaja, ndalimin e tentativave për kontrabandë etj.

Në vite, Bazës iu shtuan anije të tjera si silurë-hedhëse, gjuajtës detar, u ndërtuan vendbazimi në B. Pallë, ofiçina të riparimit të anijeve, godina e komandës, shkolla e përgatitjes së efektivave etj.

Janë të shumtë ish-detarët që kanë kryer shërbimin ushtarak në Bazën e Durrësit që punojnë në profesione të ndryshme në Flotën Tregtare, në Flotën e Peshkimit etj. Në këtë 59-vjetor të rikrijimit të Bazës Detare të Durrësit, për punën plot përkushtim në shërbim të atdheut kujtojmë me nderim e respekt kuadrot e parë që hodhën themelet e krijimit dhe konsolidimit të Bazës, të cilët janë ndarë nga jeta, si komandantët e Bazës në vite: kap. rang III D. Ohri, kap. rang I M. Plani, shefi i Shtabit të Bazës, kap. rang III M. Lulolli, komandantët e skuadriljeve silurë-hedhëse, kap. rang III Selam Qejvani, kap. rang III Ali Canosinaj, komandantin e grupit të anijeve mbiujëse Petro Treni, Ing. mekanikët Piro Tushi, Ismet Beluli, Sami Shyti, Mark Berdufi, M. Hysi; kuadrot me përvojë Xh. Bujari, Vasil Petro, Spiro Kote, A. Sevrani, B. Demko, Mihallaq Papadhopulli, B. Shehu, T. Gërveni, Skënder Sulku, Halit Hima, Thoma Rubia, B. Këlmendi, S. Beluli, I. Rexha etj., si dhe Tasim Sinani, Hektor Meçe, A. Daja, D. Hoxha, që u larguan nga jeta shumë para kohe.

Përveç vështirësive që lindën nga ridislokimi, zgjerimi i forcave detare në përmasa të tilla, nuk mund të përballohej me efektivat që kishte, veçanërisht me kuadro. Edhe pse qeveria shqiptare i kishte paraprirë këtij zgjerimi, duke dërguar disa vite më parë studentë në akademitë e BS, ndër ta kishte grupe studentësh që ende nuk i kishin përfunduar studimet. Prandaj lindi nevoja e

kalimit në forcat detare të shumë kuadrove nga repartet e artilerisë kundërajrore dhe bregdetare të ushtrisë. Ndërkohë, pranë shkollës së specialiteteve u ngrit një kurs 9-mujor me detarë që kishin mbaruar shkollën e mesme dhe që kishin aftësitë e duhura për t'i titulluar oficerë.

Pra, viti 1958 mund të quhet viti i një ndryshimi të madh në forcat detare shqiptare. Ato përfaqësoheshin në MMP nga kapiten i rangut I Abdi Mati dhe kishin këtë strukturë, Komanda dhe Shtabi i FLD-së – komandant – kapiten i rangut I Teme Sejko – shef i Degës Politike, kolonel Hajdar Aranitasi – komandant prapavije, kolonel Bedri Gjergji – shef Shtabi, kapiten i rangut II Mark Plani dhe anëtarë shtabi kapiten-lejtnant II Sezai Osmani, kapiten-lejtnant II Seit Jonuzaj, kapiten II Xhemali Milori, kapiten I Perlat Molla, kapiten-lejtnant II Qemal Hysaj, kapiten-lejtnant II inxhinier Tahir Hoxha etj.; Brigada e Nëndetëseve (Br. ND), me vendbazim në Pashaliman, Brigada e Mbrojtjes së Rajonit të Ujërave (Br. MRU), me vendbazim në Sazan, ku përfshiheshin: grupi i gjuajtësve detarë (GJD), me katër gjuajtës detarë; grupi i minaheqësve (MH), me dy minaheqëse të vogla, grupi i motosilurueseve (MS), me gjashtë motosiluruese tip 123-biz, detashmenti i anijeve ndihmëse (DAN) në varësi të komandës së prapavijës së Flotës në Vlorë, shkolla

e specialiteteve (e transferuar nga Durrësi në Pashaliman), rajoni i pikave sinjal-vrojtuese (PSV) pranë komandës së Flotës në Vlorë, shërbimi hidrografik me qendër në Ujë të Ftohtë (tek "Shtatë Pallatet"). Pas dy vjetësh pune intensive nga komanda, shtabi, gjithë repartet e Flotës, shënios së ushtrisë si dhe, falë mbështetjes së qeverisë, në mesin e vitit 1958, përfundoi ndërtimi i bazës së Pashalimanit, rikonstruksioni i bazës së Sazanit si dhe kompletimi i reparteve të Flotës. Për të festuar rezultatet e arritura në zhvillimin e modernizimin e forcave detare si dhe për t'ia bërë ato të njohura popullit, u vendos që me rastin e përvjetorit të Ushtrisë Popullore të zhvillohej në gjirin e Vlorës një paradë detare.

Për punën e mirë në riorganizimin dhe kompletimin e forcave detare, shefi i seksionit të Marinës pranë MMP, Abdi Mati dhe komandanti i Flotës Teme Sejko u graduan kundëradmiralë, ndërsa shumë kuadro të tjerë u graduan jashtë radhe si dhe u bënë dekorime. Gjithashtu, për t'iu përgjigjur nivelit të zhvillimit të forcave detare shumë kuadro e

detarë u dërguan për specializim në BS. Në vijim, efektivat e flotës intensifikuan stërvitjet në bazë dhe në det. Në verën e vitit 1959 edhe efektivat e katër nëndetëseve i kishin realizuar objektivat për marrjen në dorëzim të tyre, ndërkohë që nga anijet mbiujëse specialistët sovjetikë ishin larguar. Prandaj nga MMP u vu detyrë përgatitja dhe zhvillimi i një stërvitjeje me qëllim përpunimin e bashkëveprimit të llojeve të ndryshme të armëve të ushtrisë në bregdet, në kushtet e një zbarkimi të mundshëm armik nga deti. Për zhvillimin e saj u caktua si vend rajoni i gjirit të Drinit. Pasi u bënë të gjitha përgatitjet e nevojshme, në shkurt 1961 u vendos fillimi i stërvitjes së koduar "Drini-61", ku, nën drejtimin e komandantit të FLD-së Hito Çako, morën pjesë: Brigada e nëndetëseve shqiptare dhe nëndetëset sovjetike të dislokuara në gjirin e Vlorës; Brigada e MRU (tetë minaheqëse, katër gjuajtës detarë, cisterna e naftës Patosi, anija silurë-kapëse dhe gjashtë motosiluruese) si dhe detashmenti i anijeve ndihmëse; Artileria Bregdetare Durrës-Rodon-Shëngjin; Repartet bregdetare të këmbësores të rajonit Durrës-Shëngjin dhe Aviacioni Ushtarak Shqiptar. Në stërvitje morën pjesë komanda dhe shtabi i FLD-së, përfaqësues nga Shtabi i Përgjithshëm e Ministria e Mbrojtjes, ndërsa nga pala sovjetike një grup këshilltarësh (si vëzhgues) nën drejtimin e kundëradmiralit Kulik, të gjithë të vendosur në Bazën Lundruese Tomori. Stërvitja zgjati 10 ditë dhe u zhvillua në

kushtet e një moti të keq, mbi mesataren, por kjo gjë nuk ndikoi në realizimin e planit.

Nga fundi i vitit 1964 Këshilli i Mbrojtjes të asaj kohe vendosi rishtrukturmimin e FLD-së, e cila deri në atë kohë ishte e centralizuar, me vendbazim Ishulli Sazan. Kështu u vendos që anijet mbiujëse luftarake të ndahen e të krijohen Flotilja e Durrësit dhe Flotilja e Vlorës. Si rezultat i hapjes me botën, në ujërat tona u rrit intensiteti i lëvizjeve të anijeve të huaja për qëllime ekonomike, turistike e kontrabande. Për rrjedhojë u rrit edhe mundësia e shkeljeve të ujërave tona, u shtua veprimtaria për peshkim të paligjshëm, përpjekja për trafikë të klandestinëve, të drogës, të armëve etj.

Në të gjitha stërvitjet e përbashkëta, kuadrot tona kanë treguar përgatitje profesionale, kanë qenë në të njëjtin nivel me kuadrot e flotave të huaja partnere. Rol të rëndësishëm në zbatimin e detyrave kanë luajtur sistemi i vëzhgimit detar nëpërmjet PRT të vendosura në vendet e studiuara për këtë qëllim, të cilat janë pajisur me teknikë bashkëkohore. Tashmë anijet me të cilat u rikrijua Baza Detare kanë dalë jashtë strukturës së Flotës dhe vendin e tyre e kanë zënë anije të reja të ardhura nga vendet aleate si SHBA, Holanda, Italia etj., të cilat i përgjigjen plotësisht kryerjes së detyrave të ruajtjes së ujërave tona territoriale.



Me ndryshimin e sistemit politik në vitin 1990, Baza detare e Durrësit pësoi ndryshimet e veta në konceptin e detyrave, organizim dhe strukturë. Si rezultat i hapjes me botën, në ujërat tona u rrit intensiteti i lëvizjeve të anijeve të huaja për qëllime ekonomike, turistike e kontrabande. Për rrjedhojë u rrit edhe mundësia e shkeljeve të ujërave tona u shtua veprimtaria për peshkim të paligjshëm, përpjekja për trafikë të klandestinëve, të drogës, të armëve etj.

Baza Detare e Durrësit i ka përballuar të gjitha detyrat në ndalimin e këtyre veprimtarive të paligjshme. Në këtë aspekt kontribut ka dhënë edhe bashkëveprimi me anijet e Flotave Ushtarake të NATO-s. Vlen të përmenden veprimtaritë e përbashkëta të mjeteve të Bazës Detare të Durrësit, duke ndaluar misione kontrabande, anije naftëmbajtëse etj. Në të gjitha stërvitjet e përbashkëta, kuadrot tona kanë treguar përgatitje profesionale, kanë qenë në të njëjtin nivel me kuadrot e flotave të huaja partnere.

Rol të rëndësishëm në zbatimin e detyrave kanë luajtur sistemi i vëzhgimit detar nëpërmjet PRT të vendosura në vendet e studiuara për këtë qëllim, të cilat janë pajisur me teknikë bashkëkohore. Tashmë anijet me të cilat u rikrijua Baza Detare kanë dalë jashtë strukturës së Flotës dhe vendin e tyre e kanë zënë anije të reja të ardhura nga vendet aleate si SHBA, Holanda, Italia etj., të cilat i përgjigjen plotësisht kryerjes së detyrave të ruajtjes së ujërave tona territoriale.

Mitat Kondi, luftëtar partizan, oficer madhor, mbledhës i folklorit



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Në kuadrin e 105-vjetorit të lindjes të Mitat Kondit, ish-luftëtarit partizan të orëve të para në formacionet e vogla dhe të mëdha të LANÇ-it, ushtarakut madhor që shërbeu me dinjitet në radhët e Ushtrisë Popullore dhe mbledhësit të apasionuar të folklorit popullor, të këngëve e valleve të Labërisë për trevën e Krahinës së Kardhiqit e Rrëzomës por edhe më gjerë, si të ishte pjesë e pandarë e institutit të Kulturës Popullore Shqiptare. Dedikuar burrit të mirënjohur Mitat Kondi, për intendentin e çetës së parë partizane “Çerçiz Topulli”, luftëtarit që mbante pseudonimin gjatë luftës “Elefanti”, për partizanin e batalionit “Asim Zeneli”, partizanin dhe kuadër i Brigadës së 2-të Sulmuese, brigadë ku kreu edhe detyra me përgjegjësi, si komandant Kompanie, zëvendëskomandant Batalioni, komandant Batalioni, deri në zëvendës, komandant Brigade. Mirënjohja shkon për ushtarakun me karrierë brilante 30-vjeçare, që jetën ia kushtoi çlirimit të Atdheut nga pushtuesit nazifashistë, ngritjes e forcimit të strukturave të mbrojtjes pas çlirimit të vendit, por dhe historisë, ku u shqua veçanërisht si mbledhës i folklorit, të këngëve popullore të krahinave të Kardhiqit dhe Rrëzomës të bashkive Gjirokastër dhe Delvinë.

Nga Zhulati i historisë, bir i krahinës së Kardhiqit

Mitat Kondi është një nga personalitetet e spikatur të Krahinës së Kardhiqit i trevës labe. Mitat Mazllëm Kondi ishte lindur, më 9 janar 1919, në fshatin Zhulat të Gjirokastrës. Nëna e tij Dilija dhe babai Mazllëmi ishin të njohur në fshat dhe krahinë si njerëz të mirë, të punës dhe të sakrificës, që gëzonin respektin e fshatit dhe krahinës, si dhe mjaft të respektueshëm në zbatimin e zakoneve e sharteve të vendit. Oxhaku i fisit Kondi si në Zhulat dhe në Fushëbardhë ishin të shquar në historinë e trevës së

Labërisë. Ambienti ku u lind dhe u rrit Mitati ishte me histori të madhe, që rrezatohej dukshëm atdhetaria dhe patriotizmi. Të parët kishin luftuar për mbrojtjen e truallit arbëror sikurse gjithë bashkëfshatarët dhe bashkë-krahinarët e tjerë. Mitat Kondi arsimimin fillor e përfundoi në Zhulat, ndërkohë që u rrit dhe u burrërua para kohe në një botë plot halle. Të parët e mëkuan me bëmat e të parëve që në luftërat anti-tanzimat, me frymën atdhetare të kuvendeve të Idriz Sullit të 1770-ës në Senicë dhe më 1773 në Taroninë, tek Rrapi i Agait, me kryengritjet labe të 1847-tës, të luftës së parë anti-greke të 1854-ës, të luftërave për autonomi sipas direktivës së LSHP-së më 1878, të luftërave në Sarandë dhe në Gjashtë, me luftërat më 1897 dhe 1913-1914 në “5 Pusët”, “Grebene”, “Janinë” etj., e veçanërisht me Luftën e famshme të Vlorës, të 1920-tës. Historia e Zhulatis të këtejme dhe Zhulatis të tejmë “u saldua” në mendjen e Mitat Kondit dhe ngeli krenari jetësore. Pas çlirimit të Atdheut, Mitati i apasionuar pas arsimit, vijoi studimet në Gjimnazin e Korçës. Në vitin 1962 përfundoi studimet e larta në Tiranë në Universitetin Shtetëror, Fakulteti Histori-Gjeografi, duke u kompletuar kështu me arsimim elitar për kohën. Biografia e tij është mjaft e pasur: Në qershor të vitit 1942 hyri në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare. Po në korrik të këtij viti doli partizan, duke u inkuadruar në njësitë partizane të zonës së Kardhiqit, Çetën “Çerçiz Topulli” me detyrën e intendentit. Më 7.8.1943, kjo çetë inkuadrohet në Batalionin “Asim Zeneli”, ndërsa Mitat Kondi në nëntor 1943 inkuadrohet në Brigadën e Dytë Sulmuese. Në këtë Brigadë u ngarkua me detyra të ndryshme si komandant Kompanie, zëvendëskomandant Batalioni, komandant Batalioni, e deri në zëvendëskomandant Brigade. Mori pjesë në veprimet luftarake të kësaj brigade në zonat e Elbasanit, Tiranë, Librazhd, Dibër e Madhe, Maqedoni, Mat, Krujë, Ishëm, Pezë, Korçë, Përmet, Leskovik, Kolonjë, Devoll etj. Gjeografia e veprimtarisë partizane të Mitat Kondit është e pasur, duke futur në të dhe veprimet në zonën e Kardhiqit, Cepos, Vurgut, Delvinës, Sarandës, Libohovës, Tepelenës, Kurveleshit e tjerë. Pas çlirimit të vendit ka patur funksione të rëndësishme në ushtri, duke shërbyer në reparte e njësi të Ushtrisë në Tiranë, Shkodër, Gjirokastër, Korçë, Kavajë, Burrel, Kukës e tjera. Gjatë gjithë jetës së tij ka patur edhe ka pasion të shkruarit të historisë dhe të mbledhjes së traditës folklorike labe të krahinave

të Kardhiqit dhe Rrëzomës, krahinave që takohen në Qafën e njohur të Skërficës. Deri në frymën e fundit iu përkushtua idealeve për të cilat luftoi gjatë gjithë jetës; por la në duart e miqve, shokëve, bibliotekave, edhe libra të tillë sikurse ishte ai me vargjet e poetit brilant popullor të fillim shekullit të kaluar, Jonuz Kuci nga Fushëbardha, që ishte rrënjë e fis nga Osmën Kuci i parë prijës, luftëtar e kapedan i betejave të mëdha të historisë. Mitat Kondi e risolli të gjallë, që të mos ngelej legjendë në kujtesën popullore. Deri në fund të jetës ngeli luftëtar i llogores së luftës dhe të këngës, ngeli i paepur në mbrojtje të idealeve të LANÇ-it, si vetë emri figurativ, që i vuri lufta “elefant” për idealet e lirisë, fisnik, i vendosur, me temperament lab fizikisht dhe psikologjikisht, depërtues në mendjen e njerëzve për të vjelë thesaret e fshehura të trevës labe në dy krahina të rëndësishme. Ai shkroi gjithë jetën dhe sipas poetit Zeqo Cama që e sjell në vëmendje këtë burrë të mençur e fisnik që nga Kanadaja, ai thotë, që Mitat Kondi ka lënë disa kujtime, por dhe vargje të mbledhura nga Jonuz Kuci i Fushëbardhës, dorëshkrime me vlerë për krahinën e Kardhiqit e Rrëzomës, që janë me vlerë për historinë krahinore dhe kombëtare.

Luftëtar i çetës emërndritur në histori “Çerçiz Topulli”

Çeta partizane “Çerçiz Topulli”, ku bënte pjesë që ditën e parë të krijimit edhe Mitat Kondi u krijua më 12.12.1942 në Fushëbardhë. Mitatin e ngarkuan me detyrën e itendentit dhe e quajtën “Elefanti”. Labi i mençurisë dhe veprimit atdhetar u gjend në kohën dhe vendin e duhur nga ku nisi rrugëtimi i tij historik i jetës plot vitalitet dhe krenari në shërbim të vendit. Çetës partizane “Çerçiz Topulli”, ku aderoi Mitat Kondi ishte formacioni i parë partizan i krahinës së Kardhiqit. Kjo çetë ishte pjesë e koalicionit të madh antifashist Anglo-Sovjeto-Amerikan, që bashkë me të gjitha formacionet e tjera partizane shqiptare të çetave, batalioneve, brigadave e divizioneve të UNÇSH-së, shkruan faqe lavdie e trimërie në historinë e luftërave dhe fitoreve të shqiptarëve. Djemuria e krahinës u bashkuan me nismëtarët e krijimit të çetës, si Dilaver Poçi, Gani Haloçi, Mitat Kondi me pseudonim “Elefanti”, Ago Topulli, Islam Poçi, Hariz Shalari, Nimet Velu, Neshat Kondi, e të tjerë, një brez atdhetarësh luftëtarësh e patriotësh që u vetëvendosën në sprovë dhe morën përsipër një barrë të madhe dhe me përgjegjësi të madhe përpara kombit dhe historisë. Fushëbardha, Zhulati, Prongjia, Kardhiqi, Plesati, Mashkullora, Humelica, Palokastra dhe fshatrat përtej lumit “Belica”/lumi të Joshe si Shtëpëzi, Picari, Kolonja, Medari, Gropa e Barxhit, Golemi e Kaparieli u bënë fshatrat që ndezën pishtarin e luftës për çlirim dhe u organizuan fuqishëm rreth idesë së madhe të çlirimit. Mitat Kondi ishte pjesë e trupëzuar e çetës “Çerçiz Topulli” të krahinës së Kardhiqit e para çetë e krahinës, që i dha shpresë popullit të shtypur dhe të vuajtur jo vetëm nga skamja dhe varfëria por dhe nga çizmja e rëndë e pushtimit, e pushtimeve që nuk iu



sosën shqiptarëve. Emërtimin e kryetrimt Çerçiz Topulli ia vunë në Prongji në marsin e 1943-it. Krijimi i çetës partizane “Çerçiz Topulli” i dha rastin krahinës ta përkujtojë si ngjarje madhore, dhe të nderojë me respekt të veçantë dëshmorët e krahinës që derdhën gjakun për liri si dhe gjithë luftëtarët që sakrifkuan aq shumë, por dhe gjithë popullin e krahinës së Kardhiqit që i dha gjak, frymë e mbështetje kësaj çete që shkroi histori me lavdi. Mitat Kondi dhe djemtë e Zhulatis e kryen me sukses misionin historik. Çeta “Çerçiz Topulli” u bë shpresë për popullin dhe tmerr për armikun. Misioni i Çetës partizane “Çerçiz Topulli”, mbeti liria, si një emblemë e heroizmit, besnikërisë së idealeve të lirisë prandaj mbeti edhe emërndritur në historinë e LANÇ-it, pasi ajo luftoi me emrin çetë për 239 ditë, zhvilloi betejat në dy qarqe të Gjirokastrës dhe të Sarandës, ku hapësira e veprimeve luftarake ishte në kufij taktikë, të krahasueshme me zonën e veprimit të njësisë operative. Nga fshati i Zhulatis ranë Dëshmorë të Atdheut: (1) Axhem Velo Çela 1926-1944, (2) Hamit Demo Pula 1920-

1945, (3) Hasan Salih Çerepi 1927-1944, (4) Mahmut Zoto Bedo 1920-1944, (5) Mete Beqo Hila 1894-1944, (6) Qemal Mustafa Shabani 1920-1944, (7) Rushan Riza Pula 1922-1945, (8) Salih Malo Çerepi, (9) Alush Muharem Aliko 1913-1950; Gjykojmë që ky është edhe varianti zyrtar i Departamentit të Dëshmorëve në Ministri të Mbrojtjes dhe përfundimtar sot për sot për Zhulatin; ndërsa nga Fushëbardha: (1) Karafil Bello, (2) Sami Golemi, (3) Alem Shehu, (4) Tahir Xhuvani, (5) Baxhul Norra, (6) Gazi Kondi, (7) Zijadin Çarçani, (8) Kutbi Gjeçi, (9) Latife Norra, (10) Nishat Kondi, (11) Xhezo Proda, (12) Cirok Cama, (13) Destan Norra, (14) Tajar Proda, (15) Mato Serjan Mato që të gjithë flamur lirie në rrënjët e kombit shqiptar si dhe krenari krahinore. Për dëshmorët dhe idealet e luftës çlirimtare punoi fuqishëm për lartësimin e figurave të tyre gjithë jetën Mitat Kondi.

Burrat që rriti lufta e madhe Antifashiste partizane e shqiptarëve Në zjarrin e luftës antifashiste u rritën antifashistët e parë të trevës labe, të Zhulatis dhe mbarë krahinave e trevave rebele, që e kundërshtuan me armë pushtuesin. Çetat partizane shpejt u kthyen në batalione me përbashkimin e tre-katër çetave dhe kështu edhe Mitat Kondi nga radhët e çetës u rreshtua në formacionin solit dhe më të fuqishëm luftarak që mbante emrin e heroit të Mezhgoranit “Asim Zeneli”. Batalioni u formua nga çeta “Çerçiz Topulli”, “Hajredin Tremishti”, “Avni Rustemi” dhe “Toto Bolena”. Ky batalion u ngrit më 7 gusht 1943 dhe Mitati por dhe të 540 partizanët e këtij batalioni ia ngritën më lart lavdinë dhe krenarinë krahinës së Kardhiqit, krahinë që derdhi gjakun e 106 dëshmorëve të kësaj krahine lavdiplotë. Mitati dhe shokët e tij përfaqësonin trimat pushkë-bashkuar të të gjithë luftëtarëve të krahinës së Kardhiqit që i bënë nder Labërisë, Gjirokastrës, mbarë truallit shqiptar. Të gjitha këto të dhëna vijnë përmes shënimesh të luftëtarit, partizanit, kuadrove të lartë ushtarake Dilaver Poçi, Gani Haloçi, Mitat Kondi, Resul Bedo etj., që në fakt i bënë nder historiografisë shqiptare dhe veçanërisht asaj ushtarake. Kuadrot luftëtarë të Krahinës mbetën përjetësisht njerëzorë: “Madhështinë e njeriut nuk e bëjnë postet që arrin në jetë, por virtytet, karakteri i tij, ideali atdhetar, familja, të cilave u përkushtohesh”. Lufta çlirimtare e bijve të popullit për të cilët luftoi edhe Mitat Kondi, i cili bëri që fshatrat e krahinës së Kardhiqit të hapnin dyert e zemrat për çlirimtarët e vërtetë, për partizanët e brigadave partizane që erdhën në krahinën e Kardhiqit si misionarë të çlirimit. Fakt është se, në këtë krahinë të lavdishme janë mirëpritur me zakonet tradicional të shqiptarit, “kripë, bukë e zemër”, formacionet partizane të: Br.1S, Br.IIIS; Br.VS, Br.VIS, Br.VIIS, Br.XIVS. Pas disa muajsh luftimesh dhe pasi ishte krijuar SHP i UNÇSH dhe fillimi i krijimit të formacioneve të mëdha sikurse ishin Brigadat Partizane Mitat Kondin e gjejmë në nëntor 1943 në Brigadën e Dytë Sulmuese.

Biri i Zhulatis në brigadën partizane

që u krijua në ditën e flamurit në Shëngjergj

Riorganizimi dhe ngritja e formacioneve të mëdha partizane i dha hov të ri luftës kundër pushtuesve. Që në tetor të 1943-it në dispozicion të Br.IIS. Historia e Br.IIS është historia e luftës dhe e përpjekjeve të atyre bijve dhe bijave shqiptarë që erdhën në gjirin e kësaj njësie nga zona dhe krahina të ndryshme të Tiranës, Elbasanit, Gjirokastrës, Mallakastrës, Kurveleshit, Kolonjës,

Librazhdit etj. Këta bij të thjeshtë të popullit vullnetarisht lanë vatrat e qetësinë e tyre familjare dhe u bashkuan me familjen e madhe partizane, ku luftuan me trimëri e vetëmohim në emër të çështjes të çlirimit kombëtar dhe shoqëror të popullit. Dhe një ndër kuadrot e kësaj brigade ishte biri i Krahinës së Kardhiqit Mitat Kondi. Brigada II Sulmuese u krijua me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, më 28 Nëntor 1943, në fshatin Skrep të Shëngjergjit në rrethin e Tiranës, në ditën simbol të kombin tonë, në ditën e shpalljes së pavarësisë. Në inaugurimin e Brigadës morën pjesë drejtuesit më të lartë të SHP-së. Komandanti i Përgjithshëm Spiro Moisiu i dorëzoi flamurin luftarak komandantit të Brigadës Beqir Balluku. Brigada II Sulmuese, ishte organizuar më tre batalione dhe kishte 450 partizanë. Kjo brigadë jo rastësisht u formua në Shqipërinë e Mesme, në afërsi të kryeqytetit, në zemrën e reaksionit më të tërbuar. Koha, vendi dhe situata në të cilën lindi Br. II Sulmuese karakterizohej nga një sërë vështirësish serioze, dimër dhe zona ku vepronin partizanët ishte ndër më të varftrat. Formacioni ku shërbeu Mitat Kondi ishte bërë tmerr për armiqët dhe shpresë për popullin. Ishin 43 partizanë të kësaj brigade që ranë në fushën e betejës. Brigada II S, më 14 dhjetor 1944, vetëm dy javë pas çlirimit të hapësirës administrative shqiptare, u rreshtua në Divizionin VII Sulmues së bashku me Brigadën IX dhe Brigadën XX duke marrë pjesë në Korparmatën II dhe pas çlirimit të vendit në Korpusin II me qendër në Berat. Rugëtimi luftarak i kësaj brigade u shkrua me gjak e sakrificat të panumërta dhe ngeli flamur lirie dhe krenarie për brezat. Në çdo apel të Brigadës nuk mungonte sigurisht dhe nuk do të mungojë kurrë një bir i shquar i Labërisë: Mitat Kondi. Ai nuk do të mungojë pasi në këtë Brigadë u ngarkua me detyra të ndryshme si Komandant Kompanie, zëvendëskomandant Batalioni, komandant Batalioni, zëvendëskomandant Brigade. Mitat Kondi mori pjesë në veprimet luftarake të kësaj brigade në zonat e Elbasanit, Tiranës, Librazhd, Dibër e Madhe, Maqedoni, Mat, Krujë, Ishëm, Pezë, Korçë, Përmet, Leskovik, Kolonjë, Devoll etj. Pas çlirimit të Atdheut sikurse gjithë bashkëluftëtarët dhe fitimtarët e luftës, Mitat Kondi përveshi llërët për ta dhënë kontributin denjësisht si kuadër i lartë i Ushtrisë Popullore në periudhën me grada, por edhe pa grada ushtarake pas heqjes së tyre, më 1 maj 1966, deri në daljen në pension. Për punë të mirë dhe të përkushtuar Mitat Kondi u vlerësua me urdhra, medalje e dekorata të ndryshme përgjatë karrierës së gjatë ushtarake si medalja e trimërisë, Dekorata e Kujtimit, Medalja e 10-vjetorit të çlirimit, Medalja “Ylli i kuq”, si dhe mjaft vlerësime të tjera. Mbi të gjitha Oficeri madhor Mitat Kondi nuk punoi për tituj e medalje por ishte dhe mbeti një kontribuues i shquar në të nëntë dekadat e jetës së tij. Mitat Kondi është pa diskutim një personalitet i shquar i trevës së Labërisë si dhe emrin e tij meriton të shkruhet i ndritshëm në Zhulat e Fushëbardhë, në krahinën e Kardhiqit dhe të Rëzomës, në të dy këto krahina që qëmtoi plot finesë më shumë se 700 vargje këngësh, që përllogariten të jenë kënduar të paktën në pesë shekujt e fundit. Mbledhësi i këngëve Mitat Kondi e pasuroi më tej serinë e “Mbledhësve të folklorit” me një vëllim (nr.5), me interes shumë të madh për kulturën kombëtare shqiptare.

Brigada që shkroi histori ushtarake në LANÇ



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Brigada me dy ditëlindje

Shqipëria dhe Labëria nuk e harrojnë historinë e lavdishme të Brigadës së V Sulmuese (BrVS). Ajo ka dy ditëlindje në dy vendlindje. Baza e formimit të brigadës ishte dy batalionet "Halim Xhelo" dhe "Ismail Qemali", me një efektiv prej më shumë se 500 luftëtarë. Në fshatin Gumenicë është lapidari që përkujton ditën e formimit të BrVS, në një kodër, si një vend strategjik nga ku shikon të gjithë zonën përreth. Prej këtej vëzhgoje të gjitha lëvizjet e forcat armike që lëviznin në ndjekje të formacioneve partizane të zonës. Në ditën e formimit të saj në fshatin Gumenicë dhe deri në ditën e inaugurimit në Bramyshnje të Tërbaçit, më 20 janar 1944, brigada u ndesh në luftime të pandërprera të operacionin nazist që kishte filluar në luginën e Mesaplikut. Vendlindja e parë është Gumenica dhe datëlindja më 28 nëntor 1943, ku ishte emëruar komandant Abaz Shehu dhe komisar Hysni Kapo. Inaugurimin ngeli në gjysmë se u nis urgjent për në betejë kundër nazistëve e ballistëve në Luginën e Mesaplikut dhe në Dukat, ku po goditeshin partizanët prapa shpine e ku po terrorizoheshin populli. Për ditë e net luftimet u zhvilluan të ashpra në Dukat dhe në Gjorm, ku më 12 dhjetor 1943 bie heroikisht Abaz Shehu, komandanti i brigadës. Shefqet Peçi ka thurur vargje: Ndërmjet Gjorm e Lepenicë,/ Ku shkon lumi me furë/ Atje filloi një luftë,/ Nga xhadeja vjen ushtri./ Doli Abaz Shehu vet,/ Dha urdhër me shpejtësi,/ Gjerman bashkë më tradhtarë/ Përdorin artileri,/ Afër Gjormit më të dalë,/ Filloi një luftë e repte,/ Gjermanët me partizanë,/ U përdor



(NË KUADRIN E 80-VJETORIT TË INAUGURIMIT TË BRVS)

dhe bajonetë,/ Abazi mbeti i vranë,/ Komandanti vet' i tretë,/ Partizanët kur mësu-an,/ U vërsulën si shigjetë.

Vendlindja e dytë është Bramyshnje e Tërbaçit, vendi i inaugurimit të BrVS dhe datëlindja më 20 janar 1944. Komandant u emërua Shefqet Peçi dhe komisar Hysni Kapo, ndërsa zëvendës komisar Manush Myftiu e zëvendëskomandant Dervish Hekali.

Sheshi i Bramyshjes u mbush me popull. Aty u rreshtuan 5 batalione partizane, ku në krye ishte shtabi i brigadës, si dhe shtabet e batalioneve, të kompanive dhe të togave me skuadrat. Organizimi ishte i një ushtrie të rregullt ushtarake. Në ditën e inaugurimit efektiv i brigadës shkoi në 900 luftëtarë. Mbi 80 për qind e partizanëve ishin të rinj e të reja.

Në ditën e inaugurimit të brigadës folën komandant Shefqet Peçi, komisar Hysni Kapo, zëvendës komisar Manush Myftiu etj. U lexua dhe përshëndetja e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së dërguar efektivit të BrVS me rastin e inaugurimit. Në përshëndetje theksohej se brigada të jetë "brigada e flakës, e zjarrit, e luftës dhe e sulmit, si bij të denjë të Vlorës kreshnike, shkatërroni armikun dhe tradhtarët... Ju e keni parë haptazi këtë tradhti të Ballit Kombëtar".

U krijua në kulmin e Operacionit të Dimrit 1944

Brigada u krijua në kulmin e Operacionit armik të Dimrit dhe luftoi për të përballuar mësymjen gjermano-balliste. Operacionin e Dimrit në Qarkun e Vlorës e përballoi populli dhe partizanët e BrVS. Në pasditen e inaugurimit Shtabi i Brigadës, i cili ishte në dijeni të planit të operacionit gjerman mori masa të shpejta dhe nisi repartet në drejtimet e caktuara. Ajo kreu një sërë

aksionesh e betejash. Nuk kishte ditë që të mos mbetej pa një aksion. Ndër luftimet më heroike të BrVS janë luftimet e zhvilluara në Vajzë, Palasë, Vuno, Picar, Pilur, Salari, Gjorm. Brigada, jo vetëm e theu me sukses operacionin gjerman të Dimrit 1943-1944, por zhvilloi edhe një veprimtari të gjerë në popull, duke nxjerrë luftëtarë të tjerë të shumtë për plotësimin e pesë batalioneve të saj.

Urdhri i luftimeve që lëshoi Shtabi i Brigadës i vendoste forcat në këtë mënyrë: Batalionet e dytë e të katërt mbeteshin për mbrojtjen e krahinave të Vlorës, batalioni i tretë në mbrojtje të Bregdetit, kurse batalioni i parë e i pestë në mbrojtje të Kurveleshit të Sipërm nga Kaparieli deri në Salari, ku vepronte bashkë me ta edhe batalioni "Perlat Rexhepi". Brigada zhvilloi njëzet beteja të rëndësishme dhe qindra luftime e aksione të tjera, duke i shkaktuar armikut dëme të shumta në teknikën luftarake dhe mbi pesë mijë të vranë e të zënë robër. Përballimi i operacionit armik të Dimrit 1943-1944 në kushtet e motit të keq, lodhjes, urisë dhe mungesës së municioneve, ishte një provë e madhe e aftësisë së saj luftarake. Me manovrim, ajo e goditi armikun rëndë edhe në Qishbardhë afër Vlorës, ku vritet edhe zëvendëskomandanti i Korpusit XX Gjeneral Lejtënant Dojc. Edhe operacionet e tjerë dështuan me humbje të rënda për armikun. Më 31 mars 1944, brigada u hodh në sulm të përgjithshëm në "frontin tokësor", kështu e quanin gjermanët vijën Penkovë-Mavrovë, meqë prisnim një zbarkim të mundshëm aleat nga deti, duke u shkaktuar atyre shumë dëme. Për hakmarrje gjermanët në prill organizuan një operacion tjetër, që u prit kudo me



luftë dhe që përfundoi me disfatën e tyre në Kuç. Komanda gjermane u detyrua të pohonte për repartin e saj se “trupa me një fuqi 380 vetë, me 26 mitraloza, duke mbetur siç duket pa komandë unike u shpartallua”.

Luftime dhe përvojë në fushën ushtarake

Në muajin maj 1944 brigada u përqendrua në qarkun e Gjirokastrës dhe të Përmetit, ku zhvilloi luftime dhe goditi dislokimin e formacioneve gjermane gjatë rrugës Follorinë-Janinë, luftime të rrepta në fushën e Çarshovës, goditjet që vazhduan gati çdo natë mbi forcat armike në Leskovik, Fushë Kabash, Gostivisht, Qafëzëzë etj., duke e mbajtur armikun të gozhduar për ditë të tëra. Në fillim të qershorit pas një marshimi, brigada nisi sulmin mbi armikun në qafën e Gjarprit tek Guri i Prerë-Shëmbërdhenj të Gramshit e në Qafë Dardhë të Beratit. Luftimet në Qafën e Gjarprit u zhvilluan trup më trup, dhe ku armiku u detyrua të ndryshonte drejtimin e të mos shkelte dot Tomoricën. Komandanti i regjimentit të parë Alpin, i krahason këto luftime me ato të frontit të Lindjes, duke theksuar se “që prej Harkovit nuk është zhvilluar asnjë luftim analog natën”. Me thyerjen e Operacionit armik të Qershorit, brigada u nis për në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut. Midis luftimeve të ashpra që zhvilloi në Veri

ishin në Macukulli, në Qafë Muhur mbi trupat gjermane që vinin nga Dibra për të rrethuar dhe asgjësuar brigadën. Brigada me një manovër të madhe për dy javë rresht, me luftime të ashpra çau përpara në krahë e në shpinë të armikut, në drejtim të krahinës së Dibrës. Pas luftimeve, armiku u shpartallua dhe u çlirua Peshkopia. Në muajin gusht, gjermanët organizuan një operacion të gjerë, duke u nisur me forca të mëdha nga Dibra e Madhe, Gostivari e Korabi, kundër BrVS. U çliruan me radhë Dibra, Maqellara dhe Dibra e Madhe, ku brigadë u rreshtuan 100 luftëtarë dibranë. Luftime të tjera u zhvilluan në rrethin e Kukësit, kudo forcat partizane shpartalluan rëndë gjermanët dhe nga rrethi i Kukësit, u bashkuan me brigadën 150 luftëtarë. Në tetor-nëntor 1944 kaloi kufirin shtetëror, zhvilloi luftime të ashpra kundër nazistëve në Kosovë dhe së bashku me partizanë të Kosovës çliroi Gjakovën, Junikun, Deçanin, Prizrenin, Senicën, Priepoljen, Sanxhakun. Në Kosovë, në bashkëveprim edhe me forcat partizane kosovare, brigada çliroi Gjakovën, Prizrenin dhe gjithë Kosovën. Në radhët e saj hynë qindra vullnetarë kosovarë. Pas riorganizimit të saj me 6 batalione, BrVS marshoi në ndjekje të armikut për ta shpartalluar atë ku të gjendej deri në çlirimin e Sanxhakut. Brigada nga 1 dhjetori 1943 dhe deri më 15 mars 1945

përshkoi një rrugë luftarake prej 3.000 km nga Tërbaçi deri në Sanxhak.

Brigadë e mbuluar me lavdi

Nga kjo Brigadë ranë në fushën e nderit 357 dëshmorë të Atdheut. Dëshmori i parë i saj ishte vetë komandanti i brigadës Abaz Shehu, Heroi i Popullit.

BrVS është ndër brigadat më heroike partizane, që mban titullin e lartë “Hero i Popullit” gjiri i saj ka nxjerrë 13 “Heronj të Popullit”, ku 9 ranë në betejë, ku dy midis tyre janë heroina. Ata janë: Dervish Hekali, Kastriot Muço, Zonja Çurre, Nimete Progonati, Hysen Çino, Abaz Shehu, Zaho Koka, Laze Nuro, Llambro Andoni. Shefqet Peçi, Hysni Kapo, Hito Çako dhe Rrahman Parllaku e morën titullin kur ishin gjallë.

Brigada u bë edhe një fidanishte kuadrosh drejtues në luftë e pas saj. Të tillë ishin partizanët tashmë ushtarakë të Ushtrisë si Mehmet Jaho, Nuri Arapi, Sali Ormeni, Kadri Hazbiu, Mehmet Ali Shehu, Zenel Hamiti, Çelo Arrza, Hajdar Aranitasi, Isak Lilaj, Rrahman Parllaku, Bako Dervishaj. Kuadrot e seksioni politik Hito Çako, Bilbil Klosi, Delo Balili, Andrea Varfi, Ramize Gjebea, Kadri Brahimi dhe Tanush Shyti. Heroizmi kësaj brigade është gdhendur në poezi e në këngë.

Në vargjet popullore thuhet: "Kur lufton Brigadë e Pestë/ Vret e pret e bën kërdi, Shefqet Peçin komandant/ Komisar shokun Hysni".

Brigada IV Sulmuese, një heroinë



KOLONEL (R) SALI ONUZI

Në Auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes u promovua libri i Mihallaq Kondos, “Historiku i Brigadës IV Sulmuese”, me pjesëmarrje të gjerë, ku nderoi veprimtarinë me pjesëmarrjen e tij prefekti i Korçës, zoti Nertil Jole. Kumtuan prof. asoc. dr. Berndard Zotaj, prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi, dhe akademik, prof. dr. Pëllumb Xhufi. Në emër të familjes përshëndeti e bija e autorit, znj. Vjollca Konda Trebicka. Ndonëse urdhri i Shtabit të Përgjithshëm ishte lëshuar që në tetor për organizmin e Brigadës IV S, kjo ndodhi vetëm më 28 dhjetor 1943. Korça e meritonte një njësi të madhe luftarake, për shkak së këtu Lëvizja dhe LANÇ kishin marrë që herët vull të madh. Mijafton të themi se më 7 korrik 1943 në raportin e Shtabit Madhor të LANÇ-it që do të paraqitej në takimin me emisarët britanikë, nga 16 batalione të krijuar deri atëherë në gjithë Shqipërinë, 6 prej tyre ishin krijuar në krahinën e Korçës. Në Vithkuq të Korçës ishte krijuar Brigada I S me partizanë nga e gjithë Shqipëria. Po në qarkun e Korçës do të krijoheshin edhe Br. IX S dhe Br. XV S. Sapo batalionet e saj u rreshtuan dhe u komunikuan komandat, u dha urdhër për t’u nisur në detyra luftarake. Kishte filluar operacioni gjermano-xhandaro-ballist i Dimrit. Prandaj batalionet e Brigadës IV S u nisën kundër forcave gjermane që po mësynin nga Mokra, nga Elbasani e Gramshi, por edhe nga Berati e Çorovoda, të gjitha për në Opar.

Nga Tirana ishin nisur forca të mëdha gjermane për krahinën e Korçës. Por gjermanët nuk kishin mundur të bënin më parë rrethimin operativ të kësaj zone, siç pat ndodhur në zonat e tjera në Veri të Shkumbinit, sepse këtë plan ia kishin prishur armikut forcat partizane që para fillimit të operacionit. Prandaj krahët e formacioneve partizane në qarqet e Korçës e të Beratit, nga ana e Dangëllisë, Përmetit dhe Dëshnicës kishin mbetur krejt të lira, të pacenuara. Kjo përbënte një plus të madh për to, sepse u jepte mundësi manovrimi kundër rrethimeve të armikut.

Bashkë me Brigadën IV Sulmuese ndodheshin edhe forca të batalionit “Tomori”, një kompani e Vlorës, forca të komandës së Shtabit të Korçës, dhe në Jug batalioni “Hakmarrja” i Kolonjës, batalioni Dumre-Verçë-Sulovë etj. Por jo më shumë se 2000 veta përballë afër 9000 armiqsh, të pajisur me teknikë luftarake të fuqishme. Me partizanët e Korçës ndodheshin gjithashtu edhe dy anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, Haxhi Lleshi dhe Ramadan

Çitaku, drejues të tjerë politikë.

Më 9 janar, tri kolona gjermane të shoqëruara me ballistët dolën nga Korça dhe morën drejtimin, e para në Zvarisht, e dyta në Dersnik dhe e treta për në Vithkuq. Gjatë gjithë ditëve më 10, 11 e 12 janar, në kulmin e të ftohtit, batalionet e kompanitë e Brigadës, të ndara në drejtime të ndryshme, goditën pa prerë forcat armike, duke i dëmtuar, por nuk ishte e mundur t’i vinin në tërheqje, për shkak të epërsisë së tyre në forca dhe armatim. Në mëngjesin e 11 janarit forcat gjermane kaluan në mësymje nga Shtylla për të Qafën e Martës, nga Dërsniku për në Gjergjevicë, nga Gjonomadhi e Lavdari për në Voskopojë, nga Tresova për në Shipckë e më tej, nga Zvarishti në Osojë e Gjinikas. Forcat partizane qëndruan fort me sulme e kundërsulme, por edhe me tërheqje për të mos rënë në rrethime.

Duke kuptuar drejt situatën, anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm dhe Komanda e Brigadës kuptuan qëllimin e armikut për rrethimin e Brigadës, prandaj urdhëruan forcat që të tërhiqeshin me radhë, duke u mbrojtur, për të dalë në një drejtim nga rrethimi. Ishte zgjedhur pikërisht Qafa e Beçit në veri të malit të Ostrovicës, (2383 m) për të kaluar në zonën lindore të Skraparit. Qëllimi ishte që prej këndeje, duke kaluar në Qafën e Martës, (në jug të Ostrovicës, mal i gjatë rreth 16 km) të goditeshin gjermano-ballistët nga ky krah dhe të spastrohej terreni prej tyre.

Komanda e Brigadës caktoi në pararojë batalionin e 4-t të saj dhe si pararojë batalionin e parë, të cilit i shkruante: “Detyra juaj është të mbron shpinën në vendin ku jeni dhe të mos e lëshoni për asnjë arsye, deri sa forcat tona të kenë çarë e të kalojnë. Është çështje jete a vdekje për të gjithë ne dhe forcat tona. Duhet të qëndroni patjetër shokë.”

Të gjithë batalionet dhe forcat, të shpërndara gjatë një vije prej 17-18 km, u njoftuan për vendin dhe orën ku duhet të ishin për të krijuar kolonën e marshimit. Dhe u bë një kolonë prej 3000 vetash, (rreth 3 km gjatësi) me partizanë, që mbartnin mbi shpinë nga 20-40 kg, material luftarak dhe ushqime, me banorë të fshatrave që tërhiqeshin nën mbrojtjen e Brigadës, forca të tjera të shtabit të Qarkut, ose të ardhura nga krahina të tjera, plus anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm dhe të drejtuesve të tjerë politik, plus oficerëve britanikë. Këta të misionit britanik i shihnin me sytë e tyre ballistët duke luftuar së bashku me gjermanët, siç edhe i kanë paraqitur mjaft prej tyre në raportet e kohës.

Pararoja e batalionit të parë të Brigadës arriti që, pa gdhirë data 12 janar, të afrohej në qafën e Beçit, ku dalloj e shpartalloj një grup ushtarësh gjermanë dhe ballistësh që kishin zënë pozicion pas ahishtave. Në mëngjesin e 12 janarit 1944 qafa e Beçit u kap dhe u hap rruga e daljes nga rrethimi i Brigadës. Ky ishte një sukses shumë i madh për Brigadën dhe forcat partizane të Korçës dhe të Beratit, shkruan autori Mihallaq Konda. Komandanti i Brigadës, Nexhip Vinçani në kujtimet e tij e vlerëson lart këtë veprim luftarak dhe i jep vlerësim maksimal ndërlidhjes me radio dhe asaj telefonike, nëpërmjet të cilave iu komunikua batalioneve

MIHALLAQ KONDA
Historian Ushtarak



HISTORIKU I BRIGADËS SË IV SULMUESE

LUFTA ANTIFASHISTE NACIONAL ÇLIRIMTARE

urdhri i tërheqjes, duke fituar kohën që ishte aq e çmuar. Në zonën e Korçës perëndimore dhe të Skraparit lindor e më tej ishte vendosur për herë të parë në Ushtrinë NÇ ndërlidhje telefonike mes fshatrave dhe reparteve partizane, madje edhe stacione radioje. Marshimi i Brigadës vijoi për 14 orë pa ndërprerje gjatë gjithë natës dhe u krye pa asnjë shkëputje.

Pikërisht për këtë situatë ka shkruar nënkoloneli britanik Wheeler (Whiler) në raportin e tij, të botuar pjesërisht nga Roderick Bailey në "Lufta e fshehtë në Shqipëri". Një histori e misioneve britanike 1940-1945 Tiranë, "Naimi" 2019, f 284. Lexuesi mund të verifikojë lehtësisht saktësinë e daljes nga rrethimi që përshkruan profesor Konda në librin e tij. Ai nuk kish si ta dinte se ç' kish shkruar nënkoloneli britanik në raportin e tij, pasi ky do të botohej në vitin 2008 në Britaninë e Madhe dhe në Shqipëri.

Nga qafa e Beçit Brigada doli në rajonin e Potomit, në Skraparin lindor, ku qëndroi disa ditë për t'u ç' lodhur e përtërirë. Edhe në këtë pjesë të librit, Mihallaq Konda ka përshkruar me vërtetësi dhe krenari qëndresën e partizanëve dhe sakrificat e tyre, vajza dhe djem, disa prej të cilëve mbijetuan edhe në kushte tepër të vështira, me këmbë të ngrira, sa mjeku partizan Petro Cani i preu gishtat njërit me sharrë të zakonshme druri dhe pa narkozë, kurse disa javë më pas i preu këmbën, po me sharrë, partizanit 16-vjeçar Pandi Kocaqit, rast për të cilin është shkruar dhe botuar edhe në gjuhë të huaj tregimi "E pabesueshmja".

Në librin e tij, Konda shkruan dhe paraqet realitetin me vërtetësi, pa zbulurime, shkruan si për vlerat e larta të partizanëve e të drejtuesve, por shkruan edhe për gabimet. Tregon se si kundër një kolone gjermane në tërheqje nuk u hap zjarr, vetëm pse ishte ngatërruar se kush do të hapte zjarr i pari, ndërkohë që mungoi iniciativa dhe gjermanët u tërhoqën pa luftë. Shkruan për një skuadër partizane prej 11 vetash të batalionit të Myzeqesë, të cilëve nuk iu dha urdhri i tërheqjes pasi kishin humbur lidhjen me kompaninë e tyre. Ata nuk u tërhoqën, por e dinin se nuk mund të tërhiqeshin pa urdhër, prandaj luftuan në mbrojtje të kolonës, deri sa 7 prej tyre u vranë. Brigada IV S shumë shpejt, duke filluar nga 17 janari kaloi nëpërmjet qafave si ajo e Martës etj., në terrenin e Korçës dhe kundërgoditi forcat gjermano-xhandaro-balliste në

fshatrat Stratoberdhë, Katund, Qafëzezë e Qytezë. Më 19 janar batalioni 4p arriti në Panarit, ku u vendosën edhe anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, shtabi i Brigadës e të tjera institucione lokale të Luftës NÇ.

Nga Panariti b4p sulmoi një përqendrim gjermanësh (700-800 veta) në Shtyllë, të cilët u tërhoqën për në Korçë. Më 20 janar b3p filloi sulmin mbi armiqtë nga Shtylla në Lekas e Tudas, ndërsa b4 sulmoi në Gurmujas, Shkozanj e Gjergjevicë. Armiqtë nuk e prisnin një kthim kaq të shpejtë të Brigadës, madje kishin propaganduar se partizanët ishin asgjësuar. Po kështu b3p, në bashkëveprim me batalionin Dumre-Verçë-Sulovë, spastruan Çemericeën dhe Marjanin. Me sulm kundër ballistëve u çliruan fshatrat në Lavdar e Karbanjoz, që i pritën partizanët krahëhapur. Prej aty sulmuan forcat armike në Mazrekë, në Protopapë në Shkozanj, Gjergjevicë

e në Xerje. Një kompani mori detyrë të dilte në Opar. Historiani i mirënjohur ushtarak, Mihallaq Konda e përshkruan terrenin e situatën luftarake siç ka ndodhur. Ai shkruan se me gjithë përparimin e forcave partizane, më 26 janar, kundërsulmoi një forcë e madhe ballistësh e xhandarësh të mbështetur nga artileria gjermane. Forcat partizane në krye të të cilave qëndronin e luftonin Haxhi Lleshi, Muharrem Butka, Petrit Hakani, Medar Shtylla etj., me luftime të ashpra çanë rrethimin dhe u tërhoqën përsëri në Backë e Panarit. Armiqtë u gëzuan para kohe. Batalioni 3p marshoi nga shkëmbi i Brozdovecit dhe kapi qafën e rëndësishme të Tudasit, ku një çetë balliste që ishte caktuar për ta mbrojtur, u tërhoq. Partizanët sulmuan armiqtë brenda në fshatin Tudas. Armiqtë ikën të shpartalluar, duke lënë të vrarë 8 ballistë dhe 15 robër. Tudasit u çlirua për herë të dytë brenda 5 ditëve. Partizanët e batalioneve të tjera marshuan (18-29 janar) dhe u rikthyen në Lavdar. Edhe forcat e b3p të Br. IV bashkë me batalionin “Tomori”, e kaluan qafën e Martës në kushte të vështira të motit dhe marshuan për Xerje, Shkozanj e Gjergjevicë.

Shtabi i Brigadës, më 30 janar, bëri në Tudas një analizë të luftimeve të zhvilluara. Më 31 janar u zhvilluan luftime kundër tyre përsëri në Mazrekë, Protopapë, Osojë e Krushovë (Gorë) (rreth 600 forca) dhe u vranë mbi 25 ballistë, u plagosën mbi 30 dhe dorëzuan 30 të tjerë. Në vijim batalionet e Brigadës, më 1 shkurt sulmuan dhe spastruan nga armiqtë gjithë zonën e Oparit, në krahun e majtë të lumit Devoll deri në kufi me Tomoricën.

Në libër paraqiten me hollësi veprimet luftarake, edhe në shkallë kompanie e ndonjëherë edhe skuadre, me sulmet e kundërsulmet e tyre për çlirimin e zonës malore të Korçës perëndimore. Lexuesi mund ta ndjeje situatën duke parë skicat e sakta që ka vënë autori në libër.

Veprimet luftarake të tyre janë nga më të larmishmet, shpirti sulmues i pamposhtur, iniciativa e pathyer për të sulmuar armiqtë, ndonëse në një mot shumë të ashpër.

Komanda e batalionit 1p dhe batalioni partizan “Hakmarrrja” organizuan pritë në rrugën Qesarakë-Shën Premte e Qesarakë-Kaltanj dhe shpartalluan një forcë armike. Ndërkohë b2p marshoi nëpër malin e Rrungajës (1945 m) me 1 m borë trashësi e furtunë dhe bashkë me batalionin “Hakmarrrja” asgjësuan në Lubonjë çetën balliste të File Backës dhe vetë Filen dhe i morën automatikun e partizanit të vogël, Todit, që e kishte vrarë Filja vetë, në korrik 1943.

Pasi arritën, komandanti dhe komisari i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së, (10 mars 1944) Spiro Moisiu dhe Enver Hoxha, urdhëruan që Brigada të linte një batalion në Vithkuq e një në Gjergjevicë dhe me forcat e tjera t'i shtrinte veprimet në drejtim të Malit të Thatë e në Devoll, ku do të bashkëpunonte me batalionin “Fuat Babani” etj. Luftimet e para këtu u bënë në Dardhë, Arrëz-Sinicë e Qytezë. Aty mbetën të vrarë 30 gjermanë dhe 2 ballistë, u zunë 6 gjermanë rob dhe u kapën 4 mitraloza të lehtë, një mitraloz i rëndë, 2 mortaja 81 mm, 70 pushkë dhe 33 kafshë të ngarkuara me predha mortaje, fishekë, ushqime dhe veshmbathje. Shtabi i Përgjithshëm në komunikatën që lëshoi e vlerësonte lart këtë fitore. Madje edhe Radio “Londra” e njoftoi atë.

Luftime të ashpra u zhvilluan më 22 dhe 23 mars kundër një kolone me 10 makina gjermane dhe një numri të madh ballistësh. Më 24

mars përsëri rreth 200 gjermanë nga Bilishti kundërsulmuan forcat e bat. I S, madje edhe me një avion që i mitralonte nga lart. Por edhe këto u detyruan të kthehen në Bilisht, pasi lanë disa të vrarë e të plagosur.

Më 27 mars, batalionet e Br. IV S (b1p dhe b3p) sulmuan forcat armike në Koshnicë e në Sul., më 28 mars luftuan kundër një kolone prej 200 gjermanësh e ballistësh. Në një aksion të datës 4 prill goditën dhe gjermano-ballistë në rrugën Shënkollas-Sul. Pas tërheqjes së armiqve forcat partizane u nisën për në Sinicë e Dardhë, ku qëndruan disa ditë për veprimtari politike e kulturore. Në radhët e batalioneve vërshuan rreth 200 vullnetarë, mes të cilëve edhe 20 vajza.

Ndërkohë dy batalionet e tjera të Br. IV s zhvilluan luftime në fshatrat e Rrëzës së Korçës, duke sulmuar e shkatërruar forcat balliste në Bulgarec e Qatrom, në Dërsnik, më 17 mars, në Melçan e Biranj kundër 300 forcave gjermane dhe 100 xhandarëve, që u tërhoqën në panik, duke lënë 29 të vrarë mes tyre një major. Pas kësaj dite të turpshme për ta, komandanti i xhandarmërisë së Korçës i telegrafonte Tiranës: “Fuqi të shumta partizane, të armatosura mirë, gjenden rreth e qark Korçës në një largësi 2km jashtë qytetit. Sot në mëngjes fuqi ushtarak gjermane dhe xhandarë u përpoqën me fuqitë partizane, por për shkak të numrit të madh të kundërshtarëve u tërhoqën. Partizanët sot sulmojnë Korçën. Dërgoni fuqi”. Komanda gjermane me këtë rast shpalli shtetërthemim në qytet.

Një aksion tjetër i suksesshëm u zhvillua ato ditë në Boboshticë. Po ashtu më 3 prill u thye një sulm tjetër i 300 gjermanëve dhe ballistëve në teqenë e Velçanit e në Porodinë.

Në mbyllje të veprimtarisë së Brigadës IV S, gjatë operacionit të Dimrit nga 17 janari deri më 4 prill 1944, për 79 ditë ajo vijoi pa ndërprerje kundërgoditjen për asgjësimin, shpartallimin e spastrimin nga armiqtë të krahinave të qarkut të Korçës. Statistika e fitoreve të Brigadës që historiani i shquar Mihallaq Konda ka dhënë, shënon se Brigada gjatë këtyre ditëve zhvilloi 50 veprime të rëndësishme luftarake në të cilat ranë 42 dhe u plagosën 45 partizanë. Armiku pati 308 gjermanë të vrarë, 238 të plagosur dhe 12 robër, kurse xhandarët dhe ballistët patën 242 të vrarë, 244 të plagosur dhe 393 robër. Armikut iu zunë 300 armë e mjaft municion. U shtuan armët e rënda dhe u rrit fuqia e zjarrit të Brigadës.

Brigada IV S vazhdoi më tej në mësymjen pranverore të Ushtrisë NÇ, kaloi në Veri dhe në përbërje të Divizionit të I S zhvilloi luftime të ashpra në qarkun e Dibrës, në çlirimin e Mirditës dhe mori pjesë në Betejën e madhe për çlirimin e Tiranës e në Betejën e Mushqetasë etj.

Përfundimi: Çfarë e bënte të mundur këtë bilanc? Patjetër forca e Brigadës, kompaktësia e saj, disiplina shembullore e partizanëve, taktika e suksesshme e luftës partizane dhe fakti i mbështetjes së gjithanshme e popullit, që e shihte dhe vlerësonte si luftën e tij, Luftën Nacionalçlirimtare.

Që Brigadës IV S nuk iu dha titulli “Hero i Popullit”, kjo nuk ka tjetër shpjegim përveç shpalljes “armi” të komandantit e të komisarit të saj, Nexhip Vinçanit dhe Pëllumb Dishnicës. Por këto ditë, më 28 dhjetor, do të festohet 80-vjetori i krijimit të saj dhe viti ku kemi hyrë është viti i 80-vjetorit të çlirimit të Atdheut. Është një rast për ta çmuar këtë Brigadë të lavdishme me një Dekoratë.



Udhëtim nëpër Shqipëri

Nga Korça, kur mora rrugën për në Tepelenë, mora me vete kureshtjen dhe interesimin së bashku me vetëdijen se po shkoja në një qytet me vlera historike, krahina me burra trima dhe patriotë të pashoq.

Për të shkuar nga Tepelena në Korçë, në atë kohë, ishte e detyruar të shkoje në Gjirokastrë një ditë më parë, të pajisesh me biletë udhëtimi me autobus, për ditën e nesërme dhe një natë të flije në qytetin e Gjirokastrës. Një herë në javë, ditëve të enjte, një autobus i prodhimit çek, me 52 pasagjerë, nisej herët në mëngjes nga Gjirokastra, rrugëtonte gjithë ditën nëpër rrugën e pa shtruar e me gropa, kalonte në Këlcyrë, Përmet, Leskovik, Ersekë dhe në mbrëmje soste në Korçë. Pasagjerët ishin të detyruar të qëndronin gjithë ditën në karriget përkatëse, ku lodheshin e vuanin pisërinë e zezë. Ndërsa sot, komoditeti infrastrukturor ka bërë që këto distanca “të largëta” t’i bëjë të afërta dhe të aksesueshme për cilindo që kërkon të shijojë bukuritë shqiptare.

Tepelena ka një pamje që të tërheq dhe të imponohet. Begatinë këtij vendi ia shton uji dhe pastërtia.

Fshati Dukaj ishte destinacioni i radhës. Sa shumë histori deri në mitizim kishte ky vend. Mikpritësi ynë na jep detaje të përziera me dashuri vendlindjeje nga ato që dhembën, sidomos kur je larg dhe aty rikthehesh prej mallit të të parëve.

Shqipëria, sa vende mahnitëse dhe çfarë lidhje shpirtërore janë krijuar me këto vende, të cilat ta kthejnë gjithmonë kokën pas. Te ai gjelbërim, tek ato histori deri tek gjeneza pellazge.

Tepelena dhe kënga, pasuria e saj folklorike. Pas kaq hulumtimesh, jam bindur se Vendlindja juaj, miq tepelanas, është një kryeqendër folklorike, një thesar i çmuar i artit popullor dhe ndoshta një nga margaritarët më të rrallë në thesarin e kulturës sonë kombëtare në fushën e trashëgimisë popullore. Mbetet një çudi më vete dhe për t’u studiuar seriozisht, se cilat janë arsytet që njerëzit e kësaj

ane kanë krijuar kaq shumë perla folklorike, duke shkruar me to historinë e jetës, të luftërave dhe ngjarjeve të këtij vendi.

Këngë kushtuar atyre mijëra djemve e vajzave që ranë në lulen e rinisë, për të bërë Shqipërinë e re.

Tepelenën ndryshe do e pagëzoja “Qyteti i një mbi një kalave”. Dhe veç duke parë këto fortifike kupton dhe rëndësinë e saj historike.

Kalaja e Tepelenës, e shpallur Monument Kulture i kategorisë së parë në vitin 1963 ndodhet në veri të qytetit të Tepelenës. Sipas burimeve historike, kalaja ishte projektuar nga vetë Ali Pashë Tepelena, i cili kishte mbikëqyrur fazat e para të ndërtimit të këtij simboli heroik të rajonit. Kalaja ekzistuese u rindërtua prej tij në vitin 1819 me një sipërfaqe prej 5,5 ha, me tre hyrje dhe tre kulla. Deri në vitin 1820 është përdorur si rezidenca e dytë e Ali Pashë Tepelenës. Muret e kështjellës janë ngjitur në formën natyrale të tokës dhe nuk përbëhen nga një formë e rregullt gjeometrike. Në kthesat kryesore të mureve janë vendosur tre kulla poligonale, për t’i kontrolluar më mirë ato. Kalaja ka tre porta, njëra prej të cilave (lindore) mban mbishkrimin “Porta e Vezirit”.

Kalaja e Qytezës

Kalaja e qytezës ndodhet në kodrën afër fshatit Dukaj, 300m mbi nivelin e detit. Kalaja ka formën e një katërkëndëshi të rregullt që



mbulon një sipërfaqe 0.5 ha. Ky qytet i vogël i përket periudhës IV-III, p.e.s. Në pjesën më të madhe të saj është e mbrojtur shumë mirë nga natyra dhe gjithashtu është e fortifikuar mjaft mirë nga mure të fuqishëm në pjesët e hapura natyrore. Kalaja ka qenë e pajisur me tri kulla, muret e të cilave janë mbështetur në shkëmbin e gdhendur me qëllimin për të shmangur rrëshqitjet.

Kalaja e Leklit



Kalaja e Leklit është një tjetër monument kulture i kategorisë së parë i mbrojtur nga shteti. I përket shekullit IV para Krishtit. Kalaja e Leklit qëndron në kodrën e quajtur Shën Mëhill në pjesën perëndimore të malit Golik. Kodra shkëmbore ku ndodhet kalaja është zgjedhur për pozicionin e saj strategjik për të kontrolluar të gjitha shtigjet dhe rrugët që lidhin Ilirinë me Epirin, të cilat në antikitet njihen si Ngushticat e Antigonesë. Këto përmenden në luftërat e fundit të shekullit III – V p.e.s. Nga Kalaja e Leklit ishte e lehtë të kontrollohej hyrja veriore në Luginën e Drinosit të

të gjithë trupave të luftës. Kalaja e Leklit ka tërhequr vëmendjen e arkeologëve të ndryshëm si Hamondi dhe Ugolini të cilët e vizituan atë në shekullin e 20-të. Edhe arkeologët shqiptarë kanë nisur gërmimet pranë kalasë së Leklit në vitin 1948, dhe kjo vazhdoi derisa zbuluan qytetin e Antigonesë nga Dhimosten Budina në kodrën e Jermes, Saraqinisht. Antigonea ishte një zonë arkeologjike e kompletuar dhe e fuqishme dhe që nga ai moment Kalaja e Leklit mbeti pas dhe nuk janë bërë më punë gërmimi. Megjithatë nuk ka një pamje të qartë të formës së Kalasë së Leklit.

Kalaja Matohasanaj

Kalaja antike e Matohasanajt ndodhet në majën e një kurrizi shkëmbor, i cili ngrihet në qendër të luginës së Sinanajt, midis shtratit të lumit Vjosa dhe malit të Gribës. Kalaja i përket shek. V p.e.s dhe ka gjurmë të vazhdimet të jetës thuajse në çdo periudhë në vijim. Muret e kalasë rrethojnë një sipërfaqe rreth 3 ha, sipërfaqe e përbërë nga radhë tarracash të përshtatshme për banim. Muret rrethuese u përkasin tri periudhave të ndryshme ndërtimi, dy periudhat e para përfaqësojnë periudhën e Antikitetit në këtë qytet, ndërsa periudha e tretë e ndërtimit përfaqëson Antikitetin e vonë.

Kalaja e Nivicës

Rrënojat e kalasë së Nivicës ndodhen majë një shkëmbi të thepisur, rrethuar nga humnera, me thellësi 200-400 metra. Nga tre anë ka një mbrojtje natyrore, ndërsa vetëm nga Perëndimi është e mbrojtur nga një mur guri me llaç gëlqereje me gjerësi mbi një metër. Deri vonë është ruajtur një portë e brendshme me qemer, ndërtuar me gurë të latuar me gjatësi 0,5-1 metra, të nxjerra nga shkëmbinjtë e zonës. Në krahun lindor dallohet një udhë pothuajse shkallore që zbret në drejtim të lumit nëpërmjet një porte të çarë në shkëmb. Këto shkallare lidhin kalanë me lumin si dhe me dy mullinj që funksiononin nëpërmjet një vije uji që rridhte nga një e çarë në shkëmb. Me sa duket, ky ishte edhe shtegu i furnizimit të kalasë në raste rrethimesh. Kalaja është ndërtuar mbi një shkëmb

të pamundur t'i afrohesh, në një kryqëzim strategjik rrugësh. Këtu kalon rruga e Vermikut, ajo e Salarisë, e Kuçit dhe e Bënçës. Sipas francezit Pouqueville, këtu ka banuar fisi ilir i Amantëve, të cilët kanë qenë të parët që kanë ndërtuar kalanë në shek. IV para Krishtit. Pas kësaj mendohet se Nivica është shndërruar në qendrën e dytë të banuar për fisin e Amantëve. Të dhënat arkeologjike tregojnë se qyteti arriti kulmin e lulëzimit në shekujt III-I para Krishtit, ndërsa kronistët osmanë të periudhës së luftërave shqiptaro-turke bëjnë fjalë për një qytet me 500-600 shtëpi. Kalaja u rindërtua në periudhën e sundimit bizantin me urdhër të perandorit





Justinian, i cili i kushtoi një rëndësi të veçantë fortifikimeve ushtarake në Arbëri. Në periudhën e dyndjeve sllave dhe më pas gjatë pushtimit osman, kalaja e Nivicës ka qenë një teatër i rëndësishëm i luftimeve, duke qenë e zaptuar herë prej vendasve dhe herë prej të huajve.

Kalaja e Zharrës

Kjo kala ngrihet në majën e kodrës shkëmbore me të njëjtin emër dhe me lartësi 310 m. Kodra ndodhet në perëndim të qytetit të Tepelenës në anën e majtë të luginës së Vjosës dhe duke u zgjatur nga jugu në veri merr formën e hundës. Nga ky pozicion mund të kontrollohen rrugët që kalojnë në këtë anë të luginës së Vjosës. I pari që e ka vizituar kalanë e Zharrës ka qenë Pouqueville, sipas të cilit kjo kala është vepër e latinëve, më pas është vizituar dhe përmendur nga H. Holland. Nga arkeologët shqiptarë ka qenë H. Ceka i pari që e ka vizituar, ka përshkruar gjendjen e rrënojave dhe është shprehur për kohën e ndërtimit të saj. Më pas në vitin 1963 është bërë një ekspeditë informative, me qëllim njohjen e gjendjes së monumentit. Gërmimet e para në këtë kala janë bërë në vitin 1970. Këto gërmime janë drejtuar nga D. Komata. Kjo kala i përket periudhës së Antikitetit të Vonë (shek. IV–VI e. sonë) dhe mendohet se mund të jetë një nga fortifikimet e Justinianit I për funksionim ushtarak. Muri ndjek format e relievit të kalasë mbi të cilën është ngritur, duke marrë formën e një elipsi të zgjatur me perimetër 410 m dhe rrethon një sipërfaqe prej 0.8 ha. Ai ndiqet në gjithë gjatësinë e tij edhe pse në disa pjesë është dëmtuar dhe rrëzuar plotësisht. Lartësia më e madhe e tij është 2.8 - 2.9 m. Trashësia e murit varion nga 1.6 m në 1.8 m. Për ndërtimin e tij janë përdorur gurë gëlqerorë mesatarë, të cilët janë të punuar ose të pa punuar dhe me forma

dhe përmasa të ndryshme.

Ura mesjetare e Beçishtit – Ali Pashë Tepelenës

Kjo urë antike-mesjetare ndodhet poshtë kalasë së Tepelenës mbi lumin Vjosë. Njihet ndryshe si Ura e Beçishtit. Kjo urë ka gjurmë të periudhës romake, gjysmës së parë të shek. të 1-rë, para Krishtit. Gjatë kohës mesjetare ajo u rindërtua mbi bazat e urës romake. Më pas u restaurua nga Ali Pashë Tepelena, në shek. XVII pas Krishtit. Ura është 260 m e gjatë. Ura e Beçishtit, e ndërtuar në kohën e Ali Pashës lidh Tepelenën me 7 fshatra. Mendohet se fshati Beçisht është dhe vendi ku ka lindur Ali Pasha. Edhe sot në fshat ndodhen rrënojat e shtëpisë së tij.

Uji i Ftohtë i Tepelenës

E si mund të largoheshim prej këtyre kalave me histori trimash pa vizituar një prej atraksioneve më të bukura, bekuar nga zoti, Uji i Ftohtë. Miku ynë, bir i kësaj krahine, na sugjeroi: “Pini pak ujë nga këto burime dhe trupi juaj do t’ju jetë falënderues”, dhe kishte të drejtë. Gjithçka ishte si e pikturuar, tablo reale e resurseve shqiptare.

Uji i Ftohtë, kjo zonë turistike 8 km në jug qytetit të Tepelenës, ka marrë emrin “Uji i Ftohtë” sepse zona është e mbizotëruar nga burime natyrore-shkëmbore, ku uji rrjedh gjithmonë i ftohtë





Kanionet e Nivicës

Kanionet e Nivicës ndodhen në afërsi të fshatit Nivicë të rrethit të Tepelenës. Kanë gjatësi deri në disa km, gjerësi mesatare rreth 15 m, ndërsa thellësia arrin deri në disa dhjetëra metra. Janë formuar nga erozioni i përroit të Nivicës, pjesë e atij të Bënçës, në shkëmbinjtë gëlqerorë.

Shpatet e kanionit janë

dhe i pastër. Burimi ekziston prej më shumë se 250 vjetësh dhe është gërmuar në shkëmbinjtë e maleve të Tepelenës, qytet i qetë në jug të Shqipërisë dhe atdheu i Ali Pashës, personazh historik që ka jetuar midis viteve 1700 dhe viteve 1800, të cilit i njihet edhe zbulimi i burimit. Falë pasurisë nëntokësore të kësaj zone, në Ujin e Ftohtë marrin jetë dhjetëra burime të kristalta, të cilët “ushqejnë” rrjedhën e lumit Vjosë. Shpati ku del burimi është i veshur me bimësi natyrore të dushkut dhe shkurreve. Parku natyror i Ujit të Ftohtë përbëhet nga një bimësi mjaft e pasur e llojeve të ndryshme. Krahas shkurreve, në të mbizotëron edhe druri i rrapit apo edhe shelgu. Në afërsi të luginës, drurët e rrapeve janë mjaft të rritur. Ndërkohë përgjatë sipërfaqes së parkut natyror hasen edhe gjallesa dhe kafshë të ndryshme tipike për këtë zonë. Uji i Ftohtë në Tepelenë ka vlera shkencore (hidrologjike, gjeomorfologjive), estetike e turistike.

Ujëvara e Peshturës

Ujëvara e Peshturës ndodhet në Progonat të Tepelenës e për të shkuar atje duhet të kalohet përmes malësive të Tepelenës. Zona përbëhet nga shkëmbinj gëlqerorë të cilët në shekuj janë përshkuar nga përrenj të vrullshëm dhe lozonjarë. Forma të shumta karstike, gropa të thella, shpella të shumta dhe ujëvara është peizazhi që ofron rruga për të shkuar drejt Ujëvarës së Peshturës.

vertikalë, kanë guva e shpella karstike shumë të vështira për t'u eksploruar. Kalimi përgjatë fundit të kanionit është i vështirë, pasi ka edhe pragje me lartësi deri disa metra. Pamja e tyre madhështore, gjelbërimi në të dy anët e tyre, i bëjnë ata tërheqës. Kanë vlerë shkencore (gjeomorfologjike, gjeologjike), didaktike e turistike. Vizitohen sipas rrugës automobilistike Tepelenë – Progonat – Nivicë.

Vjosa

Lumi i Vjosës është lumi më i madh i Shqipërisë Jugore dhe një ndër lumenjtë më të mëdhenj të Shqipërisë, sidomos për sa i përket prurjeve të shumta ujore. Gjatësia e këtij lumi është 272 km, sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës 6706 km², prej të cilit, 4365 km² janë brenda territorit tonë, ndërsa pjesa tjetër në territorin grek. Degët kryesore të Vjosës janë: Sarandoporo, Drinos dhe Shushica. Në Vjosë ose në degët e saj përfundojnë edhe shumë burime karstike si ato të grykës së Këlcyrës, të Libohovës, të Viroit, të Gjirokastrës, të Ujit të Ftohtë të Tepelenës, të Poçemit etj. Vjosa buron nga malet e Pindit (Greqi) ku rrjedh nëpër një luginë të thellë, e cila zgjerohet pasi hyn në territorin tonë. Kjo është një pjesë e Shqipërisë sonë, e cila të befason me gjithçkanë e saj. Vlerat e saj historike dhe kulturore janë të pakrahasueshme me askënd tjetër sepse janë unike dhe krenari kombëtare.





Shqiptarët në sytë e të huajve

“Historia e Vërtetë e njerëzimit do të jetë e shkruar, vetëm kur ajo do të shkruhet me pjesëmarrjen e shqiptarëve”

Për Shqipërinë dhe shqiptarët është shkruar edhe atëherë kur vendi dhe kombi ynë ende nuk njihet me këtë emër. Këta kanë qenë misionarë, diplomatë, historianë, udhëtarë etj., nga rajone të ndryshme të botës. Kanë mbajtur shënime ndërsa kanë kaluar në trojet tona. Të tjerë na kanë njohur nëpërmjet letërkëmbimeve apo dorëshkrimeve. Por, të gjitha këto, të shkruara në gjuhë të ndryshme të botës, në kohë dhe persona po të ndryshëm, për herë të parë na vijnë në gjuhën shqipe. Mendime kanë përcjellë shumë udhëtarë të huaj si: anglezë, irlandezë, gjermanë, austriakë, italianë, francezë, rumunë tej. Kronistë turq dhe turistë amerikanë, përshkruajnë me emocione bukurinë e veçantë të natyrës, dhe pasurinë shpirtërore të kombit tonë. Midis tyre gjen personalitete të shquar si: Koloneli Lik, Pokevili i famshëm, Aubrey Herbert, Lorenzoni e deri tek Perez De Kuelar. Poetë dhe artistë të mëdhenj si: Bajroni, Eduard Liri, Edit Durhami etj. Vizitorë të shumtë, të cilët kanë vizituar trojet tona si: studiues, arkitektë, arkeologë, shkencëtarë, biologë, e deri dhe turistë ..., George Gordon Byron (Xhorxh Gordon Bajron) shkrimtar anglez i romantizmit dhe dashamirës i shqiptarëve. “Shqiptarët me kostumet e tyre bëjnë peizazhin më të mrekullueshëm në botë... Shqiptarët janë raca njerëzore më e bukur që ekziston, trima më të fortë se kështjellat e tyre...”, Bajroni.

Vizita në Shqipëri i la mbresa të thella Bajronit. Te shqiptarët ai pa një shpirt të veçantë, i cili ndezi imagjinatën e tij poetike për tema ekzotike. Në shënimet e mbajtura, kur ishte në Shqipëri, për poemën Shtegtimi i Çajlid Haroldit, ai shkruante për shqiptarët:

“Më tërheqin shumë me atë ngjashmërinë e tyre me Hajlanderët e Skocisë, në veshje, në pamje dhe në mënyrën e jetesës”. Si kujtim ai mori një kostum tradicional shqiptar, me të cilin piktori Tomas Filips i ka bërë një portret. Ky kostum ka një histori më të gjatë. Ai aktualisht është i ekspozuar në Bowood Estates, Angli. Në përshkrimin e udhëtimeve të tij Bajroni thotë: “Në udhëtimet e mia kam mësuar të mendoj si filozof, dhe po të mos bëja ashtu, udhëtimi s’do të kish dobi”.

Bajroni i ka kushtuar 360 vargje Shqipërisë. Nëpërmjet këtyre vargjeve del në pah njohja e Bajronit me historinë e Shqipërisë. Bajroni, ky ‘hero’ romantik, viziton Shqipërinë e Jugut dhe qëndroi si mik në sarajet e Ali Pashës, duke iu rezervuar një pritje me ndere të mëdha. Nëpërmjet vargjeve ai përcjell: Emocionet për bukuritë e veçanta të natyrës sa magjepsë, madhështore dhe e ashpër; Ali Pashën e vlerëson nga karakteri burrëror, dhe simbol i bujarisë së shqiptareve, quan kryelartë e me një autoritet sovran; Shqiptaret i quante: “...njerëz të fortë, të ashpër, të pathyeshëm, sepse nëse ata nisen në luftë, sigurisht që kthehen me fitore...”; Vlerësonte anën historike, madje himnizoi historinë shqiptare, sidomos Skënderbeun dhe kordhën e tij legjendare....

I pëlqeu pozicioni Gjeografik i Shqipërisë, sa arriti të himnizonte natyrën shqiptare (agimet dhe perëndimet e diellit, ditët me diell). U dashurua me kulturën shqiptare, sidomos duke vlerësuar veshjet, zakonet, mitet etje., dhe sidomos këngët polifonike. U përfshi dhe emocionalisht sa dhe u motivua me Moralën dhe virtutet në një këndvështrim mjaft realist, më shumë vlerësonte vetitë e shqiptarit të thjeshtë, i cili ecte kryelartë në truallin stërgjyshor, duke spikatur

mikpritja, bujaria, besa etj.

Edit Durham: “Paragjykimi mund të vijë nga padija apo mos njohja, në këto raste e vetmja rrugë për ta hequr atë, realizohet vetë nga njohja konkretisht e realitetit”.

Edit Durham (Mary Edith Durham), udhëtare, artiste, shkrimtare dhe antropologe e dëgjuar britanike, e cila përshkroi jetën në trojet shqiptare.

Edit Durham, zonja britanike që u bë e famshme me shkrimet e saj për Shqipërinë dhe shqiptarët në fund të shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit XX. Mes shqiptarëve ajo gjeti pamjen e jetesës që ishte e mbushur me ndjenja kombëtare dhe atë të lirisë. Ajo gjeti pritjen karakteristike të miqve shqiptarë, si dhe një shpirt ku ajo ndjente luftën e tyre për njohje ndërkombëtare. Ajo këto karakteristika i përcolli në çdo rast të komunikimit me të gjithë perëndimorët (anglezë e të tjerë), të cilët dinin shumë pak për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Pas botimit të librit të dytë “Refreni i Ballkanit” 1905, Edit Durham e vendosi shumë shpejt veten si autoritet i çështjeve shqiptare. Ajo pati sukses në udhëtimet e saj edhe pse u ndesh me terrere mjaft të ashpra, pengesa të qëllimshme të autoriteteve otomane, nuk u tremb nga përballja e mundshme e ndonjë pengmarrjeje nga ana kusarëve. Pavarësisht këtyre, ajo krijoi një reputacion te njerëzit në vendet ku ajo shkeli. Me mendjen dhe sytë e saj si turiste dhe artiste, arriti të evidentonte disa opinione dhe t’iu bënte atyre komente mjaft entuziaste si: “Këtu është ngjyra, jeta dhe arti”.

Gjatë udhëtimit të parë për një kohë relativisht të gjatë në Shqipëri nga Jugu në Veri në vitin 1904, asaj i bëri përshtypje fakti që të gjitha shtresat e popullsisë nga do ku shkeli kërkonin pavarësinë e atdheut dhe njohjen angleze. Durhami nga kjo zbuloi një zë legjitim plot pasion sa dhe real, një e drejtë kjo që sipas saj s’mund t’ua mohonte askush... shqiptarëve!

Gjatë vitit 1908, atë e tërhoqën viset e Malësisë së Veriut të Shqipërisë. Në këtë kohë ajo e kishte transformuar veten në një etnografe dhe shprehte vendosmërinë në bërjen e studimeve serioze të fiseve shqiptare në trevat e Malësisë, dhe këtë e bëri realitet duke shkruar librin: “Shqipëria e Epërme” (1909). Ajo udhëtoi duke kaluar nga një fshat në tjetrin, e cila mori nderim madhështor. Për çdo fshat ajo evidentoi historitë dhe fotografoi nga afër çdo aspekt të jetës në fshatrat malore dhe arriti të grumbullonte një arkiv të pasur të traditave dhe zakoneve folklorike shqiptare. Gazetari britanik, Henri Nevinson, që e shoqëroi Durhamin, kur ajo administronte ndihmat për malësorët shqiptarë, gjatë luftërave ballkanike të 1911-1913, duke përshkruar cilësitë që e shndërruan atë në legjendë, thekson: “Qysh kur vuri këmbën në Shqipëri, ajo u bë shqiptare me zemër dhe shpirt”.

Më 1918 ajo u bë sekretarja e shoqatës Angli-Shqipëri e themeluar nga Aubrey Herbert në Londër dhe me anën e kësaj organizate kërkoheshin të drejtat e shqiptarëve. Përpjekjet e saj më pas konsistonin që Shqipëria të njëhej nga Lidhja e Kombeve më 1920. Ajo vazhdoi aktivitetin e saj edhe gjatë viteve 30-të, duke bërë shumë miq nga radhët e shqiptarëve, të cilët kishin mërguar në Londër. Ditën e 7 prillit të vitit 1939, kur ushtria fashiste italiane sulmoi dhe pushtoi Shqipërinë, 76-vjeçarja doli në një rrugë të Londrës duke mbajtur në duar një pankarte ku shkruhej: “Larg duart nga Shqipëria!”.

Veprimtaria e Edith Durham për popullin shqiptar ka qenë madhështore dhe duhet të hulumtohet më tepër. Durhami dëshmon se fillimi i misionit të saj në mbështetje të çështjes së shqiptarëve qe kaq i mbarë falë ungjillorëve, sepse nuk dihet se

si Durhami do të mund të udhëtonte ndryshe, aq gjatë e gjerë në gjithë territorin shqiptar, sikur të mos i ofrohej një dorë nga shqiptarët e ndershëm.

Shqiptarët e nderojnë akoma edhe sot Editin dhe kanë respekt për të. Ajo sipas shqiptarëve është “Mbretëresha e Malësorëve”. Ajo u mirëprit nga malësorët shqiptarë dhe gjatë kalimit të saj në këto vise nuk pati asnjë keqtrajtim edhe pse ishte një femër e vetme. Përshtypje të mbetura nga Shqipëria ishte tradita e “Burrneshave Shqiptare”, që ishte një zakon ku femrat visheshin si burra dhe kishin një pozitë të qartë në shoqëri. Mbas vdekjes së saj në 1944, Mbreti Zog i Shqipërisë i dha merita të larta asaj. Mbreti Zog ka shkruar për të: “Ajo na fali neve zemrën e saj dhe fitoi si këmbim vëmendjen e malësorëve tanë”. Ajo vazhdon të nderohet si “Heroinë Kombëtare” dhe në 2004 në një deklaratë, presidentit shqiptar, Alfred Moisiu e cilësoi atë si një nga figurat më të spikatura të Shqipërisë të shekullit të kaluar.

Kushdo që e njohu nga afër popullin shqiptar shprehu për të gjithë afeksinin që ky vend delegon tek vizitorët e tij.

Nikolla Jorga: “Populli shqiptar së bashku me baskët, janë më të vjetërit në Evropë”.

Maximilian Lambertz: “Historia e Vërtetë e njerëzimit do të jetë e shkruar, vetëm kur ajo do të shkruhet me pjesëmarrjen e shqiptarëve”.

Lamartini: “Ky komb e ky popull nuk merret nëpër këmbë... Kjo është toka e heronjve të të gjithë kohërave...Homeri aty gjeti Akilin, grekët Aleksandrin e Madh, turqit Skënderbeun, njerëz këta të së njëjtës racë, të të njëjtit gjak”.

M. Huacunthe Hecquard: “Në asnjë vend të botës femrat nuk janë më të respektuara dhe nuk ushtrojnë një veprimtari më të fuqishme se shqiptaret dhe disa nëna shqiptare kanë përzënë prej shtëpisë bijtë e vet pasi ata ishin larguar nga fronti i luftës. Ato i kishin kthyer në fushën e betejës”.

Lord Bajroni: “Shqiptarët me kostumet e tyre bëjnë peizazhin më





të mrekullueshëm në botë... Shqiptarët janë raca njerëzore më e bukur që ekziston, trima më të fortë se kështjellat e tyre”.

Henry Noel Brailsford: “...Shqiptari ‘primitiv’, në fakt është ‘Mbinjeriu’ për të cilin Nietzsche ëndërronte”.

Giuseppe Katapangu: “Atlantida, e cila është zhdukur para 12.000 vjetësh, ishte tokë e Ilirëve (pellazgëve), të cilët shpëtuan nga përmbytja e Atlantidës dhe filluan civilizimet e reja në të gjitha kontinentet, sidomos në Evropë, Afrikë dhe Azi të vogël!”

Agostino Ribeco: “Të drejtat mijëvjeçare të shqiptarëve, etnografike dhe gjeografike, shtrihen prej kohërave të vjetra në Iliri, Maqedoni dhe Thesali”.

Braisllav Nusic: “Shqiptarët janë autoktonë, të cilët gjatë të gjitha dyndjeve të popujve, e ruajtën tipin dhe karakterin e vet në mënyrë të theksuar. Ata u bënë ballë sulmeve të romakëve, mësymjeve të dendura të sllavëve, të cilët ua pushtuan të gjitha fushat, ultësirat, dhe lumenjtë”.

Dushko H. Konstantinov: “Shqiptarët janë banorët më të vjetër të Gadishullit Ballkanik dhe pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve të vjetër, të cilët kishin ndërtuar shtetin më të fuqishëm në Ballkan”.

Edvin Jasques: “Ilirët ose shqiptarët, këta bijë të paepur, ishin luftëtarë të shqipes, trashëgimtarë të denjë të Akilit, Filipit, Aleksandrit të Madh dhe Piros së Epirit...”.

Edvin Pears: “Shqiptarët janë pasardhës të racës më të vjetër të Gadishullit Ballkanik, gjegjësisht të racës ariane, duke e nxjerrë këtë fjalë nga dy rrënjët e fjalëve shqipe: Ar dhe Anë, që d.m.th., ‘njerëz të arit të pastër’”.

Maks Myle: “Emrat e mjaft popujve të njohur rrjedhin nga fjala e vjetër shqipe ‘Ar’. Kjo vlen edhe për mjaft vende të botës.”

Fanulla Papazogllu: “Dardania është njëra nga krahinat antike të Ballkanit ku popullata autoktone është ruajtur më së miri”.

Gos Xhen: “Origjina e Shqiptarëve arrin deri te koha e pellazgëve dhe kanë origjinë para-helene”.

Gustav Majer: “Shqiptarët janë Ilir të rinj”.

Gjorgj Hahni: “Shqiptarët janë pasardhës të Ilirëve, ndërsa ilirët janë pasardhës të pellazgëve...Shqiptarët janë stërnipërit e Pellazgëve”.

Haki Pasha: “Po doli në shesh historia e shqiptarëve, Perandorinë Osmane e merr lumi”.

Harold Whitehal: “Hieroglifet egjiptiane, të krijuara para 4.000 vjetësh kanë domethënie shqipe”.

Henri Braisford: “Në Maqedoni, vetëm shqiptarët janë popull autokton”

Johan Fon Han: “Shqipja rrjedh nga ilirishtja dhe ilirishtja nga pellazgjishtja”.

Jovan Cvijiq: “Sllavët e jugut, pas ardhjes në Ballkan, aty gjetën shqiptarët, të cilët nën trysninë e tyre (sllavëve) u tërhoqën drejt jugut dhe në vendet më malore, ku i hasim edhe sot”.

Konstandin Paparigopulos: “Vetëm shqiptarët konsiderohen si pasardhës të racës ilire”.

Mikpritja, besa, mbajtja e fjalës së dhënë, janë disa nga vlerat më pozitive dhe tiparet më dalluese, me të cilat i karakterizojnë të huajt, shqiptarët.

Historia e popullit shqiptar, e fokusuar që nga kohët më të lashta e deri në ditët e sotme, vazhdimisht ka ngjallur dhe vazhdon të ngjallë ende interesin e shumë studiueseve, historianëve, publicistëve dhe albanologëve të huaj, të cilët herë pas here kanë botuar libra voluminoze me studime me mjaft vlera, duke pasqyruar me vërtetësi të kaluarën e Kombit shqiptar dhe rolin që ai ka luajtur në zhvillimet Ballkanike dhe Evropiane, si në planin politik ashtu dhe atë historik.

Patriotizmi, i cili është ndër ndjenjat më të theksuara e më të ngulitura te karakteri i shqiptarëve. Këtë e kanë vënë re jo vetëm studiuesit e lartpërmendur, por të gjithë studiuesit. Interesant është fakti se shqiptarët i ka bashkuar identiteti kombëtar shumë më herët se mjaft kombe evropiane. Shqiptarët në mbrojtje të atdheut, patriotizmin e tyre e përforcojnë dhe me respektimin e lidhjeve vëllazërore, që i bën një e të pa ndarë dhe si rrjedhojë ata shfaqin realisht atë që janë: besnikërinë, respektimin e fjalës së dhënë dhe mbrojtjen e të vërtetës dhe të drejtës deri dhe me sakrificë supreme. Këto vlera morale manifestohen dhe me njerëzit e tjerë që i bashkohen kauzave madhore, të personalitetit, karakterit dhe çështjeve atdhetare.

Levenderia, “kursimi i armikut të mundur”. Në kohët e lashta e tillë është quajtur kjo ndjenjë, Levenderi. Ajo tregon më së miri ndjenjën e krenarisë, fisnikërisë dhe burrërisë të shqiptarëve. Duke pasur parasysh këtë element, çdokush mund të konstatojë se shqiptarët nuk janë barbarë, ashtu siç janë përpjekur disa pseudo historianë t’i paraqesin.

“Gruaja është e paprekshme”. Ky është një parim i lashtë i shqiptarëve dhe vazhdon edhe në ditët e sotme, ndonëse jo si më parë. Në Shqipëri femra është e respektuar. Këtë e dëshmojnë fakte si mbretërimi i mbretëreshës Teuta më fronin ilir apo dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit, i cili është cilësuar barbar, porse femrën e cilëson të paprekshme.

Kjo është Shqipëria jonë, ky vend i vogël me histori të rrallë.

80 vjet nga nata e 'Shën Bartolomeut' shqiptar

4 shkurti në historinë e përbotshme, ishte simbol terrori dhe masakre, por dhe simbol i një lufte të shenjtë që rritej dhe nuk shuhej. 4 shkurti nxori në shesh para popullit figurat e vërteta të çakejve të reaksionit, zbuloi gjurmët e tyre me gjak e tradhti, lidhjet e tyre me okupatorin gjerman dhe rolin e tyre si xhelatë e tradhtarë të popullit. 4 shkurti qe prelud i çlirimit të Tiranës.

Si sot 80 vjet më parë, nën drejtimin e pushtuesve nazistë gjermanë, forcat e xhandarmërisë dhe policisë sekrete të qeverisë kuislinge të Rexhep Mitrovicës, të regjimentit mercenar "Kosovar" dhe ballisto-zogistëve kryen mbi popullin e Tiranës, krimin më të madh dhe më çnjerëzor që njeh historia e LANÇ-it, ku me egërsi çnjerëzore në natën e 4 shkurtit rrëmbyen nga gjiri i familjeve mbi 500 të rinj patriotë, ku nga këta, 84 shqiptarë u pushkatuan në rrugët e sheshet e Tiranës. Atë natë, Tirana u la me gjakun e bijve të saj të pavdekshëm, që ne sot i përkujtojmë me dhimbje dhe respekt të lartë.

Nga dokumentet arkivale, nga kujtimet e shumë veteranëve që përjetuan këto ngjarje, nga tregimet e disa pjesëtarëve të familjeve të kësaj masakre si dhe nga deponimet e bëra nga disa ish-kryepleq të lagjeve të Tiranës që u morën me forcë në bastisjen e shumë familjeve dhe arrestimin e shumë viktimave, rezultojnë se për këtë masakër çnjerëzore, nazistët-kuislingë-ballistë që më parë kishin hartuar një skenar në një takim që ishte bërë, më 16 janar 1944, në zyrën e ish-kryeministrit të qeverisë kuislinge Rexhep Mitrovicës, ku në të kishin marrë pjesë vetë kryeministri Xhafer Deva, ish-ministër i Brendshëm, Hysni Derna komandant i Përgjithshëm i Xhandarmërisë, Kadri Cakrani komandant i forcave të Ballit Kombëtar, Qazim Mulleti ish-prefekt i Tiranës dhe një oficer i Gestapos gjermane. Objektivi kryesor që synonte të realizonte në këtë operacion terrorist ishte që t'i jepet një goditje e rëndë asgjësuese organizatës së Partisë Komuniste dhe të Frontit Nacionalçlirimtar të Tiranës. Kjo do të bëhej si kundërpërgjigje që pësuan forcat ushtarake gjermane dhe bashkëpunëtorët e tyre gjatë operacionit që bënë në muajt nëntor 1943 - janar 1944 kundër ushtrisë nacionalçlirimtare. Të arrestoheshin dhe të pushkatoheshin personat që përfshiheshin në listat e hartuara nga policia sekrete, në to figuronin në radhë të parë emrat e drejtuesve të qarkorit të P. K. të Tiranës me në krye Gogo Nushin e komunistë të tjerë aktivistë të rinisë komuniste dhe të Frontit Nacionalçlirimtar, të gruas antifashiste, nacionaliste, patriotë dhe pjesëtarë të njësive guerile. Të zbuloheshin dhe të asgjësoheshin të gjitha bazat ilegale të LANÇ-it, ku ishte teknika e Partisë, ku ishin strehuar ilegalë, partizanë të plagosur dhe të sëmurë dhe këta të arrestoheshin, të pushkatoheshin. Të gjithë personat e dyshimtë të arrestoheshin dhe të burgoseshin në burgun e Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë (ish-gjimnazi i Tiranës).

Operacioni do të mbahej shumë sekret dhe do të fillonte në orët e pasdites së 3 shkurtit 1944, dhe do të përfundonte në orën 5 të mëngjesit të datës 4 shkurt 1944. Ky operacion do të drejtohej nga Xhafer Deva dhe Kadri Cakrani. Në këtë operacion terrorist, forcat e Gestapos gjermane nuk do të merrnin pjesë, pasi në një dokument të Komandës së Përgjithshme të Korpmatës së 21-të gjermane, thuhej: "Grupet nacionaliste sot natën do të ndërmarrin një kundër-reaksion. Të gjithë pjesëtarët e trupës gjermane në postat e shërbimit të qëndrojnë jashtë kësaj grindjeje". Ky ishte një mashtrim, që synonte t'i paraqiste forcat gjermane të ardhur në Shqipëri jo si pushtuese, por si kalimtare, si nevojë e sigurimit të krahëve të forcave gjermane në jug të Ballkanit dhe të sigurimit të rrugëkalimit të këtyre forcave për në veri të Evropës. Por më vonë, në dokumentet gjermane të zbuluara vërtetohet se në krye të drejtimit të këtij aksioni ka qenë oficeri i Gestapos gjermane, Haufmanlangen, përfaqësues personal i Hitlerit në Shqipëri. Nga qeveria demokratike e Shqipërisë, në vitin 1945, i është kërkuar shteteve të mëdha të koalicionit antifashist Angli-SHBA-BRSS, që ky person të gjendej dhe të gjykohej për krime lufte.

Forcat që do të merrnin pjesë në këtë operacion përbëheshin nga xhandarmëria dhe policia sekrete kuislinge, nga forcat e regjimentit mercenar "Kosovar", që kishin ardhur në Shqipëri për ta shpëtuar atë nga regjimi komunist dhe nga forcat e armatosura të Ballit Kombëtar. Ata vepruan të organizuar në grupe me nga 10-15 veta dhe në drejtime të caktuara. Në krye të tyre ishin agjentët e Gestapos, Qazim Mulleti, Osman Kukaleshi, Xhelal Staravecka, Seit Matja dhe drejtues kryesor të organizatës së Ballit Kombëtar të Tiranës, Halim Begeja, Halil Mëniku, Seit Demneri, Arif Merepeza, Osman Kazazi, Zige Hatipi dhe të tjerë. Sipas skenarit operacioni filloi në orët e pasdites së 3 shkurtit 1944 dhe kjo vërtetohet edhe nga njoftimi i bërë nga ATSH, ku thuhej: "Në orët e para të kësaj dite, disa grupe terroriste kanë tentuar të bëjnë atentat kundër qeverisë, personaliteteve të larta shqiptare, kundër Xhafer Devës, Kadri Cakranit dhe kanë sulmuar automobilat e tyre me bomba dhe revolver". Në këto përpjekje u vranë disa atentatorë. Duke marrë shkas nga këto atentate të inskenuara, Xhelal Staravecka dhe Kadri Cakrani, me agjentët e tyre në Tiranën e Re, arrestuan qytetarë të pafajshëm, të cilët ishin duke shkuar nga puna në shtëpitë e tyre dhe i pushkatuan. Këta ishin Todi Shkurti, Vangjel Kapo, Hasan Çeliku dhe Jani Koçi. Ketë krim e justifikuan se gjoja ata paskan varrë një tregtar, të quajtur Fahri Osmani dhe kishin plagosur disa qytetarë të tjerë. Fill pas kësaj ngjarjeje, qindra forca të xhandarmërisë, të policisë dhe të regjimentit mercenar "Kosovar", të armatosur gjer në dhëmbë, vendosën patrulla nëpër rrugët e Tiranës, dhe nga kjo kohë u vendos ndalim-qarkullimi. Duke filluar nga ora 2:00 e natës dhe deri në mëngjesin e ditës së 4 shkurtit, bastisën qindra shtëpi, u arrestuan mbi 500 qytetarë,



prej të cilëve 84 u pushkatuan. Shumica e të pushkatuarve ishin antifashistë, aktivistë të Frontit Nacionalçlirimtar, të rinj komunistë dhe disa ishin punëtorë që dolën të shkonin në punë në mëngjes herët. Nga të pushkatuarit pati dhe me kombësi italiane, si dhe 4 të burgosur malazezë, që me gjakun e tyre lagën sheshet dhe rrugët e Tiranës. Kështu ndodhi nata e Shën Bartolomeut shqiptar, ku Tirana u gjakos por nuk u mposht. Në mëngjesin e 4 shkurtit 1944, kufoma të vrarësh, të mbytura me gjak, ishin kudo nëpër rrugët dhe sheshet e Tiranës, kështu: Para Sahatit dhe Xhamisë ishin 12 punëtorë të pushkatuar, nga këta, 4 ishin punëtorë italianë. Në fund të Bulevardit, afër maternitetit ishin 4 malazezë të pushkatuar, ish-të burgosur politikë të nxjerrë nga burgu. Në rrugën e Pishës ishin 3 të pushkatuar. Para Xhamisë në rrugën e Kavajës ishin 3 të pushkatuar. Në rrugën e Shën Gjergjit ishin 7 të pushkatuar.

Shumë viktime të vrarë, u ishin prerë gishtat e duarve dhe u ishin rrëmbyer unazat dhe dhëmbët e florinjët. Kufomat e të pushkatuarve qëndruan deri në orën 10.00, pastaj me makina xhandarmëria i dërgoi ato në morgun e spitalit. Nga dokumentet arkivale rezulton se nga 84 të pushkatuarit janë identifikuar vetëm 29 viktime dhe këta ishin Ramiz Treni dhe Sitki Qigo, antifashistë, të dy profesorë në gjimnazin e Tiranës, Xhemal Sojli, Harito Harito dhe dr. Stefan Pano antifashistë dhe aktivistë të Frontit Nacionalçlirimtar, Fadil Rada, vëllezërit Maliq dhe Haki Huta, Sulejman Vrapit, Gjergj Legisi, Islam Alla, Fiqiri Gerblleshi dhe Ali Visha (trupit i të cilëve u gjet në lumin e Tiranës), aktivistë të rinisë komuniste dhe pjesëmarrës të njësiteve guerile; Vingenca Apoli dhe raxhioner Ravesi të dy antifashistë italianë, Gjergj Marangozi, antifashist malazez, David Kohe, çifut, Mina Thome, nga Vlora, i marrë nga hotel Parku, Vangjel Capo, Vasil Muzina, Petro Pifti, Sokrat Tako, Mihal Kogo, Dhimitër Torna, Emrullah Korja, Todi Shkurti, Osman Boriqi, Kurt Uka, Lake Kolonja e Hasan Çeliku, punëtor.

Ja ç' tregon Havaja, nëna e Fadil Radës, për natën e 4 shkurtit 1944: "Isha vetëm në shtëpi me djalin e vogël, Fadilin, se dy djemtë e tjerë, Ademi dhe Isufi, ishin partizanë. Në orën 20-00 të

natës, xhelatët e armatosur thyen derën dhe më morën Fadilin. U ngjita pas djalit tim, por katilët më shtynë dhe më shkëputën nga ai. 'Lidheni qenin!', bërtisnin Qazim Mulleti dhe Osman Kazazi dhe mua më përplasën në fund të oborrit, ku dëgjova për herë të fundit Zërin e Djalit tim të shtrenjtë duke më thënë: 'Nënë, shko në shtëpi', për dy ditë radhazi nëna me bukë në gji, kërkova nëpër Tiranë, që të gjeja djalin dhe t'i jepja për të ngrënë, por nuk e gjeta. Ah, unë e zeza! Pas dy ditësh shokët e tij ma sjellin trupin që e kishin gjetur në një gropë jashtë Tiranës, në rrugën e Elbasanit. Por mane zeza nuk e njohu Dilin, se e kishin copëtuar xhelatët. Qava dhe lotët për të s' mu thanë kurrë". (Marrë nga gazeta "Bashkimi" e datës 4 shkurt 1945). Kjo mëmë trime tiranase ka qenë e arrestuar nga kuestura në vitin 1943, kur u vra Xhorxhi Martini, të cilin e kishte strehuar të plagosur në shtëpinë e saj. Ndërsa trupat e dy vëllezërve, Maliq dhe Haki Huta, aktivistë të rinisë komuniste dhe të Frontit Nacionalçlirimtar, nuk janë gjetur, edhe sot e kësaj dite nuk dihet ku janë varrosur. Në një bisedë që kam bërë me vëllain e tyre për nënën, Mehmet Shkëmbi, kam mësuar se ai ka qenë së bashku me vëllezërit e tyre në shtëpi natën e 4 shkurtit 1944, kur ata u arrestuan. Ai tregon: "Ishte ora 3 pas mesnatës, ku mbi dhjetë xhandarë me në krye Osman Kazazin dhe një farë kapter Selimi, goditën portën me qytat e pushkëve dhe me të thirrura kërkonin që ta hapnim derën. Në shtëpi ishin baba, nëna, dy motrat dhe tre vëllezërit. Shtëpia dhe rruga e Kazanëve ishte e rrethuar nga forcat e xhandarmërisë dhe ne nuk kishim mundësi të dilnim nga rrethimi. Në fillim hezitua ta hapnim portën, por pasi dëgjua edhe zërin e ish-kryeplakut të lagjes, Xhemal Zela, e hapëm. Me një egërsi shtazore ata hynë në shtëpi dhe na arrestuan të tre ne vëllezërve, na lidhën duart dhe i thanë babës se do të na çonin te Xhaferr Deva.

Masakrat ndaj këtij populli që luftoi pa u trembur përballë 'shpurave fashiste', janë dhe do të mbeten pikë referimi për brezat, të cilët duhet të mësojnë se çdo pëllëmbë toke e atdheut tonë është larë me gjakun e djemve dhe vajzave të cilët nuk kursyen 'të ritë' e tyre para dorës vrastare.

Referuar historianit Doc. Kadri DINGU

17 janar, dita e përjetësisë së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti, Skënderbeu

Më 17 janar 1468, u nda nga jeta hero i ynë kombëtar Gjergj Kastrioti, Skënderbeu. Ai është Heroi Kombëtar dhe figura më e shquar në historinë e shqiptarëve. Gjergj Kastrioti e kaloi jetën në fushë-betejë ballë për ballë me fuqinë më të madhe të kohës dhe me sukses mbrojtë territoret arbërore. Për një periudhë kohore prej 25 vjetësh, Kastrioti zhvilloi rreth 30 luftëra të ashpra në Arbëri dhe ushtria e tij arriti fitore të bindshme kundër forcave osmane...

...Skënderbeu sintetizon një epokë të tërë historike që mori emrin e tij: luftën njëshekullore kundër pushtimit osman. Ai u lind më 6 maj të vitit 1405 dhe vdiq më 17 janar të vitit 1468.

Gjergj Kastrioti ishte djali më i vogël i Gjon Kastriotit dhe i princeshës Vojsava, fëmija i fundit mes 4 djemve dhe 5 vajzave. Në moshën 9-vjeçare u dërgua në oborrin e Sulltanit në Adrianopojë. Natyra i kishte dhënë dhunti mendore e fizike. Zgjuarsia dhe shkathtësia e çuan në shkollën e icoçllanëve, që përgatiste komandantë e nëpunës. Atje mori emrin “Iskënder” i barasvlershëm me emrin Aleksandër. Pas mbarimit të shkollës, Gjergj Kastrioti kreu detyra ushtarake në Ballkan e në Azinë e Vogël, duke u dalluar për trimëri dhe për këtë arsye iu dha titulli “bej”. Emri “Skënderbej” në turqisht do të thoshte “Princi Aleksandër”. Me vdekjen e të atit, ai shpresonte t’i zinte vendin, por në fakt sulltani e emëroi sanxhakbej jashtë tokave shqiptare. Skënderbeu nuk hoqi dorë nga ideja për t’u kthyer në Shqipëri.

Më 3 nëntor 1443, në afërsi të Nishit, u ndeshën ushtria osmane dhe ajo hungareze e drejtuar nga Janush Huniadi. Ushtria osmane u shpartallua dhe u tërhoq në panik. Skënderbeu nisi planin e kryengritjes, së bashku me 300 kalorës shqiptarë e me të nipin, Hamza Kastrioti, u kthye në Dibër. Populli e priti si çlirimtar. Mori masa për përforcimin e rrugëve nga mund të vinin osmanët, dhe prej andej iu drejtua Krujës. Me një ferman të rremë shtiu në dorë qytetin e garnizonin dhe kështu, më 28 nëntor 1443, u shpall rimëkëmbja e principatës së Kastriotëve. Mbi kështjellën e Krujës u ngrit flamuri me shkabën e zezë dykrenore. Fjalimi i Skënderbeut nxiti frymën atdhedashëse. Kryengritja çlirimtare u bë e përgjithshme. Gjatë dhjetorit, Shqipëria e Mesme dhe e Veriut u spastruan nga forcat osmane. Skënderbeu ishte organizatori i Kuvendit të Arbrit, në të cilin u zgjodh si prijës i Lidhjes Shqiptare

të Lezhës. Ai u martua me të bijën e Gjergj Arianitit për të forcuar lidhjet e tij me principatat e tjera.

Nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit, lufta e shqiptarëve u ngrit në një shkallë më të lartë e më të organizuar dhe shënoi një kthesë vendimtare në zhvillimin politik të Shqipërisë. Skënderbeu zhvilloi luftë mbrojtëse, dhe për 25 vjet, mes viteve 1443-1468, ushtria e tij prej 10 000 anëtarësh luftoi e fitoi kundër forcave osmane, me një ushtri disa herë më e madhe se ajo shqiptare. Në vitin 1451, nënshkroi një traktat me Alfonsin e Napolit për të siguruar një aleancë mbrojtëse, edhe pse ai mbeti një sundimtar de facto i pavarur. Në vitet 1460-61, ai mori pjesë në luftërat civile të Italisë në mbështetje të Ferdinandit I të Napolit. Në vitin 1463, ai u bë komandanti kryesor i forcave kryqtare të papa Piu II, por papa vdiq, ndërsa ushtritë ende po mblidheshin. Së bashku me venedikasit ai luftoi kundër osmanëve gjatë Luftës osmano-venedikase të viteve 1463-79. Aftësitë ushtarake të Skënderbeut përbënin një pengesë të madhe për zgjerimin osman. Ai u konsiderua nga shumë njerëz në Evropën Perëndimore si një model i rezistencës.

Gjergj Kastrioti ishte përfaqësuesi më konsekuent dhe më i shquar i elitës drejtuese shqiptare, që udhëhoqi më vendosmëri frontin e luftës së shqiptarëve kundër pushtuesve osmanë. Ai realizoi të parin bashkim të shqiptarëve, Lidhjen Shqiptare të Lezhës, e cila hapi rrugën e krijimit të shtetit të pavarur shqiptar, themeluesi i të cilit u bë ai vetë. Kujdes të veçantë Skënderbeu i kushtoi ruajtjes së burimeve të brendshme ekonomike, tek të cilat u mbështet lufta. Duke fuqizuar mbrojtjen në brezin kufitar, në lindje e në jug, ai i dha mundësi banorëve të viseve të lira të zhvillonin një veprimtari ekonomike deri diku normale. Krahas mbrojtjes së vendit, Skënderbeu i kushtoi vëmendje çlirimit të viseve të pushtuara që ndikoi në formimin e mëtejshëm të lidhjeve me banorët e këtyre viseve dhe në forcimin e bashkimit të gjithë popullit shqiptar. Aftësitë e Skënderbeut si burrë shteti spikatën edhe në marrëdhëniet me vendet e tjera. Duke pasur të qartë se rrezikut osman mund t’i bëhej ballë vetëm me sukses vetëm me forca të bashkuara, Skënderbeu kërkoi pareshtur pjesëmarrjen e vendeve evropiane në luftë kundër armikut të përbashkët. Në kushtet e pabarazisë së theksuar ndërmjet forcave osmane dhe atyre shqiptare, Skënderbeu përpunoi strategjinë dhe taktikën e



tij luftarake, në bazë të së cilës qëndronte mendimi se fitorja nuk mund të varej nga numri i ushtarëve. Ai mbante armikun në alarm të përhershëm, i priste rrugën e fuqizimet dhe, pasi e kishte futur në kurth, e godiste me sulme të fuqishme e të befasishme.

Skënderbeu u shndërrua në simbol të luftës për liri e pavarësi, duke mbetur një figurë e dashur për shqiptarët edhe pas vdekjes së tij. Kujtimi i tij mbeti i gjallë nëpër këngët, gojëdhënat e tregimet e shumta popullore që i dhanë atij tiparet e një figure legjendare. Vepra dhe figura e Skënderbeut kishte përmasa dhe rëndësi evropiane. Ai u vlerësua lart nga personalitetet e shquara evropiane të kohës. Këtë e dëshmon edhe fakti se për Skënderbeun është shkruar një literaturë e shumëllojshme, prej qindra vëllimesh, të botuara në shumë gjuhë, kudo në botë.

Vdekja

Në janar të vitit 1468, Skënderbeu u sëmur gjatë zhvillimit të një Kuvendi të thirrur nga ai, në të cilin ishin të ftuar të gjithë princat shqiptarë. Vdiq më 17 Janar 1468, në Lezhë. I mbuluar me lavdi, u varros në Katedralen e Shën Kollit në Lezhë, po në atë vend ku u mbajt Kuvendi i Lezhës. Shqiptarët humbën prijësin e lavdishëm

që i udhëhoqi për 25 vjet rresht. E shoqja me të birin emigruan në Itali, sikurse edhe një pjesë e parisë shqiptare.

Epoka e Skënderbeut e shekullit XV dhe vetë figura e Gjergj Kastriotit ndikoi fuqishëm në jetën shpirtërore të shqiptarëve dhe për rritjen e vetëdijes kombëtare të tyre. Të frymëzuar prej tyre, intelektualë të shquar shqiptarë, i pasqyruan ato në vepra historike, në të cilat nisi jetën e vet historiografia shqiptare. Ishte Dhimitër Frangu që shkroi i pari jetën e Skënderbeut, realisht si u zhvillua, sepse Frangu ishte bashkëshoqërues i gjithë jetës dhe luftërave të Skënderbeut. Të gjithë shkrimtarët pasardhës, u mbështeten mbi veprën e Frangut, edhe vetë Barleti. Patjetër se vepra e Barletit që u botua latinisht në vitin 1504, kushtuar luftës heroike të shqiptarëve për mbrojtjen e Shkodrës, pati jehonë të madhe. Por vepra që e lartësoi figurën e tij si historian humanist është “Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut”, të cilën e botoi italisht në Romë rreth viteve 1508-1510. Një vepër tjetër e rëndësishme për të njohur shoqërinë shqiptare të shek. XV është “Historia dhe gjenealogjia e shtëpisë së Muzakajve”, shkruar në italisht, më 1510, nga bashkëluftëtari i Skënderbeut, Gjon Muzaka.

11 janar 1946, Shqipëria shpallet Republikë

Më 11 janar të vitit 1946, vetëm 14 muaj pas ardhjes së komunistëve në pushtet, Enver Hoxha dhe pasuesit e tij, me anë të një asambleje të përbërë nga 82 deputetë të dalë nga zgjedhjet e 2 dhjetorit të vitit 1945, të mbledhur në sallën e Shtëpisë së Arteve (aty ku sot është godina e Akademisë së Arteve në Tiranë), ndryshuan formën e regjimit, duke e shpallur Shqipërinë Republikë Popullore, nga Monarki që ishte që prej vitit 1928.

Po cilat ishin procedurat që u përdorën nga qeveria komuniste e Enver Hoxhës, plot 73 vite më parë, për të ndryshuar formën e regjimit në Shqipëri nga Monarki në Republikë?

Ku u mbledh Asambleja e quajtur si Kushtetontjëse, cilët ishin eksponentët kryesorë në grupin prej 82 deputetësh që e formuan atë dhe çfarë u tha në fjalimet që ata mbajtën për paraardhësit e tyre në regjimet e kaluara?

Cilët ishin përfaqësuesit dhe gazetarët e huaj që asistuan në mbledhjen e asamblesë, ku u proklamua shpallja e Shqipërisë si Republikë Popullore dhe çfarë tha në fjalën e tij Kryeministri, gjeneral-kolonel Enver Hoxha?

Cili ishte reagimi i Mbretit Zog nga Anglia dhe çfarë thuhet në deklaratën e tij për gazetarët e huaj vetëm një ditë pas asaj ngjarjeje që u festua me bujë të madhe nga regjimi komunist i Tiranës me manifestime të mëdha në të gjithë vendin?

Formimi i Asamblesë Kushtetuese më 10 janar

Shpallja e Shqipërisë Republikë Popullore, më 11 janar të vitit 1946, u përcoll me bujë dhe vëmendje të veçantë nga propaganda e regjimit komunist të Tiranës, e cila nëpërmjet Radio-Tiranës dhe gazetës “Bashkimi”, i bëri një jehonë të madhe asaj ngjarjeje. Nën titullin e madh: “Sot, ora 10, çelet Asamblea Kushtetontjëse” dhe nëntitujt korsivë: “Ajo do t’i japë popullit shqiptar Statutin Themeltar-Frut i luftës së përgjakëshme dhe i punës së tij të palodhur”, në gazetën “Bashkimi” të datës 10 janar 1946, ndërmjet të tjerash shkruhej: “Sot më 10 Janar, ora 10, çelet Asamblea Kushtetontjëse, në sallën e Theatrit të ri që është në Shtëpinë e Arteve në Sheshin ‘Qemal Stafa’. Ata që do të hyjnë në sallë kanë ftesa të posaçme. Populli do të dëgjojë çvillimin e seancave nga altoporlantët ose me anë të radios. Pas pesë vjet lufte të pashembullt dhe pas një viti e 44 ditë, që kur në truallin tonë nuk mbeti më këmbë shkelësi, pas një viti e 44 ditë fitoresh të mbledha, erdhi më së fundi edhe data e 10 Janarit, dita që përfaqësonjësit e popullit mblihen në Asamblenë Kushtetontjëse. Këtë ditë të shënuar për historinë t’onë, populli ynë e kremton me një gëzim të patreguar se në Asamblenë e tij, që është e para Asamble me të vërtetë e tij, ay pret sanksionimin me ligj për ato që ay fitoi me gjak. 2 Dhjetori ishte për popullin t’onë një festë e madhe. Atë ditë populli ynë i lirë zgjodhi të 82 përfaqësonjësit e tij që sot mblihen në Asamble. Po dita e sotme është një festë akoma më e madhe, sepse Asamblea do të konsakrojë solemnisht frytet e



luftës së përgjakëshme dhe të punës së palodhur të popullit tonë me Statutin Themeltar; është akoma më e madhe sepse kjo është e para Asamble e popullit. Asamblea e fshatarëve, punëtorëve dhe KUSHTETONJËSE. Aty punëtorët akoma janë duke ndrequr diçka, akoma teknikët diçka zbukurojnë. Që në hyrje duken ekspozitat e ndryshme të Ministrive të ndryshme, midis të cilave çquhen ajo e Ministrisë së Bujqësisë, sepse mu në derë qëndron një bujk i pikturuar, që ka këputur zinxhirët e feudalizmit dhe që mban në dorë tapinë e tokës së tij që ia dha pushteti i tij. Me të hyrë në sallën ku sot mblihen asamblistët, të bije menjëherë në sy parulla e madhe që qëndron në krye të skenës me: ‘Rroftë Asamblea Kushtetontjëse’, nga e djathta është parulla ‘Rroftë pushteti popullor i punëtorëve, fshatarëve dhe intelektualëve’, nga e mëngjra parulla ‘Rroftë Ushtria Kombëtare mburoja e Shqipërisë së Re’. Janë 82 vende të ndara në dhjetë grupe-grupe të asamblistëve të çdo prefekturë dhe çdo vënt ka mbi tryezë emrin e përfaqësonjësit që është caktuar të rrijë. Në krye të tribunës janë dy seri vendesh. Përkundraill këtyre vendeve qëndron kjo parrullë: ‘Asamblistë! Populli u besoi vullnetin e tij. Mbetet tek ju të bëni detyrën ndaj tij. I siguroni popullit me Kushtetutën, një jetë më të lumtur. Dhe fitoret e luftës e të rindërtimit le të bëhen mbështetje për fitore të reja...’

E premte, 11 janar, hapja e seancës së parë të Asamblesë

Seanca e parë e Asamblesë Kushtetuese u hap nga Dr. Omer Nishani, kryetar i Këshillit Antifashist, i cili pas një fjale të shkurtër, ftoi deputetin e Korçës, Dr. Petraq Popa, si përfaqësuesin më të vjetër në moshë që të kryesonte përkohësisht mbledhjen. Pas fjalës së tij, u zgjodhën tre sekretarë të përkohshëm. Lidhur me këtë seancë, në mes të tjerash në shtypin e asaj dite, shkruhet: “U zgjodhën tre sekretarë të përkohshëm. Përfaqësonjësit e popullit

dorzojnë certifikatat e zgjedhjes së tyre të lëshuara nga komisionet e qarqeve. U zgjodhën 20 veta për të vërtetuar mandatet. Dje në ora 10 paradite u bë mbledhja e parë e Asamblesë Kushtetuese. Kryesia e Këshillit Antifashist, në bazë të ligjit mi Asamblesë Kushtetuese numër 123 datë 27.IX.1945 propozoi këtë rend dite:

- Hapja e mbledhjes prej Kryetarit të Kryesisë së Këshillit Antifashist.
- Ftesa e përfaqësuesit në moshë më të madhe për të kryesuar për kohësisht mbledhjen.
- Pranimi i tre përfaqësuesve të propozuar nga Kryetari, për të kryer detyrën e sekretarit të për kohësisht.
- Dorëzimi Kryetarit të Asamblesë nga ana e përfaqësuesve të popullit të certifikatave të zgjedhjes së tyre të lëshuara nga Komisionet e Qarqeve.

• Zgjedhja nga ana e asamblesë e një komisioni prej 20 vetash për vërtetimin e mandateve dhe caktimi i kryetarit të këtij komisioni. Në seancën e mbledhjes së datës 11 janar 1945, në sallën e Akademisë së Arteve, ku ishin mbledhur asokohe Asambleja me 82 deputetët e dalë nga zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, ishin dhe përfaqësuesit e misioneve të huaja të akredituara në Tiranë. Lidhur me këtë, në gazetën “Bashkimi” të asaj dite, thuhet: “Para orës 10, të ftuarit kishin mbushur lozhat dhe galerinë. Në lozhën e parë, nga e mëngjërta në të hyrë, merrte vënt, Ministri i Jugosllavisë z. Josip Djerdj me sekretarin e Legatës; në lozhën e dytë, Gjeneral Brigadier D.E.P. Hodgson, Shef i Misionit Ushtarak Britanik në Shqipëri dhe Kolonel Sokolov Shef i Misionit Ushtarak Sovjetik në Shqipëri; në lozhën e parë nga djathta zoti Jakobs, funksionar i Departamentit të Punëve të Jashtme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me zotin Stevens; në lozhën e dytë Kolonel Teyssier, Shef i Misionit Ushtarak Francez në Shqipëri dhe përfaqësues i UNRRAS. Në lozhat e tjera ishin shumë përfaqësues dhe personalitete si dhe korrespondenti i Agjensisë TASS, i ISVESTIA-s, dhe i BORBA-s. Pikërisht në ora 10 përfaqësuesit e popullit kishin zënë vendet e tyre të caktuara. Pas dy tre minutash, Kryetari i Qeverisë Gjeneral-Kolonel Enver Hoxha ngrihet dhe shkon në tribunën e parë që është tribuna e Qeverisë. Përfaqësuesit e popullit dhe tërë të ftuarit e duartrokitën pareshtur. Pastaj tërë anëtarët e qeverisë zunë vënt në tribunën e tyre, duke patur në mes Kryetarin e Qeverisë. Pas kësaj tribune është tribuna e Kryesisë së Këshillit Antifashist ku qëndron Dr. Omer Nishani me tre nënkryetarët. Gjen. Leit. Koci Xoxe, Hasan Pulo dhe Kolonel Baba Faja. Kur të gjithë janë në vendet e tyre, Dr. Omer Nishani ngrihet dhe thotë se asamblistat kanë përpara tyre rendin e ditës, të cilin e vuri për aprovim. Asamblistët e aprovuan unanimisht”.

Përshëndetja e Dr. Omer Nishanit dhe dorëzimi i mandateve

Pastaj Dr. Omer Nishani u drejtoi Asamblistëve këtë përshëndetje: “Shokë e shoqe Asamblistë, Ju përshëndes në emër të Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar dhe ju uroj mirëseardhje. Është një nder i veçantë për mua që të përshëndes përfaqësuesit e popullit shqiptar, i cili me sakrificat e tij të mbledha, dhe me gjakun e bijëve të tij më të mirë çliroi Shqipërinë nga okupatorët fashistë dhe nga organizatat tradhtarë të vendit, nga Balli dhe Legaliteti. Dita e sotme është një ditë feste dhe gëzimi për popullin shqiptar, se sot këtu është mbledhur Asambleja Kushtetuese, e cila do të vërë themelet e institucioneve demokratike të Shqipërisë së Re. Asambleja e sotme nuk u ngjet Asambleve të kohës së kaluar, të cilat bëheshin me një sistem elektoral që s’kishte as frymë demokratike as frymë popullore.

Formula e vendimit për shpalljen e Republikës Popullore të Shqipërisë

Përpara kësaj lufte, Populli Shqiptar, për 15 vjet me radhë lëngoi nën regjimin monarkist të Ahmet Zogut. Ky regjim antipopullor, i vendosun në Vëndin t’onë kundër vullnetit të Popullit, me anën e forcës dhe bajonetës së huaj, shtypi pa mëshirë dhe çfrytëzoi në mënyrë çnjerëzore popullin shqiptar. Aspiratat e popullit shqiptar u shtypën pa mëshirë dhe politika sociale reaksionare dhe brutale e Zogut e dobësuan pa masë popullin t’onë. Regjimi i Zogut përgatiti invadimin e Shqipërisë prej Italisë fashiste, duke u bërë vegla e politikës fashiste të Musolinit. Në regjimin e Zogut, Shqipëria u bë një koloni e Italisë e cila hodhi në duart e saj të gjitha pasuritë e Shtetit Shqiptar, ekonominë e vendit, financat, pasurinë e nëntokës, Ushtrinë, e tjera. Regjimi i Zogut e izoloi Shqipërinë tërësisht nga shtetet e tjera përparimtare dhe demokratë. Një gjendje e tillë pati si rezultat katastrofën e 7 prillit 1939. Më 7 Prill 1939, Ahmet Zogu kurorëzoi tradhëtinë e tij duke lënë popullin të papërgatitur që t’i kundërshtonte me armë okupatorin dhe duke e braktisur popullin shqiptar në fatin e tij, ay iku fshehurazi jashtë kufirit. Gjatë luftës heroike Nacional-Çlirimtare të popullit shqiptar, Ahmet Zogu ka ndihmuar tradhëtorët e popullit shqiptar që në bashkëpunim



me okupatorët kanë penguar luftën kundër okupatorit dhe kanë luftuar me armë kundër popullit dhe Ushtrisë së tij Nacional-Çlirimtare. Populli Shqiptar rroku armët dhe u hodh në luftë kundër okupatorëve dhe tradhëtorëve të vendit, për të çliruar Atdheun, për të fituar lirin e popullit dhe independencën e Sovranitetin e vendit. Me luftën e tij heroike, populli ynë jo vetëm fitoi kundër okupatorëve dhe tradhëtorëve, por njëkohësisht likuidoi atë regjim që në të shkuarën e kishte shtypur pa mëshirë. Populli Shqiptar u bë zot i fateve të tij për të rregulluar gjendjen e brendshme që do të ndihmojë në zhvillimin e drejtë të së ardhmes së tij të lumtur. Sovran për fatin e tij, Populli Shqiptar me një zë dhe lirisht me anën e Asamblesë Kushtetuese që përfaqëson vullnetin e tij vendosi që:

I. Shqipëria emërohet republika popullore e Shqipërisë.

II. Me këtë vendim në emër të popullit shqiptar, hiqet përgjithmonë monarkia në Shqipëri. Ahmet Zogu dhe trashëgimtarët e tij humbasin të gjitha të drejtat që kishin pasur dhe u ndalohet për gjithmonë hyrja e tyre në Shqipëri.

Pas vendimit për shpalljen e Shqipërisë Republikë, kryetari i Asamblesë u paraqiti asamblistëve rendin e ditës, ku si pikë e parë ishte dorëheqja e qeverisë dhe e dyta, raporti i kryesisë së Këshillit Antifashist mbi veprimtarinë legjislative që nga Kongresi i Përmetit e deri në atë mbledhje të Asamblesë.

Liderët botërorë që lanë shenjë në historinë e civilizimit njerëzor

Strategjia brilante, teknika dhe mendjet logjistike kishin kontroll total të ushtrive të mëdha dhe ato ushtri u bënë fitimtare ose u mundën për shkak të aftësive të një njeriu të vetëm. Komandantët ushtarakë në listë kanë qenë komandantë në fushë, me autonomi të padiskutueshme në betejat e tyre dhe jo gjeneralë që qëndronin në karriget e tyre larg luftës. Liderë botërorë që vijnë vetëm një herë në jetë, dhe që lënë shenjë në historinë e civilizimit njerëzor.

Aleksandri i Madh

Aleksandri i Madh qëndron më lart se Napoleon Bonaparti për sa i përket pushtimeve të tij në një periudhë më të shpejtë kohore. I kurorëzuar mbret në moshën 20-vjeçare, pasi i ati i tij, Filipi, u vra, Aleksandri vendosi të pushtonte të gjithë botën e njohur. Aleksandri plotësoi dëshirën e të atit për të pushtuar Persinë në pak vite, duke rrëzuar Mbretin Dar. Duke mos qenë i kënaqur me kaq pak territor, Aleksandri marshoi drejt më shumë pushtimeve në zonat ku sot shtrihet Afganistani dhe Azia Qendrore.



Në përpjekje për t'i rënë rreth e qark botës në rrugë oqeanore, Aleksandri u përpoq të pushtonte Indinë, por u bind nga ushtarët e tij për t'u rikthyer në Babiloni ku dhe vdiq në moshën 32-vjeçare, pasi kishte pushtuar një pjesë të madhe të botës, i kishte vënë 20 qyteteve emrin e tij si dhe përhap qytetërim Helen.

Napoleon Bonaparti

Napoleoni cilësohet si gjenerali më i aftë deri më sot. Ai ka udhëhequr fushata brilante ushtarake, ka përdorur forcën e përqendruar në sulme në fushën e betejës, ka zhvilluar trupat e pavarura dhe të plota të ushtrisë (një sistem i përdorur akoma sot), ka instaluar udhëheqës kukulla, ka rekrutuar trupa nga çdo komb që mposhte, duke bërë revolucion në mënyrën e të luftuarit.

Në dekadën e parë të shekullit të 19-të ai i drejtoi ushtritë e Francës kundër çdo fuqie të madhe evropiane dhe arriti të dominonte Evropën kontinentale, nëpërmjet një sërë fitoresh historike të gjata, në beteja të tilla si ajo e Austerlitzit dhe Fridlandit.



Hannibal Barka

Kundërshtari më i tmerrshëm që Roma ka hasur, u rrit me detyrën e mposhtjes së romakëve nga babi i tij, Hasdrubali. Hannibali i la mënjane taktikat kartagjenase të superioritetit pasiv detar dhe marshoi me elefantë në alpet italiane. Hannibali e pushtoi perandorinë e fuqishme Romake nëpërmjet alpeve.

Ai mundi romakët në një sërë



betejash në Trebë dhe Traseminë. Asnjëherë nuk ka humbur personalisht në një betejë me romakët dhe e ka mbajtur ushtrinë e tij në Itali për më shumë se një dekadë pas Luftës së Dytë Kartagjenase.

Ai konsiderohet një prej strategëve më të mëdhenj ushtarakë që kanë ekzistuar. Armiqtë e tij romakë, madje adoptuan disa prej taktikave të tij për përdorimin e tyre.



Sun Tzu

Kur ju kërkoni një libër rreth taktikave ushtarake, të cilat akoma mësojnë dhe inspirojnë liderë edhe pas 2500 vitesh, bëni gjënë e duhur nëse lexoni veprën 'Arti i Luftës' nga Sun Tzu. Emri i Sun Tzu tani është i famshëm falë atij libri. Vepra brilante e Sun Tzu e trajton luftën nga ana filozofike, duke i trajtuar ato në detaje.

Libri flet për strategjinë e durimit si një nga elementët bazë për fitimin e një lufte. Libri sot është shumë popullor jo vetëm për ushtarakët, por edhe për diplomatët, trajnerët e futbollit apo CEO-t e kompanive të ndryshme. Ajo çka e bën atë një figurë interesante ushtarake është se zgjidhte gjithnjë një qasje sa më pak të përgjakshme. Sun Tzu preferonte t'i fitonte luftërat pa nisur ato akoma. Gjeniale.

Georgy Zhukov

Kjo figurë ushtarake njihet për fitoren e Europës gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Edhe pse përpjekjet sovjetike për të shtypur pushtimin nazist ishin diçka kolektive siç janë të gjithë luftërat në përgjithësi, Zhukov shihet si personi që shkatërroi makinerinë naziste të luftës. Në atë kohë, Hitleri e kishte thyer paktin e tij me Stalinin, më 22 qershor 1941, dhe Zhukov ishte tashmë një oficer i gradës së lartë. I ngarkuar nga Stalini për të mbrojtur Moskën dhe të



largonte gjermanët.

Ushtria e Kuqe nën komandën e Zhukov ndaloi avancimin e nazistëve gjermanë dhe i mposhti ata. Zhukov vazhdoi të fitonte disa beteja të mëdha kundër gjermanëve. Ushtria e Zhukov marshoi në drejtim të perëndimit deri sa arriti në kryeqytetin e Gjermanisë Naziste, Berlin në pranverën e vitit 1945.

Jul Cezari

Fushata ushtarake e Cezarit kundër galëve vazhdon të jetë në librat e shumë akademive ushtarake në botë.

Jul Cezari mori kontroll absolut të Republikës Romake dhe ushtrive të saj dhe kreu për herë të parë pushtimin romak të Britanisë. Ekspeditat ushtarake të Cezarit në çdo terren dhe në të gjitha kushtet klimaterike i detyrohet disiplinës strikte të legjionarëve të tij, admirimi dhe devocioni i të cilëve ndaj tij ishte shembull tipik i brilancës së tij taktike.

Gjithashtu ai i manovronte trupat e tij me një shpejtësi legjendare, si dhe përdorimi i sistemit me shifra që përdorte për të komunikuar me gjeneralët e tij.



Gjergj Kastrioti Skënderbeu

I lindur me emrin Gjergj Kastrioti në mbretërinë e vogël të Shqipërisë, Skënderbeu u zu rob nga sulltani osman.

Duke u rritur në radhët e ushtrisë osmane ai u rrit edhe për t'u bërë një prej gjeneralëve më të mëdhenj, duke fituar titullin 'Skënderbeu', që do të thotë Zoti Aleksandër, që e barazonte atë me heroizmat e Aleksandrit të Madh.

Por kjo nuk e pengoi të kthehej në vendin e tij, gjë që zemëroi Perandorinë Osmane, që dërgoi për 25 vjet me radhë ushtri të stërmëdha për ta pushtuar Shqipërinë, por pa sukses. Me ushtritë e tij që nuk arrinin në më shumë se 20 mijë njerëz, Skënderbeu arrinte t'i bënte ballë ushtrive dhjetë herë më shumë të trupave armike. Për mbrojtjen e Europës Perëndimore nga hordhitë osmane, Papa i dha titullin 'Kampion i Krishtit'.



Mundësit ushtarakë të Forcave të Armatosura shqiptare, afër medaljes së bronzit në Botërorin e Azerbajxhanit

Në Baku, Azerbajxhan u zhvillua Kampionati i 36-të Botëror Ushtarak i Mundjes për meshkuj dhe femra. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe ekipi shqiptar i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke përfaqësuar denjësisht vendin tonë, me trajner Major Zylfi Shehun dhe mundësit, nëntoger Oltjan Bardhi, kategoria e peshës 57 kg, stili i Lirë, rreshter Klodjan Koçi, kategoria e peshës 130 kg, stili Greko - Romak dhe Ushtar II Marjan Kola, i kategorisë së peshës 87 kg, stili Greko - Romak. Më shumë se 230 sportistë të shteteve të ndryshme të botës morën pjesë në këtë aktivitet.

Mundësit tanë zhvilluan ndeshje të forta, ku dhe arritën të futeshin në garën për medalje bronz (vendi 3 - 5). U-II Marjan Kola, pas ndeshjeve fituese,

u kualifikua më tej për t'u

ndeshur me nën kampionin

e botës dhe kampionin

e Evropës në kategorinë

87 kg, ku mundësi i ekipit

tonë U-II Marjan Kola zuri

vendin e 5-të në botë,

duke zhvilluar ndeshje të

nivelit të lartë dhe duke

marrë edhe duartrokitjet e

publikut. Gjithashtu edhe

mundësit e kategorisë 57

kg u renditën i 7-ti dhe ai

130 kg u rendit i 8-ti në

peshën e tij, çka përbën një lajm të mirë dhe premtues për të ardhmen e sportit të mundjes në Forcat e Armatosura.

Synimi i trajnerit Major Zylfi Shehu ka qenë zona e medaljeve, ai shprehet se tashmë kemi krijuar një ekip cilësor dhe premtues

për të ardhmen, objektivi kryesor për garat e ardhshme ndërkombëtare do të jetë marrja e medaljeve individuale si dhe

do të synohet edhe për rezultat ekipor. Të rinjtë dhe të rejtat që do të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura do të kenë

mundësinë që të bëhen pjesë e ekipit të sporteve ndeshës. Risi e veçante do të jetë edhe përfshirja për herë të parë e femrave

në ekipin e mundjes.

Trajneri, major Zylfi Shehu



Ismet Bellova, legjenda e mikrofonit sportiv shqiptar, profesori model i Shkollës Ushtarake “Skënderbej”

Ismet Bellova, mjeshtri i radio-kronikës dhe gazetarisë sportive, komentatori me zërin brilant që për gati gjashtë dekada përcolli në shtëpitë dhe hapësirat mbarë shqiptare emocionet e jashtëzakonshme të sportit e në veçanti futbollit. Në trashëgiminë e fondit të artë të radios shqiptare, transmetimet e klasit të lartë të Profesor Bellovës, zënë një vend të merituar, aq të vlefshme për brezat e rinj të gazetarëve sportivë. Ashtu sikundër me të drejtë vlerësohet edhe kontributi i tij i spikatur në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej” dhe Klubin Sportiv “Partizani”, në edukimin dhe përgatitjen e shumë talenteve sportive.

Ismet Bellova, legjenda e papërsëritshme e mikrofonit sportiv, mësuesi pasionant i skënderbegasve e qindra të rinjve në mbarë vendin që ishin të apasionuar e arritën rezultate në sportin shqiptar, u lind më 1 qershor të vitit 1934...Ai ishte mjeshtër i mikrofonit dhe mik i shtrenjtë për këdo që mbështetej tek ai, profesor Bellova është shprehur se “Anton Mazreku u përket atyre figurave të shquara të kulturës fizike dhe sporteve tona, që e kanë filluar jetën e tyre me sportin qysh në moshë të njomë, në fëmijëri, i kanë dhënë rininë sportit dhe e kanë mbyllur jetën e tyre po me sportin”. Dhe sikur Plutarku t’i kishte njohur këta dy viganë inteligjentë të lëvizjes tonë sportive, padyshim që do t’i kishte shtuar veprës së tij “Jetët paralele” edhe atë të këtyre dy njerëzve me aq vlera dhe aq të ngjashëm. Madje, do të shtoja se kjo ngjashmëri arrin deri tek kultura e tyre e lartë letrare. Dhe ashtu sikurse vëren i ndjeri dhe i dituri Jup Kastrati për Antonin, duke e quajtur atë një poet të vërtetë, po kaq poet në prozën e tij paraqitet në nektarin që nxjerr nga goja edhe Ismet Bellova, i cili ka ditur të qëndisë aq bukur me metafora, krahasime dhe figura letrare në të gjitha transmetimet në mikrofon apo në artikujt e pafund dhe librat që ai ka shkruar.

Profesor Ismeti, bashkoi në një, sportin me artin, duke i dhënë atij rëndësën që i jepnin grekët e vjetër pas vitit 581 para erës së re, Lojëra Olimpikë, ku veç garave sportive zhvilloheshin edhe ato muzikore. Kushdo që e ka dëgjuar, vështirë të mos jetë drithëruar nga vibrimet melodioze të zërit bellovian, vështirë të mos jetë emocionuar deri në përlojtje dhe vështirë të mos i jetë rritur adrenalina e krenarisë dhe atdhedashurisë.

“Mësues i Popullit”, “Nderi i Sportit Shqiptar”, “Urdhri Olimpik”, Urdhri i Artë “Naim Frashëri”, Urdhri “Naim Frashëri” i klasit të parë, Urdhri i Punës i klasit të parë, fitues i disa çmimeve, deri “Mirënjohja e Tiranës” etj., flasin qartë për personalitetin madhor të Ismet Bellovës. Por rruga për të mbërritur këto maja nuk ka qenë aspak e lehtë. Fillimisht, mësues në gjimnazin “Qemal Stafa” në Tiranë e më vonë, duke qenë fare i ri në moshë, caktohet kryetar i komitetit të fizkulturës dhe sporteve në Qarkun e Dibrës, ku me aftësitë dhe seriozitetin e tij u bë prekursor i mobilizimit për kalimin e mungesave dhe vështirësive të jashtëzakonshme, dhe ku ai la gjurmë të pashlyeshme. Më pas, emërohet mësues për një dekadë në shkollën e mesme të lavdishme “Skënderbej”, për të vazhduar në një tjetër shkollë “Politeknikumin 7 Nëntori”, me aq tradita edhe në sporte, ku punoi për dymbëdhjetë vjet të tjera. Kjo ka qenë dhe periudha më shkëlqimtare e gjithë karrierës së tij ose apogjeu i tij pedagogjik, pasi është ashtu sikurse vëren Artur Shopenhaueri se “sa më fisnike të jetë puna, aq më e madhe do të jetë kënaqësia”. Tani, ai kishte eksperiencën e vyer të Dibrës, të Korçës, ku kreu shërbimin ushtarak dhe Elbasanit, duke organizuar mjaft mirë punën për paraqitjen e ekipeve në spartakiadat që zhvilloheshin, por edhe atë të drejtimin të ekipit të atletikës së sport-klubit “Partizani”, ku arriti të caktohet edhe krye trajner i ekipeve të atletikës dhe që u kurorëzua me shumë e shumë rekorde dhe fitimin e kupave të kampionit. Në fillimin e viteve '60,



Ismeti, kishte fituar autoritetin e një njeriu shumë të dashur, të aftë dhe punëtori të palodhur dhe fjala e tij dëgjohej me të njëjtin respekt si nga nxënësit, ashtu dhe nga kolegët apo eprorët e asaj shkolle. Ky autoritet nuk e largonte aspak, përkundrazi, ai dinte të fitonte zemrat dhe të futej në botën e brendshme. Duke e ndjerë veten krejtësisht të shpenguar në marrëdhënie me nxënësit, njeri prej tyre tregon: “Mbaj mend se njëherë, kur nisëm të flasim për teoricienët pararendës të marksizmit, na tha se ky François-Noël Babeuf-i juaj të gjithë doktrinën babuviste, mund ta ketë ngritur mbi një kështjellë rëre, por diçka, që ju begsat duhet ta dini mirë, e ka thënë tmerrësisht saktë: “Në shoqërinë e ardhshme, personaliteti kryesor do të jetë mësuesi, jo gjenerali”. Dhe ndofta se e kishte kuptuar kështu dhe para kohe, ai ndihej i barabartë me gjeneralët që nuk mungonin asnjëherë në mjediset dhe stadiumet tona, pasi ishte me të vërtetë një gjeneral pa spalela në profesionin e tij fisnik. Sugjerimet dhe kërkesat e Bellovës, ata i merrnin përherë si të mirëqena, ndaj dhe e përkrahën atë pa rezerva si për sigurimin e bazës së nevojshme materiale, ashtu edhe për krijimin e terreneve sportive, aq sa te ne vinin e stërviteshin ekipet e para të “Partizanit” në futboll, basketboll, voleyboll, atletikë, gjimnastikë, boks etj., ku natyrisht, kishin vendin dhe rolin e tyre edhe sportistët e shumë skënderbegas”.

Ora e mësimit me Ismet Bellovën, pritej nga të gjithë me një gëzim të veçantë, pasi ajo më shumë se mësim, shndërrohej, me shpirtin e garës që ai nxiste, në spektakël, ku aktivizimi qe maksimal dhe përfitimi po ashtu. Profesori, njëkohësisht jepte shumë informacione nga kultura e tij e gjerë, deri edhe për zhvillimet dhe përparimet e sporteve në botë, pasi ai nga ana tjetër, ishte dhe komentatori zyrtar radiofonik dhe gazetari i pandarë i gazetës së mezi pritur “Sporti Popullor”. Edhe në shtëpi atë e konsiderojnë kryetar të familjes sportive, pasi nga të gjithë njihet fakti se bashkëshortja e tij Bukuroshja, kapitenia emblematike e kombëtares së basketbollit tonë, djemtë Sokoli dhe Enisi kanë studiuar në Institutin e Kulturës Fizike dhe së bashku me Edisonin, Arminin dhe me tri mbesat, pa bërë fjalë për vëllezërit e tij e më tej, janë përfaqësuar denjësisht në lloje të ndryshme sporti. Ndjeshmëria e tij dhe nostalgjia që ka për mikrofonin e bëjnë që fjalët t’i dalin me një emocion fëmijor. Kujtimet e tij rrjedhin si në një film, ku nga fjala në fjalë gjen të papritura dhe të veçanta që mund t’i glesh vetëm në arkivat e RTSH-së. Ai është një arkiv me vete, në botën e bukur të sportit, në atë botë ku njeriu përjashton politikën, mëritë, inatet dhe përqafton relaksin shpirtëror që aq shumë na mungon ne shqiptarëve të rritur mes hallesh.

REVISTA MBROJTJA

*[http://www.mbrojtja.gov.
al/index.php/publikime/
revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)*

